

# ANALIZË E SISTEMIT TË DREJTËSISË PENALE NË SHQIPËRI

RAPORT I PROGRAMIT PËR ZHVILLIMIN E NJË GJYKIMI TË  
DREJTË

**osce**

2006

© Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, 2006  
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Autore: Mari-Ann Roos, LL.M.  
Të dhënat statistikore: Ama Kraja

Përkthimi: Adriana Dervishaj, Mira Kroqi dhe Ama Kraja  
Redaktimi shkencor dhe letrar: Frank Dalton dhe Alba Jorganxhi

Kopertina: Bledi Shkalla



Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë  
Prezenca në Shqipëri  
Sheraton Tirana Hotel & Towers, Kati i I-rë  
Sheshi "Italia"  
Tiranë  
[www.osce.org/albania](http://www.osce.org/albania)

SHTËPIA BOTUESE & SHTYPSHKRONJA

**PEGI**

Lundër – Tiranë  
Tel.: 04 374 947, Fax.: 04 88 10 177  
Cel: 069 20 26 773  
E-mail: [pegi@icc-al.org](mailto:pegi@icc-al.org)  
TIRANË, SHQIPËRI

<b>Hyrje</b>	5
Përmbledhje e gjetjeve	9
Falënderime	12
Tabela e shkurtimeve	13
<b>I. Të drejtat gjatë paraburgimit</b>	15
1. Hyrje	15
1.1 Vëzhgimi i paraburgimit dhe studimi i dosjeve të prokurorisë	16
2. Vendimet për caktimin e masës së sigurisë “arrest në burg”	17
3. Mundësia për të pasur një avokat mbrojtës	22
4. Marrja në pyetje e të arrestuarit apo të ndaluarit	26
5. Keqtrajtimi fizik nga policia	28
6. Afati i shqyrtimit të vleftësimit të arrestit dhe caktimit të masës së sigurisë	29
7. Seanca për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë	33
8. Përmbajtja e vendimit; apelimi dhe revokimi	34
9. Shqyrtimi i mëtejshëm mbi ligjshmërinë e masës së sigurisë “arrest në burg”	41
10. Alternativat e paraburgimit	42
11. Afatet e paraburgimit	43
12. Pezullimi i afateve të paraburgimit	47
13. Mbarimi i afateve të paraburgimit	50
14. Hetimi paraprak dhe afatet e paraburgimit	55
14. 1 Studimi i dosjeve të prokurorisë	56
15. Komente përmbyllëse	61
REKOMANDIME	62
<b>II. E drejta për një mbrojtje efektive</b>	67
1. Hyrje	67
2. Kuadri ligjor	67
2.2 Ligji për profesionin e avokatit	70
3. Sjellja e avokatit mbrojtës	71
3. 1 Çështja “Balliu kundër Shqipërisë”	75
4. Masat disiplinore	76
5. Mbrojtja ligjore falas	79
6. Tarifat e shpërblimit të avokatëve të caktuar nga shteti	81
7. Tarifat e shpërblimit për avokatët e caktuar privatisht	84
7.1 Tarifat minimale të shpërblimit dhe Kodi Etik	90
7. 2 Publikimi i tarifave të shpërblimeve	92
8. Komente përmbyllëse	93
REKOMANDIME	94
<b>III. Studimi i dy çështjeve gjyqësore</b>	97
1. Çështja “Hakmarrja për Drejtësinë Shqiptare”	97
2. Çështja e Avokatit	105
<b>IV. Dhuna në familje dhe sistemi gjyqësor penal</b>	113
1. Hyrje	113
2. Konteksti shqiptar	117
3. Dhuna në familje dhe legjislacioni penal shqiptar	119
3. 1. Dhuna në familje si vepër penale – analizë	120

4. Ndjekja penale e çështjeve që kanë të bëjnë me dhunën në familje	124
5. Mundësitë për të kërkuar kompensim në rastin e çështjeve penale	128
6. Studimi i rasteve të dhunës në familje në gjykatat shqiptare	130
7. Vendimet gjyqësore mbi dhunën në familje	134
7. 1. Vërejtje të përgjithshme	135
7. 2. Rrethanat rënduese dhe lehtësuese	135
8. Analizë e mëtejshme të vendimeve që kanë të bëjnë me dhunën në familje	142
9. Projektligji për dhunën në familje	144
10. Komente përmbyllëse dhe perspektiva	145
REKOMANDIME	146
<b>V. Transparenca dhe e drejta e informimit</b>	149
1. Hyrja dhe kuadri ligjor	149
2. Realiteti shqiptar	155
3. Vërejtje përfundimtare	163
REKOMANDIME	164
<b>VI. Korrupsioni brenda sistemit shqiptar të drejtësisë</b>	167
1. Korrupsioni si vepër penale	167
2. Perceptimi i korrupsionit në Shqipëri	168
3. Korrupsioni brenda sistemit shqiptar të drejtësisë	169
4. Përpjekjet për t'u ballafaquar me korrupsionin brenda sistemit të drejtësisë	174
5. “Një mjedis i favorshëm për korrupsionin”	175
6. Vërejtje përfundimtare	176
REKOMANDIME	177
<b>VII. Gjykime efikase dhe çështje lidhur me dëshmitarët</b>	179
1. Gjykime efikase	179
1.1. Shkaqet	181
1.2. Rrugëzgjdhjet	181
1.3. Hetimi paraprak	187
REKOMANDIME	189
2. Mbi integritetin e dëshmitarëve dhe çështje të tjera lidhur me të	191
REKOMANDIME	202
Paraburgimi; Shtojca 1	205
Paraburgimi; Shtojca 2	204
Paraburgimi; Shtojca 3	208
Paraburgimi; Shtojca 4	211
Paraburgimi; Shtojca 4	217
Paraburgimi; Shtojca 5	218
Paraburgimi; Shtojca 5	219
E drejta për një mbrojtje efektive; Shtojca 1	220
E drejta për një mbrojtje efektive; Shtojca 2	221
E drejta për një mbrojtje efektive; Shtojca 3	224
E drejta për një mbrojtje efektive; Shtojca 4	227
Dhuna në familje; Shtojca 1	230
Dhuna në familje; Shtojca 2	242

## Hyrje

Duke pranuar që e drejta për një gjykim të drejtë është thelbësore, shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së janë angazhuar të lejojnë vëzhgues kombëtar dhe ndërkombëtar të vëzhgojnë proceset gjyqësore.<sup>1</sup> Eksperiencia e misioneve të tjera të OSBE-së, p.sh., Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe Bosnje dhe Hercegovinë, tregojnë gjithashtu se monitorimi i proceseve gjyqësore dhe analiza e sistemit gjyqësor janë mënyra efikase për të përmirësuar sistemin gjyqësor në vendet në tranzicion. Megjithatë askush nuk dëshiron të kritikohet, monitorimi i proceseve gjyqësore është shpesh i mirëpritur si nga palët ashtu dhe nga gjykatat. Arsyeja për këtë është se monitorimi ka një ndikim të drejtpërdrejt në transparencën e procedimeve dhe mund të shërbejë si mbrojtje nga keqadministrimi i drejtësisë. Këto përfundime mund të përdoren gjithashtu nga gjykatat në diskutimet lidhur me buxhetin me përfaqësuesit e qeverisë kur ata kërkojnë përmirësimin e kushteve. Së fundmi, meqë cilësia e sistemit të drejtësisë është një nga etapat e reformës në bisedime me organizmat ndërkombëtare, si Bashkimi Evropian, qeveritë mund t'i referohen këtyre përfundimeve në raportet e monitorimit të proceseve gjyqësore për të treguar arritjet si dhe hapat konkretë që duhen marrë për të përmirësuar sistemin e drejtësisë. Kjo mënyrë argumentimi mbështetet nga Komiteti Kombëtar mbi Politikën Amerikane në Projektin e tij për Parandalimin e të Shteteve të Dështuara, Shqipëri. Në Raportin e publikuar në maj të vitit 2005, Projekti rekomandon se donatorët ndërkombëtarë të mbështesin një sistem monitorimi ligjor (si p.sh., nëpërmjet OSBE-së)...<sup>2</sup>

Në mbështetje të mandatit të saj, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri jep ndihmë dhe ekspertizë për autoritetet shqiptare dhe përfaqësuesit e grupeve të shoqërisë civile, duke u përqendruar veçanërisht, ndër të tjera, në reformën gjyqësore dhe legjislative. Për të përmbushur mandatin dhe në bazë të një analize të institucioneve ligjore dhe kuadrit legjislativ,<sup>3</sup> Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, midis programeve të tjera, krijoi dhe filloi në vitin 2003 Programin për Zhvillimin e një Gjykimi të Drejtë (PZhGjD). Në bazë të vëzhgimeve të mënyrës së funksionimit de facto të sistemit ligjor, PZhGjD analizon si të drejtën materiale, ashtu edhe legjislacionin procedural që formon sistemin e drejtësisë në Shqipëri. Analiza, me rekomandime të veçanta për përmirësimin e sistemit gjyqësor, janë botuar në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe.<sup>4</sup> Qëllimi i projektit është të rrisë transparencën dhe standardet e procesit gjyqësor brenda sistemit të drejtësisë, si edhe të përmirësojë respektimin e shtetit të së drejtës në përgjithësi, dhe të drejtave të njeriut në veçanti.

Analiza e parë, Raporti i periudhës tetor 2003 - korrik 2004 i Programit për Zhvillimin e një Gjykimi të Drejtë, u botua në shkurt të vitit 2005 dhe përfshinte periudhën nga tetori i vitit 2003 deri në korrik të vitit 2004. Raporti në fjalë përqendrohej kryesisht në

<sup>1</sup> Shih <http://www.osce.org/odihr/13473.html> [vizituar më 3 gusht 2006].

<sup>2</sup> <http://www.ncafp.org/projects/failedstates.htm> [vizituar më 18 korrik 2006].

<sup>3</sup> Shih Analizën e sistemit ligjor në Shqipëri, OSBE, Prezenca në Shqipëri, 2004; [http://www.osce.org/documents/pia/2004/02/2117\\_sq.pdf](http://www.osce.org/documents/pia/2004/02/2117_sq.pdf) [vizituar më 18 korrik 2006].

<sup>4</sup> [http://www.osce.org/documents/pia/2004/09/4280\\_sq.pdf](http://www.osce.org/documents/pia/2004/09/4280_sq.pdf) [vizituar më 18 korrik 2006].

Gjykatën e Rrethit Tiranë (GjRrT) dhe Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda (GjKR), e cila duke marrë parasysh sugjerimet e komunitetit ndërkombëtar për të luftuar krimin e organizuar, u përrua në janar të vitit 2004. Në raport përmendëj, ndër të tjera, se gjykatat kanë shumë probleme logjistike që shpesh pengojnë procedimet. Më pas, vërehej se e drejta për një gjykim publik jo gjithmonë respektohet në Gjykatën e Rrethit Tiranë ku proceset gjyqësore zhvillohen shpesh në zyrat e gjyqtarëve. Probleme të tjera të konstatuara janë që proceset gjyqësore shpesh janë vonuar për periudha të zgjatura kohe, ato shpesh zhvillohen në mungesë të të pandehurve ose si gjykime të shkurtuara, nuk janë marrë masa për të mbrojtur dëshmitarët nga presionet ose kërcënimet, nuk ka sistem të unifikuar për ndarjen e çështjeve dhe, si përfundim, vendimet shpesh nuk pasqyrojnë se ku është mbështetur gjykata për nxjerrjen e përfundimeve.

Megjithëse shumë probleme të pasqyruara në Raportin e periudhës tetor 2003 - korrik 2004, ende pengojnë sistemin shqiptar të drejtësisë, vitin e kaluar dhe gjashtëmujorin e parë të këtij viti janë vërejtur disa përmirësime. Pas qëndrimit në mjediset e përshtatura të Gjykatës së Rrethit Tiranë, në shtator 2005, GjKR-ja u shpërngul në ambientet e saj të përkohshme.<sup>5</sup> Në godinën e re të gjykatës është një ambient i veçantë për dëshmitarët. Gjykata është pajisur me kompjutera dhe ka faqen e saj të informimit në internet dhe u ofron gjithashtu personave që vijnë në gjykatë një broshurë informative me të dhëna bazë për aktivitetet e GjKR-së dhe informacion për të pandehurit, dëshmitarët, mjetet e informimit masiv dhe publikun e gjerë.<sup>6</sup> Megjithëse ka disa mangësi në personelin administrativ, GjKR-ja ka një numër të plotë të gjyqtarëve dhe pritet që kjo të rrisë shpejtësinë e gjykimit të çështjeve. Pavarësisht nga kushtet e vështira fillestare të punës, bashkë me presionin politik dhe vëmendjen e madhe të mjeteve të informimit, GjKR-ja ka treguar gjithashtu se është një institucion me standarde relativisht të larta profesionale dhe integritet, si edhe një gjykatë që punon shumë për të dhënë drejtësi në mënyrë transparente dhe të drejtë.

Nga ana legjislativë, “paketa ligjore antimafia”, e përbërë nga ligji për luftën kundër krimit të organizuar, ligji kundër financimit të terrorizmit dhe ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, u miratua në vitin 2004.<sup>7</sup> Paketa jep një përkufizim

<sup>5</sup> Kjo është një zgjidhje e përkohshme deri në përfundim të ndërtimit të një godine të re për Gjykatat e Krimeve të Rënda, d.m.th. Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, si edhe për Prokuroritë e Krimeve të Rënda në bazë të programit CARDS 2003 të BE-së.

<sup>6</sup> Si pjesë të Projektit për Ndërtimin e Kapaciteteve për GjKR-në, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka dhuruar një numër kompjuterësh dhe një central telefonik, ka siguruar programe kompjuterike për të ndihmuar mbajtjen e procesverbaleve gjatë seancave gjyqësore, ka mobiluar dhomën e dëshmitarëve, ka financuar publikimin e faqes së internetit dhe botimin e broshurës informative, si edhe ka siguruar trajnim për nëpunësit gjyqësor dhe sekretaret në Gjykatën për Krime të Rënda.

<sup>7</sup> Ligji nr. 9205, datë 15 mars 2004, “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë”; ligji nr. 9284, datë 30 shtator 2004, “Për parandalimin e luftës dhe goditjen e krimit të organizuar”; ligji nr. 9275, datë 16 shtator 2004, “Për disa shtesa dhe ndryshime të ligjit nr. 7895, datë 27 janar 1995, ‘Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë’, i ndryshuar”; dhe ligji nr. 9276, datë 16 shtator 2004, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21 mars 1995, ‘Kodi i Procedurës Penal të Republikës së Shqipërisë’, i ndryshuar”.

të domosdoshëm ligjor të organizatave kriminale dhe trafikimit të qenieve njerëzore. Ajo paraqet edhe mjete të tjera ligjore që ndihmojnë konfiskimin e pasurive që burojnë nga krimi dhe parashikon shfrytëzimin e mjeteve të veçanta hetimore për të ndaluar korrupsionin dhe shpërdorimin me detyrën, dhe shpërblen gjithashtu bashkëpunimin me autoritetet. Aktet e nevojshme nënligjore të ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, u miratua me vonesë në verën e vitit 2005.<sup>8</sup> Pas miratimit të akteve nënligjore, Sektori i Mbrojtjes së Dëshmitarëve, që është pjesë e Drejtorisë së Krimin të Organizuar dhe Mbrojtjes së Dëshmitarëve në vartësi të Policisë së Shtetit të Republikës së Shqipërisë, ka filluar të zbatojë programin për mbrojtjen e dëshmitarëve. Nga ana politike, qeveria e re, e cila erdhi në fuqi pas zgjedhjeve të muajit korrik 2005, ka treguar se është e angazhuar të luftojë krimin e organizuar dhe korrupsionin. Kjo gjë ka dhënë rezultat në përparimet e bëra për goditjen e organizatave kriminale dhe vënien e anëtarëve të tyre përpara drejtësisë, si edhe ka çuar në disa përpjekje legislative për të ndaluar praktikat korruptive.

Analiza e dytë e PZhGjD-së (d.m.th, ky botim) ka të bëjë me një numër çështjesh shumë problematike. Kapitulli i parë dhe më i gjerë trajton shkallën e respektimit të të drejtave të njeriut dhe atyre procedurale nga ana e autoriteteve shqiptare ndaj personave që u është hequr liria në bazë të dyshimeve për kryerjen e një veprë penale. Kapitulli i dytë trajton të drejtën për një mbrojtje efikase dhe kapitulli i tretë përmban studimin e dy çështjeve gjyqësore. Kapitulli i katërt analizon se si trajtohen rastet e dhunës në familje nga sistemi i drejtësisë penale në Shqipëri. Kapitulli i pestë trajton transparencën dhe të drejtën për informim, ndërsa kapitulli i gjashtë trajton korrupsionin brenda sistemit të drejtësisë. Dhe kapitulli i shtatë dhe i fundit, përmban dy studime që më parë janë paraqitur në kontekste të ndryshme. Ndërsa qëllimi i fazës së dytë të PZhGjD ishte të analizonte nga njëra anë situatën e të paraburgosurve dhe nga ana tjetër se si trajtohen çështjet e dhunës në familje nga sistemi i drejtësisë penale, temat e tjera të analizuara në këtë raport janë çështje që dolën gjatë ecurisë së këtyre analizave. Me përjashtim të kapitullit të studimit të dy rasteve gjyqësore, çdo kapitull përmban një numër rekomandimesh të veçanta lidhur me mënyrën e trajtimit të problemeve të konstatuara brenda sistemit të drejtësisë.

Besojmë se kjo analizë do të shërbejë si mjet i dobishëm për autoritetet shqiptare të drejtësisë dhe për aktorët ndërkombëtarë në këtë fushë, në përpjekjet e vazhdueshme për të përmirësuar sistemin gjyqësor në Shqipëri. Një pikësynim tjetër është se pjesë të ndryshme të këtij raporti do të jetë të dobishme për aktorë të veçantë, si gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët mbrojtës, si edhe për organizatat jofitimprurëse (OJF), të cilat punojnë për të ndaluar dhunën në familje ose që janë aktive në fushën e drejtësisë. Së fundmi por jo më pak e rëndësishme, shpresojmë që ky libër t'ju vijë në ndihmë Shkollës së Magjistraturës dhe Fakulteteve të Drejtësisë në Shqipëri në përpjekjet e tyre për të edukuar brezat e ardhshëm të gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve mbrojtës.

---

<sup>7</sup> Ligji nr. 9205, datë 15 mars 2004, "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë" dhe aktet nënligjore, botuar në *Fletoren Zyrtare* nr. 61, datë 3 gusht 2005.





## *Përmbledhje e gjetjeve*

### *Vëzhgime të përgjithshme*

Sistemi gjyqësor shqiptar ka pësuar ndryshime rrënjësore dhe një përmirësim të konsiderueshëm gjatë dhjetëvjeçarit të fundit. Gjithsesi, kjo analizë tregon se ka nevojë për përmirësime të mëtejshme në mënyrë që të krijohet një sistem gjyqësor i qëndrueshëm dhe transparent, i bazuar në parimet e shtetit të së drejtës. Siç do të shihet edhe në kapitullin për dy rastet e marra në studim si dhe në kapitujt e tjerë të këtij raporti, instrumentet ligjorë shpeshherë nuk respektohen ose abuzohen në mënyrë që të arrihen rezultate “të dëshiruara” – por jo domosdoshmërisht të ligjshme. Për pasojë, të drejtat dhe liritë e individëve dhunohen shpeshherë dhe kështu krijohet përshtypja që sistemi gjyqësor nuk është as i drejtë dhe as i pavarur.

### *Të drejtat dhe kushtet gjatë paraburgimit*

Heqja e lirisë e vendos individin në një situatë jashtëzakonisht të cenueshme. Për këtë arsye është e rëndësishme që heqja e lirisë të jetë sa më e kufizuar dhe të ndiqen procedura rigorozë të përcaktuara në dokumentet ndërkombëtarë dhe në legjislacionin vendas. Të gjithë aktorët e përfshirë kanë gjithashtu një rol kyç në ruajtjen e këtyre standardeve dhe në marrjen e masave ndaj çdo abuzimi. Në këtë aspekt në kontekstin shqiptar, ka vend për shumë përmirësim. Kështu, është vënë re se në shumicën e rasteve, personat të cilëve u hiqet liria nuk informohen për arsyet e arrestimit/ndalimit apo për të drejtat e tyre; ata keqtrajtohen rregullisht nga policia; nuk kanë mundësi të komunikojnë me avokatin mbrojtës dhe nuk dërgohen përpara gjykatës brenda afatit të përcaktuar në Kushtetutë. Vendimet argumentohen në mënyrë shumë të dobët dhe japin përshtypjen se masa e sigurisë e arrestit në burg shpeshherë jepet pa pasur arsye ligjore. Avokatët bëjnë shumë pak për të kundërshtuar vendimet, për të nxjerrë në pah rastet e abuzimit, apo praktika të tjera të gabuara. Hetimet paraprake shpeshherë karakterizohen nga periudha të zgjatura ku nuk ndërmerret asnjë veprim dhe afatet e paraburgimit pezullohen pa arsye të ligjshme dhe për periudha të gjata. Shpeshherë këto afate tejkalohen dhe kjo nuk sjell lirim të pandehurit. Kushtet në të cilat mbahen personat e paraburgosur lënë shumë për të dëshiruar dhe nuk i përmbushin aspak standardet ndërkombëtare.

### *Dhuna në familje dhe sistemi gjyqësor penal*

Dhuna në familje në Shqipëri raportohet shumë pak, pothuaj nuk hetohet fare, ndiqet shumë pak penalisht dhe dënimet e parashikuara për të nuk janë në masën e duhur. Në pjesën më të madhe ndjekja penale e rasteve të dhunës në familje varet plotësisht nga gruaja dhe dënimet që parashikohen në Kodin Penal janë të ulta në krahasim me dënimet që parashikohen për vepra të tjera të dhunshme. Kodi Penal nuk merr parasysh natyrën sistematike të dhunës në familje apo pasojat që mund të kenë mbi viktimat vitet e dhunës së ushtruar nga burrat e tyre, as në dënimet bazë që parashikon dhe as në rrethanat rënduese. Për pasojë, pjesa më e madhe e shkatërrimeve të dhunës nuk dënohen, ndërsa gratë të cilat kërkojnë rrugëzgjidhje ndaj dhunës në familje kanë shumë pak apo aspak mbështetje nga autoritetet. Policët, prokurorët, gjyqtarët dhe avokatët nuk kanë ndërgjegjësimin dhe kualifikimin e duhur për t'u marrë me çështje që kanë të bëjnë me dhunën në familje.

Projektligji ndaj dhunës në familje dhe mbështetja e madhe që mori ky projektligji, gjë e cila u duk në mbledhjen e firmave, tregoi se shoqëria shqiptare është gati për të ndërmarrë hapa konkretë në luftën kundër mbizotërimit të dhunës në familje. Duke siguruar mbrojtje për gratë që janë viktime të dhunës në familje, zbatimi i ligjit mund të shërbejë edhe për të rritur ndjekjen penale të rasteve të dhunës në familje. Sidoqoftë, është e rëndësishme që miratimi i projektligjit të konsiderohet vetëm si hapi i parë në luftën ndaj dhunës në familje në Shqipëri dhe të merren masa për të forcuar kuadrin ligjor për të luftuar dhunën në familje si vepër penale.

#### *Transparenca dhe e drejta e informimit*

Transparenca dhe e drejta e publikut për informim janë elemente kryesore në një shoqëri demokratike dhe shërbejnë për t'i dhënë medias, shoqërisë civile dhe organeve të tjera të interesuara mjetet për të vëzhguar me kujdes se si përdoret dhe drejtohet pushteti dhe burimet e tjera shtetërore. Kompjuterizimi i disa gjykatave kryesore në vend dhe krijimi i faqeve në internet ku vendimet e gjykatës shpallen të plota është një hap i rëndësishëm përpara për të pasur një sistem gjyqësor më transparent në Shqipëri. Megjithatë përpara se të vazhdojë ky proces, ka nevojë për vendosjen e rregullave, të cilat baraspeshojnë nga njëra anë interesat e transparencës dhe nga ana tjetër, sigurinë e integritetit të personit. Sidoqoftë, veç kësaj, mbetet shumë për t'u bërë për t'u dhënë mjeteve të informimit masiv dhe publikut të gjerë një pamje më të gjerë e të plotë të sistemit shqiptar të drejtësisë, gjë që është e domosdoshme në një shoqëri demokratike që bazohet në respektin për të drejtat e njeriut dhe në shtetin e së drejtës. Prandaj, gjykatat dhe prokuroritë duhet të vendosin rregulla të brendshme, si edhe të krijojnë struktura për t'iu përgjigjur me kujdes kërkesave për mundësinë e marrjes së informacionit. Publiku i gjerë duhet të ndërjegjësohet për të drejtën e marrjes pjesë në seancat gjyqësore dhe të drejtën për të marrë informacion për vendimet gjyqësore, si edhe informacion rreth dokumenteve të tjera zyrtare në gjykata dhe prokurori.

#### *Korrupsioni në sistemin gjyqësor shqiptar*

Studimet ndërkombëtare dhe ato vendase tregojnë se korrupsioni në sistemin gjyqësor shqiptar perceptohet të jetë shumë i lartë dhe të jetë pengesë serioze për funksionimin e sistemit gjyqësor. Ndërkohë që qeveria e re ka treguar një angazhim serioz në luftën kundër korrupsionit, pak masa konkrete janë marrë deri tani për të prekur çështjen e korrupsionit në sistemin gjyqësor. Për të gjetur zgjidhje lidhur me korrupsionin e vërtetë dhe me atë të perceptuar, brenda sistemit të drejtësisë duhet të merren masa të vendosura. Hapi i parë do të ishte t'i jepej fund menjëherë kontakteve/lidhjeve të papërshtatshme ndërmjet anëtarëve të gjyqësorit dhe palëve në proces ose përfaqësuesve të tyre. Veç kësaj, çdo gjykatë dhe prokurori duhet t'i kërkojë të ndërtojë strategji dhe të marrë masa konkrete për të luftuar korrupsionin brenda institucionit përkatës. Çdo strategji e parashikuar do të duhej të merrte gjithashtu parasysh nivelet e pagesës dhe përfitimeve të tjera të stafit brenda sistemit të drejtësisë në përgjithësi dhe të gjyqtarëve në veçanti. Një nivel i përshtatshëm i pagesës dhe përfitimeve të tjera është ndoshta një nga mënyrat më efikase për të “imunizuar” punonjësit nga korrupsioni.

### *Gjykime efikase dhe çështje lidhur me dëshmitarët*

Proceset gjyqësore në Shqipëri karakterizohen nga vonesa të shpeshta dhe për pasojë edhe për çështjet e thjeshta duhen muaj e në disa raste edhe vite që të përfundojnë. Kjo gjë krijon pasoja negative dhe shpenzime për palët, si dhe shpenzime për sistemin gjyqësor. Proceset e zgjatura gjyqësore kanë ndikim negativ në besimin e publikut në sistemin gjyqësor dhe krijojnë hapësira për të bërë marrëveshje korruptive. Për këtë arsye, duhen marrë masa praktike dhe ligjore për të trajtuar vonesat e pajustificuara gjatë proceseve gjyqësore. Në njërin anë, rritja e përpjekjeve për të siguruar pjesëmarrjen në kohë të të gjithë personave të përfshirë mund të kërkojë më shumë shpenzime, por nga ana tjetër procese gjyqësore më të shkurtra e më efikase do t'i ulnin shpenzimet në mënyrë të konsiderueshme për të gjithë dhe në këtë mënyrë do të krijohej mundësia që burimet të përdorëshin për të gjykuar më shumë çështje.

Dëshmitarët janë një element i rëndësishëm në pjesën më të madhe të proceseve gjyqësore dhe për pasojë, edhe për funksionimin e çfarëdolloj sistemi gjyqësor. Për këtë arsye është e nevojshme të sigurohet sa më shumë të jetë e mundur që dëshmitarët të paraqiten në gjykatë dhe të japin dëshmi të sakta dhe të vërteta. Kjo do të thotë që të ketë masa për parandalimin e dëmtimit, frikësimit, kanosjes apo ndikimit në forma të tjera të dëshmitarëve. Sado që ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij shënojnë një hap të rëndësishëm përpara, përsëri mbetet shumë për të bërë për të siguruar mbrojtjen e dëshmitarëve të tjerë dhe për të rritur besueshmërinë e deklarimeve të dëshmitarëve në Shqipëri.

## *Falënderime*

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dëshiron të shprehë mirënjohjen e saj për gjithë ata gjyqtarë, prokurorë, avokatë dhe drejtuesit e gjykatave, të cilët na kanë mundësuar marrjen e informacionit, i cili përbën bazën e këtij libri, si dhe të gjithë ata që kanë qenë të gatshëm të ndajnë mendimet e tyre me ne. Do të donim të falënderonim gjithashtu të gjithë ata persona të paraburgosur të cilët qenë të gatshëm të ndanin përvojat e tyre me ne nëpërmjet intervistave, si dhe ata avokatë që shpenzuan kohë dhe mundim për të plotësuar pyetëtorët tanë. Së fundmi, do të donim të falënderonim edhe të gjithë ata studiues dhe juristë në fusha të ndryshme të cilët me durim u janë përgjigjur pyetjeve tona dhe kanë qenë të gatshëm të diskutonin çështje të ndryshme me ne. Pa ndihmën e tyre, ky raport nuk do të ishte bërë i mundur.

## *Tabela e shkurtimeve*

<b>ABA-CEELI</b>	Organizata e Juristëve Amerikanë – Iniciativa Ligjore për Vendet e Evropës Qendrore dhe Euroazisë
<b>AI</b>	Amnesty International
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>CARDS</b>	Ndihma Komunitare për Zhvillim, Rindërtim dhe Stabilizim (Programi CARDS i BE-së)
<b>CEDAW</b>	Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
<b>DUDNj</b>	Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
<b>GjAKR</b>	Gjykata e Apelit për Krime të Rënda
<b>GjKR</b>	Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda
<b>GjRr</b>	Gjykata e Rrethit
<b>GjRrT</b>	Gjykata e Rrethit Tiranë
<b>IDRA</b>	Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi
<b>IPK</b>	Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit
<b>KASHLE</b>	Këshilli i Avokatëve dhe Shoqërive Ligjore të Evropës [Council of Bars and Law Societies of Europe (CCBE)]
<b>KE</b>	Këshilli i Evropës
<b>KEDNj</b>	Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut Komentari i KPrP Komentari i Procedurës Penale (Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda)
<b>KP</b>	Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
<b>KPrC</b>	Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë
<b>KPrP</b>	Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë
<b>KPT</b>	Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtitimit ose Dënimit Çnjerëzor dhe Poshtëruës
<b>OJF</b>	Organizatë jofitimprurëse
<b>OJQ</b>	Organizatë joqeveritare
<b>OKB</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara
<b>OSBE</b>	Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>PNDCP</b>	Pakti Ndërkombëtar lidhur me të Drejtat Civile dhe Politike
<b>PT</b>	Prokuroria e Rrethit Tiranë
<b>PZhGjD</b>	Programi për Zhvillimin e një Gjykimi të Drejtë
<b>ShGPS</b>	Shoqata e Grave me Probleme Sociale
<b>USAID</b>	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (United States Agency for International Development)
<b>ZMQ</b>	Zyra për Mbrojtjen e Qytetarëve



# I. TË DREJTAT GJATË PARABURGIMIT

## 1. Hyrje

E drejta për të mos u privuar nga liria në mënyrë arbitrare është një e drejtë themelore dhe është shprehur në të gjitha dokumentet kryesore për të drejtat e njeriut, si në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut,<sup>9</sup> Paktin Ndërkombëtar lidhur me të Drejtat Civile dhe Politike,<sup>10</sup> Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNj),<sup>11</sup> Kartën Afrikane të të Drejtave të Njeriut dhe Popujve<sup>12</sup> dhe Konventën Amerikane të të Drejtave të Njeriut.<sup>13</sup> Liria personale është e lidhur ngushtë me konceptin e dinjitetit njerëzor dhe është një parakusht për të gëzuar liritë dhe të drejtat e tjera të njeriut. Megjithatë, ka raste kur shteti ka interes legjitim për t'i hequr një personi lirinë e tij/saj me qëllim që të mbrojë vetë individin, individët të tjerë ose interesa të tjera të rëndësishme. Meqenëse cenimi i lirisë nga autoritetet shtetërore e vendos individin në një pozitë tepër të cenueshme, është tepër e rëndësishme që çdo cenim i lirisë të shoqërohet me një procedurë ligjore dhe transparente, dhe të mos zgjasë më shumë se sa është plotësisht e nevojshme për të arritur qëllimin që ka heqja e lirisë.

Në këtë kapitull do të diskutohen çështje që lidhen me masën e sigurisë “arrest në burg”. Do të paraqitet dhe analizohet kuadri ligjor dhe shqyrtimi i çështjeve që kanë të bëjnë me paraburgimin në praktikë. Diskutimi do të përqendrohet në mënyrën se si janë respektuar të drejtat procedurale të personit të arrestuar dhe të ndaluar. Prezantimi do të fillojë me një diskutim se kush e merr vendimin për arrest në një situatë të veçantë dhe më pas do të diskutojë gjendjen e arrestit, mundësinë për të pasur avokat mbrojtës, marrjen fillestare në pyetje, seancën për vlefësimin të arrestit/ndalimit dhe caktimin e masës së sigurisë, si dhe për shqyrtimin e vazhdueshëm të vendimeve që lidhen me arrestin në burg. Prezantimi më pas vazhdon me diskutimin e pezullimit të afatit të paraburgimit dhe çfarë ndodh kur përfundon afati ligjor i paraburgimit. Kjo do të pasohet me një diskutim mbi shqyrtimin e paraburgimit në rastet kur të pandehurit i është dhënë masa e sigurisë arrest në burg, dhe se si kjo lidhet me afatet e paraburgimit. Analiza bazohet në vëzhgimin e proceseve gjyqësore, vendimeve të gjykatës dhe një numër studimesh të kryera në burgje dhe nëpërmjet intervistave me avokatë mbrojtës, si edhe në studimin e dosjeve hetimore. Kapitulli përfundon me disa konstatime përfundimtare dhe një numër rekomandimesh shumëpërfshirëse në lidhje me mangësitë e vërejtura në legjislacion dhe në praktikë. Në kapitullin që vijon do të diskutohen kushtet e të arrestuarve/ndaluarve dhe qendrave të paraburgimit në Shqipëri.

---

<sup>9</sup> Neni 9.

<sup>10</sup> Neni 9.

<sup>11</sup> Neni 5.

<sup>12</sup> Neni 6.

<sup>13</sup> Neni 7.

## 1.1 Vëzhgimi i paraburgimit dhe studimi i dosjeve të prokurorisë

Vëzhgimi i paraburgimit u krye nga tetori deri në dhjetor 2005 në qendrat e paraburgimit në Sarandë, Gjirokastrë, Vlorë, Fier, Lushnje, burgjet 302 dhe 313 në Tiranë, Durrës, Krujë, Lezhë (burgun e Shënkollit), Shkodër, Kukës dhe Bajram Curri. Vëzhgimi konsiston në tri pjesë dhe tre pyetësorë. Së pari, iu drejtuan pyetje drejtorit të qendrës së paraburgimit në lidhje me kapacitetin dhe kushtet e qëndrimit në paraburgim.<sup>14</sup> Së dyti, u intervistuan disa nga të arrestuarit në mënyrë individuale,<sup>15</sup> dhe së treti Dhomat e Avokatisë së rretheve shpërndanë pyetësorë për t'u plotësuar mbi baza vullnetare nga anëtarët e saj.<sup>16</sup> Megjithatë pyetjet e pyetësorit janë në përgjithësi të tilla që nuk u japin personave që e plotësojnë atë, arsye për të dhënë përgjigje të pasakta, të dhënat në përgjigje përfaqësojnë pikëpamjet dhe perceptimet e të intervistuarve dhe jo të OSBE-së. Për më tepër, janë analizuar një numër vendimesh lidhur me arrestin në burg.<sup>17</sup> Së fundmi, u studiuan një numër dosjesh hetimore për të pasur një tablo të mënyrës se si kryhen hetimet në fazën e paraburgimit në Shqipëri.<sup>18</sup>

### **Terminologjia e përdorur në këtë kapitull lidhur me “paraburgimin”**

**Arrestim** – veprim i policisë që ka të bëjë me kapjen e dikujt (Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut përdor “arrestimin dhe ndalimin” për të përshkruar personin i cili është arrestuar dhe më pas është ndaluar nga policia, ndërsa Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë përdor arrestin për të përshkruar kapjen në bazë të provave dhe ndalimin për kapjen bazuar në dyshim)

**Dhomë shoqërimi** – vendi ku mbahet personi i arrestuar

**Seancë për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë**– seancë gjatë së cilës provohet ligjshmëria dhe vazhdimësia e heqjes së lirisë, para gjykimit të çështjes. Në kontekstin shqiptar, kjo do të thotë që ky nocion përfshin si seancën e verifikimit<sup>19</sup> ashtu edhe të vleftësimit<sup>20</sup>.

**Arrest në burg**– gjendje pas së cilës është dhënë masa e sigurisë nga gjykata.

**Dhoma të paraburgimit** – vendi ku mbahet personi ndaj të cilit është dhënë masa e sigurisë së arrestit në burg.

**Paraburgim** – çdo formë e heqjes së lirisë deri në vendimin përfundimtar të gjykatës për çështjen në themel

<sup>14</sup> Shih Paraburgimi- Shtojca 1.

<sup>15</sup> Paraburgimi - Shtojca 2.

<sup>16</sup> E drejta për një mbrojtje efikase – Shtojca 1

<sup>17</sup> Për informacion bazë lidhur me vëzhgimet, shih Shtojcën 3 - Paraburgimi

<sup>18</sup> Për informacion statistikor bazuar në vëzhgimet, shih Paraburgimin-Shtojca 4 dhe 5.

<sup>19</sup> Kodi i Procedurës Penale, neni 248

<sup>20</sup> Kodi i Procedurës Penale, nenet 258 dhe 259



## 2. Vendimet për caktimin e masës së sigurisë “arrest në burg”

### *Kuadri ligjor*

Kushtet në të cilat një personi mund t'i hiqet liria dhe të drejtat e tij/saj janë përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

#### **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë<sup>21</sup>**

##### **Neni 27**

1. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj.
2. Liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastet e mëposhtme:
  - a) kur është dënuar me burgim nga gjykata kompetente;
  - b) për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës ose për moszbatim të ndonjë detyrimi të caktuar me ligj;
  - c) **kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj;**
  - ç) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent;
  - d) kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paaftë mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë;
  - dh) për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose të ekstradimit.
3. Askujt nuk mund t'i hiqet liria vetëm për shkak se nuk është në gjendje të përmbushë një detyrim kontraktor.

##### **Neni 28**

1. Kushdo, të cilit i hiqet liria, **ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e kësaj mase, si dhe për akuzën që i bëhet. Personi, të cilit i është hequr liria, duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me avokatin, si dhe t'i jepet mundësia për realizimin e të drejtave të tij.**
2. **Personi, të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, paragrafi 2, nënparagrafi c, duhet të dërgohet brenda 48 orëve përpara gjyqtarit, i cili vendos paraburgimin ose lirimin e tij jo më vonë se 48 orë nga çasti i marrjes së dokumenteve për shqyrtim.**
3. I paraburgosuri ka të drejtë të ankohet kundër vendimit të gjyqtarit. Ai ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të procedohet i lirë përkundrejt një garancie pasurore sipas ligjit.
4. Në të gjitha rastet e tjera, personi, të cilit i hiqet liria në rrugë jashtëgjyqësore, mund t'i drejtohet në çdo kohë gjyqtarit, i cili vendos brenda 48 orëve për ligjshmërinë e kësaj mase.
5. Çdo person, të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij.

<sup>21</sup> Kushtetuta e vitit 1998 e Republikës së Shqipërisë. Teksti u aprovua me referendum më 22 nëntor 1998 dhe u shpall më 28 nëntor 1998 [është shtuar theksimi me të zeze]

Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë<sup>22</sup> (KPrP) ndan masat e sigurimit personal në masa shtrënguese dhe ndaluese.<sup>23</sup> Arresti në burg si masë sigurie klasifikohet si një masë shtrënguese.<sup>24</sup>

1. Sipas Kodit të Procedurës Penale “askush nuk mund t’u nënshtrohet masave të sigurimit personal (p.sh., arresti në burg ) në qoftë se në ngarkim të tij/saj nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova [për kryerjen e një krimi]” [*kriteri i dyshimit të arsyeshëm*].<sup>25</sup>

2. Masat e sigurimit personal do të merren në rastet kur (dhe vetëm kur)<sup>26</sup> “ka shkaqe të rëndësishme që kërcënojnë marrjen ose vërtetësinë e provave” (*rrezikun e dëmtimit të provës*), kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai/ajo të largohet (*rreziku i arratisjes*) ose kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai/ajo të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin ai/ajo procedohet ( rreziku i kryerjes së krimeve të tjera) [*kritere të veçanta*].<sup>27</sup>

3. Në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret dhe çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. [*kriteri i proporcionalitetit*].<sup>28</sup>

4. Arresti në burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të pandehurit. [*kriteri i domosdoshmërisë*].<sup>29</sup>

5. Kur i pandehuri është i mitur gjykata mban parasysh kërkesën për të mos ndërprerë proceset edukative.<sup>30</sup> Të miturit nuk mund të arrestohen kur akuzohen për kundërvajtje penale.<sup>31</sup>

6. Arresti në burg mund të vendoset ndaj një gruaje që është shtatzënë ose me fëmijë në gji, ndaj një personi që ndodhet në gjendje shëndetësore veçanërisht të rëndë ose që ka kaluar moshën 70 vjeç ose ndaj një personi toksikoman apo të alkoolizuar, për të cilin zbatohet një program terapeutik në një institucion të posaçëm, vetëm kur ka shkaqe të rëndësia të veçantë për krimet që dënohen jo më pak në maksimum se dhjetë vjet burgim.

### ***Kush vendos për arrestin në burg ose arrestimin në flagrancë***

Ligji përcakton, se si rregull kryesore, gjykata merr vendimin *arrest në burg*,<sup>32</sup> ku është e qartë se aplikohen të gjitha kushtet e renditura më sipër. Por, siç vijon më poshtë, ka disa përjashtime nga rregulla, duke i dhënë prokurorit ose policisë kompetencë për të arrestuar një person.<sup>33</sup> Në praktikë duket gjithashtu se shumica e ndalimeve/arrestimeve

<sup>22</sup> Ligj nr. 7905, datë 21 mars 1995.

<sup>23</sup> KPrP, neni 227.

<sup>24</sup> KPrP neni 232 paragrafi 1. dh).

<sup>25</sup> KPrP, neni 228.

<sup>26</sup> Kushtetuta, neni 27, paragrafi 2 c).

<sup>27</sup> Kushtetuta, neni 27, paragrafi 2 c).

<sup>28</sup> KPrP neni 229, paragrafët 1 dhe 2.

<sup>29</sup> KPrP, neni 230.

<sup>30</sup> KPrP, neni 229, paragrafi 3.

<sup>31</sup> KPrP, neni 230, paragrafi 4.

<sup>32</sup> KPrP, neni 244, 245 dhe 246.

<sup>33</sup> KPrP, nenet 251 dhe 253.

në Shqipëri bëhen nga policia pa vendim gjykate. Meqenëse *arrest* nuk përkufizohet nga KPrP si masë sigurie, nuk është e vetëkuptueshme që dispozitat e KPrP duhet të zbatohen për sa i përket *dyshimit të arsyeshëm, rrezikut të dëmtimit të provave, arratisjes ose krimin të përsëritur*. Megjithatë, duke marrë në konsideratë nenin 27 paragrafi 2 (c) i Kushtetutës, është e qartë se për çdo heqje të lirisë (d.m.th. arrest në shtëpi ose arrest në burg) autoriteti që kryen arrestin duhet të sigurohet që kushtet e sipërpërmendura të plotësohen.<sup>34</sup> Kjo është gjithashtu në përputhje me nenin 5, paragrafi 1 (c), të KEDNj.

- Sipas KPrP arresti në flagrancë është një arrest në gjendjen e flagrancës. Personi i arrestuar në këtë mënyrë është përshkruar si: *“një person që është kapur në kryerje e sipër të veprës penale ose ai që menjëherë pas kryerjes së veprës ndiqet nga policia gjyqësore, nga personi i dëmtuar ose nga persona të tjerë ose që është kapur me sende dhe prova materiale, nga të cilat duket se ka kryer veprën penale”*.<sup>35</sup>

<i>Lloji i veprës penale</i>	<i>Kushti paraprak</i>	<i>Kush vendos</i>	<i>Vendimi</i>
<b>Çdo veprë penale</b>	<b>Dyshim i arsyeshëm, rreziku i:</b> - dëmtimit të provave - ikjes - krimeve të tjera	<b>Gjykata</b>	Parimi kryesor është se gjykata, me kërkesën e prokurorit, vendos arrestin në burg <sup>36</sup> Autoriteti që bën arrestimin, p.sh., policia, i dorëzon një kopje të vendimit të gjykatës personit dhe i bën të njohur të drejtën për të zgjedhur një avokat mbrojtës. Njofton menjëherë avokatin mbrojtës të zgjedhur nga i pandehuri ose të caktuar kryesisht. <sup>37</sup>
<b>Dënimi me burgim jo më i ulët në maksimum se pesë vjet</b>	<b>Kapur në flagrancë</b>	<b>Policia gjyqësore</b>	Policia gjyqësore kryen detyrimisht arrestimin e cilitdo që kapet në flagrancë për një krim me dashje, të kryer ose të mbetur në tentativë, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se pesë vjet. <sup>38</sup>
<b>Dënimi me burgim jo më i ulët në maksimum se 2 vjet</b>	<b>Kapur në flagrancë<sup>39</sup></b>	<b>Policia gjyqësore</b>	Policia gjyqësore ka të drejtë të arrestojë cilindo që kapet në flagrancë për një krim me dashje, të kryer ose të mbetur në tentativë, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se dy vjet. <sup>40</sup>

<sup>34</sup> Kjo konfirmohet gjithashtu nga *Procedura penale: Komentar* - Halim Islami, Artan Hoxha dhe Ilir Panda, (2003) [Komentari i KPrP] fq. 343.

<sup>35</sup> KPrP, neni 252, shih gjithashtu edhe Komentarin i KPrP, fq. 346.

<sup>36</sup> KPrP, nenet 238 dhe 244.

<sup>37</sup> KPrP, neni 246.

<sup>38</sup> KPrP, neni 251, paragrafi 1.

<sup>39</sup> KPrP, neni 252.

<sup>40</sup> KPrP, neni 251, paragrafi 2.

<i>Lloji i veprës penale</i>	<i>Kushti paraprak</i>	<i>Kush vendos</i>	<i>Vendimi</i>
<b>Dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se 10 vjet</b>	<b>Kapur në flagrancë dhe krimi i kryer nga pakujdesia</b>	<b>Policia gjyqësore</b>	Policia gjyqësore ka të drejtë të arrestojë cilindo që kapet në flagrancë për një veprë penale të kryer nga pakujdesia, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se dhjetë vjet. <sup>41</sup>
<b>Çdo krim</b>	<b>Kapur në flagrancë. Nevojë e domosdoshme, për shkak të rëndësisë së faktit ose të rrezikshmërisë së subjektit</b>	<b>Policia gjyqësore</b>	Policia gjyqësore ka të drejtë të arrestojë cilindo që kapet në flagrancë, kur lind nevoja e domosdoshme, për shkak të rëndësisë së faktit ose të rrezikshmërisë së subjektit, e motivuar me akt të veçantë. <sup>42</sup>
<b>Dënimi me burgim jo më të ulët në maksimum se 2 vjet</b>	<b>Shkaqe të bazuara, rrezik ikjeje/dhe gjendje e ngutshme</b>	<b>Prokurori ose, policia gjyqësore për shkak të gjendjes së ngutshme</b>	Kur ka shkaqe të bazuara për të menduar se ka rrezik ikjeje, prokurori urdhëron ndalimin e personit që dyshohet për një krim për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se 2 vjet. <sup>43</sup> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Policia gjyqësore kryen ndalimin me iniciativën e vet për shkak të gjendjes së ngutshme.<sup>44</sup></li> </ul>

### **Analiza**

Siç u tha më sipër, një arrestim mund të kryhet me urdhër të gjykatës ose prokurorit si dhe me iniciativën e policisë. Pavarësisht nga rrethanat e vendimit, ndalimi i të dyshuarit kryhet nga policia. Për të përmbushur detyrimet sipas Kushtetutës, nëpunësi i policisë ia dorëzon të arrestuarit ose të ndaluarit vendimin e gjykatës, i cili përmban shkaqet e masës së sigurisë arrest në burg, ose e njofton gojarisht për arsyet e arrestit, si edhe të drejtën për të mos bërë ndonjë deklaratë, për të drejtën e njoftimit të familjes dhe për të pasur avokat mbrojtës. Megjithatë, siç u përmend edhe më sipër, KPrP, nuk e detyron shprehimisht policinë gjyqësore, si autoriteti që kryen arrestin, të njoftojë të arrestuarin për shkaqet e masës së sigurisë, por vetëm se personi nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe se ka të drejtën për të zgjedhur avokat mbrojtës.<sup>45</sup>

<sup>41</sup> Po aty.

<sup>42</sup> KPrP, neni 251, paragrafi 3.

<sup>43</sup> KPrP, neni 253.

<sup>44</sup> Po aty.

<sup>45</sup> KPrP, nenet 255 dhe 246, paragrafi 1. *Shih gjithashtu* Komentarin e KPrP fq. 351.

Nga vëzhgimi i kryer del qartë se në shumicën e rasteve i arrestuari nuk vihet në dijeni për arsyen e arrestimit. Vëzhgimi më tej tregon se në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penale, një person i arrestuar rrallë njoftohet nga policia për të gjitha të drejtat e tij/saj (se ka të drejtë të zgjedhë mbrojtës dhe të njoftojë familjen dhe se ka të drejtë të mos bëjë ndonjë deklaratë). Prandaj, nga 71 të ndaluar të intervistuar, 26 (37%) u shprehën se u ishte dhënë vendimi nga gjykata, ndërsa 23 (32%) thanë se ishin vënë në dijeni për arsyen e arrestimit. Nëntëmbëdhjetë të ndaluar (27%) thanë se ata as nuk kishin marrë kopje të vendimit dhe as nuk ishin vënë në dijeni për arsyet e arrestimit të tyre në kohën e arrestimit.

Nga ata që ishin njoftuar, shumica nuk ishin vënë në dijeni në momentin e ndalimit të tyre, por pasi kishin arritur në komisariatit e policisë. Gjithashtu, shumica e personave që thanë se ishin vënë në dijeni nuk kishin marrë të dhëna për të gjitha të drejtat e tyre. Vetëm 17 të paraburgosur (24%) thanë se ata ishin vënë në dijeni për çdo të drejtë të tyre. Informacioni i dhënë kishte të bënte me të drejtën për të mos bërë deklaratë (70%), nganjëherë me të drejtën e mbrojtjes me avokat (34%) dhe rrallë me të drejtën për të njoftuar familjen (28%). Në një numër rastesh, të pandehurit ishin arrestuar në prani të anëtarëve të familjes dhe për këtë arsye, njoftimi ishte i panevojshëm. Ka të dhëna se në çështjet e rënda, në veçanti atëherë kur të pandehurit dorëzohen vetë tek autoritetet, policia është më e kujdesshme në dhënien e informacionit të nevojshëm dhe se në këtë drejtim, policia në Durrës është më e kujdesshme, veçanërisht kur kemi të bëjmë me të mitur, krahasuar me zona të tjera ku është zhvilluar vëzhgimi.

Me sa duket ekziston mundësia që disa prej të intervistuarve ishin vënë në dijeni, por që kishin harruar ose nuk e kishin kuptuar informacionin që kishin marrë. Kur janë pyetur rreth praktikës së zakonshme gjatë arrestit, disa drejtorë policie shpjeguan se çdo i arrestuar është vënë në dijeni me shkrim për të drejtat e tij/saj dhe i është kërkuar të firmosë një dokument. Kjo dukuri është konfirmuar edhe nga disa të intervistuar, të cilët thanë se u ishte kërkuar të firmosnin diçka në komisariatit e policisë. Megjithatë, asnjë nga këta persona nuk e kishte lexuar atë çfarë u ishte kërkuar të firmosnin dhe policia në asnjë rast nuk u kishte shpjeguar se çfarë po u kërkohej të firmosnin dhe përse duhej ta firmosnin.

Meqenëse të drejtat e garantuara nga KEDNj kanë për qëllim të garantojnë të drejtat që janë *praktike dhe efikase dhe jo teorike dhe të rreme*,<sup>46</sup> në mënyrë që policia të përmbushë detyrimet e saj, ata duhet të sigurohen se të arrestuarit vihen në dijeni në një mënyrë të qartë dhe të kuptueshme. Si rrjedhim, vëzhgimi tregon qartë se policia nuk i përmbush detyrimet e përcaktuara nga KEDNj dhe Kushtetuta për sa i përket njoftimit të personave që u është hequr liria për arsye të arrestimit dhe të drejtat e tyre.

<sup>46</sup> *Shih, p.sh.*, çështjen “Neni kundër Italisë”, 13 maj 1980.

Për sa i përket bazës ligjore të arrestit, personit i hiqet liria vetëm për ato arsye që parashikon Kushtetuta, d.m.th., rrezikun e dëmtimit të provave, rrezikun e arratisjes ose rrezikun e kryerjes së një krimi të ngjashëm apo të krimeve më të rënda. Megjithatë, kjo nuk pasqyrohet nga KPrP dhe duket se në rastet kur policia kryen arrestimet, këta faktorë nuk merren në konsideratë, por merret parasysh vetëm nëse është apo nuk është një gjendje “fragrance”. Ka edhe të dhëna që personat janë arrestuar dhe mbajtur deri në seancën e përcaktimit të masës së sigurisë dhe të vleftësimit të arrestit më tepër si një “dënim paraprak” sesa si një masë për të siguruar integritetin e procesit gjyqësor, apo për të shmangur krime të mëtejshme.

**Shembull:**

Sipas GY, në 17 mars 2005, ai u thirr si dëshmitar në një rast të gjykuar nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda (GjKR). Ndërsa GY u largua nga salla e gjyqit, pas dhënies së dëshmisë, prokurori e ndoqi duke e ndaluar dhe i tha se ai akuzohej për dëshmi të rreme. Prokurori i tha gjithashtu se ai do të ndalohej tri ditë sipas ligjit. GY më pas u dërgua në dhomat e paraburgimit dhe më pas në komisariatit e policisë. Ditën tjetër, erdhi oficeri i policisë gjyqësore dhe e pyeti nëse dëshironte të mbrohej me avokat. Në asnjë rast GY nuk u takua me ndonjë avokat mbrojtës para seancës për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë, e cila u zhvillua tri ditë më vonë. Para seancës për vleftësimin të arrestit dhe caktimit të masës së sigurisë, GY u takua me avokatin mbrojtës në sallën e gjyqit në prani të policisë. Avokati i tha GY-së se do ta lironin dhe po kështu vendosi gjyqtari duke urdhëruar GY-në të paraqitej para policisë çdo javë. GY kishte një punë të qëndrueshme, nuk kishte pasur precedentë penal të mëparshëm dhe paraqitej në gjykim.

### 3. Mundësia për të pasur një avokat mbrojtës<sup>47</sup>

#### *Kuadri ligjor*

- Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore i bëjnë menjëherë të ditur të arrestuarit ose të ndaluarit se nuk ka asnjë detyrim të bëjë deklarata (pra, ka të drejtë të mos flasë ) dhe se çfarëdo që ai thotë, mund të përdoret ndaj tij në gjyq dhe së fundmi, se ka të drejtën për të zgjedhur mbrojtës.<sup>48</sup>
  - o Nëse i pandehuri nuk ka mjete të mjaftueshme, i sigurohet mbrojtja falas me avokat dhe avokati mbrojtës caktohet nga organi që procedon, d.m.th., prokurori ose gjykata.<sup>49</sup>
- Personi i arrestuar në flagrancë ose i ndaluar ka të drejtë të flasë me mbrojtësin menjëherë pas arrestimit ose ndalimit.<sup>50</sup>
- Mbrojtësi ka të drejtë të komunikojë vetëm për vetëm me të arrestuarin, të ndaluarin apo të dënuarin.

<sup>47</sup> Shih gjithashtu kapitullin mbi të drejtën për një mbrojtje efikase.

<sup>48</sup> KPrP, neni 255.

<sup>49</sup> KPrP, neni 53.

<sup>50</sup> KPrP, neni 53.

- o Mbrojtësi ka të drejtë të njoftohet paraprakisht për kryerjen e veprimeve hetimore ku është i pranishëm i pandehuri dhe të marre pjesë në to, të njihet me të gjithë materialin e çështjes në përfundim të hetimeve.<sup>51</sup>
- Sipas ligjit “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, me përjashtim të burgjeve të sigurisë së lartë, avokatët mund të vizitojnë pa autorizim klientët e tyre.<sup>52</sup>
  - Mundësia për takime është e kufizuar normalisht vetëm për ditët e javës nga 9.00 deri 15.00.

### Analizë

Siç përmendet më sipër, Kushtetuta i garanton çdo njeriu, të cilit i është hequr liria të drejtën për të komunikuar *menjëherë* me avokatin (dhe personit i jepet gjithashtu mundësia për ta ushtruar këtë të drejtë). Edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, edhe Kushtetuta i garantojnë më tej kujtdo që ka kryer një vepër penale të drejtën për t’u mbrojtur vetë ose për të pasur ndihmën e një mbrojtësi të zgjedhur prej tij dhe, në qoftë se ai nuk ka mjete për të shpërblyer një mbrojtës, mund të ndihmohet falas. Sipas nenit 5 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e drejta për asistencë ligjore, e cila është e lidhur me parashikimin e nenit 6 të Kartës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, rrjedh nga e drejta për t’u ankuar ndaj heqjes së lirisë. Që kjo e drejtë të zbatohet, i arrestuari duhet të ketë mundësi të kontaktojë me një avokat, të flasë me të dhe të ketë kohën e mjetet e nevojshme për të përgatitur një kërkesë për lirim. Mundësia e menjëhershme për të pasur një avokat mbrojtës është gjithashtu një masë mbrojtëse ndaj abuzimit të policisë dhe është e rëndësishme për të siguruar një mbrojtje efikase për të arrestuarin gjatë procesit gjyqësor.

Vëzhgimi i gjendjes së sistemit të paraburgimit tregon se të arrestuarve në përgjithësi në Shqipëri nuk u jepet mundësi e menjëhershme për avokat mbrojtës. Në shumë raste, të arrestuarit nuk e takojnë avokatin mbrojtës deri në seancën për vleftësimin e arrestit dhe caktimin të masës së sigurisë. Nëse bëhet ndonjë konsultim para kësaj seance, ajo normalisht zhvillohet në prani të policisë, prokurorit dhe çdo personi tjetër që mund të ndodhet në sallën e gjyqit ose në zyrën e gjyqtarit ku zhvillohet kjo seancë.

Kjo është një shkelje e standardeve ndërkombëtare. Konsulta nuk zgjat më shumë se disa minuta dhe konsiston kryesisht në prezantimin mes palëve. Si rrjedhim, 29 të paraburgosur (ose 41%) thanë se nuk e kishin takuar avokatin e tyre mbrojtës para seancës për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë. Nga këta, 28 thanë se takimi fillestar nuk ishte zhvilluar vetëm për vetëm, por në sallën e gjyqit dhe në praninë e kujtdo që ishte ndodhur atje.

<sup>51</sup> KPrP, neni 50.

<sup>52</sup> Ligji nr. 8328, datë 16 prill 1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, neni 43 paragrafi 3, *shih gjithashtu* Rregulloren nr. 1075 të Ministrisë së Rendit Publik, datë 15 shtator 1999, “Për sigurinë dhe trajtimin e të paraburgosurve”, kapitulli III.

Nga ana tjetër, nga 69 avokatë që iu përgjigjën pyetësorit në lidhje me avokatin mbrojtës, 41 (59%) thanë se ata *nuk* ishin të pranishëm në momentin fillestar të marrjes së klientit të tyre në pyetje. Për sa i përket seancës për vleftësimin të arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë, 45 avokatë (65%) thanë se ata gjithmonë konsultoheshin me klientët e tyre para seancës për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë. Tetëmbëdhjetë avokatë (26%) thanë se ata në shumicën e rasteve konsultoheshin me klientët e tyre para seancës për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë ndërsa dy prej tyre (3%) thanë se *ndonjëherë, rrallë ose asnjëherë*, nuk konsultoheshin me klientët e tyre para kësaj seance. Kjo do të thotë se 35% e avokatëve të intervistuar nuk konsultohen gjithmonë me klientët e tyre para seancës për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë. Kjo përputhet shumë mirë me rezultatin e nxjerrë nga vëzhgimi i situatës së paraburgimit, i cili tregon se 41 për qind e të paraburgosurve të intervistuar nuk ishin takuar me avokatin e tyre mbrojtës para kësaj seance. Për sa i përket vendit të konsultimit, 38 avokatë (55%) thanë se takimi i parë konsultativ ishte zhvilluar në dhomat e paraburgimit, ndërsa vetëm 9 (13%) thanë se konsultimi ishte zhvilluar në gjykatë. Bazuar në pyetësorin për avokatët mbrojtës nuk është e mundur të nxirren konkluzione për sa i përket kohës ose cilësisë së këtij konsultimi të parë.<sup>53</sup> Ia vlen të theksohet se një avokat u shpreh se u ishte mohuar e drejta për të takuar të paraburgosurit sepse nuk lejohej të takoheshin me ta para seancës për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë.<sup>54</sup>

*Koment:* Për sa u përket të dhënave dhe mundësisë për të pasur një avokat mbrojtës, Kryetari i Dhomës Kombëtare të Avokatëve ka konfirmuar se është e zakonshme që të arrestuarit të mos jenë të informuar për të drejtën e tyre për të pasur avokatin ose janë vënë në dijeni vetëm pas 24 orësh, duke i dhënë kështu më shumë kohë policisë të ushtrojë presion mbi të arrestuarit. Ai nënvizoi gjithashtu se zakonisht mbrojtësit i jepet mundësia të takohet me të pandehurin vetëm pas një fare kohe vonesë.<sup>55</sup> Kjo përkon me përfundimet e Komitetit Shqiptar të Helsinkit në një studim të botuar kohët e fundit.<sup>56</sup>

Shumica e të intervistuarve raportuan se u ishte mohuar e drejta e mbrojtjes në rastet kur e kishin kërkuar një të tillë. Në lidhje me pyetjen nëse kishin kërkuar të kishin një avokat gjatë marrjes në pyetje, një numër fare i vogël raportuan se nuk ishin në dijeni të kësaj të drejte, e cila tregon edhe njëherë se ata nuk ishin udhëzuar si duhet për të drejtat e tyre. Prandaj, duket se ka arsye të ndryshme për vonesa lidhur me të drejtën e mbrojtjes, duke përfshirë mungesën e njohjes dhe informacionit për këtë të drejtë.

<sup>53</sup> Shih "E drejta për një mbrojtje efikase" - Shtojca 2.

<sup>54</sup> Shih "E drejta për një mbrojtje efikase" - Shtojca 3, pyetja 16 b.

<sup>55</sup> Takim, datë 27 prill 2005.

<sup>56</sup> Botimi "E drejta e mbrojtjes falas në Shqipëri", Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Tiranë 2005, fq. 23, ku thuhet se sipas të dhënave të dala nga intervistat me personat e arrestuar ose të ndaluar, vetëm 50,09 % e të 350 të intervistuarve, ishin informuar për të drejtat e tyre.



**Disa shembuj të deklarimeve të të intervistuarve për të drejtën për të pasur avokat:**

*Personi 1: U vura në dijeni për të drejtën për të mos deklaruar dhe për të njoftuar anëtarët e familjes para se të pyeteshin por vetëm pasi më morën në pyetje më njoftuan për të drejtën për të pasur avokat.*

*Personi 2: Më thanë se mund të mbrohesha me avokat sapa të kisha mbaruar së treguari të gjitha rrethanat e krimit.*

*Personi 3: Unë kërkova të kisha një avokat mbrojtës por më thanë se nuk kisha nevojë për një të tillë.*

*Personi 4: Unë kërkova një avokat mbrojtës por më thanë që policia nuk kishte telefon.*

Një problem tjetër është se të arrestuarve ose të ndaluarve nuk u krijohet mundësia të kontaktojnë një avokat mbrojtës dhe se, edhe kur sigurohen mjetet, i pandehuri zor se ka dijeni se me cilin avokat të kontaktojë apo se si ta kontaktojë atë. Në vend të tyre, shumica e të pandehurve treguan se ishte familja e tyre që u kishte caktuar avokatin. Kjo gjë që rrallë ndodh, nga ana tjetër, presupozon se i pandehuri është në gjendje të kontaktojë familjen e tij menjëherë pas arrestit. Meqenëse disa të pandehur nuk kanë mjete financiare për të paguar për shërbimin ligjor, ata janë gjithashtu në mëshirë të prokurorit për të zgjedhur mbrojtës të caktuar nga shteti. Në rastet kur i paraburgosuri është marrë në pyetje nga prokurori para seancës për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë, që normalisht ndodh kur i arrestuari ose i ndaluar është arrestuar në flagrancë,<sup>57</sup> si rregull avokati mbrojtës duhet të jetë i pranishëm. Sidoqoftë, në shumë raste, kjo duket më shumë si një formalitet dhe nuk ka për qëllim të mbrojtë në të vërtetë interesat e të pandehurit. Ka raste në të cilat avokati nuk është prezantuar me të pandehurin dhe raste kur avokati nuk është paraqitur më pas kësaj seance.

Një faktor tjetër që kufizon të drejtën e avokatëve mbrojtës është se vizitat mund të bëhen vetëm gjatë ditëve të javës nga ora 9.00 deri 15.00. Kjo do të thotë që personave që arrestohen apo ndalohen pas orës 15.00 në një ditë të premtë u mohohet mundësia për të pasur një avokat mbrojtës deri të hënë në orën 9.00. Kjo dhuron hapur Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Kushtetutën dhe Kodin e Procedurës Penale. Disa avokatë deklarojnë gjithashtu se atyre u nevojitet një autorizim nga prokurori për të kryer vizita. Megjithatë, nuk ka qenë e mundur të evidentohen arsyet ligjore për këtë praktikë. Me këtë gjë mund të abuzohet lehtësisht për të mohuar të drejtën e takimit me të paraburgosurit. Ndërkohë që ekziston një nevojë e ligjshme për të vërtetuar se avokati mbrojtës, i cili kërkon të takojë klientin të mbajtur në komisariatit e policisë apo në dhomat e paraburgimit, është në të vërtetë ai që pretendon se është dhe se është i autorizuar të përfaqësojë personin në fjalë, ky verifikim mund të bëhet lehtësisht duke kontrolluar identitetin dhe licencën e tij dhe duke e krahasuar këtë me regjistrin e anëtarësisë së Dhomës së Avokatisë.

<sup>57</sup> KPrP, nenet 255 dhe 256.

### **Shembull i një përfaqësimi formal nga një avokat mbrojtës**

Një i paraburgosur i mitur: *Pas 12 ditësh oficeri i policisë gjyqësore donte që unë të firmosja diçka. Unë nuk pranova. Ditën tjetër erdhi prokurori dhe kishte sjellë një avokat mbrojtës. Ata thanë se unë duhet të firmosja dhe qeshën. Kur unë nuk pranova të firmos, atëherë avokati mbrojtës firmosi për mua. Nuk e pashë më asnjëherë atë avokat mbrojtës. Pas rreth 30 ditësh, familja ime caktoi një avokat mbrojtës për mua.*

Si përfundim, edhe kur caktohet një avokat mbrojtës, duket se vetë avokatët mbrojtës rrallë shkojnë të konsultohen me të arrestuarin apo të ndaluarin përpara seancës për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë. Mund të ketë arsye të ndryshme për këtë, por një nga këto mund të jetë që avokati mbrojtës nuk e konsideron këtë seancë si një mundësi reale për të kundërshtuar heqjen e lirisë.

Si përfundim, në Shqipëri, personit të cilit i hiqet liria nuk ka mundësi të komunikojë me avokatin mbrojtës në kohën e duhur dhe praktikisht i mohohet e drejta për të kundërshtuar heqjen e lirisë. Ky problem rëndohet më tej nga fakti që vendimet për arrest në burg rrallë apelojnë.

## **4. Marrja në pyetje e të arrestuarit apo të ndaluarit**

### *Kuadri ligjor*

- Oficerët dhe agentët e policisë gjyqësore njoftojnë menjëherë prokurorin për arrestimin ose ndalimin.
- Me pëlqimin e të arrestuarit apo të ndaluarit, policia gjyqësore duhet të lajmërojë pa vonesë familjarët. Kur i arrestuari ose i ndaluarit është i mitur lajmërimi është i detyrueshëm dhe nuk varet nga pëlqimi i të miturit.<sup>58</sup>
- Prokurori merr në pyetje të arrestuarin në prani të mbrojtësit të zgjedhur ose të caktuar nga gjykata. Personi i arrestuar njoftohet për akuzën dhe përsëri për të drejtën për të mos dhënë deklaratë.<sup>59</sup>
  - o **Shënim:** Konventat ndërkombëtare, siç është Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, si dhe Kushtetuta kërkojnë që personi i arrestuar të vihet në dijeni menjëherë për akuzën që i bëhet në një gjuhë që ai kupton. Kushtetuta ka përparësi në krahasim me KPrP, i cili detyron vetëm prokurorin dhe jo autoritetin që ka bërë arrestimin, d.m.th. policinë, që të njoftojë personin e arrestuar.<sup>60</sup>
  - o Sipas KPrP, një person i dyshuar, të cilit ende nuk i është njoftuar akuzë, konsiderohet “person të cilit i atribuohet vepra penale” ose “person ndaj të cilit zhvillohen hetimet”. Pasi të jetë njoftuar akuzë, personi konsiderohet “i pandehur”.<sup>61</sup>

<sup>58</sup> KPrP, neni 255.

<sup>59</sup> KPrP neni 256 dhe neni 38 pika 3.

<sup>60</sup> Kushtetuta, nenet 31 dhe 4. Shih gjithashtu edhe Komentarin e KPrP, fq. 351.

<sup>61</sup> KPrP, neni 34, shih gjithashtu edhe Vendimin e Unifikues të Gjykatës së Lartë, nr. 3, datë 27 shtator 2005

- Megjithëse KPrP e shpreh qartë se është prokurori i cili drejton hetimet, përsëri KPrP i jep kompetenca policisë gjyqësore të marrë deklarata nga personi nën procedim penal.<sup>62</sup>

### Analizë

Prokurori drejton hetimet dhe si pasojë, kur kryhet një arrestim apo ndalim, policia gjyqësore informon prokurorin dhe e vë të arrestuarin në dispozicion të prokurorit për ta marrë në pyetje.<sup>63</sup> Gjithsesi, në bazë të dispozitave të përgjithshme lidhur me procedimin penal, policisë gjyqësore i jepen disa kompetenca për të marrë në pyetje personin ndaj të cilit zhvillohen hetimet.<sup>64</sup> Si KPrP ashtu edhe Komentari nuk japin ndonjë shpjegim se si lidhen këto dispozita me njëra tjetrën.

Për më tepër, neni 296, i cili i jep policisë gjyqësore kompetenca për të “marrë të dhëna nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet”, në fillim të tij përcakton praninë e detyrueshme të një avokati mbrojtës,<sup>65</sup> dhe më pas thuhet se në vendin e ngjarjes apo në rastin e veprave penale të dukshme ata mund të marrin *të dhëna të nevojshme për vazhdimin e hetimit*, pa praninë e një avokati mbrojtës.<sup>66</sup> Në fund të këtij neni përcaktohet që policia gjyqësore mund të marrë deklarata nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet, por përdorimi i tyre në gjykim nuk lejohet, me përjashtim të rastit kur kundërshtohet përmbajtja e deklaramit të bërë para gjykatës. Duket se kjo i hap rrugë policisë gjyqësore që të marrë në pyetje cilindo të dyshuar pa praninë e avokatit dhe të përdorë deklarime që vetëfajësojnë personin, mundësisht të marra gjatë ushtrimit të dhunës apo formave të tjera detyruese, të kundërshtojë deklaratat e mëvonshme me përmbajtje të ndryshme. Nga ana tjetër, kjo duhet krahasuar edhe me nenet 36 dhe 37 të KPrP, të cilët në mënyrë të qartë përcaktojnë se deklaramet e dhëna nga i pandehuri gjatë hetimeve nuk mund të përdoren kundër tij dhe se kur një person “i cili [ende] nuk është marrë si i pandehur” bën deklarime nga të cilat dalin të dhëna që e vetëfajësojnë, autoriteti procedues ndërpret pyetjen, duke e paralajmëruar, se pas këtyre deklaramëve mund të zhvillohen hetime ndaj tij dhe e fton të caktojë një mbrojtës. Deklarime të tilla nuk mund të përdoren kundër personit.

Praktika e policisë për të marrë në pyetje personin e arrestuar/ndaluar pa e njoftuar atë më parë për të drejtën e caktimit të një avokati mbrojtës është pra e paligjshme si dhe dhunon të drejtën e të pandehurit për të mos fajësuar veten. Mungesa e koherencës midis pjesëve të ndryshme të KPrP është thellësisht shqetësuese dhe e bën KPrP të hapur ndaj abuzimeve dhe interpretimeve keqdashëse. Siç do të shihet më poshtë, marrja fillestare në pyetje nga policia, shpeshherë shoqërohet me dhunë fizike, që është një argument më tepër për ta ndaluar menjëherë këtë praktikë.

<sup>62</sup> KPrP, nenet 277 dhe 296, pika 3.

<sup>63</sup> KPrP, neni 277.

<sup>64</sup> KPrP, neni 296.

<sup>65</sup> KPrP, neni 296, pika 1.

<sup>66</sup> Po aty, pika 2.

## 5. Keqtrajtimi fizik nga policia<sup>67</sup>

### Analizë

Shumë të arrestuar, 35 nga 71 (49%) të intervistuarit, 7 prej të cilëve ishin të mitur, pohuan se ishin keqtrajtuar ose gjatë arrestimit, gjatë transportimit për në posten e policisë ose gjatë marrjes në pyetje në komisariatit e policisë. Asnjëri nuk tha se kishte pësuar keqtrajtim pas kësaj. Disa nga personat që deklarojnë të jenë abuzuar fizikisht pretendojnë se kjo gjë u është bërë me qëllim që të pranonin një krim, ndërsa të tjerë deklarojnë se nuk e kishin idenë se çfarë donte policia prej tyre. Në shumë raste rrahja është bërë më shkop gome ose me mjete të tjera dhe duket se janë synuar ato pjesë të trupit që janë normalisht të mbuluara, siç janë këmbët. Disa nga të intervistuarit thonë se kanë pasur hematoma të dukshme në fytyrë dhe njëri prej tyre tha se ai gjatë seancës së vleftësimit të arrestit dhe caktimit të masës së sigurisë, i kishte thënë gjyqtarit për keqtrajtimin, por gjyqtari nuk i kishte kushtuar aspak vëmendje kësaj gjëje.

### Disa shembuj keqtrajtimi nga policia:

Një grua e arrestuar në shtëpinë e saj: *Ata më shkullnin flokët, më rrihnin dhe më gjuanin me grusht në bark dhe në këmbë. Ata më thoshin fjalë fyese.*

Një i mitur i arrestuar në rrugë: *Jam keqtrajtuar në komisariatit e policisë. Atje ishin nja 4- 5 policë. Ata më dogjën me cigare në krahun e djathtë dhe njëri prej tyre mori një kabëll elektrik dhe më rrahu me të. Ata më hoqën edhe çorapet dhe me bënë këmbët me vaj dhe pastaj më gjuanin me shkopinj të tyre në këmbë. Unë kisha të nxira gjithandej. Kjo gjë vazhdoi për rreth 2 deri në 3 orë. Ata donin që unë të pranoja gjithçka.*

Një burrë: *Ishte dita pas arrestimit. Ishin shtatë policë. Duart dhe këmbët i kisha të prangosur dhe isha vetëm me të mbathura. Ata po më gjuanin gjithandej me shkop, sidomos në këmbë dhe në kofshë. Dy oficerë policie më kapën duart nga prapa. Ata gjithashtu më gjuajtën në hundë me pjesën e pasme të automatikut dhe ma vendosen armën në gojë duke më thënë se do të më qëllonin. Kam një shenjë në hundë që prej kësaj dhe jam nxirë gjithandej, sidomos nëpër këmbë dhe në prapnicë. Që prej atëherë kam dhimbje në brinjë dhe në nofull. Nuk e di se çfarë deshën. Ndoshta donin që unë të pranoja...*

Një burrë: *Marrja në pyetje zgjati 5 deri në 6 orë pa ndërprerje dhe gjatë kësaj periudhe policia më rrahu disa herë.*

Një burrë: *Marrja në pyetje zgjati 5 ose 6 orë dhe mua më rrahën të gjithë, kujt ia kishte qejf. Ata më rrahën me copa druri. Bluza m'u mbulua me gjak. Më në fund më detyruan me forcë të nënshkruaja një dokument.*

Një burrë: *Ata më godisnin sa herë nuk u pëlqente përgjigjja ime, kryesisht me duar dhe me grusht. Në fund shkruan çfarë deshën dhe më detyruan që ta nënshkruaja.*

<sup>67</sup> Shih gjithashtu Raportin Vjetor të "Amnesty International" të vitit 2006 për Shqipërinë. <http://www.amnesty.org/report2006/alb-summary-eng> [vizituar më 27 maj 2006].

Praktika e policisë për të keqtrajtuar të arrestuarit është e paligjshme dhe në kundërshtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Nivelet e larta të policisë shqiptare dhe sistemi i drejtësisë nuk kanë mundur të veprojnë kundër rasteve të abuzimit nga policia, gjë e cila nxjerr në pah të metat e sistemit. Ekziston një nevojë urgjente për të ndërmarrë masa të menjëhershme për t'i dhënë fund kësaj praktike dhe për të trajtuar çdo rast kur ajo ndodh. Duhet pasur parasysh se çfarëdolloj e dhëne e marrë nga një i dyshuar, i cili ende nuk është njoftuar për akuzën, është e papranueshme në gjykim dhe, për më tepër, çfarëdolloj e dhëne e marrë me forcë është e papranueshme në vetvete.<sup>68</sup>

## 6. Afati i shqyrtimit të vleftësimit të arrestit dhe caktimit të masës së sigurisë

### *Kuadri ligjor*

- Në bazë të Kushtetutës, personit të cilit i është hequr liria duhet të dërgohet brenda 48 orëve përpara gjyqtarit, i cili vendos paraburgimin ose lirimin e tij jo më vonë se 48 orë nga çasti i marrjes së akteve për shqyrtim.<sup>69</sup>
- Gjithsesi, sipas KPrP, ku gjykata përpara arrestimit ka dhënë urdhër për arrest në burg, i arrestuari merret në pyetje nga gjykata jo më vonë se tri ditë nga zbatimi i vendimit “arrest në burg” [seanca e verifikimit]. Kjo bëhet me qëllim që të verifikohet nevoja për të vazhduar paraburgimin. Në këtë seancë marrin pjesë prokurori dhe avokati mbrojtës.<sup>70</sup>
  - o **Shënim:** Kjo është një ditë më shumë se sa parashikohet në Kushtetutë, dhe duke qenë se Kushtetuta ka përparësi,<sup>71</sup> kufiri kohor është 48 orë.<sup>72</sup>
- Në rastet kur prokurori vendos për arrestimin/ndalimin, atëherë ai brenda 48 orëve duhet të *kërkojë* vleftësimin e masës nga ana e gjykatës [seanca e vleftësimit]. Mosrespektimi i këtij afati e bën arrestimin të humbasë fuqinë. Gjykata më pas cakton seancën sa më shpejt.<sup>73</sup>
  - o **Shënim:** Edhe kjo dispozitë është në kundërshtim me Kushtetutën, duke qenë se Kushtetuta kërkon që personit të cilit i është hequr liria të sillet përpara gjykatës brenda 48 orëve. Kështu pra, sipas KPrP, prokurori mund ta depozitojë çështjen në orën e 48-të, *pas së cilës* gjykata cakton seancën.
- Seanca e vleftësimit zhvillohet në prani të prokurorit dhe të avokatit mbrojtës.
- Arrestimi e humbet fuqinë nëse gjykata nuk e shpall vendimin e saj brenda 48 orëve nga momenti që prokurori ia paraqet kërkesën gjykatës.<sup>74</sup>

<sup>68</sup> KPrP, neni 296, pika 3 dhe Kushtetuta, neni 32, pika 2.

<sup>69</sup> Neni 28, pika 2.

<sup>70</sup> Neni 248.

<sup>71</sup> Kushtetuta, neni 4.

<sup>72</sup> Diskutimet me një sërë prokurorësh në të gjithë Shqipërinë kanë treguar se sidoqoftë, afati prej 48 orësh i përcaktuar në Kushtetutë nuk respektohet, por ndërkohë zbatohet vetëm KPrP.

<sup>73</sup> KPrP, neni 258.

<sup>74</sup> KPrP, neni 259, pika 5.

## Analizë

KPrP nuk e paraqet me saktësi afatin kohor prej 48 orëve të përcaktuar në Kushtetutë. Kështu sipas KPrP, kur gjykata lëshon urdhrin për arrest, gjyqtari duhet të zhvillojë seancën e verifikimit *jo më vonë se tri ditë* pas arrestimit.<sup>75</sup> Kur arrestimi është urdhëruar nga prokurori apo është bërë me nismën e policisë gjyqësore, prokurori brenda 48 orëve duhet t'i *kërkojë* gjykatës të vlerësojë arrestimin, kohë *pas* së cilës gjykata cakton datën e seancës së vleftësimit sa më shpejt të jetë e mundur. Në shumicën e rasteve, në të dyja procedurat rezulton që seanca e vlerësimit të mbahet *pas* përfundimit të afatit kohor prej 48 orëve të përcaktuar në Kushtetutë. Nëse për shembull prokurori e dorëzon kërkesën në orën e 48-të, është praktikisht e pamundur për gjykatën që të mbajë një seancë përpara përfundimit të afatit.

Sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Gjykata Evropiane), neni 5 i KEDNj *“garanton një të drejtë themelore të njeriut, konkretisht mbrojtjen e individit kundër ndërhyrjeve arbitrare të shtetit ndaj të drejtës [së tij/saj] për liri. Kontrolli gjyqësor i ndërhyrjeve të ekzekutivit në të drejtën e individit për liri është një element thelbësor i sigurisë i mishëruar në nenin 5, paragrafi 3, i cili ka për qëllim të minimizojë rrezikun për arbitraritet.”*<sup>76</sup> Gjuha e përdorur nga gjykata në vendimin e sipërcituar, mund të interpretohet se do të thotë që neni 5 është i zbatueshëm vetëm kur ekzekutivi, d.m.th policia, bën arrestimin me nismën e saj dhe jo kur arrestimi është urdhëruar nga gjyqësori. Megjithatë, ky interpretim është në kundërshtim me formulimin e nenit 5, paragrafi 3, të KEDNj, ku thuhet: *“Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur, në kushtet e parashikuara në paragrafin 1.c të këtij neni, duhet të çohet menjëherë”*<sup>77</sup> përpara një gjyqtari...”. Për më tepër, ndërsa një vendim për arrestim mund të merret nga një gjyqtar, në fakt kryhet nga ekzekutivi, d.m.th policia, që do të thotë se shqyrtimi i mëtejshëm nga gjyqtari përsëri shërben për të kontrolluar ekzekutivin. E drejta e paraqitjes përpara një gjyqtari i jep personit të arrestuar gjithashtu mundësinë për të kundërshtuar heqjen e lirisë (*habeas corpus*) dhe garanton që gjyqësori të shqyrtojë çdo arrestim të kryer nga ekzekutivi. Ky shqyrtim shërben gjithashtu edhe si një siguri minimale kundër mospasqyrimin të saktë të të dhënave dhe abuzimit nga policia. Është e dokumentuar fare mirë nga “Amnesty International” që shumica e mospërputhjes së afateve kohore dhe dhunës policore ngjasin gjatë arrestimit fillestar.<sup>78</sup>

Kushtetuta e Shqipërisë, formulimi i së cilës bazohet shumë në KEDNj, kërkon që *personi* të cilit i është hequr liria (i dyshuar për kryerjen e një vepre penale), të paraqitet përpara gjyqtarit brenda 48 orëve.<sup>79</sup> Ky gjyqtar më pas vendos për paraburgimin apo

<sup>75</sup> KPrP, neni 248.

<sup>76</sup> Çështja “Brogan dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar”, 28 tetor 1988, paragrafi 58.

<sup>77</sup> Kjo fjalë në tekstin origjinal nuk është me germa të zeza. Këtu është bërë e tillë për ta vënë në dukje.

<sup>78</sup> Shih p.sh. <http://www.amnesty.org/library/eng-344/index> [vizituar më 27 maj 2006]. Shih gjithashtu Fletëpalosjen nr.6 (Rishikimi 2) i Zyrës së Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, mospërputhja e afateve kohore me forcë apo të pavullnetshme <http://www.unhchr.ch/html/menu6/2/fs6.htm> [vizituar më 27 maj 2006].

<sup>79</sup> Koha fillon të matet që në momentin e arrestimit/kapjes, jo më vonë, p.sh. kur personi është mbyllur në komisariatit e policisë. KPrP, neni 250 dhe Komentari i KPrP, fq. 349.

lirimin e personit jo më vonë se 48 orë nga momenti kur gjyqtari merr dokumentacionin për shqyrtim. Mënyra si është formuluar Kushtetuta nuk dallon midis arrestimeve të bëra me nismën e ekzekutivit dhe ato të bëra në bazë të urdhrave të gjyqësorit, që do të thotë se sipas Kushtetutës *çdo person* të cilit i është hequr liria (në bazë dyshimesh të arsyeshme për kryerjen e një krimi), ka të drejtë që *personalisht* të paraqitet para një gjyqtari brenda 48 orëve nga momenti i arrestimit. Për më tepër, ndërkohë që KPrP nuk i jep personit të arrestuar me urdhër të gjykatës, të drejtën të paraqitet përpara një gjyqtari brenda 48 orëve, ai ia njuh të drejtën personit *për marrjen në pyetje nga gjyqtari*, por vetëm brenda tri ditësh. Gjyqtari i *dytë* duhet të verifikojë kushtet dhe nevojat e sigurimit [mbi të cilat është bazuar vendimi i gjyqtarit të parë].<sup>80</sup> Fakti që parimi i *habeas corpus* njihet në sistemin shqiptar të drejtësisë, konfirmohet edhe nga Komentari i Kodit të Procedurës Penale.<sup>81</sup> Atëherë, përse ekziston kjo mospërputhje ndërmjet Kushtetutës dhe KPrP?

Neni 258 i KPrP, sipas të cilit prokurori duhet t'i *kërkonte* gjykatës të vlerësonte arrestimin, u ndryshua në vitin 2002, d.m.th pas miratimit të Kushtetutës.<sup>82</sup> Më parë kërkesa për vleftësim duhej dorëzuar brenda 24 orësh, që do të thotë se ishte ky ndryshim që bëri që KPrP të jetë në kundërshtim me Kushtetutën për sa u përket arrestimeve të ndërmarra nga policia apo prokuroria. Një shpjegim i mundshëm për këtë kontradiktë mund të gjendet tek *Debati Kushtetues*,<sup>83</sup> ku diskutimet në lidhje me afatet për të paraqitur një person të arrestuar përpara gjyqtarit nxjerrin në pah se anëtarët e komisionit të posaçëm nuk e kanë të qartë se KEDNj dhe Kushtetuta i japin *personit* të cilit i është hequr liria të drejtën të paraqitet, d.m.th *të shohë* një gjyqtar. Në këta debate nuk bëhet dallimi midis *aktit* apo *dosjes* dhe *personit*. Një tregues tjetër që tregon se ky mund të jetë burimi i kontradiktës është se në *Debatin Kushtetues* diskutohet shumë për afatin e *dytë* kohor sipas të cilit “[gjyqtari] do të vendosë paraburgimin apo lirimin [e të arrestuarit] jo më vonë se 48 orë nga momenti që [gjyqtari] merr dokumentacionin për shqyrtim.”<sup>84</sup> Kjo në fakt do të thotë që nëse dokumentet arrijnë në gjykatë pas 10 orësh, vendimi duhet dhënë jo më vonë se 48 orë pas kësaj, pavarësisht se kur paraqitet i arrestuari përpara gjyqtarit.<sup>85</sup> Ndoshta nuk ishte ky qëllimi.

<sup>80</sup> KPrP, neni 248 pika 2 dhe Komentari i KPrP fq. 334, 334.

<sup>81</sup> Komentari i KPrP fq. 334, “Detyrimi për marrjen në pyetje e të arrestuarit buron nga parimi i njohur i *Habeas Corpus*, sipas të cilit personi i arrestuar duhet të dëgjohet nga gjyqtari ....”. Shih më tej tek i njëjti, fq. 364, “Në këtë mënyrë shkelet parimi i njohur i *Habeas Corpus*, sipas të cilit i arrestuari duhet të **paraqitet fizikisht** përpara gjyqtarit për t’iu dhënë mundësia të dëgjohet para se të vendoset qëndrimi i mëtejshëm në burg.” [është shtuar theksimi me të zezë].

<sup>82</sup> Ligji nr. 8813, datë 13 qershor 2006, që ndryshon paragrafin 1 të nenit 258.

<sup>83</sup> Gjatë hartimit të Kushtetutës në vitin 1998, u mbajtën një sërë debatesh në komisionin e posaçëm parlamentar për hartimin e kushtetutës. Këto debate u regjistruan dhe më pas Prezenca e OSBE-së në Shqipëri financoi transkriptimin dhe redaktimin e debateve, të cilat u botuan në qershor të vitit 2006. Botimi i *Debatit Kushtetues* paraqet historinë legjislative të Kushtetutës dhe do të ndihmojë në të kuptuarin dhe zbatimin e duhur të Kushtetutës.

<sup>84</sup> *Debati Kushtetues: Diskutimet në Komisionin Parlamentar për Hartimin e Projektkushtetutës (Tiranë, 2006), vëllimi I, fq. 85-98.*

<sup>85</sup> Shih gjithashtu KPrP neni 259, pika 5.

**Disa fragmente të shkëputur nga *Debati Kushtetues*:<sup>86</sup>**

Zë i paidentifikueshëm: Pra, bëhet fjalë për një 48 orësh, tek pika 2, brenda së cilës organi përkatës mund ta çojë tek gjyqtari, si dhe për 48 orë të tjera që nga momenti që *personi i ndaluar* shkon tek gjyqtari...

Zë i paidentifikueshëm: A e realizojmë dot kalimin e *dokumenteve* të personit të ndaluar nga policia tek prokuroria, dhe pasi kjo t'i ketë studiuar e përgatitur, t'i kalojmë për miratim përfundimtar tek gjykata brenda 48 orëve të dyta?...

Zë i paidentifikueshëm: Pika 2 flet për një person në gjendjen e ndalimit, ndaj të cilit organi i policisë, brenda 48 orëve, duhet të marrë një nga këto masa: ose t'i përcjellë *dokumentet* në gjykatë nëpërmjet prokurorisë, duke kërkuar kthimin e tij nga të ndaluar në të arrestuar, ose ta lirojë këtë person...

Zë i paidentifikueshëm: Asnjë nuk mund të mbahet më shumë se 48 orë; në qoftë se mbahet pas këtyre 48 orëve, do të thotë se *dosja* e këtij personi ka kaluar për gjykim në gjykatë...

Zë i paidentifikueshëm: A ju duket i arsyeshëm ky sugjerim, sipas të cilit policisë t'i lihen 48 orë që të marrë masa *për të çuar dosjen* e të ndaluarit në gjykatë, kurse gjykatës t'i lihen vetëm 24 orë?...

Zë i paidentifikueshëm: Prokurorit i duhet që, brenda 48 orëshit, të përgatisë *dosjen* në ngarkim të të ndaluarit dhe t'ia dërgojë atë gjykatës ...

Zë i paidentifikueshëm: Për të gjykuar nëse është e vlefshme ose jo masa që ka marrë prokuroria, ndoshta do të ishte mirë një shprehje këtu, që do të qartësonte më mirë kuptimin e këtij neni, ku të thuhet që askush nuk mund të mbahet më shumë se 48 orë, përpara paraqitjes tek gjyqtari...

Zë i paidentifikueshëm: Është bërë përpjekje për të ndarë kohën që organet e tjera kanë që nga koha e ndalimit deri në momentin e kalimit të *materialeve të çështjes* për vlerësimin e masës në gjykatë. Po të shprehesh siç propozon zoti Abdiu, duket sikur prokuroria *ia kalon dokumentet* gjykatës për vlerësim orën e fundit...

Arben Imami: Për të qenë në përputhje me standardet evropiane dhe vëzhgimet e Këshillit të Evropës, propozimi ynë është që të hiqet nga ky nen pika 2: "askush nuk mund të mbahet i arrestuar për më shumë se 72 orë", dhe se 48 orët në pikën parashikohen për arrestimin përpara se *çështja* të çohet përpara gjykatës....

Pandeli Majko: Pra kjo do të thotë që brenda 48 orësh *ai* duhet të paraqitet përpara gjyqtarit dhe brenda 24 orësh gjyqtari duhet të marrë një vendim?...

Krenar Loloçi: Ekziston një praktikë e unifikuar nga Këshilli i Evropës sipas së cilës 48 orët e para janë në dispozicion të policisë dhe prokurorit, dhe mbas këtyre 48 orësh, kur i *dokumentat* i kalojnë gjyqtarit, fillon 48- orëshi tjetër në dispozicion të gjykatës për të shqyrtuar *këta dokumenta*. ...

Nga bisedat e shumta me prokurorë dhe gjyqtarë duket gjithashtu se pak janë në dijeni të kësaj kontradikte dhe shumë prej tyre e thanë shprehimisht se ndjekin KPrP dhe jo Kushtetutën. Është interesant fakti që megjithë të përmendurin e parimit të *habeas corpus* që u citua më sipër, Komentari nuk e përmend këtë kontradiktë.<sup>87</sup>

<sup>86</sup> *Debati Kushtetues*, Vëllimi I, fq. 89-98.

<sup>87</sup> Komentari i KPrP, fq. 351.



Vëzhgimi për paraburgimin e konfirmon gjithashtu se dërgimi i të arrestuarve përpara gjyqtarit brenda 48 orëve nga momenti i arrestimit, ndodh vetëm si përjashtim dhe se nuk është e pazakontë që ata të paraqiten përpara gjyqtarit 4 ose edhe 5 ditë pas arrestimit. Kështu, vetëm trembëdhjetë për qind e të paraburgosurve të intervistuar pohuan se kishin dalë përpara gjyqtarit brenda 48 orësh nga arrestimi i tyre. Shtatëdhjetë e katër për qind deklaruan se ishin paraqitur përpara gjyqtarit më vonë se 48 orë pas arrestimit dhe nga këta, 17 për qind deklaruan se ishin sjellë përpara gjyqtarit më vonë se tri ditë pas arrestimit.<sup>88</sup> Sipas disa treguesve, vonesat më të gjata mund të vijnë si rezultat i praktikës së gabuar për fillimin e numërimit të orëve jo në momentin e arrestimit, por pas regjistrimit dhe mbylljes së personit në komisariatit dhe policisë.

## 7. Seanca për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë

1. *Kriteri i dyshimit të arsyeshëm i bazuar në prova*
2. *Kriteri specifik*
  - a. *rreziku i dëmtimit të provave,*
  - b. *rreziku i largimit/arratisjes nga burgu ose,*
  - c. *rreziku i kryerjes së krimeve të tjera*
3. *Kriteri i përshtatshmërisë*
4. *Kriteri i domosdoshmërisë*

Qëllimi i seancës për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë është rishikimi i arsyeve dhe ligjshmërisë së masës paraprake. Kjo aplikohet pavarësisht se nga është urdhëruar arresti - nga një gjyqtar, nga një prokuror apo me iniciativën e policisë gjyqësore. Prandaj, rishikimi duhet të marrë në konsideratë nëse, për shkak të rrethanave të veçanta të çështjes dhe të individit, ka baza të arsyeshme për dyshim, *si edhe* nëse ekziston rreziku i dëmtimit të provave, arratisjes apo veprave të tjera penale. Kur gjyqtari të jetë bindur se janë plotësuar këto kushte, ai duhet të marrë në konsideratë nëse masa është e përshtatshme dhe së fundmi, nëse asnjë masë tjetër, si arrest në shtëpi, lirim me kusht apo paraqitje e detyrueshme për dhënie të dhënash nuk do të ishte e mjaftueshme.<sup>89</sup> Dyshimi duhet të bazohet në fakte dhe prova dhe përcaktimi i kushteve të tjera duhet të bazohet gjithashtu në fakte lidhur me çështje të veçanta, jo vetëm në supozime të thjeshta ose çfarë mendon apo beson gjyqtari ose prokurori.<sup>90</sup> Meqenëse një nga arsyet e seancës është të sigurohet e drejta *habeas corpus*, seanca duhet t'i japë gjithashtu të arrestuarit një mundësi të vërtetë për të ankimmuar vendimin. Kështu, i arrestuari mund të prapësojë dyshimin mbi baza të arsyeshme dhe/ose deklaratat se rrezikohet vërtetësia e provave, se ekziston rreziku i largimit apo i kryerjes së veprave të tjera penale, dhe se masa është gjithashtu në raport me rëndësinë e faktit.

<sup>88</sup> Shih Paraburgimin - Shtojca 1.

<sup>89</sup> KPrP, nenet 228, 229 dhe 230.

<sup>90</sup> Komentari i KPrP, fq. 319.

Megjithatë, në praktikë duket sikur seanca për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë është thjesht një formalitet që në shumë raste mbaron brenda pak minutash. Shumë nga të intervistuarit në burg treguan se gjyqtari vetëm lexonte të dhënat e tyre personale dhe akuzën, nganjëherë pyeste nëse ata e pranonin akuzën apo jo dhe më pas merrte vendimin. Për sa i përket vendimit, vetëm 6 prej tyre (8 për qind) sipas pyetësorit në paraburgim thanë se arsyet për dhënien e masës së sigurisë u përmendën nga gjyqtari pas dhënies së vendimit. Dyzet e pesë për qind, d.m.th., më pak se gjysma e të intervistuarve, thanë se ishin njoftuar se vendimi mund të apelohej. Megjithatë, për të siguruar se i arrestuari mund të ushtrojë të drejtat e tij, gjyqtari që drejton seancën duhet t'i shpjegojë të pandehurit se në çfarë lloj seance ai/ajo po merr pjesë, cilat janë të drejtat e tij/saj, cilat janë arsyet e heqjes së lirisë dhe cila është mundësia e apelimit të vendimit për arrestin në burg (nëse seanca është *seancë verifikimi*) ose të vendimit që pason *seancën e vleftësimin*.

Duke pasur parasysh që në shumicën e rasteve avokatët mbrojtës i takojnë klientët e tyre për herë të parë *gjatë* seancës për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë, mund të mos jetë çudi të zbulohet se roli i tyre gjatë seancës të jetë shumë pasiv. Ndërsa avokatët me raste argumentonin se arresti në shtëpi do të ishte i mjaftueshëm, nuk kishte të dhëna që ky pretendim është marrë parasysh në çështjet e shqyrtuara.

## 8. Përmbajtja e vendimit; apelimi dhe revokimi

### *Kuadri ligjor*

Vendimet për arrestin në burg:

- Vendimet për arrestin në burg përmbajnë gjeneralitetet e të pandehurin, akuzën, fakte dhe nene të kodit penal, si edhe arsyet për caktimin e masës.
  - Kur ndaj një personi jepet masa e arrestit në burg për shkak se ekziston rreziku i dëmtimit të provave, duhet të përcaktohet kohëzgjatja e masës.<sup>91</sup>
- Prokurori, i pandehuri dhe avokati mbrojtës mund të apelojnë vendimin në Gjykatën e Lartë. Kërkesa ankimore duhet të depozitohet në sekretarinë e gjykatës ku është marrë vendimi brenda dhjetë ditëve nga dhënia e vendimit ose njoftimi i vendimit.
- Brenda pesë ditëve nga marrja e kërkesës ankimore, dosja dërgohet në gjykatën [d.m.th., në Gjykatë të Apelit ose Gjykatë të Lartë] e cila shqyrton kërkesën brenda dhjetë ditëve të tjera, pas njoftimit të palëve të paktën tri ditë para seancës.<sup>92</sup>
- Prokurori dhe i pandehuri mund të kërkojnë në çdo kohë revokimin ose zëvendësimin e masës paraprake. Gjykata duhet t'i shqyrtojë këto kërkesa brenda pesë ditëve. Gjykata mund ta revokojë ose zëvendësojë masën kryesisht.<sup>93</sup>

---

<sup>91</sup> KPrP, neni 245.

<sup>92</sup> KPrP, neni 249.

<sup>93</sup> KPrP, neni 260.

- Nëse nuk respektohen afatet kohore për seancat e *vleftësimit ose verifikimit*, arresti e “humbet fuqinë e tij”, d.m.th. bëhet i pavlefshëm dhe nuk ka fuqi ligjore.<sup>94</sup> Kur arresti “humbet fuqinë e tij” gjykata vendos lirim të pandehurit.<sup>95</sup>

### ***Analizë – Vendimi për arrest në burg***

Siç u përmend edhe më sipër, një vendim për arrest në burg përmban, ndërmjet të tjerave, parashtrimin përmbledhës të fakteve, duke përfshirë referimin për veprën penale për të cilën dyshohet i arrestuari, si dhe parashtrimin e shkaqeve të posaçme dhe të të dhënave që përligjin masën e sigurimit. Kohëzgjatja e masës duhet të caktohet kur ajo urdhërohet për të garantuar marrjen ose vërtetësinë e provës.<sup>96</sup> Nëse arresti është bërë me iniciativën e prokurorit ose policisë, gjykata *merr vendim për vleftësimin e masës së sigurimit*.<sup>97</sup> Megjithëse jo e qartë nga KPrP, mund të mendohet se vendimi duhet të merret në përputhje me atë që theksohet më sipër. Kur arresti është urdhëruar me vendim gjykatë, *seanca e vleftësimit* pasqyrohet në procesverbal me datën dhe orën e zhvillimit të seancës.<sup>98</sup> Vendimi “origjinal” i gjykatës mund të apelohe brenda 10 ditëve nga marrja ose njoftimi i tij.<sup>99</sup>

### ***Komente të përgjithshme***

Për qëllime studimi janë analizuar 10 vendime të marrjes së masës së sigurisë arrest në burg.<sup>100</sup> Përveç një rasti, ku nuk u paraqit asnjë fakt dhe të pandehurit u liruan, të gjitha vendimet shprehin, të paktën deri në një farë mase, faktet e çështjes. Shtatë vendime gjithashtu trajtonin çështjen nëse kishte dyshim të arsyeshëm kundër të pandehurve, që është kriteri i parë [*kriteri i dyshimit të arsyeshëm*] i cili nevojitet për të marrë masën e arrestit në burg. Për sa i përket kriterit të dytë [*kriteri specifik*] sipas Kushtetutës dhe KPrP, vetëm tri (nr. 3, 5 dhe 8) nga nëntë vendimet që konfirmojnë arrestin, i referohen secilës nga këto kritere. Ato tri vendime i referohen gjithashtu disa prej kritereve të tjera të përcaktuara në nenet 229 dhe 230 të KPrP [*kriteret e domosdoshmërisë dhe të përshatshmërisë*]. **Vetëm një vendim (nr. 5) i referohet të gjitha kritereve të domosdoshme për arrest në burg.** Ndërsa vendimet nr. 1, 4 dhe 6, i referohen vetëm kriterit të *domosdoshmërisë*, vendimi nr. 2 i referohet vetëm faktit që ka një veprë penale të rëndë, i cili është *kriteri i përshatshmërisë*.

Tri vendime (nr. 1, 2 dhe 6) argumentojnë që nevoja për më shumë prova ose hetime është arsye për të arrestuar një person në burg, ndërsa një vendim (nr. 8) argumenton se situata e tensionuar ndërmjet familjes dhe përhapja e asaj veprë penale, janë arsye për arrestin në burg. Asnjë prej këtyre nuk është arsye e ligjshme për heqjen e lirisë së kujtdo.

<sup>94</sup> KPrP, neni 261.

<sup>95</sup> KPrP, neni 262.

<sup>96</sup> KPrP, neni 245.

<sup>97</sup> KPrP, neni 259 paragrafi 3.

<sup>98</sup> KPrP, neni 115, shih gjithashtu Komentarin e KPrP, fq. 337.

<sup>99</sup> KPrP, neni 349, paragrafi 1.

<sup>100</sup> Për tabelën me të dhënat bazë për vendimet, shih Paraburgimi - Shtojca 3.

Në vendimin nr. 9, lidhur me arrestimin e Leonard Kokës, vëllait të Kryetarit të Bashkisë së Partisë Socialiste (PS) në Durrës, Lefter Koka, vlen të theksohet se në vendim, përveç dyshimit të arsyeshëm, *nuk janë përmendur arsye të tjera për arrestin*. Në vendimin nr. 10, lidhur me dy të pandehurit, njëri prej tyre i mitur 16-vjeç, shpjegohen fakte të sekuestrimit të një sasive kanabis, por jo se si është kryer arresti. Në këtë vendim *nuk diskutohet as dyshimi i arsyeshëm, as arsyet e tjera të arrestit*; nenet 228 dhe 229 të KPrP thjesht janë përmendur pa shpjegime të mëtejshme.

Vetëm njëri prej tri vendimeve që i referohet *kriterit specifik* shpjegon, se pse rrethanat e veçanta të çështjes ishin të tilla që përmbushnin një ose më shumë *kritere specifike*. Pra, në vendimin nr. 3, kundër një të pandehuri që dyshohej për trafikim dhe kërcënim të një gruaje, e cila më pas e kishte denoncuar atë në polici, fakti që ai kishte qenë jashtë shtetit shumë herë në të kaluarën, ishte konsideruar si argument që prezumonte se ai mund të largohej përsëri. Gjyqtari vazhdonte edhe me arsyetimin se kishte rrezik që i pandehuri mund të kryente vepra të tjera penale ndaj të dëmtuarës/viktimës. Ky vendim diskuton gjithashtu *kriterin e përshtatshmërisë*. Dy vendimet e tjera (nr. 5 dhe 8) nuk japin ndonjë shpjegim se pse rrethanat e veçanta tregojnë se i pandehurit mund të largohet ose t'i zhdukë provat.<sup>101</sup>

#### *Arrest në burg për më shumë se sa një të pandehur*

Në vendimet 1, 2, 4, 6, 7 dhe 10 shumë të pandehur dyshohen se kanë marrë pjesë në të njëjtën vepër penale. Ndërsa vendimet 1 dhe 2 janë paraqitur me korrektësi veç e veç, vendimet e tjera janë të vlefshme për shumë të pandehur; vendimi 6 përfshin pesë të pandehur. Në asnjë nga vendimet që përfshijnë më shumë se sa një të pandehur nuk janë shpjeguar rrethanat e veçanta për secilin të pandehur; por në vend të kësaj, të gjithë janë trajtuar sikur të ishte vetëm një person. E drejta e mosheqjes së lirisë në mënyrë arbitrare është një e drejtë individuale. Si rrjedhim, gjykata duhet të jetë e bindur që rrethanat individuale të çdo personi të cilit i është hequr liria janë të tilla që përbëjnë baza të arsyeshme për arrestin e tyre në burg. Megjithatë, nuk është praktikë e pranueshme të trajtohen shumë të pandehur sikur të ishte një i vetëm.

#### *Arrest në flagrancë*

Siç shpjegohet në fillim të këtij kapitulli, një situatë *flagrance* është kur dikush kapet në kryerje e sipër të veprës penale, kapet pas një ndjekjeje të pandërprerë nga vendngjarja ose kapet me sende që tregojnë se ai/ajo ka kryer veprën penale.<sup>102</sup> Nëse plotësohen kushtet e tjera **dhe** vepra penale mund të dënohet me burgim jo më të ulët në maksimum se dy vjet, policia gjyqësore ka të drejtë të kryejë arrestimin me iniciativën e saj.<sup>103</sup> Nga shembujt e mëposhtëm del se këto kërkesa procedurale nuk plotësohen gjithmonë dhe policia gjyqësore kryen arrestime me iniciativën e saj edhe kur nuk është në *flagrancë*.

<sup>101</sup> Për lexime shtesë rreth arsyetimeve të vendimeve mbi arrestin në burg, shih Komentarin fq. 321 e në vijim.

<sup>102</sup> KPrP, neni 252.

<sup>103</sup> KPrP, neni 251.

Vendimet 1 dhe 2 kanë të bëjnë me të njëjtën vepër penale: trafikimin e grave për qëllime prostitucioni. Nga shpjegimi i fakteve, duket se i pandehuri në vendimin nr. 1 (i pandehuri 1) u kap së bashku me një grua të trafikuar më 30 janar 2003. Gruaja dëshmoi se ishte “marrë” nga i pandehuri 1 prej të pandehurit 2 (vendimi nr. 2). Më pas, ajo kishte udhëtuar me të pandehurin 1 për në Durrës, Tiranë dhe Kosovë dhe më pas u kthyen në Shqipëri dhe u kapën. Duket qartë se për të pandehurin 1, i cili u kap bashkë me gruan në *flagrancë*, me sa duket nuk ishte e njëjta gjë edhe për të pandehurin 2.

Në vendimin nr. 3, duket se krimi dhe arresti nuk kanë ndodhur në të njëjtën ditë, që do të thotë se me siguri nuk ka qenë një rast *flagrance*. Për sa i përket shpjegimit të fakteve në vendimin nr. 5, në lidhje me veprën penale të trafikut të narkotikëve, theksohet se është gjetur një sasi kanabis gjatë një kontrolli në një shtëpi më 18 prill 2003. Disa dëshmitarë më vonë dëshmuan se kishin blerë kanabis nga i pandehuri. I pandehuri u arrestua më 2 prill 2003. Arsyeya pse ky rast u konsiderua si çështje në *flagrancë* nuk shpjegohet. Në vendimin nr. 7, policia gjyqësore arrestoi dy persona pasi policia kishte regjistruar në video të një emisioni televiziv ku një ose dy prej tyre shfaqeshin duke marrë rryshfet. Me sa duket, ky nuk ishte një rast *flagrance*. Vendimi nr. 10 i referohet një arresti në *flagrancë*. Ka të bëjë me dy të pandehur, një të rritur dhe një të mitur. Vendimi shpjegon se një sasi kanabis ishte sekuestruar në një dyqan të zotëruar nga i pandehuri i rritur, që e identifikoi të miturin si pronarin e lëndës narkotike. Nga vendimi nuk është e qartë nëse dyqani ishte vendi ku i mituri e kishte lënë drogën apo vendi ku ai ishte arrestuar. Si rrjedhim, nuk është e qartë nëse arrestimi i të miturit ishte një arrest në *flagrancë*.

#### *Vdekja e Sokol Halilit (Vendimi nr. 8)*

Në 22 qershor 2005, Sokol Halili, 36 vjeç, u arrestua në *flagrancë* pas një përlëshjeje, gjatë së cilës ai i nguli thikën viktimës në stomak dhe në shpatull. Më datë 24 qershor, gjatë seancës për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë, Sokol Halili pësoi një krizë epilepsie.<sup>104</sup> Pavarësisht nga kjo, atij iu dha masa e arrestit në burg. Meqenëse personeli i burgut nuk ishte në gjendje ta ndihmonte gjatë krizave të vazhdueshme të epilepsisë, prokurori paraqiti një kërkesë për të zëvendësuar arrestin në burg me arrest në shtëpi. Më 27 qershor gjykata vendosi ta pranojë kërkesën dhe ta lirojë Sokol Halilin nga burgu. Megjithatë, para se gjykata të vepronte, Sokol Halili vdiq në dhomën e paraburgimit.

Për sa i përket vendimit të arrestimit të Sokol Halilit në burg, pas përcaktimit të dyshimit të arsyeshëm, gjykata konstatoi se për shkak të dënimit të rëndë të parashikuar (3–10 vjet) ekzistonte rreziku se Sokol Halili do t’i fshihej hetimit dhe gjyqit.<sup>105</sup> Megjithatë, gjykata nuk dha shpjegime se çfarë rrethanash konkrete dhe specifike provonin rrezikun e supozuar të largimit të Sokol Halilit. Vendimi argumentonte më tej se serioziteti

<sup>104</sup> Kjo u konfirmua nga Policia e Durrësit si dhe gjyqtari që merrej me çështjen.

<sup>105</sup> Megjithëse ky nuk është një dënim i rëndë në kontekstin shqiptar, ky lloj arsytimi do të rezultonte “automatikisht” në arrest në burg në çdo rast kur krimi ndëshkohet me dënim të lartë, shtrohet pyetja se përse kjo gjë nuk parashikohet shprehimisht si rregull në KPrP.

i faktit, moshë e të arrestuarit, krimi për motive të dobëta, sanksionet e vëna dhe situata e tensionuar ndërmjet familjeve e çmon arrestin në burg si të vetmen masë të përshtatshme. Për sa i përket pretendimit të Sokol Halilit se ishte i sëmurë, dhe për këtë arsye arresti në shtëpi do të ishte më i përshtatshëm, gjykata konstatoi se ai nuk kishte sjellë prova për ta mbështetur atë. Si rrjedhim, gjykata nuk konstatoi se argumentet e tij ishin të bazuara në prova. Kriza e epilepsisë gjatë seancës për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë, nuk ishte përmendur fare.

Duke marrë parasysh arsyetimet e gjykatës se Sokol Halili nuk i kishte mbështetur me prova dëshmitë e tij lidhur me shëndetin, duhet të mbahet parasysh se i pandehuri *nuk kishte barrë prove* në seancën për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë. *Është gjykata që ka për detyrë të sigurojë* përmbushjen e të gjitha kriterëve për heqjen e lirisë së personit. Ligji thekson shprehimisht se nuk mund të jepet masa e arrestit në burg ndaj një *personi në kushte veçanërisht të rënda shëndetësore*, dhe për më tepër duhet të merret parasysh kur vendoset nëse masa është në përputhje me parimin e proporcionalitetit.<sup>106</sup> Veç kësaj, kriza epileptike që pësoi Sokol Halili gjatë seancës së vleftësimit duhet të kishte qenë e mjaftueshme për të treguar se personi kishte probleme të rënda shëndetësore. Megjithatë, duhet të ishin marrë në konsideratë mundësitë e trajtimit të Halilit kur u mor masa e arrestit në burg.

#### *Të pandehurit e liruar (Vendimi nr. 7)*

Vendimi nr. 7 ka të bëjë me dy punonjës dogane të dyshuar *për mitëmarrje*, d.m.th., ***një rast korrupsioni***. Arresti u krye pasi një program televiziv *Fiks Fare* tregoi një nga doganierët, i cili në shkëmbim të të hollave, lejoi një person (gazetar) të kalonte kufirin për në Greqi me një ngarkesë cigaresh pa paguar taksën doganore. Gjatë programit, gazetari shfaqet duke i dhënë diçka doganierit, i cili e fut atë në xhep. Policia e regjistroi programin televiziv në një kasetë dhe prokurori e paraqiti atë në seancë si provë për të mbështetur “*dyshimin e arsyeshëm*”.

Sidoqoftë, gjykata i hodhi poshtë provat dhe liroi të dyshuarit, duke arsyetuar se kasetat *nuk përbënte provë*, meqë nuk ishte marre në përputhje me nenet 198–226 të KPrP, dhe prokurori nuk kishte kërkuar ndonjë autorizim ose vlerësim tjetër të regjistrimit. Megjithëse Gjykata e Apelit e mbështeti këtë mënyrë të arsyetuarit, Gjykata e Larta e hodhi poshtë.

Sipas legjislacionit shqiptar, prova janë njoftimet mbi faktet e rrethanat që lidhen me veprën penale, që merren prej burimeve të parashikuara në ligjin procedural penal dhe në përputhje me rregullat e përcaktuara prej tij.<sup>107</sup> Sipas paragrafit të titulluar “*Dokumentet*”, neni 191 i KPrP përcakton shprehimisht se lejohet marrja e dokumenteve që përfaqësojnë fakte, persona ose sende nëpërmjet fotografimit, *filmimit*, fonografimit ose çdo mjeti tjetër. Në kapitullin që vijon, në nenet 198–226 përcaktohen qartë “*mjetet*

<sup>106</sup> KPrP, neni 230, paragrafi 2, dhe 229, paragrafi 2.

<sup>107</sup> KPrP, neni 149.

e kërkimit të provave”. Nenet 221 e në vijim kanë të bëjnë me përgjimin dhe përcaktojnë në mënyrë specifike se përgjimi i komunikimeve nga një person lejohet vetëm në rrethana të veçanta që nuk kanë të bëjnë me këtë rast. Arsyeja e këtyre dispozitave është mbrojtja e individëve ndaj ndërhyrjeve të pajustificuara nga ana e shtetit në punët e tyre private. Këto dispozita nuk shprehin asgjë në lidhje me regjistrimet e veprave penale në rrethana të tjera, siç është kamera e shitësit që regjistron një grabitje të dyqanit, filmim në mënyrë private të një zënke në rrugë, grabitjen e një banke ose, si në këtë rast, një gazetar (provokues dhe) filmimi i një veprave penale.

*Koment:* Me rritjen e shpejtë në numër të telefonisë celulare me anë të kamerave dhe pajisjeve të fotografimit, mund të shpresohet se kjo lloj prove mund të bëhet e zakonshme dhe në këtë mënyrë të luajë një rol të rëndësishëm në luftën kundër krimit dhe demaskimin e tij.<sup>108</sup> Meqenëse mundësia e manipulimit të regjistrimeve nuk duhet të nënvleftësohet, një regjistrim filmi, me fotografi apo me kasetë audio e një ngjarjeje është normalisht burimi më i mirë i mundshëm i provës, sepse tregon thjeshtë faktet siç ishin në një moment të caktuar kohe. Megjithatë, çështja shtrohet nëse kjo gjë është e dëshirueshme dhe nëse duhet të lejohet të sjellësh si provë regjistrime me fotografi të personave të cilët nuk ishin në dijeni të faktit se po regjistroheshin. Aktualisht, nuk ka legjislacion që e rregullon këtë çështje. Diskutimi tjetër ka të bëjë me faktin nëse vepra penale në këtë rast të veçantë ishte e provokuar apo e simuluar.<sup>109</sup> Si përfundim, nëse është arritur në përfundimin se regjistrimet e fshehta si ato që përdoren zakonisht në programin televiziv *Fiks Fare*, cenojnë jetën private të individit, legjislacioni mbi këtë çështje duhet të rregullohet dhe të ndiqen penalisht rastet e abuzimit.

Lidhur me rastin që u diskutua më sipër, mund të argumentohet se videokaseta do të kishte qenë provë e mjaftueshme për të paraqitur të paktën një *dyshim të arsyeshëm*. Mbetet për t’u diskutuar se ku mund të aplikohet secili nga kriteret për të arrestuar të dy të dyshuarit.

Siç u përmend më sipër, vendimi në këtë rast u apelua në të gjitha shkallët deri në Gjykatën e Lartë, e cila arriti në konkluzionin se arsyetimet e bëra nga gjykatat më të ulëta nuk ishin të drejta dhe se kaseta nuk ishte e mjaftueshme për të vërtetuar një dyshim të arsyeshëm! Gjykata u shpreh se “vërtet videokaseta shërben si bazë për fillimin e çështjes penale, por ajo nuk mund të shërbejë si provë, ku të bazohet dyshimi i arsyeshëm ndaj të akuzuarve. Kjo do të thotë se organi i akuzës mbi bazën e saj duhet të kishte paraqitur prova të tjera në përputhje me ligjin procedural.”<sup>110</sup> Në përputhje me atë që u shpreh më sipër, ky vendim është problematik sepse ai në fakt shërben për moslejimin e përdorimit të regjistrimit si provë, p.sh., përgjimet telefonike ose regjistrimet nga përgjimet, pa diskutuar për problemin kryesor, d.m.th, se si të trajtohen regjistrimet private dhe nëse kjo ishte një vepër penale e provokuar, e cila në të kundërt nuk do ndodhte.

<sup>108</sup> Shih për shembull ndikimin e sekuencave të filmuara të masakrës së Srebrenicës, që u shfaqën në 2 qershor 2005, [http://en.wikipedia.org/wiki/Srebrenica\\_massacre](http://en.wikipedia.org/wiki/Srebrenica_massacre) [vizituar më 27 prill 2006].

<sup>109</sup> Krahaso me KPrP, neni 294/a.

<sup>110</sup> Vendim i Gjykatës së Lartë, nr. 37, 8 prill 2004.

Pasi u hodhën poshtë akuzat ndaj njërit prej punonjësve të doganës, çështja u dërgua në gjykatë. *Gazetari u dëgjua si dëshmitar* në gjyq para gjykatës së rrethit gjyqësor. Megjithatë, gjykata iu referua vendimit të Gjykatës së Lartë dhe konstatoi se, meqë prokurori nuk kishte sjellë prova të tjera [*pavarësisht nga kaseta dhe dëshmia e gazetarit*], nuk u gjet fajtor i pandehuri. Për më tepër, gjykata arsyetoi se, meqenëse nuk kishte lidhje ndërmjet shkakut dhe pasojës [nuk kishin kaluar cigare kontrabandë në kufi], punonjësi i doganës duhet të shpallej i pafajshëm.

Duke marrë parasysh vendimin e Gjykatës së Lartë, arsyetimi për sa i përket vlerësimit të provave të paraqitura është i diskutueshëm, pa marrë fare në konsideratë se kaseta u konfirmua edhe nga deklarata e dëshmitarit, nga gazetari. Pavarësisht nga mungesa e rregullave për mënyrën e trajtimit të regjistrimeve private, duhet të theksohet se përveç ADN-së *dhe* dëshmitarit, është e vështirë të mendohet se çfarëdolloj kombinimi i provave do të ishte më i argumentuar se ajo që u paraqit këtu në lidhje me këtë çështje, d.m.th, *një sekuençe filmike që paraqet disa fakte dhe një dëshmitar që konfirmon atë që është shfaqur*. Mënyra tjetër e të arsyetuarit, d.m.th., që “vepra penale” nuk kishte pasojë [meqenëse cigaret nuk kishin kaluar në kufi pa paguar taksat], është gjithashtu e diskutueshme. Neni 260 i Kodit Penal e përkufizon veprën penale të “mitëmarrjes” si:

marrja e çdo shpërblimi, dhurate ose përfitime të tjera nga funksionari i lartë shtetëror ose i zgjedhuri vendor dhe gjatë ushtrimit të funksionit të tyre, për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tij, ose ushtron ndikimin e tij tek autoritete të ndryshme për t’i siguruar çdo individ favorë, shpërblime, punë dhe përfitime të tjera,...

Vepra penale e mitëmarrjes përfundon kështu me marrjen e ryshfetit dhe pavarësisht nga fakti nëse funksionari e ka realizuar atë që ka premtuar apo jo. Nëse do të pranohej ky arsyetim i gjykatës, i gjithë legjisllacioni mbi veprën penale të korrupsionit do të bëhej i pavlefshëm, meqenëse *çdo nëpunës administrate do të ishte i lirë të pranonte ryshfet, për aq kohe sa ai të mos e përmbushte pjesën e tij/saj të marrëveshjes korruptive!* Atëherë, nëse vepra penale e sjellë në gjykatë do të ishte një rast kontrabande, rezultati përfundimtar sigurisht që do të ishte i ndryshëm. Kontrabanda është një *vepër penale që ka pasojë*, dhe penalizon personat, të cilët sjellin ose tentojnë të transportojnë mallra në kufi pa paguar taksat ose pa marrë licencat e duhura. Si rrjedhim, nëse cigaret nuk kalojnë ose nuk janë bërë gati për të kaluar kufirin, nuk do të kishim të bënim me ndonjë lloj vepre penale. Por përsëri mund të argumentohet se vepra penale e korrupsionit në këtë çështje është e provokuar, dhe nëse rasti është i tillë, të paktën *rezultati* i çështjes do të ishte i drejtë.

Si përfundim, vendimi i mësipërm i Gjykatës së Lartë dhe vendimet e gjykatës së shkallës së parë paraqesin nevojën për të diskutuar *standardin e provës* në kontekstin ligjor shqiptar. **Standardi i provës** është niveli i provës që kërkohet në një veprim ligjor për të bindur gjykatën se një pohim i caktuar është i vërtetë. Shkalla e provës së



kërkuar varet nga rrethanat e supozimit.<sup>111</sup> Cili është standardi i provës, për shembull, për të vërtetuar që ndaj personit ka dyshime të arsyeshme apo që ai/ajo është fajtor për një vepër penale? Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë me sa duket identifikon gjashtë nivele të dyshimit, ku secili prej tyre duhet të përputhet me nivelin e provës që nevojitet për të bindur gjykatën që supozimi apo akuza mund të jetë e vërtetë. Me fjalë të tjera, sa prova nevojiten për të vërtetuar secilin nivel? Nivelet janë:

- |    |   |
|----|---|
| 1) | personit të cilit i atribuohet vepra penale, <sup>112</sup> |
| 2) | personit nën hetim, <sup>113</sup>                          |
| 3) | të pandehurit, <sup>114</sup>                               |
| 4) | dyshimit të arsyeshëm, <sup>115</sup>                       |
| 5) | kërkesës për gjykim <sup>116</sup> dhe si përfundim         |
| 6) | vendimit të fajësisë <sup>117</sup>                         |

Ndonëse një shqyrtim i kujdesshëm i KPrP nxjerr në pah tri nivele, nuk përmendet se sa prova nevojiten për secilin nivel. Standardi i provës në përgjithësi i pranuar në mbarë botën në rastin e një vendimi fajësie është se fajësia duhet të *provohet përtëj dyshimit të arsyeshëm*. Në kontekstin shqiptar, as KPrP dhe as Komentari i KPrP nuk e përcaktojnë standardin e provës në lidhje me vendimin e fajësisë. Megjithatë, në rastin e një pafajësie, Komentari i KPrP sqaron se “nuk provohet se i pandehuri e ka kryer veprën për të cilën akuzohet.”<sup>118</sup> Pamundësia për të dhënë më shumë udhëzime e bëjnë të vështirë zbatimin e standardit të drejtë nga sistemi i drejtësisë.

## 9. Shqyrtimi i mëtejshëm mbi ligjshmërinë e masës së sigurisë “arrest në burg”

Në rastin e personave ndaj të cilëve është vendosur masa e sigurisë arrest në burg, KPrP kërkon që prokurori të njoftojë gjyqtarin për personin e paraburgosur ***çdo dy muaj që nga ekzekutimi i vendimit për paraburgim***. Ky informacion duhet paraqitur me shkrim dhe duhet të përmbajë të dhëna lidhur me gjendjen e procedimeve, marrjen në pyetje të të pandehurit dhe të personave të tjerë, së bashku me një përmbledhje të të dhënave të marra dhe kopje të dokumenteve në dosje. Me marrjen e informacionit, gjyqtari mund të revokojë apo zëvendësojë masën e sigurimit.<sup>119</sup> *Qëllimi i kësaj dispozite është*

<sup>111</sup> Shih, p.sh., [http://en.wikipedia.org/ëëiki/Burden\\_of\\_proof](http://en.wikipedia.org/ëëiki/Burden_of_proof) [vizituar më 27 maj 2006] ose *Black's Law Dictionary*, [Fjalori *Black's Law*], kryeredaktor: Bryan A. Garner, (botimi i tetë).

<sup>112</sup> KPrP, neni 287, shih edhe Vendimin e Unifikuar të Gjykatës së Lartë, Vendimi nr. 3, 27 shtator 2005.

<sup>113</sup> KPrP, neni 293 paragrafi 1, 295 paragrafi 1, 296 paragrafët 1 dhe 2, 302, 303, paragrafi 3, dhe 308.

<sup>114</sup> KPrP, neni 34.

<sup>115</sup> KPrP, neni. 228, paragrafi 1.

<sup>116</sup> KPrP, nenet 327 dhe 331.

<sup>117</sup> KPrP, neni 390.

<sup>118</sup> Komentari i KPrP, fq. 504.

<sup>119</sup> KPrP, neni 246, pika 6.

që të sigurohet me anë të kontrollit të vazhdueshëm nga ana e gjykatës në rastet e personave të paraburgosur, që hetimi të kryhet me kujdes të veçantë dhe gjykimi të bëhet brenda një afati të arsyeshëm.<sup>120</sup> Kjo është gjithashtu edhe në përputhje me kërkesën e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për kontrollin periodik të ligjshmërisë së një arrestimi, me arsyetimin se me kalimin e kohës një arrestim fillimisht i ligjshëm mund të kthehet në të paligjshëm.<sup>121</sup> Udhëzuesi për zbatimin e nenit 5 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, shprehet si më poshtë:

Një këndvështrim përfundimtar në këtë aspekt të mbikëqyrjes gjyqësore (gjykimit) është rishikimi periodik ku gjyqtari vendos që vazhdimi i ndalimit është i justifikuar. Kjo domosdoshmërisht që ndiqet nga çështja e diskutuar më sipër që rrethanat mund të ndryshojnë dhe, ndërsa motivet për ndalim mund të ekzistojnë në fazat e hershme të një hetimi, mund të mos mbështetet më çështja në to në një fazë të mëvonshme. Kështu, është përgjegjësia e autoriteteve zbatuese të ndalimit që të parashirojnë çështjen për ndalim mbikëqyrjes gjyqësore në intervale të përhershëm dhe këto intervale nuk duhet të kalojnë një muaj apo dy. Pa këtë mbikëqyrje të vazhdueshme – e cila duhet të jetë rigorozë sa ne fillim të shqyrtimit të çështjes – një person mund të mbahet në masën e ndalimit kur kjo nuk do të jetë në pajtim me Konventën.<sup>122</sup>

**Shënim:** Sipas studimit të një sërë çështjesh dhe nga diskutime me prokurorë dhe gjyqtarë në gjykata të ndryshme në Shqipëri, del se kjo rregull nuk zbatohet. Një shpjegim i dhënë është, se meqenëse mosinformimi nuk ka pasoja, prokurorët nuk e shohin të nevojshme ta respektojnë rregullën. Kështu, një nga funksionet kontrollues të parashikuar në KPrP, për të siguruar që hetimet të kryhen me kujdes të veçantë, del jashtë loje. Megjithëse përgjegjësia kryesore u mbetet prokurorëve duhet theksuar se në rastet kur prokurorët nuk e informojnë gjykatën, është gjyqtari përgjegjës ai që duhet ta kërkojë dhe në këtë mënyrë të rivendoset funksioni kontrollues.

## 10. Alternativat e paraburgimit

Siç u diskutua në këtë kapitull, heqja e lirisë është shkelje e së drejtës themelore të njeriut dhe duhet përdorur vetëm si metoda më e fundit dhe në përputhje me procedura të rrepta.<sup>123</sup> Kjo do të thotë gjithashtu se edhe personat e dyshuar për kryerjen e kundërvajtjeve penale apo veprave penale gjykohen pa u vendosur masa e sigurisë. Për më tepër, kur është e nevojshme të merren masa për të siguruar praninë e të pandehurve, duhen të merren parasysh masa sigurimi të tjera, të cilat aplikohen ndaj personit të dyshuar për kryerjen e një veprë penale përpara se t'i jepet masa e arrestit në burg. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë parashikon masat e mëposhtme të sigurimit (*Llojet e masave shtrënguese*):<sup>124</sup>

<sup>120</sup> Shih gjithashtu edhe Komentarin e KPrP, fq. 359-360.

<sup>121</sup> Për shembull, shih çështjen e Gjykatës Evropiane, “Herczegfalvy kundër Austrisë”, 24 shtator 1992, fq. 75.

<sup>122</sup> Manuali nr. 5 i Këshillit të Evropës, fq. 61.

<sup>123</sup> KPrP, neni 230, pika 1.

<sup>124</sup> KPrP, neni 232.

- a) ndalimi i daljes jashtë shtetit;
- b) detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore;
- c) ndalimi dhe detyrimi për qëndrimin në një vend të caktuar;
- ç) garancia pasurore;
- d) arresti në shtëpi;
- dh) arresti në burg;
- e) shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik.

Sipas statistikave të vendosura në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme në vitin 2004, kishte 13 143 procese të rinj kundër 8 419 të pandehurve, prej të cilëve 2 753 ose **30.5 % ishin të paraburgosur**.<sup>125</sup> Sipas Prokurorisë së Përgjithshme, nuk ka statistika mbi aplikimin e masave të tjera të sigurimit. Për të bërë një krahasim, në Suedi u njoftuan 104 157 persona se ndaj tyre kishin filluar procese penale në vitin 2004. Nga këta 11 237 persona, ose më pak se 11 % ishin paraburgosur, ndërsa 203 persona ose afërsisht 0.2 % ishin nën masa të tjera sigurimi.<sup>126</sup> Sigurisht që infrastruktura më e mirë në Suedi, si sistemi gjendjes civile, sistemi i adresave, sistemi telefonik, kontrolli më i mirë i kufijve, mund të shpjegojë një pjesë të mospërputhshmërisë, por përsëri ndryshimi është i konsiderueshëm dhe në krahasim me Suedinë, Shqipëria duket se ka një aplikim shumë të lartë të masës së arrestit në burg.

## 11. Afatet e paraburgimit

Kodi i Procedurës Penale përcakton kohëzgjatjen maksimale të paraburgimit me disa afate maksimale të mundshme në varësi të rëndësisë së veprës penale në fjalë. Nëse këto afate tejkalohen, paraburgimi e “humbet fuqinë” dhe gjykata vendos lirim të menjëhershëm të të pandehurit.<sup>127</sup> Edhe nëse i pandehuri lirohet, hetimi mund të vazhdojë.

### *Kuadri ligjor*

- Si Kushtetuta ashtu edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut i japin personit të paraburgosur të drejtën për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm kohor ose të gjykohen në gjendje të lirë.<sup>128</sup>
  - Ndërkohë që Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut përcakton që lirimi mund të kushtëzohet nga garancia për t'u paraqitur në gjyq, në Kushtetutë lirimi kushtëzohet nga një garanci pasurore. Kjo mund

<sup>125</sup> [www.pp.gov.al/alb/raporte/rap05.html](http://www.pp.gov.al/alb/raporte/rap05.html) [vizituar më 14 qershor 2006].

<sup>126</sup> Për sa u përket masave të tjera të sigurimit, 102 kishin detyrimin të raportonin në polici, 23 persona u ishte kufizuar udhëtimi, ndërsa 78 persona ishin të detyruar të raportonin në polici dhe u ishte kufizuar udhëtimi. Pjesa tjetër u gjykua në gjendje të lirë. Statistikat janë marrë nga Prokuroria e Përgjithshme e Suedisë, <http://www.aklagare.se/nyweb3/Filarkiv/AR2005slutligLaguppl.pdf> [vizituar më 27 maj 2006]; *shih gjithashtu* [http://www.bra.se/extra/pod/?action=pod\\_show&id=21&module\\_instance=11](http://www.bra.se/extra/pod/?action=pod_show&id=21&module_instance=11) [vizituar më 27 maj 2006].

<sup>127</sup> KPrP, nenet 263 dhe 262.

<sup>128</sup> Kushtetuta, neni 28, pika 3, KEDNj neni 5, pika 3.

të diskutohet pasi mund të përjashtojë nga kjo e drejtë një person që nuk ka mjete financiare.

- Sipas Gjykatës Evropiane, garancia e afatit të arsyeshëm kohor në kuptimin e nenit 5, do të thotë që autoritetet duhet të tregojnë një "kujdes të veçantë" në drejtimin e procesit në ato çështje ku i pandehuri është në paraburgim.<sup>129</sup>
- Kjo do të thotë që çfarëdolloj periudhe ku nuk ndërmerret asnjë veprim duhet justifikuar objektivisht. Shembuj rastesh objektivisht të justifikueshme janë mbledhja e deklaratave të ekspertëve, dëgjimi i dëshmitarëve jashtë shtetit dhe vlerësimi i gjendjes mendore të të pandehurit. Ngarkesa e punës së prokurorëve apo policisë, fakti që gjyqtarët mund të jenë me pushime, etj., nuk janë justifikime objektive.

*Koment:* Sipas ligjit për organizimin e pushtetit gjyqësor, gjyqtarët kanë të drejtën e 30 ditëve pushim në vit, leje cila duhet marrë në muajin korrik apo gusht.<sup>130</sup> Ligji përcakton më tutje se ata gjyqtarë të cilët kryejnë detyra urgjente gjatë kësaj periudhe, marrin lejë në një periudhë tjetër dhe përfitojnë pesë ditë pushimi shtesë.<sup>131</sup> Në bazë të kësaj dispozite, praktikisht të gjitha gjykatat në Shqipëri mbyllen që nga gjysma e dytë e korrikut deri në javën e parë të shtatorit. Për shembull, në vitin 2005 pushimet e gjykatës zgjatën pothuaj shtatë javë, që nga 21 korriku deri më 4 shtator. Gjatë kohës së pushimit të gjykatave janë mbajtur seanca verifikimi/vleftësimi, po përveç këtyre nuk është zhvilluar *asnjë seancë gjyqësore*. Kjo është në kundërshtim me parimin e gjykimit të pandërprerë të shprehur në nenin 342 të Kodit të Procedurës Penale, i cili përcakton se gjyqet mund të shtyhen për arsye të veçanta *deri* në pesëmbëdhjetë ditë. Është gjithashtu shkelje e të drejtës së të pandehurve të paraburgosur për t'i kryer proceset ndaj tyre me "kujdes të veçantë". Të pyetur nëse pushimet verore i pezullonin afatet e paraburgimit, gjyqtarët dhanë përgjigje të ndryshme dhe jo shumë të qarta, që tregonin se mund të mos ketë një praktikë të unifikuar në lidhje me këtë. Kur diskutohet çështja e pushimeve të gjyqtarëve, shpeshherë i referohet sistemit italian. Në Itali ashtu si edhe në Suedi gjykimet në rastet kur të pandehurit janë të paraburgosur vazhdojnë edhe gjatë sezonit të pushimeve.<sup>132</sup> Kjo do të thotë se si në Itali edhe në Suedi të vetmet procese që *nuk* zhvillohen gjatë periudhës së pushimeve janë ato ku të pandehurit gjykohen në gjendje të lirë ose në çështjet civile.

Legjislacioni shqiptar parashikon afate maksimale të paraburgimit për secilën etapë të procedimit. Afatet maksimale varen nga rëndësia e veprës penale. Ndërkohë që kjo në vetvete nuk krijon konflikt me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, duhet

<sup>129</sup> Shih për shembull, çështjen "Labita kundër Italisë", 6 prill 2000, "Conrada kundër Italisë", 24 gusht 1998 dhe "Gjykimit i I.A.-së kundër Francës", 23 shtator 1998.

<sup>130</sup> Ligji nr. 8436, datë 28 dhjetor 1998, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" [Ligji për pushtetin gjyqësor], neni 39, pika 1.

<sup>131</sup> Po aty, neni 39, pika 2.

<sup>132</sup> Për Italinë: (Regio Decreto) nr. 12/1941, neni 91, përcakton se gjatë sezonit të pushimeve, gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatat e apelit vazhdojnë seancat penale ku të pandehurit janë në paraburgim si dhe çështje të tjera penale urgjente. Në Suedi afatet e përcaktuara për gjykimin e çështjeve penale ku të pandehurit janë në paraburgim, garantojnë që këto çështje të vazhdojnë edhe gjatë sezonit të pushimeve.

pasur parasysh se afati i arsyeshëm vlerësohet nën suazën e rrethanave të veçanta të një çështjeje dhe nuk i përjashton autoritetet nga detyrimi për ta kufizuar në minimum kohën e heqjes së lirisë dhe për të proceduar me kujdes të veçantë. Kështu, një periudhë paraburgimi trevjeçar mund të jetë e arsyeshme nëse nuk ka *periudha ku nuk ndërmerret asnjë veprim* dhe kjo kohë ka qenë absolutisht dhe objektivisht e nevojshme për të përfunduar gjykimin.

Në përcaktimin se çfarë është “e arsyeshme”, gjykata nuk e ka pranuar asnjëherë idenë se ka një kohëzgjatje maksimale të periudhës së paraburgimit, e cila nuk duhet tejkaluar asnjëherë pasi kjo do të çonte në një vlerësim *in abstracto* dhe në një gjykim duhen marrë gjithmonë parasysh të gjitha karakteristikat e veçanta të një çështjeje. Çfarëdolloj periudhe, pavarësisht se sa e shkurtër është, duhet justifikuar në çdo rast. Jurisprudenca e gjykatave e ka provuar rëndësinë e rrethanave të veçanta të një çështjeje. Ndërkohë që periudhat më tepër se një vit konsideroheshin të tepërta, periudhat ndërmjet dy dhe tre vjetësh ishin edhe të pranueshme edhe të papranueshme. Një ndryshim i ngjashëm në lidhje me këtë mund të vihet re edhe në periudhat midis tre dhe katër vjetësh. U pa që periudhat përtej pesë vjetësh nuk justifikohen.<sup>133</sup>

<sup>133</sup> Manuali nr. 5 i Këshillit të Evropës: E drejta e lirisë dhe sigurisë së personit. Një udhëzues për zbatimin e nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, (Strasburg: Këshilli i Evropës, 2002) [Manuali nr. 5 i Këshillit të Evropës], fq. 35.

<b>Paraburgimi e humbet fuqinë kur përfundojnë afatet e mëposhtëm<sup>134</sup></b>				
<b>ETAPA</b>	<b>VEPRA PENALE TË LEHTA</b>	<b>MAKSIMUMI DERI NË 10 VJETË BURGIM</b>	<b>BOSHLLËK*</b>	<b>MINIMUMI TË PAKTËN 10 VJETË OSE PËRJETË</b>
<b>Periudha midis arrestimit dhe kërkesës për gjykim/akteve të dorëzuara në gjykatë</b>	3 muaj	6 muaj		12 muaj
<b>Periudha midis kërkesës për gjykim dhe dënimit në shkallën e parë</b>	2 muaj	9 muaj		12 muaj
<b>Periudha midis shkallës së parë dhe dënimit në gjykatën e apelit</b>	2 muaj	6 muaj		9 muaj
Në rast se çështja dërgohet për rigjykim nga Gjykata e Lartë apo Gjykata e Apelit, afatet e ndryshme rifillojnë që nga data e vendimit. <sup>135</sup>				
<b>Periudha maksimale e paraburgimit duke përfshirë edhe zgjatjet<sup>136</sup></b>	10 muaj	2 vjet		3 vjet
Kohëzgjatja e paraburgimit nuk mund të kalojë <b>gjysmën e dënimit maksimal</b> të parashikuar për veprën penale. <sup>137</sup>				

\* **Shënim:** Këtu ka një boshllëk. Disa vepra penale janë të dënueshme me pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet<sup>138</sup> ose shtatë deri pesëmbëdhjetë vjet<sup>139</sup> burgim, rast në të cilin nuk ka dënim maksimal deri në dhjetë vjet as dënim minimal me të paktën dhjetë vjet burgim. Në këtë rast, në veçanti duke mbajtur parasysh detyrimin për të proceduar me kujdes të veçantë kur të pandehurit që janë në paraburgim, duhet zgjedhur zgjidhja më e favorshme për të pandehurin. Kjo do të thotë që të aplikohen periudhat e vendosura për veprat penale të dënueshme me maksimumi deri në dhjetë vjet burgim. Ky boshllëk

<sup>134</sup> KPrP, neni 263. Në versionin e KP të botuar në vitin 2002 dhe 2004 nga Qendra e Publikimeve Zyrtare, në pikën 6 të nenit 263 thuhet gabimisht “minimumi” në vend të “maksimumi”, ndërsa në pikën 6 (c) thuhet gabimisht “maksimumi” në vend të “minimumi”, që i bën këto dy pika të papërputhshme me pikat 1, 2 dhe 3 (b) dhe (c). Shih Fletoren Zyrtare Nr. 2, shkurt 2000.

<sup>135</sup> Shih Vendimin Unifikues të Gjykatës së Lartë, nr. 6, 11 nëntor 2003.

<sup>136</sup> KPrP, neni 264.

<sup>137</sup> KPrP, neni 264 pika 3, shih gjithashtu Vendimin Unifikues të Gjykatës së Lartë, nr. 6, 11 nëntor 2003.

<sup>138</sup> Neni 88, paragrafi 2; neni 101, paragrafi 1; neni 102, paragrafi 2; neni 104; neni 110/a, paragrafi 1; neni 138/a, paragrafi 2; neni 139; neni 141/a, paragrafi 2; neni 151, paragrafi 3; neni 153, paragrafi 3; neni 154, paragrafi 3; neni 155, paragrafi 3; neni 183, paragrafi 2; neni 202, paragrafi 2; neni 203, paragrafi 2; neni 215; neni 220; neni 234; neni 278, paragrafi 3; neni 284/ç, paragrafi 3; neni 323, paragrafi 2; dhe neni 333.

<sup>139</sup> Neni 100, pika 1; neni 103, pika 2; neni 114/b, pika 1; neni 278/a, pika 1; neni 282/a, pika 1; neni 283, pika 2; neni 284, pika 3; neni 284/c, pika 2; neni 287/a, pika 2.

krijon konfuzion dhe krijon hapësirë për abuzim, prandaj duhet rishikuar. Kjo tregon edhe njëherë nevojën e ngutshme për rishikimin e KPrP.<sup>140</sup>

- Periudhat kohore mund të zgjaten me pothuaj gjysmën e periudhës maksimale të parashikuar për vepra të ndryshme penale. Zgjatja vendoset nga gjykata mbi kërkesën e prokurorit, pasi dëgjohet mbrojtësi, në rastet e mëposhtme:<sup>141</sup>
  - o Kur në çfarëdolloj kohe gjatë procesit, është kërkuar ekspertimi i gjendjes mendore të të pandehurit;
  - o Kur gjatë hetimeve paraprake, në një çështje veçanërisht komplekse, afatet janë në mbarim e sipër dhe zgjatja është absolutisht e domosdoshme në aspektin e sigurisë. Zgjatja mund të bëhet vetëm një herë dhe nuk mund të jetë më shumë se tre muaj.
- Afatet mund të pezullohen nga gjykata:<sup>142</sup>
  - o për shkak të veprimeve apo kërkesave **të padrejta nga i pandehuri apo mbrojtësi i tij**, përveç rasteve kur kërkesa bëhet për marrjen e provës ose
  - o kur shqyrtimi gjyqësor shtyhet për shkak të **mosparaqitjes ose largimit së mbrojtësve**.<sup>143</sup>
- Koha e paraburgimit llogaritet në caktimin e dënimit. Një ditë paraburgim është e barabartë me një ditë e gjysmë burgim.<sup>144</sup>

## 12. Pezullimi i afateve të paraburgimit

Siç u përmend edhe më sipër në paraqitjen e kuadrit ligjor, afatet e paraburgimit mund të pezullohen për shkak të veprimeve apo kërkesave të padrejta nga i pandehuri apo mbrojtësi i tij, ose kur shqyrtimi gjyqësor shtyhet për shkak të mosparaqitjes së mbrojtësit apo heqjes dorë nga mbrojtja.<sup>145</sup>

Qëllimi i kësaj dispozite është ndalimi i praktikës së disa të pandehurve dhe avokatëve mbrojtës që zvarrisin procesin me qëllim që të përfundojë afati i paraburgimit dhe i pandehuri të lirohet.<sup>146</sup> Në disa raste, fakti që një ditë paraburgim është e barabartë me një ditë e gjysmë burgim mund të jetë një shtysë për ta zgjatur procesin, megjithëse kushtet e tmerrshme të disa dhomave të paraburgimit duhet të ishin një frenim i efektshëm kundër kësaj praktike.

Afatet e parashikuar për hetimin paraprak dhe paraburgimin duhen parë si udhëzime që u jepen prokurorisë dhe gjykatave për të përfunduar pjesën përkatëse të *gjykimit*<sup>147</sup>

<sup>140</sup> Shih gjithashtu edhe diskutimin më poshtë për Vendimin Unifikues të Gjykatës së Lartë, nr. 6, 11 nëntor 2003, për të sqaruar se si duhen interpretuar këto dispozita.

<sup>141</sup> KPrP, neni 264.

<sup>142</sup> KPrP, neni 265.

<sup>143</sup> Shih diskutimin më tej në lidhje me praktikën e pezullimit të afateve të paraburgimit.

<sup>144</sup> KPrP, neni 238, pika 2 dhe Kodi Penal, neni 57.

<sup>145</sup> KPrP, neni 265.

<sup>146</sup> Komentari i KPrP, fq. 366.

<sup>147</sup> Këtu “gjykim” është përdorur me kuptimin e dhënë nga Gjykata Evropiane kur llogaritet afati përkatës; *shih* “Deweer kundër Belgjikës”, 27 shkurt 1980, paragrafët 42, 44 dhe 46.

brenda një afati të përcaktuar. Këto dispozita interpretohen në mënyrë që të trajtojnë çështje me më shumë se një të pandehur, si *një çështje* ndaj së cilës zbatohen të njëjta afate dhe rregulla. Kur përfundon afati i paraburgimit për një të pandehur dhe jo për të gjithë, prishet koherenca e çështjes dhe ai i pandehur duhet liruar pavarësisht situatës së të pandehurve të tjerë. Kjo gjë është patjetër problematike për gjykatat. Megjithëse nuk është gjithmonë e mundur shmangia e vonesave për shkak të bashkëpandehurve apo avokatit të tyre, ekziston mundësia të ndahet procesi për shumë të pandehur kur afati për një ose më shumë të pandehur është pezulluar.<sup>148</sup>

Gjithsesi, në praktikë çështjet nuk ndahen por afatet e paraburgimit pezullohen për *të gjithë* të pandehurit e përfshirë në proces pavarësisht se cili i pandehur apo mbrojtës nuk është sjellë në mënyrë *të drejtë* apo nuk është paraqitur. Siç është vënë në dukje në mënyrë të vazhdueshme nga Gjykata e Lartë, kjo praktikë është e paligjshme dhe bën që të ndëshkohen të pandehurit për veprime që *nuk* u atribuohen atyre.<sup>149</sup> Është vënë re gjithashtu se praktika e pezullimit të afatit të paraburgimit është përdorur pa vend në rastet kur mosparaqitja e avokatëve nuk justifikohet. Pezullimet duhet të kufizohen në kohëzgjatjen minimale të mundshme, që do të thotë se ato duhet të zgjasin për aq kohë sa ekziston edhe shkaku për pezullim.<sup>150</sup> Në praktikë pezullimet urdhërohen deri në seancën pasardhëse gjyqësore, e cila zakonisht planifikohet të zhvillohet pas dy javësh.<sup>151</sup> Kjo është një shkelje e qartë e këtij detyrimi. Kur është diskutuar për të tilla praktika me disa gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë, ata kanë treguar se janë në dijeni të këtij abuzimi të ligjit (dhe e pranojnë).

---

<sup>148</sup> KPrP, neni 93 pika 1 (a).

<sup>149</sup> Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë, nr. 365, 7 nëntor 2000, Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë, nr. 6, 11 nëntor 2003 *shih gjithashtu* Komentarin e KPrP, fq. 365.

<sup>150</sup> Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë, nr. 6, 11 nëntor 2003.

<sup>151</sup> Sipas KPrP, neni 342, pika 1, një gjykim duhet të jetë i pandërprerë dhe mund të shtyhet vetëm në rrethana të veçanta, dhe deri vetëm në 15 ditë. Shih gjithashtu edhe kapitullin për gjykimet efikase.



**Disa shembuj**Seanca në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda (GjKR) - 13 maj, 7 korrik dhe 29 shtator 2005

Çështja kishte tetë të pandehur: katër në mungesë dhe katër në paraburgim. Në seancat e datave 13 maj dhe 7 korrik, katër të pandehur si dhe një avokat mbrojtës që përfaqësonte një prej tyre ishin të pranishëm, ndërsa avokati mbrojtës që përfaqësonte tre të tjerët mungonte. Gjykata vendosi të pezullojë afatin e paraburgimit *për të katër* të pandehurit. Në seancën e datës 29 shtator, avokati mbrojtës i një të pandehuri të proceduar në mungesë nuk ishte paraqitur. Gjykata vendosi të pezullonte afatet e paraburgimit për të katër të pandehurit e paraburgosur, avokatët e të cilëve ishin të pranishëm.

Seanca në GjKR, 12 korrik dhe 15 korrik 2005

Dy nga katër të pandehurit gjykoreshin në mungesë. Në seancë avokati mbrojtës i dy të pandehurve që gjykoreshin në mungesë nuk u paraqit. Prokurori kërkoi pezullim të afatit të paraburgimit. Avokati mbrojtës i dy të pandehurve të tjerë e kundërshtoi kërkesën me argumentin se duke qenë se ai ishte i pranishëm, nuk kishte arsye për të pezulluar afatin e paraburgimit për klientët e tij. Pavarësisht, gjykata vendosi të pezullojë afatin e paraburgimit për dy të pandehurit e paraburgosur deri në seancën pasardhëse. Në seancën pasardhëse, më 15 korrik, avokati mbrojtës i dy të pandehurve të paraburgosur nuk u paraqit. Gjithsesi, ai kishte paraqitur një raport mjekësor ku vërtetohej se ai ishte shumë sëmurë. Pavarësisht, gjykata vendosi të pezullojë afatin e paraburgimit për të dy të pandehurit deri në seancën pasardhëse, e cila do të mbahej pas pushimeve të verës, më 12 shtator, *d.m.th., pezullimi zgjati për plot dy muaj dhe jo siç duhet, deri sa të mos ekzistonte më shkaku i pezullimit.*<sup>152</sup>

Seancë në GjKR 18 korrik 2005

Njëri i pandehur ishte i paraburgosur, tjetri gjykohej në gjendje të lirë dhe i treti në mungesë. Në këtë seancë, nuk ishte paraqitur avokati mbrojtës i të pandehurit që gjykohej në mungesë. Prokurori kërkoi pezullimin e afatit të paraburgimit të të pandehurit të paraburgosur. Avokati mbrojtës i të pandehurit të paraburgosur e pranoi kërkesën! Gjykata vendosi ta pezullojë afatin e paraburgimit për të pandehurin e paraburgosur megjithëse avokati i tij mbrojtës ishte i pranishëm.

<sup>152</sup> Shih Vendimin Unifikues të Gjykatës së Lartë, nr. 6, 11 nëntor 2003.

### 13. Mbarimi i afateve të paraburgimit

Siç u përmend më sipër, masa e sigurimit e humbet fuqinë kur kalojnë afatet maksimale dhe kjo do të thotë që të pandehurit në fjalë duhet të lirohen. Formulimi *e humbasin fuqinë* është gjithashtu një tregues i qartë që gjykatat dhe prokuroria duhet të veprojnë kryesisht dhe pavarësisht nga kërkesa për lirim nga ana e të pandehurit. Sidoqoftë, në praktikë duket se këto rregulla nuk respektohen gjithmonë dhe gjyqtarët nuk veprojnë kryesisht, por vetëm të nisur nga një kërkesë për lirim, e cila dërgohet nga i pandehuri. Në lidhje me mënyrën se si lidhen me njëri tjetrin afatet maksimalë në nenet 263, paragrafi 6, dhe 264, paragrafi 3, dhe se si llogaritet koha për afatet e pezullimit, duhet parë *Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë*, nr. 6, 11 nëntor 2003.

Çështja ka të bëjë me tre të pandehur të akuzuar për vjedhje me armë dhe me vepra të tjera penale. Njëri nga të pandehurit akuzohej gjithashtu për dezertim nga shërbimi ushtarak. Të tre të pandehurit ishin arrestuar në flagrancë në nëntor të vitit 1999 dhe arrestimi ishte vleftësuar i ligjshëm nga Gjykata e Rrethit Sarandë. Duke pasur parasysh që njëri nga të pandehurit akuzohej për një vepër penale ushtarake, Prokuroria e Sarandës vendosi se nuk ishte kompetente për ndjekjen e çështjes dhe ia kaloi atë Gjykatës Ushtarake në Gjirokastrë (Gjykata Ushtarake në Gjirokastrë) për hetimet në vazhdim. Kërkesa për gjykim u paraqit në qershor të vitit 2000 dhe në maj të vitit 2001, Gjykata Ushtarake në Gjirokastrë i shpalli të tre të pandehurit fajtorë për veprat penale për të cilat akuzoheshin. Gjykata Ushtarake e Apelit e shfuqizoi vendimin dhe e dërgoi çështjen për rishqyrtim përpara një trupi të ri gjykues në Gjykatën Ushtarake në Gjirokastrë. Përpara se Këshilli i Lartë i Drejtësisë të caktonte një trup të ri gjykues, në qershor të vitit 2002, mbrojtja i dorëzoi një kërkesë Gjykatës Ushtarake në Gjirokastrë që të revokonte masën e sigurisë (masën e paraburgimit) për të pandehurit. Gjykata Ushtarake në Gjirokastrë vendosi se duke qenë se masa e sigurisë ishte vendosur fillimisht nga Gjykata e Rrethit Sarandë, nuk ishte kompetencë e Gjykatës Ushtarake të vendoste mbi këtë çështje. Në korrik të vitit 2002, Gjykata e Rrethit Sarandë i kërkoi Gjykatës së Lartë të zgjidhte konfliktin e juridiksionit. Gjykata e Lartë vendosi që Gjykata Ushtarake në Gjirokastrë ishte kompetente dhe ia ktheu çështjen kësaj gjykate. Në shtator, Gjykata Ushtarake në Gjirokastrë nuk pranoi kërkesat e të pandehurit për lirim. Vendimi u pranua në apel në janar të vitit 2003. Në maj të vitit 2003 një trup i ri gjykues në Gjykatën Ushtarake të Gjirokastrës la në fuqi vendimin e fajësinë për të tre të pandehurit. Dy prej tyre apeluan dhe në shtator të vitit 2003, Gjykata e Apelit Ushtarak pranoi vendimet për fajësi. Të gjithë të pandehurit u dënuan me burgim të gjatë. Gjatë zhvillimit të procesit, afatet e paraburgimit u pezulluan për 53 ditë gjithsej për të zgjidhur konfliktin e kompetencave dhe për shkak se Gjykata Ushtarake në Gjirokastrë nuk ishte në gjendje të ngrinte një trup gjykues dhe priste një vendim nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

*Vendimi i shumicës* – Në vendimin e saj të datës 11 nëntor 2003, Gjykata e Lartë vendosi se afatet e paraburgimit<sup>153</sup> në secilën etapë të procesit ishin tejkaluar. Gjithsesi, Gjykata e Lartë nuk urdhëroi lirimin e të pandehurve pasi ata ishin dënuar me burgim me vendime gjykate (në shtator të vitit 2003), të cilët po ekzekutoheshin.

<sup>153</sup> Të cilët ishin ndryshe në atë kohë.

Për sa u përket interpretimit dhe zbatimit të “afateve të paraburgimit, rifillimit të tyre, pezullimit dhe lidhjes ndërmjet të gjithë periudhës së paraburgimit me gjysmën e dënimit maksimal të parashikuar për veprën penale etj.” Shumica e Gjykatës së Lartë doli në përfundimin se:

1. Pezullimet nuk përfshihen në llogaritjen e afatit total, d.m.th., ato i zbriten afatit total.
2. Gjykatat i kanë pezulluar në mënyrë të padrejtë afatet e paraburgimit për arsye që kishin të bënin me gjykatat dhe jo me të pandehurit;
3. Apelimi i një vendimi për pezullimin e afatit të paraburgimit nuk pezullon *gjykimin* [d.m.th., që gjykimi në shkallën e parë vazhdon ndërkohë që shqyrtohet apelimi];
4. Pezullimet duhet të zgjasin vetëm për aq kohë sa ekziston edhe shkaku i pezullimit dhe parimi i gjykimit të pandërprerë<sup>154</sup> duhet respektuar sidomos kur personave u është hequr liria;
5. ***Në një rigjykim*** (kur një vendim është hedhur poshtë nga Gjykata e Lartë apo një gjykatë apeli dhe është rikthyer për gjykim) ***afatet e paraburgimit nuk mund të rifillojnë nëse është konsumuar e gjithë kohëzgjatja***, ndërsa për raste të tjerë, afatet e paraburgimit të parashikuar në nenin 263 të KPrP, rifillojnë për secilën etapë të procesit ndërkohë që duhet pasur parasysh se nuk duhet tejkualuar gjithë kohëzgjatja e paraburgimit. Në vend që të shohin se çfarë parashikon ligji për secilën etapë, gjykatat pra duhet të kenë parasysh se sa kohë mbetet. ***Kjo do të thotë që kur koha maksimale është shpenzuar për hetime dhe gjykim, rifillimi i afatit të paraburgimit në rigjykim është i pavlefshëm***;
6. Afatet e parashikuar në nenin 263 të KPrP janë afatet maksimale, në përfundim të të cilëve paraburgimi e humbet fuqinë. Sidoqoftë, kjo nuk do të thotë që këto afate duhen konsumuar gjithmonë. Përkundrazi, duke pasur parasysh edhe parimin e gjykimit të pandërprerë si dhe detyrimin për t’i kryer hetimet me kujdes, gjykatat dhe prokuroria janë të detyruar të bëjnë të mundur që çështjet të përfundojnë brenda kohës më të shkurtër të mundshme;
7. Neni 263, pika 6, e KPrP është një dispozitë e përgjithshme që përcakton, sipas kategorive, të gjithë kohëzgjatjen e paraburgimit. Neni 264, pika 3, paraqet një kufizim të kësaj dispozite në lidhje me veprën penale konkrete për të cilën akuzohet personi dhe për të cilën ky person është paraburgosur. Kjo do të thotë që megjithëse afati maksimal (në nenin 263, pika 6) mund ta lejojë, kohëzgjatja e paraburgimit nuk mund të tejkalojë gjysmën e maksimumit të dënimit të parashikuar për veprën penale në fjalë.

*Mendimi i pakicës* – Në mendimin e pakicës, dy anëtarë të trupit gjykues arritën në përfundimin se arsyetimi i shumicës [në paragrafin 5 më sipër] ishte në kundërshtim me formulimin e nenit 263 pika 4 e KPrP, i cili në mënyrë të veçantë përcakton se në rast të një rigjykimi “afatet e parashikuar për secilën shkallë të procedimit fillojnë të ecin përsëri që nga vendimi i Gjykatës së Lartë apo Gjykatës së Apelit.” Sipas pakicës, dispozitat përkatëse (263 pika 6 dhe 264 pika 3) do të thonë që afatet fillojnë të ecin përsëri [nga fillimi] pasi çështja kthehet për rigjykim dhe se afatet e konsumuar gjatë gjykimit të parë dhe të dytë nuk mund të tejkalojnë gjysmën e maksimumit të parashikuar për veprën penale që po procedohet – dhe nuk mund të kuptohen ndryshe.

<sup>154</sup> Shih më tej kapitullin “Gjykime efikase dhe çështje lidhur me dëshmitarët”.

*Koment* – Megjithëse është për t'u përgëzuar që shumica mundohet ta kufizojë kohën që një person mund të rrijë në paraburgim dhe megjithëse ka shumë argumente të mirë në vendim, ky vendim krijon probleme. Siç vihet në dukje edhe nga pakica, interpretimi që i jep shumica nenit 263, pika 4 (në paragrafin 5 më sipër) duket sikur është në kundërshtim me formulimin e nenit. Për më tepër neni 263, pika 6, parashikon që koha e paraburgimit nuk mund të tejkalojë:

- dhjetë muaj kur procedohet për kundërvajtje penale,
- dy vjet kur procedohet për një vepër penale të dënueshme me maksimumi deri në dhjetë vjet burgim,
- tri vjet për një vepër penale të dënueshme me minimumi të paktën dhjetë vjet burgim ose burgim të përjetshëm.

Duke pasur parasysh se neni 264, pika 3, parashikon se kohëzgjatja e paraburgimit nuk mund të tejkalojë gjysmën e maksimumit të parashikuar për veprën penale që procedohet, vendimi i shumicës (në nenin 7 më sipër) është me vend për kundërvajtje penale<sup>155</sup> të dënueshme me burgim deri në një vit, që do të thotë se dhjetë muaj do ta tejkalonin gjysmën e maksimumit, ose 6 muaj. Për veprat penale të kategorisë së dytë do të ishte me vend për vepra penale të dënueshme në maksimum me katër vjet, por *asnjëherë* për vepra penale të kategorisë së tretë, për të cilat dënimi minimal është të paktën 10 vjet burgim.

Ndërkohë që është shqetësuese që një vendim unifikues i Gjykatës së Lartë e bën të përdorshëm një pjesë të ligjit, mungesa e koherencës në Kodin e Procedurës Penale është edhe me shqetësuese pasi krijon mjaft hapësirë për interpretime të ndryshme dhe për abuzim. Një mënyrë e mundshme për të kuptuar nenin 264, pikën 3, do të ishte ta shihje atë në lidhje me situatat e parashikuara në nen, do të thotë aty ku afatet e paraburgimit *zgjaten*:

- për të bërë një ekzaminim për gjendjen mendore të të pandehurit *ose*
- kur gjatë hetimeve paraprake prokurori kërkon zgjatje për nevoja të domosdoshme sigurie *dhe* për hetime veçanërisht komplekse.

Kur zgjatja kërkohet për arsye të rëndësishme sigurie dhe hetime komplekse, kohëzgjatja mund të jepet vetëm një herë dhe nuk mund të jetë më shumë se tre muaj. Për ekzaminimet mendore nuk është vendosur afat, por nuk mendohet që një ekzaminim mund të zgjasë më shumë se disa muaj. Prandaj kjo dispozitë do të ishte me vend vetëm për një numër të kufizuar veprash penale. Ekziston pra një nevojë urgjente për ligjvënësin t'i sqarojë këto çështje.

---

<sup>155</sup> Një kundërvajtje penale është e dënueshme me gjobë ose burgim nga 5 ditë deri në 2 vjet, KP, nenet 29 dhe 32.

**Disa shembuj**Cështja “Hakmarrja për Drejtësinë Shqiptare” në GjKR

Më 23 nëntor 2005, i pandehuri Gëzim Gjoni u lirua nga paraburgimi pasi u paraburgos në mënyrë të paligjshme që prej (të paktën) 13 shtatorit të vitit 2005. Gëzim Gjoni u akuzua për rrëmbim personi dhe vjedhje banke në gjyqin e zgjatur të “Hakmarrjes për Drejtësinë Shqiptare”.<sup>156</sup> Gjyqi nisi fillimisht në fund të vitit 1998 dhe u pushua në shkurt të vitit 2003 pasi prokurori kërkoi që aktet të ktheheshin përsëri në prokurori për hetim të mëtejshëm. Pushimi i çështjes u rrëzua në apel dhe më 4 shtator 2003 çështja u kthye për hetime të mëtejshme. Kërkesa e re për gjykim u paraqit më 14 shtator 2004.

Gëzim Gjoni u arrestua më 19 maj 2003, d.m.th., pas pushimit por përpara se çështja të kthehej për hetime të mëtejshme. Duke pasur parasysh që Gjoni ishte akuzuar për krime të dënueshëm në minimum me 10 vjet burgim, periudha maksimale e qëndrimit të tij në paraburgim gjatë fazës së hetimeve ishte një vit, dhe një vit shtesë gjatë procedimit në shkallën e parë. Ndërsa mund të jetë e diskutueshme nëse Gjoni duhej liruuar një vit pas datës 19 maj 2003, është e qartë se paraburgimi i tij e humbi fuqinë kur akuza e re nuk u depozitua deri më 3 shtator 2004. Pavarësisht kësaj, ai nuk u lirua. Më 13 shtator 2005 paraburgimi e humbi fuqinë *përsëri*, pasi nuk u dha vendim nga GjKR. Pavarësisht kërkesës nga ana e mbrojtjes, Gjoni nuk u lirua. Një tjetër kërkesë për lirim të tij u paraqit në mes të nëntorit por u refuzua me arsyen se ishte paraqitur “jo në formën e duhur ligjore”. Pasi shqyrtoi edhe një kërkesë tjetër, më në fund, më 23 nëntor 2003, gjykata vendosi ta zëvendësojë paraburgimin për Gjonin me arrest shtëpie dhe e liroi atë.

Rigjykimi i çështjes së Kanunit në Gjykatën e Rrethit Durrës

Në çështjen e Kanunit, pesë të pandehur ishin akuzuar për rrëmbim personi, krijimin e një bande të armatosur dhe organizate kriminale dhe për krime të tjera. Rrëmbimi i personit është i dënueshëm në minimum me dhjetë vjet burgim, kështu që afatet maksimale të paraburgimit janë të aplikueshëm për të gjithë të pandehurit. Katër nga të pandehurit u arrestuan më 17 korrik 2002, kurse tjetri nuk u kap dot.<sup>157</sup> Kërkesa për gjykim u dorëzua më 15 tetor 2003 (çështja u regjistrua në gjykatë vetëm nëntë ditë më vonë, më 24 tetor 2004), d.m.th., pasi kishte skaduar afati maksimal i paraburgimit gjatë fazës së hetimeve.<sup>158</sup> Vendimi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës u dha më 14 dhjetor 2004, d.m.th., më shumë se një vit pas paraqitjes së kërkesës për gjykim. Pa pezullime, periudha maksimale prej tri vjetësh do të kishte mbaruar më 16 korrik 2005, por dihet që *afatet e paraburgimit janë pezulluar në mënyrë të përsëritur për të katër të pandehurit e paraburgosur*. Më 20 qershor 2005, Gjykata e Apelit Durrës e ktheu çështjen për rigjykim. Rigjykimi filloi më 18 janar 2006. Mbrojtja i paraqiti gjykatës dy herë kërkesë për të liruuar të paraburgosurit për shkak se afatet maksimale të paraburgimit kishin kaluar. Gjykata, duke iu referuar vendimit të Gjykatës së

<sup>156</sup> Shih më tej kapitullin mbi çështjen “Hakmarrja për Drejtësinë Shqiptare”.

<sup>157</sup> Ky informacion është marrë nga dosja gjyqësore dhe nga vendimet e gjykatës të shkallës së parë dhe gjykatës së apelit. Sipas vendimit të gjykatës të shkallës së parë, të katër u arrestuan më 19 korrik, jo më 17 korrik. Duke marrë parasysh letërporosinë më 17 korrik dhe seancën e verifikimit/vleftësimit në datën 20 korrik, është më e mundshme që arrestimi të ketë ndodhur në datë 17 korrik.

<sup>158</sup> Hetimi filloi në Itali; pasi të pandehurit u arrestuan në Shqipëri, Prokurori i Përgjithshëm kërkoi me anë të një letërporosie, transferimin nga Italia të dosjes hetimore bashkë me provat. Kjo kërkesë u përmbush vetëm më 15 tetor 2004, pra më tepër se një vit më vonë.

Lartë të përmendur më sipër, i hodhi poshtë kërkesat me arsyetimin se a) afati i paraburgimit rihillohet për çdo shkallë të hetimit kur një çështje dërgohet për rigjykim pasi një vendim është hedhur poshtë nga një gjykatë e një shkalle më të lartë dhe b) afatet e paraburgimit nuk mund të zgjasin më tepër se gjysma e maksimumit të dënimit të parashikuar për veprën penale që po procedohet. Një anëtar i trupi gjyqësor paraqiti mendimin e pakicës dhe arsyetoi që, përderisa të pandehurit janë mbajtur në paraburgim për më tepër se 3 vjet, ata duhet të lirohen.

*Koment:* Shumica në këtë rast vendosi në kundërshtim me vendimin e Gjykatës së Lartë dhe nuk pranoi të lironte të pandehurit, ndërsa pakica arsyetoi në përputhje me vendimin e Gjykatës së Lartë dhe donte të lironte të pandehurit. Kjo edhe njëherë dëshmon nevojën e ngutshme për sqarim nga ligjvënësi.

#### Gjykatë, vendimi nr. 57, 1 nëntor 2005

Ky rast ka të bëjë me katër të pandehur, dy burra, GH dhe KX dhe dy gra, ML dhe TL. Dy burrat akuzoheshin për trafikimin e një femre, SK, për qëllime prostitucioni në rrethana të rënduara që solli si pasojë vdekjen e SK. KX akuzohej më tej për shfrytëzim prostitucioni në rrethana të rënduara si dhe për bashkëpunim me ML dhe TL në trafikim femrash për qëllime prostitucioni. GH dhe KX ishin paraburgosur, ndërsa ML dhe TL gjykoreshin në mungesë. GH ishte arrestuar më 19 gusht 2002, ndërsa KX ishte arrestuar më 6 dhjetor 2003 (megjithatë, vendimi për paraburgimin e tij është i datës 16 dhjetor 2003!). Kërkesa për shqyrtim gjyqësor u paraqit më 10 maj 2004 dhe vendimi përfundimtar u dha më 1 nëntor 2005. Zgjatja e gjykimit ndodhi në pjesën më të madhe për shkak të vonesave nga ana e autoriteteve italiane për t'iu përgjigjur një *letërporosie* të datës 16 shtator 2004 me anë të së cilës u kërkohej autoriteteve gjyqësore italiane që të lejonin trupin gjyqësor shqiptar të dëgjonte 31 dëshmitarë në Itali.

Në bazë të akuzave të rënda për të dy të pandehurit GH dhe KX, u zbatuan afatet maksimale të paraburgimit. Duke pasur parasysh se GH u arrestua më 19 gusht 2002, kërkesa për gjykim në këtë rast duhej të ishte dorëzuar një vit më vonë ose me një zgjatje tremujore, pas një viti e tre muaj, d.m.th., më 19 gusht ose më 19 nëntor 2003. Kjo gjë nuk ndodhi, por GH nuk u lirua. Ndërsa për KX, kërkesa për gjykim u paraqit brenda vitit (5 muaj) që nga arrestimi i tij. Meqenëse kërkesa për gjykim u paraqit më 10 maj 2004, të dy, edhe GH edhe KX, duhej të ishin liruar kur vendimi i gjykatës nuk ishte dhënë atë ditë, apo disa ditë më pas nëse gjatë gjykimit ishin urdhëruar pezullime legjitime të afateve të paraburgimit. Gjithsesi, GH dhe KX nuk u liruan dhe gjyqi në shkallën e parë vazhdoi derisa u dha vendimi më 1 nëntor 2005. Në vendimin e gjykatës, të gjithë të pandehurit u shpallën fajtorë për akuzat për të cilat ishin akuzuar. GH u dënua me burgim të përjetshëm, ndërsa KX u dënua me 25 vjet burgim. Në vendimin e gjykatës nuk përmendet që afatet e paraburgimit për GH dhe KX kishin mbaruar apo që llogaritja e dënimit për KX duhet të fillojë që nga dita e arrestimit. Vendimi i gjykatës u apelua dhe gjyqi vazhdon në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda. Megjithatë është për të ardhur keq që kërkesa për ekzekutimin e *letërporosisë* shkaktoi një vonesë të tillë në procedim dhe nuk u trajtua me më shumë kujdes, kjo nuk është për faj të GH apo KX, prandaj ata duhej të ishin liruar kur mbaruan afatet e përcaktuar në KPrP.

## 14. Hetimi paraprak dhe afatet e paraburgimit

Sipas nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe nenit 42, pika 2 të Kushtetutës, kushdo ka të drejtën e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Gjykata Evropiane është shprehur se garancia për një afat të arsyeshëm fillon që nga momenti që personi është i akuzuar,<sup>159</sup> apo i prekur në mënyrë të konsiderueshme<sup>160</sup> nga një procedim penal. Në përpjekje për të përmbushur këtë kërkesë, Kodi i Procedurës Penale parashikon gjithashtu afate brenda të cilave duhet kryer një procedim penal. Këto afate mund të zgjaten në disa kushte të caktuara. Në rastet e personave të paraburgosur, neni 5 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe neni 28 i Kushtetutës, shprehen se kur një personi i hiqet liria, ai ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet gjatë procedimit. Interpretimi se çfarë është *një afat i arsyeshëm* kur personat janë të paraburgosur, duhet kufizuar meqenëse vendimi për heqjen e lirisë dhe kryerja e hetimeve duhen bërë më kujdes të veçantë.<sup>161</sup>

### *Kuadri ligjor*

Gjatë hetimit paraprak duhen mbajtur parasysh dhe respektuar afatet e mëposhtëm:

- **3 muaj** – Brenda tre muajve nga data e njoftimit të personit që i atribuohet vepra penale, prokurori vendos dërgimin e çështjes për gjykim, pushimin ose pezullimin e saj.<sup>162</sup>
  - Afati pezullohet kur prokurorit i nevojitet një autorizimi për të proceduar, kur nuk njihet autori i veprës penale ose kur i pandehuri vuan nga një sëmundje e rëndë që pengon hetimin.<sup>163</sup>
- **6 muaj** – Prokurori mund ta zgjasë afatin e hetimeve për një kohë deri në tre muaj.<sup>164</sup>
- **9 muaj deri në 2 vjet** – Zgjatje të mëtejshme, secila për një kohë jo më shumë se tre muaj, mund të bëhen nga prokurori në rastet e hetimeve komplekse ose të *pamundësisë objektive* për t'i përfunduar ato brenda afatit të zgjatur.<sup>165</sup>
- **3 vjet** – Përtej afatit prej dy vjetësh, kohëzgjatja e hetimeve mund të zgjatet me një vit, *në raste të jashtëzakonshëm*, vetëm me miratimin e Prokurorit të Përgjithshëm, *jo më tepër se tre muaj për çdo zgjatje*, pa ndikuar afatet e zgjatjes së paraburgimit.<sup>166</sup>
- I pandehuri dhe i dëmtuari kanë të drejtë, brenda dhjetë ditëve nga njoftimi, të bëjnë ankim në gjykatën e rrethit kundër vendimit të prokurorit për zgjatjen e afatit të hetimeve.<sup>167</sup>

<sup>159</sup> Çështja “Imbroscia kundër Zvicrës”, 24 nëntor 1993, paragrafi 36.

<sup>160</sup> Çështja “Deweer kundër Belgjikës”, 27 shkurt 1980, paragrafët 42, 44 dhe 46.

<sup>161</sup> Shih për shembull çështjen “Labita kundër Italisë”, 6 prill 2000; çështjen “Conrada kundër Italisë”, 24 gusht 1998 dhe çështjen “Gjykimi i I.A.-së kundër Francës”, 23 shtator 1998.

<sup>162</sup> KPrP, neni 323, pika 1.

<sup>163</sup> KPrP, neni 323, pika 2, dhe neni 326.

<sup>164</sup> KPrP, neni 324, pika 1.

<sup>165</sup> KPrP, neni 324, pika 2.

<sup>166</sup> Shih gjithashtu kapitullin mbi çështjen “Hakmarrja për Drejtësinë Shqiptare”.

<sup>167</sup> KPrP, neni 325.

## 14. 1 Studimi i dosjeve të prokurorisë

Për të pasur të qartë se si zhvillohen hetimet paraprake në Shqipëri, një kërkesë iu dorëzua prokurorive të Gjirokastrës, Vlorës, Fierit, Lushnjës, Tiranës, Durrësit, Shkodrës dhe Kukësit si dhe prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda për të parë një numër dosjesh për çështje që ishin dërguar për gjykim. Një kopje e kërkesës iu dërgua gjithashtu edhe Prokurorit të Përgjithshëm duke i shpjeguar se qëllimi i studimit nuk ishte marrja e informacionit sekret, por studimi i kopjeve të dosjeve gjyqësore që mbaheshin në prokurori<sup>168</sup> që të kuptonim më mirë se si zhvilloheshin hetimet paraprake. Për të parë nëse çështjet ku të pandehurit janë në paraburgim trajtohen me përparësi, u studiuan gjithashtu edhe disa dosje ku të pandehurit nuk ishin paraburgosur.

U studiuan gjithsej 59 dosje. Në 36 raste, njëri ose më shumë prej të pandehurve ishin të paraburgosur, ndërsa në 23 raste të pandehurit nuk ishin paraburgosur. Periudha mesatare e mungesës së aktivitetit ishte 3 muaj e gjysmë në rastet kur të pandehurit ishin të paraburgosur dhe 2 muaj e gjysmë në rastet kur të pandehurit nuk ishin të paraburgosur. Si rregull, çështjet kur të pandehurit nuk janë paraburgosur nuk janë ato më të rëndat. Për pasojë në shumë raste kërkojnë hetime më pak të komplikuar dhe rrjedhimisht edhe më të shkurtër. Gjithsesi, kjo gjë nuk gjen mbështetje në studimin e bërë. Numri mesatar i veprimeve hetimore të ndërmarrë ishte 12 për të gjitha dosjet.<sup>169</sup> Për dosjet ku të pandehurit ishin të paraburgosur, mesatarja ishte 11, ndërsa për dosjet ku nuk kishte masa paraburgimi mesatarja ishte 13. Është mjaft interesant fakti që 10 dosjet e studiara nga prokuroria e Tiranës dolën me një numër shumë të konsiderueshëm veprimesh hetimore. Mesatarja për dosjet e Tiranës ishte 25, ndërsa mesatarja për dosjet e tjera, përjashtuar Tiranën, ishte 9. Një shpjegim i mundshëm mund të jetë që prokuroria e Tiranës kryen hetime më të gjera. Një shpjegim tjetër mund të jetë që prokurori të ndryshme kanë pikëpamje të ndryshme mbi atë se çfarë përfshihet në dosjen gjyqësore. Gjithsesi, bazuar në këtë studim, nuk mund të nxirren përfundime në lidhje me këtë papërputhshmëri.

Vetëm në 8 dosje *nuk* kishte periudha relativisht të gjata pa ndërmarrë veprime, që do të thotë se nuk kishte periudha më të gjata se dy javë pa ndërmarrë veprime. Në tri nga rastet kishte periudha më të gjata se një vit pa ndërmarrë veprime. Në dy nga këta raste (rastet nr. 12 dhe 19) të pandehurit ishin në paraburgim por në një nga rastet (rasti nr. 12), periudha më e gjatë pa veprime (9 muaj) ndodhi përpara se të arrestohej i pandehuri. Në rastin tjetër (rasti nr. 19) kishte katër të pandehur të paraburgosur, ndërsa një i pandehur nuk u kap dot. Këtu pati dy periudha pa veprime, prej 5 muajsh e gjysmë dhe prej 9 muajsh, që u ndanë vetëm nga një veprim hetimor. Në 24 nga rastet ku të pandehurit ishin të paraburgosur (67%), kishte periudha ku nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim të cilat zgjasnin nga dy javë deri në gjashtë muaj. Ndërkohë që nuk pretendohet

<sup>168</sup> KPrP, neni 332, pika 2.

<sup>169</sup> Çfarëdolloj veprimi hetimor, si p.sh., arrestimi i të pandehurit, marrje në pyetje e dëshmitarëve, kontrolllet e banesave, kërkesat për ekspertim apo për informacion nga autoritete të tjerë apo vendime të prokurorisë.



aspak që ky studim të jetë gjithëpërfshirës, është gjithsesi një tregues se rastet ku të pandehurit janë në paraburgim nuk trajtohen aspak me “kujdesin e veçantë” që kërkohet në Konventën Evropianë të të Drejtave të Njeriut dhe në Kushtetutë, por ato trajtohen njësoj si rastet e tjera (ose ndoshta edhe me më shumë vonesa) dhe periudhat e zgjatura ku nuk ndërmerret asnjë veprim, nuk janë përjashtime por rregull.<sup>170</sup>

Disa çështje të gjykuara nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Më poshtë jepet një përshkrim i disa çështjeve të personave të paraburgosur, ku duket se hetimi nuk është kryer me *kujdesin e veçantë* të duhur. Duhet theksuar megjithatë, se Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda (GjAKR), si dhe Prokuroria për Krime të Rënda filluan të funksiononin më 1 janar 2004. Për këtë arsye çështjet e përmendura më poshtë u hetuan, fillimisht nga zyrat e prokurorisë së rrethit. Në çështjet e diskutuara, zbatim i rreptë i detyrimit të prokurorit për të raportuar çdo dy muaj mbi ecurinë e hetimeve mund të kishte shërbyer për të mënjeluar disa nga vonesat.

Çështja 1 – Vendimi nr.1 i GjKR, datë 10 mars 2004

(Informacioni është bazuar në vendimin e gjykatës)

Çështja është në ngarkim të dy meshkujve, njëri 16 vjeç, i mitur, dhe tjetri i lindur në vitin 1980, të akuzuar për grabitje me armë në bashkëpunim.<sup>171</sup> Dënimi maksimal i mundshëm është nga 10 deri në 20 vjet burgim.

**26 shtator 2003** – Rreth orës 23.00 të pandehurit arrijnë me makinë në fshatin Plyg ku dhe ndaluan. Pasi u maskuan dhe u armatosën me pistoleta ose pushkë, ata ndaluan një makinë me dy pasagjerë dhe u vodhën atyre telefonat celularë dhe 8 000 lekë [65 euro].

- Në bazë të akuzave të dy viktimave/dëshmitarëve, të dy të dyshuarit u arrestuan në një lokal.
- U krye hetimi në vendin e ngjarjes dhe armët dhe fishekët e përdorur nga të dyshuarit u gjetën në makinën e përdorur nga të dyshuarit dhe u sekuestruan. U morën edhe shenjat e gishtërinjve. U gjetën edhe dy targa makinash që përdorëshin nga të pandehurit dhe u sekuestruan. Maskat e përdorura nga të pandehurit u gjetën dhe u sekuestruan gjithashtu.
- Një dëshmitar njohu të dyshuarit si personat të cilët kishin shitur të dy telefonat celularë të vjedhur.
- Një dëshmitar i dytë njohu njërin nga të pandehurit.

**14 tetor 2003** – Ekspertiza teknike konfirmoi që shenjat e marra të gishtave i përkisnin njërit prej të pandehurve.

**28 tetor 2003** – Ekspertiza teknike konfirmoi që armët e sekuestruara funksiononin.

**10 dhjetor 2003** – Ekspertiza vlerësoi se vlera e celularëve të vjedhur ishte 7 000 lekë [57 euro] për secilin.

**10 shkurt 2004** – Kërkesa për gjykim u paraqit në gjykatë **4 muaj dhe 15 ditë** pas hapjes së hetimeve.

**10 mars 2004** – Çështja u zgjidh me *gjykim të shkurtuar*<sup>172</sup> gjatë të cilit të dy të pandehurit e pranuan fajësinë.

<sup>170</sup> Për informacion të mëtejshëm për studimin e dosjeve së prokurorisë, shih Paraburgimin – Shtojca 4.

<sup>171</sup> KP, nenet 140 dhe 25.

<sup>172</sup> KPrP, 403.

*Analizë* – Çështja nuk është e ndërlikuar. Të dyshuarit u arrestuan dhe provat u mblodhën ditën e ngjarjes. Ekspertiza teknike për shenjat e gishtërinjve dhe armët u përfundua brenda një muaji, ndërsa për vlerësimin e celularëve të vjedhur u deshën dy muaj e gjysmë. Koha e gjatë që u desh për të konfirmuar vlerën e celularëve duket e papranueshme, pasi një vlerësim i tillë mund të bëhet dukë kërkuar në internet apo duke pyetur në çfarëdolloj pike ku shiten telefona celularë. Për më tepër, kërkesa për gjykim mund të ishte paraqitur edhe pa këtë raport dhe shumë më përpara se të kalonte afati prej tre muajsh. Një gjë e tillë nuk ndodhi; përkundrazi, periudha fillestare prej tre muajsh u zgjat dhe kërkesa për gjykim u paraqit katër muaj dhe 16 ditë pasi kishin filluar hetimet. Arsyeja për këtë zgjatje nuk është e qartë.

Çështja 2 – Vendimi i nr. 2 i GjKR, datë 7 prill 2004

(Informacioni është i bazuar në vendimin e gjykatës)

Çështja është në ngarkim të dy meshkujve, të lindur në vitin 1977 dhe në vitin 1981, të akuzuar për vjedhje me armë në bashkëpunim<sup>173</sup> dhe mbajtje pa leje te municionit luftarak.<sup>174</sup> Dënimi maksimal i mundshëm është nga 10 deri në 20 vjet burgim.

**22 shtator 2003** – Gjatë orëve të para të mëngjesit, më 22 shtator, dy persona me maska e ndaluan një person që udhëtonte në rrugën Vlorë–Fier për në Tiranë, i vodhën me armë paratë dhe celularin. Ai e denoncoi krimin në polici, e cila e filloi hetimin në orën 9.00 të po atij mëngjesi.

- Më vonë gjatë asaj dite u arrestuan dy të pandehurit dhe u bënë hetimet në vendin e ngjarjes dhe kontrolli i banesës. Gjatë kontrollit të ushtruar në banesë u sekuestruan telefoni celular, disa para dhe municione. Ata u identifikuan nga viktimë/dëshmitari të njëjtën ditë. U dëgjua gjithashtu edhe një *dëshmitar i dytë* i cili e kishte parë vjedhjen.

**11 nëntor 2003** – Viktimë/dëshmitari u dëgjua nga policia gjyqësore.

**23 shkurt 2004** – Çështja iu dorëzua gjykatës **5 muaj e 1 ditë** pas fillimit të hetimeve.

**7 prill 2004** – Çështja u zgjidh me *gjykim të shkurtuar* gjatë të cilit të dy të pandehurit e pranuan fajësinë.

*Analizë* – Rasti është nga më të thjeshtët. Kjo duket sidomos nga pranimi i fajit dhe qëndrimi pendues i të pandehurve në gjyq. Dy të dyshuarit u arrestuan pasi krimi u denoncua nga viktimë/dëshmitari dhe krahas dëgjimit të dytë të viktimës/dëshmitarit më 11 nëntor, të gjithë provat e paraqitura në kërkesën për gjykim u mblodhën ditën e ngjarjes më 22 shtator 2003. Në vendim nuk del e qartë se pse viktimë/dëshmitari u dëgjua përsëri në nëntor dhe nëse deklarata e tij u mor kur ai kallëzoi krimin. Sipas kronologjisë së ngjarjes, hetimi i krimit përfundoi ditën e ngjarjes dhe deklaratat e mëvonshme, siç ishte deklarata e dytë e viktimës/dëshmitarit duhet të ishin marrë brenda pak ditësh. Pas kësaj, duhej të ishte paraqitur menjëherë kërkesa për gjykim. Gjithsesi, kërkesa për gjykim u paraqit vetëm pas 5 muajsh e një dite që nga moment i arrestimit të të pandehurve, që do të thotë se prokurori e zgjati afatin tremujor të hetimit paraprak. Arsyeja për zgjatjen është e paqartë.

<sup>173</sup> KP, nenet 140 dhe 25.

<sup>174</sup> KP, neni 278, pika. 3.

**Çështja 3 – Vendimi nr.9 i GjKR, datë 24 maj 2004**

(Informacioni është i bazuar në vendimin e gjykatës)

Çështja është në ngarkim të një të pandehuri, i lindur në vitin 1981, i akuzuar për vjedhje me armë në bashkëpunim<sup>175</sup> dhe mbajtje të armëve luftarake pa autorizim.<sup>176</sup> Dënimi maksimal i mundshëm është nga 10 deri në 20 vjet burgim.

**17 janar 2004** – Dy persona që udhëtonin me makinë drejt Tiranës u ndaluan tek “Unaza e Rubikut” nga një person, i cili kishte një armë automatike. Atyre iu tha të fiknin dritat dhe të dorëzonin paratë dhe telefonat celularë, gjë të cilën ata e bënë.

**18 janar 2004** – Pasi viktimat/dëshmitarët e kallëzuan krimin, i dyshuari u arrestua dhe hetimet paraprake filluan.

- U bërë hetimi në vendin e ngjarjes.
- I dyshuari u kërkua dhe telefoni celular u gjet.
- Arma dhe telefoni celular u sekuestruan.<sup>177</sup>

**19 janar 2004** – Objektet e vjedhur u njohën.

- U dëgjuan viktimat/dëshmitarët.<sup>178</sup>

**27 prill 2004** – Çështja iu dorëzua gjykatës **3 muaj e 9 ditë** pas fillimit të hetimeve.

**24 maj 2004** – Çështja u zgjidh me *gjykim të shkurtuar* gjatë të cilit të pandehurit e pranuan fajësinë dhe treguan pendesë të thellë.

*Analizë* – Situata në këtë rast është e ngjashme me dy çështjet e tjera që u diskutuan më sipër. Duket se hetimi ka përfunduar ditën e ngjarjes dhe përsëri u deshën më shumë se tre muaj që çështja të paraqitej në gjykatë për shqyrtim.

<sup>175</sup> KP, neni 140.

<sup>176</sup> KP, neni 278, pika 3.

<sup>177</sup> Nga vendimi nuk është e qartë, se në cilën ditë u sekuestruan arma dhe telefonat celularë, por duke pasur parasysh se i dyshuari u arrestua dhe u kontrollua, mendohet që sekuestrimi të ketë ndodhur po atë ditë.

<sup>178</sup> Në vendim nuk është e qartë, nëse u dëgjuan në këtë ditë, por duke marrë parasysh se kjo ishte dita në të cilën ata njohën objektet e vjedhur, mendohet që atë të jenë dëgjuar atë ditë ose një ditë përpara, kur e raportuan krimin.

Çështja 4 – Vendimi nr. 10 i GjKR, datë 7 qershor 2004

(Informacioni është i bazuar në dosjen e gjykatës, kërkesën për shqyrtim gjyqësor dhe në vendimin e gjykatës.)

Çështja është në ngarkim të një personi të akuzuar me pjesëmarrje dhe organizim të një organizate kriminale dhe me trafikim narkotikësh.<sup>179</sup> Dënimi maksimal i mundshëm është 5 deri në 15 vjet burgim.

**20 shtator 2002** – Gjykata e Apelit në Romë autorizoi përgjimin e thirrjeve në telefonat e të dyshuarve.

**Tetor – dhjetor 2002** – U krye përgjimi i telefonave.

**10 mars 2003** – Hetimi u krye nga Prokuroria e Teramos (Itali) dhe u dorëzua një kërkesë për ndjekjen e çështjes në Shqipëri.

**13 mars 2003** – U mor vendimi italian për të arrestuar të dyshuarit ( në mungesë).

**7 korrik 2003** – I dyshuari u arrestua në Vlorë.

**9 korrik 2003** – U mbajt seanca e vlefësimimit.

**10 korrik 2003** – Ministria e Jashtme italiane kërkoi transferimin e dosjes në Shqipëri.

**7 gusht 2003** – Prokuroria e Vlorës i dërgoi një *letërporosi* autoriteteve gjyqësore italiane me anë të së cilës u kërkon transferimin e dosjes.

**13 gusht 2003** – Dosja transferohet nga Italia në Shqipëri.

**8 tetor 2003** – Prokuroria shqiptare vendos ta ndryshojë akuzën *dhe* ta zgjasë hetimin me tre muaj, deri më 9 janar 2004.

**8 janar 2004** – Hetimi zgjatet edhe 3 muaj të tjerë, deri më 8 prill 2004. Arsyet e cituara janë: për të përfunduar hetimin, për të njoftuar të pandehurin për ndryshimin e akuzës dhe për të marrë në pyetje të pandehurin.

- Asgjë që përmban dosja nuk dëshmon të jetë ndërmarrë ndonjë nga këta veprime.

**8 prill 2004** – Hetimi zgjatet edhe për 2 muaj të tjerë, deri më 8 qershor 2004. Arsyet: për të shtuar akuzat të reja (KP, neni 333 - Akuzat të reja), për të marrë në pyetje të pandehurin për aktet e reja kriminale, për të bërë hetime të mëtejshme dhe për të përfunduar hetimin.

- Asgjë që përmban dosja nuk dëshmon të jetë ndërmarrë ndonjë nga këta veprime.

**23 prill 2004** – Kërkesa për shqyrtim gjyqësor u depozitua **9 muaj e 16 ditë** pas arrestimit të të dyshuarit<sup>180</sup>

**7 qershor 2004** – Çështja u zgjidh me gjykim të shkurtuar.

*Analizë* – Hetimi u krye kryesisht në Itali më anë të përgjimit të telefonatave, përpara se çështja të transferohej në Shqipëri. Nuk është e qartë nëse u ndërmor apo jo ndonjë veprim hetimor pasi i pandehuri u arrestua në Shqipëri më 9 korrik 2003 dhe çështja u regjistrua nga prokuroria shqiptare. *As akuzat dhe as vendimi nuk tregojnë të jetë kryer ndonjë hetim pas transferimit të dosjes. Megjithatë, afati për të përfunduar “hetimin” në Shqipëri u zgjat tri herë, për 8 muaj gjithsej. Më tej akuzat u depozitua më 23 prill 2004 dhe pas një gjykimi të shkurtuar, gjykata e shpalli vendimin më 7 qershor 2004.*

<sup>179</sup> KP, nenet 333 dhe 284/a.

<sup>180</sup> Dënimi maksimal i parashikuar në këtë rast ishte 5 deri në 15 vjet burgim, që i përket pikërisht atij boshllëku që u diskutua më sipër, pra, dënimi i parashikuar nuk është as në maksimum 10 vjet (15 janë më shumë se 10) dhe as në minimum 10 vjet (5 janë më pak se 10). Me logjikën e argumentit të mësipërm, i pandehuri duhet të ishte liruar kur të kishin kaluar gjashtë muaj nga arrestimi i tij dhe çështja nuk ishte dërguar në gjykatë.

## 15. Komete përmbyllëse

Siç u vërejt edhe në hyrjen e këtij kapitulli, heqja e lirisë së individit e vendos atë në një situatë jashtëzakonisht delikate. Për këtë arsye, është e rëndësishme që heqja e lirisë të jetë sa më e kufizuar dhe që të ndiqen procedurat rigorozë të përcaktuara në dokumentet ndërkombëtarë, në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në Kodin e Procedurës Penale. Të gjithë aktorët e përfshirë, që janë policia, prokuroria, gjyqtari dhe avokati mbrojtës, kanë gjithashtu një rol kyç në ruajtjen e këtyre standardeve dhe në marrjen e masave ndaj abuzimeve kundrejt personave apo veprimeve hetimore. Në këtë aspekt ka vend për shumë përmirësim në kontekstin shqiptar. Kështu, është vënë re se në shumicën e rasteve personat të cilëve u hiqet liria nuk informohen për arsyet e arrestimit apo për të drejtat e tyre; ata keqtrajtohen rregullisht nga policia; ata nuk kanë mundësi të kontaktojnë me një avokat mbrojtës dhe nuk dërgohen përpara një gjyqtari brenda afatit të përcaktuar në Kushtetutë. Vendimet argumentohen në mënyrë shumë të dobët dhe japin përshtypjen se vendimet për caktimin e masave të sigurisë shpeshherë lëshohen pa pasur arsye ligjore. Avokatët bëjnë shumë pak për të kundërshtuar vendimet apo për të nxjerrë në pah rastet e abuzimit apo praktika të tjera të gabuara. Hetimet paraprake shpeshherë karakterizohen nga periudha të zgjatura, ku nuk ndërmerret asnjë veprim dhe për momentin i vetmi mekanizëm për ta ndrequr këtë, i parashikuar në Kodin e Procedurës Penale, në mënyrë sistematike nuk merret parasysh. Afatet e paraburgimit pezullohen pa arsye të ligjshme; shpeshherë tejkalohen dhe kjo nuk sjell lirinë e të pandehurit.

Për t'i ndrequr këto probleme duhet rishikuar kuadri ligjor në mënyrë që të harmonizohet Kodi i Procedurës Penale me Kushtetutën. Kodi i Procedurës Penale duhet rishikuar dhe përmirësuar në mënyrë që t'u japë udhëzime të qarta të gjithë aktorëve të përfshirë për rolin dhe detyrimet e tyre në lidhje me heqjen e lirisë. Duhet krijuar mekanizma për të siguruar që praktikata e gabuara të sistemit të zbulohen menjëherë dhe të korrigjohen, si dhe të merren masa disiplinore për zyrtarët të cilët abuzojnë me procedurat apo nuk marrin masa për të ndrequr gabimet. Policia, prokuroria, gjyqtarët dhe avokatët mbrojtës duhen trajnuar mbi standardet e të drejtave themelore të njeriut, mbi kuadrin ligjor dhe mbi rolin që ata kanë në trajtimin e çështjeve ku personit i është hequr liria. Masat për trajtimin e problemeve që kanë të bëjnë me masat e sigurisë në çështjet penale nuk duhet as të jenë të kushtueshme dhe as të kërkojnë harxhim të madh kohor, gjë që do të jetë padyshim një hap i rëndësishëm përpara në rrugën e Shqipërisë drejt integritimit evropian dhe standardeve të drejtësisë.

## Rekomandime

### *Arrestimi dhe ndalimi*

1. KPrP, në veçanti 251, duhet të ndryshohet për të bërë të qartë që kushtet e parashikuara në Kushtetutë për arrestimin/ndalimin e personit të dyshuar për kryerjen e një vepre penale janë të zbatueshme për çfarëdolloj arrestimi/ndalimi të kryer nga policia.
2. Neni 251 i KPrP duhet ndryshuar për të garantuar që policia të njoftojë menjëherë personin e arrestuar *me shkrim dhe gojarisht* për arsyet e arrestimit si dhe për të drejtat, që janë: e drejta për të mos dhënë deklaratë, e drejta për të patur një avokat mbrojtës, në rast nevojë edhe falas, si dhe e drejta për të kontaktuar me familjen.
3. Policia duhet të krijojë, për shembull, nëpërmjet rregulloreve të brendshme, një rutinë një rutinë të përcaktuar qartë në lidhje me:
  - informimin e personit të arrestuar për të drejtat e tij në mënyrë të tillë që të garantohet që personat t'i kuptojnë të drejtat e tyre,
  - mënyrën se si të garantohet që personi të mund të kontaktojë familjen dhe avokatin mbrojtës,
  - mënyrën se si të garantohet që personi të mos firmosë asgjë që nuk e ka lexuar, që duket se nuk e kupton apo me të cilën ai nuk është dakord,
  - mënyrën se si të dokumentohen veprimet që kanë të bëjnë me personat të cilëve u është hequr liria.
4. Policia duhet trajnuar mbi kuadrin ligjor për heqjen e lirisë dhe në veçanti mbi nenin 5 të Konventës Evropiane të të Drejtave e Njeriut dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane lidhur me këtë dispozitë.
  - I duhet kushtuar vëmendje e veçantë konceptit të arrestit *në flagrancë* për të garantuar që policia të mos i tejkalojë kompetencat e saj në ndalimin e personave.
5. Të drejtat e personave të cilëve u është hequr liria, duhen afishuar në çdo ambient ku mbahen personat e arrestuar apo të paraburgosur.
6. Publiku i gjerë duhet informuar për të drejtat e personave të cilëve u është hequr liria.
7. Çfarëdolloj kontrolli ose mbikëqyrjeje të veprimtarisë së policisë duhet të shqyrtojë praktikën e zakonshme të arrestimit dhe ndalimit, për të siguruar në mënyrë të veçantë respektimin e të drejtave sipas Kushtetutës dhe Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

*E drejta për të pasur avokat mbrojtës*

1. Dhoma e Avokatisë duhet të publikojë çdo vit lista me emrat, llojin e çështjeve me të cilat merret secili anëtar si dhe kontaktet e tij/saj, duke përfshirë edhe numrat e telefonit të të gjithë anëtarëve, të ndarë sipas dhomave të avokatisë në rrethe (Listë anëtarësie).
2. Për kontaktime jashtë orarit të punës, Dhoma e Avokatisë duhet të krijojë një sistem avokatësh mbrojtës që rrinë në dispozicion.
3. Çdo komisarjat policie si dhe dhomat e paraburgimit duhet të kenë një kopje të listës së anëtarësisë të Dhomës së Avokatisë.
4. Menjëherë pas arrestimit, policia duhet të informojë me shkrim personin mbi të drejtat e veta; në këtë informacion duhet të përmendet edhe lista e anëtarësisë e Dhomës së Avokatisë si dhe mundësia e personit të arrestuar për të kontaktuar me një avokat.
5. Çdo personi të arrestuar i duhet dhënë menjëherë mundësia për të parë listën e anëtarëve të Dhomës së Avokatisë dhe të kontaktojë me një avokat.
6. Avokati mbrojtës nuk duhet të ketë nevojë të kërkojë autorizim nga prokurori për të vizituar klientët e tij. Duhet të jetë e mjaftueshme të këtë vendimin e emërimit apo prokurën (nga familja apo personi i arrestuar) bashkë me licencën nga Dhoma e Avokatisë.
7. Avokatët mbrojtës duhet të sigurohen që gjithmonë të takohen dhe të flasin me klientët e tyre privatisht përpara seancës së verifikimit/vlerësimit.
8. Për sa i përket sistemit të caktimit të avokatit mbrojtës nga shteti për personat që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, i gjithë ky sistem në Shqipëri duhet të rishikohet.<sup>181</sup>

*Marrja fillestare në pyetje*

1. Në mungesë të udhëzimeve të veçanta nga prokurori në ngarkim të hetimeve, policia *nuk* duhet ta marrë në pyetje personin e arrestuar.
2. Përpara se të kryhet hetimi, personi i arrestuar duhet të informohet për të drejtën e një avokati mbrojtës dhe për mundësinë reale për të kontaktuar me një të tillë.
  - Dorëheqja nga një e drejtë e tillë nga ana e të pandehurit duhet bërë me vullnetin e tij dhe pa kurrfarë presioni. Aktdorëheqja duhet bërë me shkrim.

<sup>181</sup> Shih më tej kapitullin “E drejta për një mbrojtje efektive”.

- Një i mitur apo person me aftësi të kufizuara (të përkohshme apo të përhershme), nuk duhet lejuar të heqë dorë nga e drejtat për një avokat mbrojtës dhe nuk duhet marrë asnjëherë në pyetje pa praninë e avokatit mbrojtës.
3. Nëse i pandehuri kërkon praninë e avokatit mbrojtës gjatë marrjes në pyetje, derisa të plotësohet kjo kërkesë, i pandehuri nuk duhet të merret në pyetje. Nëse avokati mbrojtës i kërkuar nuk është i disponueshëm brenda një kohe të shkurtër, atëherë duhet parë mundësia për praninë e një avokati tjetër që të jetë i pranueshëm për të pandehurin.
  4. Gjatë marrjes në pyetje, të pandehurit nuk i duhet kërkuar të nënshkruajë asgjë pa qenë të sigurtë që i pandehuri e ka lexuar ( apo ia ka lexuar dikush tjetër) dhe e ka kuptuar atë që po nënshkruan.

#### *Keqtrajtimi fizik*

1. Çdo raportim për keqtrajtim fizik nga ana e policisë gjatë arrestimit, duhet hetuar dhe personat përgjegjës duhen disiplinuar dhe duhen sjellë përpara drejtësisë.
2. Prokurorët, gjyqtarët dhe avokatët duhet të vënë re nëse ka shenja keqtrajtimi tek personat e arrestuar. Kur ka shenja keqtrajtimi ata duhet të veprojnë menjëherë për të verifikuar keqtrajtimin dhe t'i paraqesin autoritetit përkatës një raport në lidhje me keqtrajtimin.

#### *Afatet e kohëzgjatjes së seancës për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë*

1. Nenet 248 dhe 258 të KPrP duhen ndryshuar për t'i bërë të pajtueshëm me Kushtetutën, e cila parashikon që kujtdo që i hiqet liria, ka të drejtë të dërgohet përpara një gjyqtari brenda 48 orësh pas arrestimit.
2. Mosrespektimi i afateve duhet të sjellë lirimin e të dyshuarit.
3. Duhet krijuar mekanizma kontrolli të brendshëm e të jashtëm për të garantuar që afatet kohorë të respektohen dhe që të paraburgosurit të lirohen sa herë që nuk respektohen afatet. Moszbatimi i këtyre rregullave duhet të sjellë si pasojë masë disiplinore apo akuzë për shpërdorim detyre.

#### *Seancat për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë dhe vendimet për masën e arrestit në burg*

1. Gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët duhet të trajnohen mbi çështjet e paraburgimit, si më poshtë:



- Në çfarë rrethanash mund t'i hiqet liria një personi?
    - Cili është standardi i provës për të provuar:
      - Një dyshim të arsyeshëm (në raste individuale);
      - Rrezikun për largim (në raste individuale);
      - Vënien në rrezik të garantimit e të marrjes së provës (në raste individuale);
      - Rrezikun për kryerjen e krimeve të tjera (në raste individuale)?
    - Si të mbahet parasysh kriteri i proporcionalitetit?
  - Cila palë ka barrën e provës për secilin element?
  - Si të zhvillohet seanca për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë, në mënyrë që të garantohet që i paraburgosuri të ketë me të vërtetë mundësi të kundërshtojë urdhrin për paraburgim;
  - Si të hartohet një vendim caktimi masë sigurie dhe rëndësia e trajtimit të secilit të paraburgosur në mënyrë individuale në bazë të të mirave e të këqijave?
2. Dhoma Kombëtare e Avokatisë duhet të ofrojë trajnime për anëtarët e saj mbi çështje që kanë të bëjnë me paraburgimin dhe në veçanti se si të kundërshtojnë me sukses urdhrat e paraburgimit.
  3. Avokati i Popullit si dhe inspektoratet në varësi të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe në varësi të Ministrisë së Drejtësisë duhet të kryejnë kontrole të rregullt se si trajtohen nga policia, prokuroria dhe gjykatat rastet që kanë të bëjnë me heqjen e lirisë.

#### *Afatet dhe hetimi paraprak*

1. I duhet dhënë fund praktikës së pezullimit/shtyrjes së gjyqeve, në çështjet ku i pandehuri është i paraburgosur, për shkak të periudhës së pushimeve të gjykatës.
2. Duke marrë parasysh parimin e “gjykimit të pandërprerë” siç shprehet edhe në nenin 342 të KPrP, ka nevojë të sqarohet se si lidhet kjo dispozitë me nenin 39 të ligjit për pushtetin gjyqësor ku përcaktohet afati i lejes së gjyqtarëve.
3. Neni 263 i KPrP duhet ndryshuar për të eliminuar boshllëkun që mbulon krimet e dënueshëm me 5 deri në 15 vjet apo me 7 deri në 15 vjet burgim.
4. Në botimin e radhës të KPrP duhet korrigjuar gabimi i keqvendosjes së fjalëve “minimumi” dhe “maksimumi” në nenin 263, pikat (c) dhe (d).

5. Duhet respektuar me rigorozitet detyrimi i prokurorisë për të informuar gjykatën me shkrim rreth procedimeve për çështjet ku i pandehuri është i paraburgosur.
  - Kur nuk jepet informacioni që kërkohet në përputhje me nenin 246 të KPrP, gjykata dhe avokati mbrojtës duhet të kërkojnë informacion rreth zhvillimit të procedimeve.
  - Si gjyqtari dhe prokurori duhen kontrolluar rregullisht për të garantuar zbatimin e rregullave.
6. I duhet dhënë fund praktikës së pezullimit të afateve të paraburgimit për të gjithë të pandehurit në një çështje, pavarësisht se cili i pandehur apo avokat mbrojtës bëhet shkak për pezullimin.
  - Inspektoratet e Ministrisë së Drejtësisë dhe të Këshillit të Lartë të Drejtësisë duhet të bëjnë një vlerësim të plotë në lidhje me përdorimin e pezullimeve.

Në rastet ku të pandehurit janë të paraburgosur, hetimet paraprake duhen përfunduar në kohën më të shkurtër të mundshme dhe nuk duhen pranuar periudha ku nuk ndërmerret asnjë veprim. Kontrollat mbi veprimtarinë e prokurorisë duhen përqendruar në mënyrë të veçantë në këtë çështje. Nuk duhen dhënë zgjatje pa pasur arsye të forta dhe objektivist të justifikueshme.

## II. E DREJTA PËR NJË MBROJTJE EFEKTIVE

### 1. Hyrje

E drejta për t'u mbrojtur është pjesë themelore e të drejtës për një gjykim të drejtë në procedimet penale dhe shërben ndër të tjera, për të siguruar respektimin e parimit të *barazisë së armëve*. Parimi i *barazisë së armëve* do të thotë që të gjitha palëve në një proces u duhen dhënë mundësi të arsyeshme për të paraqitur çështjet e tyre në të tilla kushte që të mos i vendosin në një disavantazh të dukshëm në krahasim me kundërshtarët e tyre.<sup>182</sup> Në një sistem gjyqësor i cili funksionon siç duhet dhe është i balancuar, aktorët e ndryshëm në të, vëzhgojnë dhe ruajnë njëri-tjetrin me shumë kujdes, duke bërë të mundur kështu kundërveprim të shpejtë ndaj çfarëdolloj tendence për keqadministrim të drejtësisë, qoftë kjo e qëllimshme apo jo. Për sa i përket parimit të *barazisë së armëve*, duhet theksuar se ndërsa në mjaft çështje civile palët ndodhen pak a shumë në të njëjtën situatë, kjo gjë ndodh shumë rrallë në çështjet penale ku individi përballet me të gjithë pushtetin e aparatit shtetëror. Për më tepër, fakti që gjykatat dhe prokuroritë janë institucione shtetërore mund të krijojë përshtypjen, si brenda ashtu edhe jashtë, se ato punojnë së bashku. Në kontekstin e çështjeve shumë të diskutuara në fushën politike, siç është lufta kundër krimit të organizuar, gjykatat dhe prokuroritë mund të mendohet se kanë një qëllim të përbashkët dhe mund të ketë presion politik për të rritur numrin e dënimeve për këto lloj krimesh.

Në këtë kapitull do të shqyrtohet kuadri ligjor i cili rregullon funksionin e avokatëve mbrojtës në Shqipëri si dhe do të diskutohet sjellja e avokatëve mbrojtës gjatë proceseve gjyqësore. Duke pasur parasysh se shpeshherë janë avokatët mbrojtës ata që shkaktojnë vonesat e gjyqeve, do të analizohet me imtësi mundësia për të ndërmarrë masa disiplinore ndaj tyre. Pas kësaj, do të diskutohen e drejta për mbrojtje falas, si dhe pagesat për avokatët e caktuar nga shteti dhe për ata të caktuar privatisht.

### 2. Kuadri ligjor

Në nenin 6 paragrafi 3 (a-c) të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, përcaktohet:

3. Çdo i pandehur ka të paktën të drejtë që:
  - a. të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që bëhet kundër tij;

<sup>182</sup> Shih për shembull çështjen “Krcmár dhe të tjerë kundër Republikës çeke”, 3 mars 2000, paragrafi 39.

- b. t'i jepen koha dhe lehtësitë e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes;
- c. të mbrohet vetë ose të ketë ndihmën e një mbrojtësi të zgjedhur prej tij dhe, në qoftë se nuk ka mjete për të shpërblyer një mbrojtës, të mund të ndihmohet falas nga një avokat i caktuar zyrtarisht, kur e kërkojnë interesat e drejtësisë;

Në Shqipëri, e drejta për t'u mbrojtur në *procedimet penale* është e sanksionuar në Kushtetutë, neni 31 pikat b dhe ç, ku përcaktohet që i pandehuri ka të drejtë:

- të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet dhe
- të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme.

Në nenin 6 dhe nenet 48 deri në 57, KPrP parashikon kuadrin e përgjithshëm për avokatin mbrojtës në procedimet penale. Përveç disa të drejtash, siç është e drejta për të pranuar akuzën apo e drejta për të mos qenë i pranishëm, avokati mbrojtës gëzon të njëjta të drejta si dhe i pandehuri të cilin përfaqëson.<sup>183</sup>

Brenda kontekstit të veçantë shqiptar, duhet theksuar se në regjimin komunist avokatët mbrojtës nuk lejoheshin dhe për këtë arsye koncepti i kundërshtimit në gjykim është mjaft i vonët.<sup>184</sup> Arsimimi i avokatëve në Shqipëri varion nga një kurs gjashtëmujor në katër vjet studime në fakultetin e drejtësisë, pasuar nga tre vjet në Shkollën e Magjistraturës (ose studime pasuniversitare në fakultetin e drejtësisë).<sup>185</sup> Ndërkohë që cilësia e arsimimit në fakultetet e drejtësisë mund të mos jetë ende sipas standardeve evropiane, Shkolla e Magjistraturës konsiderohet gjerësisht të jetë një hap përpara në dhënien e kualifikimit të duhur për gjyqtarët dhe prokurorët e ardhshëm. Aktualisht në Shqipëri nuk ofrohen trajnime të veçanta apo të vazhdueshme për avokatët mbrojtës dhe kështu avokatët janë personat me përgatitjen më të pakët akademike në sallën e gjyqit. Këta janë faktorë që mund të ndikojnë negativisht në të drejtën për një mbrojtje efektive.

Takimet me avokatët, veçanërisht në Dhomën Kombëtare të Avokatisë, konfirmojnë se avokatët mbrojtës shqiptarë shpeshherë kanë përshtypjen se ata nuk ndodhen në një pozitë të njëjtë me prokurorët. Megjithëse kjo është e vështirë për të evidentuar, vëzhgimet e proceseve gjyqësore të bëra në kuadër të Programit për zhvillimin e një gjykimi të drejtë, tregojnë që kjo mund të jetë në fakt e vërtetë. Për shembull, pretendimet nga prokurori shpeshherë pranohen ndërsa ato të paraqitura nga mbrojtja shpeshherë hidhen poshtë. Ndërkohë që një arsye për këtë mund të jetë se ato të paraqitura nga mbrojtja mund të jenë të shkruara dhe të argumentuara jo mirë, mund të ketë edhe arsye të tjera që nuk kanë të bëjnë me çfarë është shkruar më sipër.

---

<sup>183</sup> KPrP, neni 50.

<sup>184</sup> Pasi u ndalua në vitin 1967, profesioni i avokatit u rivendos në vitin 1990; për më tepër shih *Analizën e Sistemit Ligjor në Shqipëri* (Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Tiranë, 2004), kapitulli VI.

<sup>185</sup> Për një pasqyrë lidhur me arsimimin në fushën e drejtësisë, shih po aty, kapitujt X dhe XI.

**Disa shembuj të trajtimit të diferencuar midis prokurorit dhe mbrojtjes**

**Çështje e gjykuar në Gjykatën e Rrethit të Gjirokastrës:** Sa herë që avokati mbrojtës i drejtohej trupit gjykues, gjyqtarët flisnin dhe qeshnin midis tyre.

**Çështje e gjykuar në Gjykatën e Rrethit të Tiranës:** Kryetari i trupit gjykues sillej vazhdimisht në mënyrë shumë të pasjellshme me mbrojtjen, ndërsa prokurorit i përgjigjej me shumë mirësjellje. Njëri nga të pandehurit u indinjua nga kjo dhe u mundua të ndërhynte por u ndërpre në mënyrë të ashpër. Pas seancës njëri nga gjyqtarët e trupit gjykues u shpjegoi të pandehurve se ata nuk mund të merrnin fjalën në gjyq pa marrë lejë.

**Avokatet mbrojtës në Kukës:** Sipas një rregulloreje të brendshme të vitit 2004, avokatët mbrojtës nuk lejohen të hyjnë në gjykatë për të studiuar dosjet apo për të dorëzuar dokumente përpara orës 13.00.

**Çështje e gjykuar në Gjykatën e Rrethit të Tiranës:** Ndërkohë që seancat zhvilloheshin në një sallë të veçantë gjyqi, kryetari i trupit gjykues e priste prokurorin rregullisht në zyrën e tij pesë deri në pesëmbëdhjetë minuta përpara fillimit të gjyqit. Këto diskutime nuk ndiqeshin nga avokatët mbrojtës. Gjatë seancës, gjyqtarët ishin shumë të sjellshëm me prokurorin, duke i thënë të qetësohej dhe të procedonte me ngadalë ndërkohë që dukej qartë se ai ishte shumë i paorganizuar në paraqitjen e provave. Në të njëjtën kohë, kryetari i trupit gjykues i qortoi ashpër të pandehurit të cilët donin të flisnin, që të mos humbnin kohë duke thënë gjëra që ishin thënë më parë. Më në fund, trupi gjykues pranoi si provë një kasetë, vlefshmëria e së cilës ishte kundërshtuar nga mbrojtja me arsyen se mbrojtja nuk kishte pasur mundësi ta shqyrtojë atë, siç parashikohet nga neni 223 të KPrP. As gjykata ku u gjykua çështja dhe as gjykata e apelit nuk dhanë ndonjë arsye për pranimin e kasetës dhe as prokurorit nuk iu kërkua të jepte argumente për vlefshmërinë e saj. Përveç gjithë kësaj, gjyqtarët u vunë re disa herë të qeshnin me avokatët dhe të pandehurit.

**Çështje e gjykuar në Gjykatën e Rrethit të Tiranës:** Seancat u mbajtën më së shumti në zyrën e gjyqtarit dhe prokurori i çështjes shpeshherë ndodhej në zyrën e gjyqtarit përpara fillimit të pjesës më të madhe të seancave. Dukej se gjyqtari dhe prokurori ishin shumë miq. (Të tilla kontakte jozyrtare mes gjyqtarëve dhe prokurorëve vihen re shpeshherë.)

## 2.2 Ligji për profesionin e avokatit<sup>186</sup>

Për të pasur një pasqyrë më të qartë lidhur me profesionin e avokatit në Shqipëri, mund të lexoni *Analizën e Sistemit Ligjor në Shqipëri*, botuar nga OSBE-ja në vitin 2004. Në këtë analizë theksohet se integriteti i profesionit të avokatisë është një çështje e rëndësishme veçantë dhe ndërsa gjyqtarët dhe prokurorët shpesh akuzohen për veprime jo të rregullta, shkaku kryesor shpeshherë qëndron tek avokatët dhe noterët.<sup>187</sup> Komentet mbi projektligjin për profesionin e avokatit janë bërë nga Shoqata e Juristëve Amerikanë, Iniciative Ligjore për Vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore (ABA/CEELI).<sup>188</sup>

Në Shqipëri ka rreth 2 400 avokatë, por vetëm 1 000 prej tyre e ushtrojnë profesionin dhe nga këta 70% e ushtrojnë profesionin në Tiranë.<sup>189</sup>

Profesioni i avokatit në Shqipëri rregullohet me ligjin për profesionin e avokatit, ligj i cili është miratuar në vitin 2003.<sup>190</sup> Sipas ligjit, ekziston një Dhomë Kombëtare e Avokatisë e cila është përgjegjëse për të rregulluar dhe kontrolluar ushtrimin e profesionit të avokatit. Ky ligj përcakton se profesioni i avokatit është profesion i lirë, i pavarur, i vetërregulluar dhe i vetëdrejtuar.<sup>191</sup> Në këtë ligj përcaktohen mënyrat sesi avokati jep *ndihmë juridike*<sup>192</sup> si dhe renditen të drejtat dhe detyrat e avokatit.<sup>193</sup> Në kreu IV përcaktohen kushtet për ushtrimin e profesionit të avokatit. Këto kritere janë: arsim i lartë juridik, një vit stazh si asistent pranë një avokati, marrja e më shumë se 50% të pikëve në provimin e kualifikimit për ushtrimin e profesionit të avokatisë dhe anëtarësimi në një nga Dhomat e Avokatisë në rrethe. Organet më të larta përfaqësuese të Dhomës Kombëtare të Avokatisë janë Këshilli i Përgjithshëm dhe Komiteti Drejtues. Dhoma Kombëtare e Avokatisë ka në varësi dhomat e avokatisë në rrethe, të cilat janë të organizuara në të njëjtën mënyrë si dhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë.<sup>194</sup> Këshilli i Përgjithshëm i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, ndër të tjera, ka përgjegjësinë të miratojë Statutet dhe Kodin e Etikës për avokatët si dhe është përgjegjës për të ndihmuar dhe për të bashkërenduar veprimtaritë e dhomave në rrethe. Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë është përgjegjës për hartimin e Statuteve dhe Kodit të Etikës. Ai revokon gjithashtu me ose pa afat ose heq lejen për ushtrimin e profesionit si dhe përfaqëson Dhomën Kombëtare të Avokatisë në marrëdhëniet me të tretët sipas rregullave të vendosura në statut.<sup>195</sup> Sipas statuteve të Dhomës Kombëtare të Avokatisë,

<sup>186</sup> Termi *avokat* këtu përdoret për të përcaktuar një jurist i cili vepron dhe kërkon në emër të të tjerëve, për shembull si avokat mbrojtës apo këshillues ligjor për paditësin në procedimet civile.

<sup>187</sup> *Analizë e Sistemit Ligjor në Shqipëri*, fq. 168.

<sup>188</sup> <http://www.abanet.org/ceeli/publications/assessments/home.html#albania> [vizituar më 31 maj 2006].

<sup>189</sup> Intervistë, Maksim Haxhia, Kryetar i Dhomës Kombëtare të Avokatëve [takim i datës 27 prill 2005].

<sup>190</sup> Ligji nr. 9109, datë 17 korrik 2003, "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë" [Ligji për avokatinë].

<sup>191</sup> Ligji për avokatinë, neni 1.

<sup>192</sup> Ligji për avokatinë, nenet 2-5.

<sup>193</sup> Ligji për avokatinë, kreu II, nenet 6-16.

<sup>194</sup> Ligji për avokatinë, kreu III.

<sup>195</sup> Ligji për avokatinë, neni 20.

kryetari i Dhomës Kombëtare të Avokatisë është gjithashtu kryetar i Këshillit të Përgjithshëm dhe kryetar i Këshillit Drejtues dhe përfaqëson Dhomën Kombëtare të Avokatisë në marrëdhëniet me të tretët.<sup>196</sup>

Koment: Përqendrimi i pushtetit në një person të vetëm, siç u përshkrua më sipër, është një çështje për të cilën mund të vihet në diskutim nëse është e mirë për cilëndo organizatë, sidomos për një organizatë, funksioni i së cilës është të përfaqësojë anëtarët e saj, si dhe të kontrollojë e të rregullojë veprimtaritë e tyre. Do të ishte mirë që vendosja e personave në funksione të tilla të bëhej me zgjedhje.

### *Kodi Etik i Avokatit*

Siç u përmend edhe më lart, ligji shqiptar për profesionin e avokatit parashikon që Dhoma Kombëtare e Avokatisë të miratojë Kodin Etik të Avokatit, ndërsa këshillat e përgjithshëm dhe dhomat e avokatisë në rrethe janë përgjegjës ndër të tjera, për të inkurajuar respektimin e Kodit Etik të Avokatit ndër anëtarët e tyre.

Kodi aktual Etik i avokatit u miratua në nëntor të vitit 2005. Ky kod është hartuar duke u bazuar pjesërisht në modelin e Kodit Etik për Avokatët në Bashkimin Evropian (Kodi Etik i Këshillit të Avokatëve dhe Shoqërive Ligjore të Evropës (KASHLE), i cili rregullon veprimtaritë ndërkufitare të avokatëve në Zonën Ekonomike Evropiane.<sup>197</sup> Sipas dispozitës së fundit të Kodit Etik, ky hyn në fuqi ditën kur është diskutuar në Këshillin e Përgjithshëm të Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe kodi i mëparshëm i etikës shfuqizohet në të njëjtën ditë. Sidoqoftë, sipas informacionit nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Statutet si dhe Kodi i Etikës do të botoheshin bashkë në Fletoren Zyrtare dhe këto dokumente do të hynin në fuqi vetëm pas botimit.<sup>198</sup> Duke pasur parasysh se Statutet u miratuan më 10 prill 2005 dhe Kodi i Etikës më 12 nëntor 2005, është shqetësues fakti që asnjë nga këto dokumente nuk ka hyrë ende në fuqi dhe që vazhdojnë të jenë në fuqi kodi i etikës dhe statutet e mëparshëm.

## **3. Sjellja e avokatit mbrojtës**

Në gjykimin e çështjes “Artico”, Gjykata Evropiane theksoi rëndësinë e ndihmës efektive ligjore në çështjet penale.

Gjykata thekson se Konventa ka për qëllim të garantojë jo ato të drejta që janë teorike apo të rreme por ato të drejta që janë praktike dhe efektive; kjo është veçanërisht e vërtetë për të drejtat e mbrojtjes duke pasur parasysh vendin shumë të rëndësishëm që zë në

<sup>196</sup> Statuti i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, nenet 43 dhe 44.

<sup>197</sup> Kodi Etik për Avokatët në Bashkimin Evropian, miratuar në seancën plenare të Këshillit të Avokatëve dhe Shoqërive Ligjore të Evropës (KASHLE) më datë 28 tetor 1988 neni 3.4. Shih [http://www.ccbe.org/doc/En/code2002\\_en.pdf](http://www.ccbe.org/doc/En/code2002_en.pdf) [vizituar më 15 qershor 2006].

<sup>198</sup> Intervistë me telefon, datë 21 prill 2006.

një shoqëri demokratike e drejta për një gjykim të drejtë, nga e cila ato rrjedhin (shih gjykimin në çështjen Airey, datë 9 tetor 1979, Seria A nr. 32, faqe 12-13, paragrafi 24, dhe paragrafi 32 më lart). Siç u theksua me të drejtë edhe nga Delegatët e Komisionit, neni 6 paragrafi 3 (c) (neni 6-3-c) flet për “ndihmë” dhe jo për “emërim”. Përsëri, thjesht emërimi nuk siguron një ndihmë efektive duke qenë se avokati i emëruar për të dhënë ndihmë juridike mund të vdesë, mund të sëmuret rëndë, mund t’i ndalohej për një kohë të gjatë të veprorë ose ai mund t’i shmanget detyrave të tij. Nëse autoritetet njoftohen për situatën, ata mund ta zëvendësojnë avokatin apo ta bëjnë atë që t’i përmbushë detyrimet e tij. Pranimi i interpretimit të kufizuar të qeverisë do të sillte rezultate që do të ishin të paarsyeshme dhe të papërputhshme si me formulimin e nënparagrafit (c) (neni 6-3-c) ashtu edhe me strukturën e nenit 6 (n. 6) të marrë në tërësi; në shumë raste ndihma juridike falas mund të dalë pa vlerë.<sup>199</sup>

*Avokati mbrojtës i caktuar nga gjykata/prokuroria* – Gjatë monitorimit të proceseve gjyqësore të kryera në kuadër të Programit për Zhvillimin e një Gjykimi të Drejtë është krijuar përshtypja se avokatët mbrojtës të caktuar nga gjykata shpeshherë luajnë një rol pasiv dhe formal. Anketimi lidhur me paraburgimin tregoi se nuk është e pazakontë që avokatët e caktuar nga gjykata të shoqërojnë prokurorin gjatë marrjes në pyetje dhe të marrin pjesë në mënyrë shumë pasive gjatë seancës së pyetjeve pa u konsultuar paraprakisht me të pandehurin – dhe më pas të mos shihen më asnjëherë. *Në përgjithësi*, avokatët e caktuar nga gjykata, kanë prirjen të takohen më rrallë me klientët e tyre dhe thjesht paraqiten në seanca pa kryer konsultime të mëparshme. Për shembull, nga Kukësi raportohet se nuk është e pazakontë që avokati të caktohet në fillim të seancës së parë dhe më pas të marrë pjesë në mënyrë pasive në seancë pa kurrfarë përgatitjeje. Raportime po nga Kukësi tregojnë se sjellja e avokatëve të emëruar nga gjykata rrallëherë bëhet shkak për vonesa. Fakti që avokatët mbrojtës nuk bëhen shkak për vonesa është padyshim një gjë e mirë, gjithsesi kjo së bashku me pasivitetin e tyre në kryerjen e detyrës tregon se ata veprojnë më shumë për llogari të gjykatave sesa të të pandehurve dhe ka mundësi që këtë gjë ta bëjnë për të siguruar emërimet e tjera në të ardhmen.

*Sjellja e avokatëve mbrojtës në përgjithësi*<sup>200</sup> – Pyetësorët e përgatitur me të paraburgosurit dhe me avokatët mbrojtës tregojnë se avokatët mbrojtës luajnë një rol shumë pasiv gjatë hetimeve paraprake. Kështu, pjesa më e madhe e avokatëve mbrojtës thanë se ata *asnjëherë ose rrallë* marrin pjesë në veprimet që kryhen gjatë hetimeve paraprake. Vetëm 19 avokatë mbrojtës (27%) u shprehën se kishin marrë pjesë gjithmonë apo shumicën e kohës në hetime, ndërsa 18 prej tyre (26%) thanë se kishin marrë pjesë disa herë në hetime. Tridhjetë e dy avokatë (47%) u shprehën se ata rrallë ose asnjëherë nuk marrin pjesë në hetime.<sup>201</sup> Një arsye për këtë mund të jetë që avokatët mbrojtës rrallëherë njoftohen për veprimet hetimore që ndërmerren. Nga ana tjetër, një avokat mbrojtës duhet ta marrë vetë nismën për të asistuar. Ndërsa pjesa më e madhe e avokatëve mbrojtës shprehen se ata konsultohen me klientët e tyre përpara seancës së vleftësimit

<sup>199</sup> Çështja “Artico kundër Italisë”, 3 maj 1980, paragrafi 33.

<sup>200</sup> Shih “E drejta për një mbrojtje efikase” – Shtojcat 1, 2 dhe 3.

<sup>201</sup> Shih KPrP, nenet 302, 310 dhe 321.



të arrestit dhe caktimit të masës së sigurisë në shumicën e rasteve ose gjithmonë, disa të tjerë thanë se këtë gjë ata e bëjnë shumë rrallë. Nga ata që u shprehën se konsultohen me klientët e tyre përpara seancës së vleftësimit të arrestit dhe caktimit të masës së sigurisë në shumicën e rasteve ose gjithmonë, shumica thanë se konsultimet i bëjnë në gjykatë. Në lidhje me këtë çështje, nga pyetësi i të paraburgosurve del se konsultimi kryhet në një sallë të hapur gjyqi dhe në praninë e policëve apo të cilitdo që ndodhet i pranishëm dhe se rrallëherë është më tepër se sa vetëm një prezantim. Në lidhje me praktikën problematike të prokurorëve për të mos informuar gjykatën për kryerjen e hetimeve paraprake, ku i pandehuri është i paraburgosur,<sup>202</sup> duhet thënë gjithashtu që avokatët mbrojtës nuk e kërkojnë një informacion të tillë. Nëse avokatët do e bënin një gjë të tillë, atëherë kjo do të shtynte gjykatën dhe prokurorinë ta respektonin këtë dispozitë dhe të shpejtonin procedimin. Kështu do të rivendosej një nga funksionet *garantues*.

### *Konflikti i interesave*<sup>203</sup>

Nuk është e pazakontë që një avokat mbrojtës të përfaqësojë disa të pandehur në një çështje. Në përgjithësi kjo gjë nuk është shqetësuese në çështjet ku të bashkëpandehurit vetëdeklarohen fajtorë dhe tregojnë të gjithë faktet përkatëse. Në një çështje ku dy ose më shumë të bashkëpandehur të përfaqësuar nga i njëjti avokat mbrojtës kërkojnë pafajësi, situata është më e ndërlikuar. Pavarësisht se të pandehurit do të kenë pak a shumë të njëjtin qëndrim, mund të ketë faktorë të tjerë që diktojnë mbrojtjen e interesave të ndryshëm tek të pandehurit. Duke marrë në konsideratë se detyra kryesore e avokatit është të veprojë në interes të klientit të vet, është shumë e rëndësishme që një avokat mbrojtës të mos marrë përsipër përfaqësimin e disa të pandehurve pa u siguruar që një gjë e tillë nuk do të krijojë konflikt interesash. Në përgjithësi një avokat mbrojtës duhet të jetë i kujdesshëm në mbrojtjen e disa të pandehurve dhe duhet t'i informojë të pandehurit gjithmonë për konfliktet e mundshëm të interesit. Gjykata gjithashtu ka detyrimin të sigurojë që nuk ka konflikt interesash ndërmjet të pandehurve të përfaqësuar nga i njëjti avokat mbrojtës.<sup>204</sup> Ndërsa në disa raste të vëzhguara, përfaqësimi i të bashkëpandehurve nga i njëjti avokat ka qenë për t'u vënë në dyshim, ka pasur gjithashtu raste kur gjykata ka ndërmarrë masa për të parandaluar apo për të zgjidhur situatat e konfliktit të interesave.

<sup>202</sup> Shih "E drejta për një mbrojtje efikase" – Shtojca 2, dhe KPrP, neni 246, pika 6.

<sup>203</sup> Shih gjithashtu diskutimin mbi konfliktin e interesave në Komentarin e KPrP, fq. 133-136, dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 222, datë 4 nëntor 2002.

<sup>204</sup> KPrP, neni 54.

**Shembull – Konflikt interesash**

*Çështja 50/14, regjistruar më 10 maj 2004 në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda*

Në këtë çështje, dy burra dhe dy gra ishin akuzuar për krime të ndryshme në lidhje me trafikim femrash dhe prostitucion. Njëri nga burrat ishte i martuar me njërën nga gratë dhe tjetra ishte kunata e tij. Gjatë gjykimit, burrat ishin të pranishëm ndërsa gratë u proceduan në mungesë. Të katër u mbrojtën nga i njëjti avokat. Gjatë gjykimit, njëri nga burrat u akuzua edhe për shfrytëzimin e gruas së tij dhe e të kunatës për prostitucion në rrethana të rënduara.<sup>205</sup> Pasi u njoftuan të pandehurit për akuzat e reja, prokurori kërkoi që të caktohej një avokat tjetër për dy gratë duke pasur parasysh konfliktin e qartë të interesave. Megjithatë, avokati mbrojtës e kundërshtoi këtë kërkesë me arsyetimin se duke marrë në konsideratë marrëdhëniet familjare, nuk mund të kishte konflikt interesash. Gjithsesi, gjykata me të drejtë caktoi një avokat tjetër mbrojtës për të dy gratë.

*Mosparaqitja e avokatit mbrojtës*

Detyrimi i avokatit për të mos krijuar vonesa të panevojshme në procedimet gjyqësore thuhet shprehimisht në Kodin Etik të Avokatit.<sup>206</sup> Në praktikë një nga rastet më të shpeshta të shtyrjeve të procedimeve penale në Shqipëri është mosparaqitja e pajustificuar e avokatëve mbrojtës.<sup>207</sup> Kjo reflektohet gjithashtu në diskutimet që janë bërë me kryegjyqtarë dhe kryeprokurorë në Shqipëri. Megjithëse të gjithë ishin të mendimit se avokatët mbrojtës e përdorin shtyrjen e gjykimit qëllimisht si strategji mbrojtjeje, ata ofruan edhe shpjegime të ndryshme se si mund të përfitojnë të pandehurit nga këto situata. Një shpjegim i dhënë shpesh në çështjet e gjykuara nga Gjykata për Krime të Rënda është se të pandehurit duan që të skadojë afati trevjeçar i paraburgimit në mënyrë që të gjykohen në gjendje të lirë.<sup>208</sup> Një shpjegim tjetër ishte se në llogaritjen e dënimit, një ditë paraburgimi llogaritet si një ditë e gjysmë burgim.<sup>209</sup> Një shpjegim i mëtejshëm i dhënë nga bashkëbiseduesit ishte se shtyrjet përdoren për të arritur marrëveshje korruptive në lidhje me çështjen në fjalë.

<sup>205</sup> KP, neni 114/a.

<sup>206</sup> Kodi Etik i Avokatit, neni 25, pika 3.

<sup>207</sup> Shih gjithashtu raportin e Programit për Zhvillimin e një Gjykimi të Drejtë, 2004, fq. 19.

<sup>208</sup> KPrP, neni 263, paragrafi 6.

<sup>209</sup> KPrP, neni 238, paragrafi 2 dhe KP, neni 57.

**Një shembull – Vonesa në gjykim për shkak të avokatit mbrojtës**

Gjatë gjykimit të çështjes nr. 22/68 në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, avokati mbrojtës MP mbronte fillimisht dy nga tre të pandehurit, njëri ishte i paraburgosur dhe tjetri gjykohej në gjendje të lirë (i treti gjykohej *në mungesë* dhe mbrohej nga një avokat tjetër). Pasi MP nuk u paraqit në një seancë, gjykata caktoi një avokat tjetër për të pandehurin e paraburgosur, ndërsa tjetri këmbënguli për t'u mbrojtur nga MP. Procesi gjyqësor u shty 14 ditë për t'i dhënë kohë avokatit të sapocaktuar të njihej më çështjen. Në seancën tjetër MP përsëri nuk u paraqit, prandaj gjykata vendosi të caktonte një avokat tjetër edhe për të pandehurin e dytë, të njoftonte Dhomën e Avokatisë dhe të pezullonte periudhën e paraburgimit për të pandehurin e parë (avokati i të cilit nuk mungonte) dhe ta shtynte gjyqin 12 ditë për t'i dhënë kohë avokatit të ri që të njihej me çështjen. Gjatë seancës pasardhëse, i pandehuri në paraburgim nuk ishte dakord me gjykatën që zëvendësoi MP dhe më pas kërkoi të ndërrohej avokati i caktuar nga gjykata, kërkesë e cila pas disa diskutimesh, u pranua. Çështja u shty edhe 6 ditë të tjera. Gjykata gjithashtu pezulloi afatin e paraburgimit. Më në fund, pas sa e sa shtyrjesh, MP u paraqit dhe u rivendos si avokati mbrojtës i dy të pandehurve që u diskutuan. Ky model u përsërit gjatë gjykimit, disa herë me të pandehurit e disa herë me mosparaqitjen e MP apo me refuzimin për tu paraqitur në gjyq. Pavarësisht se iu paraqitën disa raporte Dhomës së Avokatisë, ndaj MP nuk u ndërmor asnjë veprim.

Dukë parë shembullin e mësipërm duket se ka një nevojë urgjente për të miratuar dispozita dhe procedura për të garantuar që avokatët t'i përmbushin detyrat e tyre profesionalisht dhe të mos shkaktojnë vonesa të panevojshme në procedim.

### 3. 1. Çështja “Balliu kundër Shqipërisë”<sup>210</sup>

Gjykimi nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut i një çështjeje lidhur me Shqipërinë, mund të kuptohet sikur trajton përdorimin e vonesës si një strategji mbrojtjeje.

#### *Çështja Balliu*

Në gjykimin e saj, Gjykata Evropiane konsideron se shteti shqiptar *nuk* ka shkelur të drejtën e z. Balliu për një gjykim të drejtë sipas nenit 6, paragrafëve 1 dhe 3 (c) dhe (d) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në procedimet penale kundër bandave të armatosura që vepronin gjatë trazirave të vitit 1997, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, në shkurt të vitit 2000 e dënoi z. Balliu me burgim të përjetshëm për pesë vrasje, dy vrasje në tentativë, një veprë penale për mbajtje të municionit luftarak dhe veprën penale të krijimit dhe pjesëmarrjes në bandë të armatosur. Vendimi i gjykatës u pranua në apel. Gjatë procedimeve, avokati mbrojtës i z. Balliu nuk u paraqit në shumicën e seancave dhe nuk dha asnjë arsye për mosparaqitjen e tij. Si pasojë, gjykata caktoi një avokat tjetër për z. Balliu por ai nuk pranoi të mbrohej nga një avokat që nuk ishte zgjedhur nga ai vetë, kështu avokati i caktuar nga gjykata u shkarkua dhe seancat vazhduan pa praninë e një avokati mbrojtës

<sup>210</sup> Çështja “Balliu kundër Shqipërisë”, 16 qershor 2005.

për z. Balliu. Z. Balliu u ankua në Gjykatën Evropiane se atij i ishte mohuar e drejta e një gjykimi të drejtë sipas nenit 6 paragrafëve 1 dhe 3 (c) dhe (d) pasi ai nuk ishte mbrojtur siç duhet më anë të ndihmës juridike dhe nuk kishte qenë në gjendje të merrte në pyetje disa dëshmitarë apo të paraqiste dëshmitarë nga ana e tij.

Gjykata çmoi se autoritetet shqiptarë e kishin përmbushur detyrimin e tyre për të dhënë ndihmë juridike, duke shtyrë seancat për t'i dhënë avokatit mbrojtës së kërkuesit mundësinë për të përmbushur detyrën e tij si dhe duke caktuar një avokat nga gjykata për të. Duke mbajtur parasysh edhe detyrimin e autoriteteve për t'i kryer procedimet “brenda një afati kohor të arsyeshëm”, rrethanat e përfaqësimit të kërkuesit nuk treguan mosdhënie të ndihmës juridike apo mohim të së drejtës për një gjykim të drejtë sipas nenit 6 paragrafëve 1 dhe 3 (c). Për më tepër, gjatë seancave si kërkuesi ashtu edhe avokati i tij, kishin mundësi t'i pyesnin dëshmitarët e akuzës kur i kishin përballë, megjithëse ata kishin zgjedhur të mos e bënin këtë, gjë që duket në mosparaqitjen e avokatit mbrojtës dhe në heshtjen e kërkuesit.

#### 4. Masat disiplinore

Një parim i njohur gjerësisht është që sjellja profesionale e avokatëve mbrojtës rregullohet me kode të etikës të krijuar dhe të miratuar nga avokatia.<sup>211</sup> Një tjetër parim i njohur gjerësisht është se në rastet kur avokatët nuk veprojnë në përputhje me standardet profesionale, duhen filluar procedime disiplinore nga një komision disiplinor i krijuar nga avokatia, një organ i krijuar me ligj, apo një gjykatë dhe të jenë subjekte të një shqyrtimi gjyqësor të pavarur.<sup>212</sup>

Sipas legjislacionit shqiptar, vetëm Dhomat e Avokatisë mund të marrin masa disiplinore ndaj avokatëve. Kështu KPrP parashikon që organi procedues, d.m.th., gjykata apo prokuroria i referon Këshillit Drejtues të Dhomës së Avokatëve (në të cilën avokati është anëtar) në rastet kur:

1. avokati mbrojtës lë klientin,
2. avokati mbrojtës refuzon të mbrojë klientin dhe
3. avokati mbrojtës shkel detyrat e besnikërisë dhe ndershmërisë<sup>213</sup>

Megjithatë, Këshilli Drejtues ka të drejtë të marrë masa disiplinore *vetëm* kur një avokat *i caktuar nga gjykata* ka lënë apo ka refuzuar të mbrojë klientët. Nëse arsyeja për këto veprime ka qenë shkelja e të drejtave të mbrojtjes, atëherë nuk merret asnjë veprim.<sup>214</sup>

<sup>211</sup> Parimet bazë të Kombeve të Bashkuara për Rolin e Avokatëve [Parimet e OKB për Avokatët], neni 26, Rekomandimi nr. R(2000)21 i Këshillit të Evropës, parimet V (4) (g) dhe VI 1 dhe Kodi Etik i KAShLE, neni 1.2.1 dhe 1.2.2.

<sup>212</sup> Parimet e OKB-së për Avokatët, nenet 28 dhe 29, Rekomandimi (2000)21 i Këshillit të Evropës, parimi VI (1) dhe (2).

<sup>213</sup> KPrP, neni 56, pika 1.

<sup>214</sup> KPrP, neni 56, pikat 2 dhe 3.

Lidhur me atë se cili apo cilat organe mund të ankohen kundër avokatëve mbrojtës, neni 37 i ligjit për avokatinë parashikon që ankesat mund të paraqiten nga:

- a. çdo person që mbrohet, përfaqësohet apo ndihmohet juridikisht nga avokati;
- b. çdo person i tretë që pretendon se është dëmtuar nga sjellja apo veprimet e avokatit.<sup>215</sup>

**Koment:** Ndërsa KPrP u jep autoritet gjykatave të ankohen kundër avokatit mbrojtës vetëm në një numër shumë të kufizuar situatash, ligji për avokatinë nuk parashikon *ankesa* nga ana e gjykatës apo prokurorisë.<sup>216</sup> Gjithsesi, kapitulli që rregullon “kriteret për ushtrimin e profesionit të avokatit” parashikon që gjykata apo prokuroria mund të propozojë heqjen e së drejtës së ushtrimit të profesionit të avokatit.<sup>217</sup> Duke marrë parasysh faktin se heqja e së drejtës së ushtrimit të profesionit është masa më e rëndë disiplinore që mund të merret ndaj avokatit,<sup>218</sup> duket se gjykatat dhe prokuroria kanë autoritet të marrin masa ndaj avokatëve vetëm në rastet më serioze. Më tej, KPrP e ngushton më tepër mundësinë e marrjes së masave disiplinore ndaj avokatëve, duke e kufizuar atë tek avokatët e caktuar nga gjykata dhe vetëm për veprime që lidhen me klientin, jo për shembull për veprime që mund të pengojnë seriozisht kryerjen e procedimeve.<sup>219</sup> Kjo do të thotë që gjykatat nuk kanë fuqi të marrin masa ndaj avokatëve mbrojtës të caktuar privatisht. Do të thotë gjithashtu se për shkelje të tjera të Kodit Etik të Avokatit, si shkelje e dispozitës për të mos shkaktuar vonesa të panevojshme në proceset gjyqësore,<sup>220</sup> gjykatat nuk kanë kompetencë të ankohen në Dhomën e Avokatisë por vetëm mund të propozojnë heqjen e së drejtës së ushtrimit të profesionit për avokatin. Kjo duket mjaft e papërshtatshme dhe tregon edhe njëherë nevojën e rishikimit të KPrP si dhe të ligjit për avokatinë.

Ankesat kundër avokatëve depozitohen pranë kryetarit të dhomës përkatëse të avokatisë. Brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës, këshilli drejtues i dhomës së avokatisë së rrethit duhet të shqyrtojë dhe të zgjidhë ankesën me anë të një përgjigjeje me shkrim. Vendimet e këshillit drejtues mund të apeloohen brenda 10 ditësh në komitetin disiplinor të dhomës së avokatisë të rrethit përkatës. Procedimi disiplinor kryhet nga një komitet disiplinor i dhomës së avokatisë të rrethit.<sup>221</sup> Komiteti Disiplinor përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari, sekretari dhe jo më tepër se pesë avokatë të zgjedhur nga Këshilli i Përgjithshëm. Komiteti Disiplinor shqyrton dhe gjykon çështjet me anë të një komisioni disiplinor të përbërë nga tre deri në pesë anëtarë, siç përcaktohet nga këshilli drejtues i dhomës së avokatisë në rreth.<sup>222</sup>

<sup>215</sup> Ligji “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, pika 2 (a) dhe (b). Vini re se neni 40 i referohet gabimisht pikës 2 të nenit 38.

<sup>216</sup> Është e vështirë të arsyetohet se një gjykatë mund të konsiderohet si “një person i tretë që pretendon të jetë dëmtuar nga sjellja apo veprimet e avokatit”.

<sup>217</sup> Ligji “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, neni 33.

<sup>218</sup> Ligji “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, neni 43.

<sup>219</sup> Megjithëse dispozitat e KPrP të përmendura këtu janë identike me ato të Kodit italian të Procedurës Penale (Codice di Procedura Penale, art. 105), duket se në Itali ekziston një kuptim i përgjithshëm se gjykatat, ashtu sikurse cilido tjetër, mund të informojnë Dhomën e Avokatëve për sjelljen e avokatëve.

<sup>220</sup> Kodi Etik i Avokatit, neni 25, pika 3.

<sup>221</sup> Ligji “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, neni 37.

<sup>222</sup> Ligji “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, neni 39.

Ndaj një avokati merren masa disiplinore nëse vendoset se ai/ajo:

1. ka vepruar në kundërshtim me parashikimet e dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë e avokatisë,
2. ka vepruar në kundërshtim me rregullat e parashikuara në Statut apo Kodin Etik të Avokatit, ose
3. ka shkelur rregulla të tjera të vendosura nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë.<sup>223</sup>

Sipas Kryetarit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, në maj të vitit 2005 do të krijohej një komiteti kombëtar disiplinor. Megjithë ankesat e shumta nga gjykatat në të gjithë vendin si dhe nga Ministria e Drejtësisë, asnjë procedim disiplinor nuk ka filluar deri më datë 7 prill 2006. Duke marrë parasysh se as Statutet dhe as Kodi i Etikës së Avokatit nuk kanë hyrë në fuqi, procedimet disiplinore të mbetura do të duhet të zgjidhen në bazë të kodit të mëparshëm të etikës. Kështu, tani për tani nuk ka mekanizma efektive për të siguruar që avokatët mbrojtës i përmbushin detyrat e tyre në bazë të parimit të shtetit të së drejtës, humanizmit, dhe dinjitetit njerëzor si dhe të respektit ndaj së vërtetës dhe drejtësisë, siç thuhet me krenari në preambulën e Kodit Etik të Avokatit. Ky është një problem shqetësues dhe tregon se Dhomës Kombëtare të Avokatisë i duhet ende shumë për të bërë për të qenë një organ funksional, i pavarur, i vetërregulluar dhe i vetëdrejtuar siç parashikohet në ligjin “Për profesionin e avokatin në Republikën e Shqipërisë”.

---

<sup>223</sup> Ligji “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, neni 38.

## 5. Mbrojtja ligjore falas<sup>224</sup>

Në lidhje me të drejtën për mbrojtje ligjore falas, KPrP parashikon:

### Neni 6 – Sigurimi i mbrojtjes

1. I pandehuri ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e mbrojtësit. Kur nuk ka mjete të mjaftueshme i sigurohet mbrojtja falas me avokat.
2. Mbrojtësi ndihmon të pandehurin që t'i garantohen të drejtat procedurale dhe t'i ruhen interesat e tij ligjore.

### Neni 49 – Mbrojtësi i caktuar

1. I pandehuri që nuk ka zgjedhur mbrojtës ose që ka mbetur pa të, ndihmohet nga një mbrojtës i caktuar nga organi që procedon, në qoftë se e kërkon atë.
2. Kur i pandehuri është nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç ose me të meta fizike a psikike që e pengojnë për të realizuar vetë të drejtën e mbrojtjes, ndihma nga një mbrojtës është e detyrueshme.
3. Këshilli drejtues i dhomës së avokatëve vë në dispozicion të autoriteteve proceduese listat e avokatëve dhe vendos kriteret për caktimin e tyre.
4. Gjykata, prokurori dhe policia gjyqësore, kur duhet të kryejnë një veprim për të cilin parashikohet ndihma e mbrojtësit dhe kur i pandehuri është pa mbrojtës, njoftojnë për këtë veprim mbrojtësin e caktuar.
5. Kur kërkohet prania e mbrojtësit dhe mbrojtësi i zgjedhur ose i caktuar nuk është siguruar, nuk është paraqitur ose e ka lënë mbrojtjen, gjykata ose prokurori cakton si zëvendësues një mbrojtës tjetër, i cili ushtron të drejtat dhe merr përsipër detyrimet e mbrojtësit.
6. Mbrojtësi i caktuar mund të zëvendësohet vetëm për shkaqe të përligjura. Ai i pushon funksionet kur i pandehuri zgjedh mbrojtësin e tij.
7. Kur i pandehuri nuk ka mjete të mjaftueshme, shpenzimet e bëra për mbrojtjen paguhen nga shteti.

Kur i pandehuri arrestohet, ndalohet apo dënohet me burgim, avokati mbrojtës mund të zgjidhet/caktohet nga familjarët e të pandehurit.<sup>225</sup> Pyetësi i kryer me personat e arrestuar/ndaluar apo të paraburgosur tregon se në shumicën e rasteve kjo është mënyra se si zgjidhen avokatët mbrojtës.

### Analizë

Formulimi i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut duket se tregon se kur një i pandehur nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar një avokat mbrojtës sipas zgjedhjes së tij, shteti i siguron mbrojtje falas po sipas zgjedhjes së të pandehurit. Sidoqoftë, në interpretimin e këtij parimi, Gjykata Evropiane është shprehur se avokati mbrojtës i paguar nga shteti mund të zgjidhet nga të tjerë, si për shembull nga Dhoma e Avokatisë.<sup>226</sup>

<sup>224</sup> *Shih gjithashtu, botimin E drejta e mbrojtjes falas në Shqipëri*, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, (Tiranë 2005).

<sup>225</sup> KPrP, neni 48, pika 3.

<sup>226</sup> Çështja “Kamasinski kundër Austrisë”, 23 nëntor 1989, paragrafi 45.

Në kontekstin shqiptar, formulimi në Kushtetutë duket sikur tregon se një i pandehur ka të drejtë të ketë një avokat mbrojtës sipas zgjedhjes së tij, pavarësisht se avokati mund të jetë falas (i paguar nga shteti). KPrP është më pak i qartë lidhur me këtë çështje. Kështu, në nenin 49 parashikohet që në rastet kur është e nevojshme, për shembull kur i pandehuri është i mitur apo me të meta mendore apo thjesht nuk ka zgjedhur një avokat, është gjykata apo prokuroria që cakton një avokat mbrojtës. Pika tre i jep Dhomës së Avokatisë të drejtën për të vendosur kriteret për caktimin e avokatit mbrojtës dhe pika shtatë garanton ndihmë juridike të paguar kur i pandehuri nuk ka mjetet e mjaftueshme. Komentari i KPrP është gjithashtu i paqartë mbi çështjen e zgjedhjes së avokatit mbrojtës pasi në pikat e para të tij theksohet se:

- ndihma ligjore “zgjidhet nga [i pandehuri] ose kryesisht nga organi procedues”<sup>227</sup> dhe më tej shprehet se
- “Nuk duhet ngatërruar e drejta e zgjedhjes, që i takon të pandehurit dhe të afërmeve e tij kur ai nuk ka mundësi që ta realizojë këtë të drejtë, me caktimin kryesisht të mbrojtësit, që është një detyrë për organin procedues.”<sup>228</sup>

Megjithatë në praktikë, në rastet kur i pandehuri nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar avokatin mbrojtës, është prokuroria apo gjykata që e cakton avokatin pa u konsultuar me të pandehurin.

Vende të ndryshme kanë skema të ndryshme të ndihmës ligjore dhe për arsye ekonomike apo për arsye të tjera, jo çdo avokat [i kualifikuar] që ushtron profesionin në fushën penale, do të ishte i gatshëm të merrte përsipër mbrojtje falas, prandaj mund të arsyetohet që një të pandehuri me mjete të pamjaftueshme duhet t’i sigurohet avokat mbrojtës sipas zgjedhjes së tij deri në një farë mase. Kjo do t’i shërbente dy qëllimeve: trajtimit të njëjtë të të gjithë të pandehurve dhe ndalimit të praktikës së gjykatave, prokurorive apo dhomave të avokatisë që të caktojnë avokatë mbrojtës që ata, për një arsye apo për një tjetër, duan t’i favorizojnë. Shembujt e mëposhtëm të marrë nga intervista me avokatë mbrojtës tregojnë se një gjë e tillë ndodh në të vërtetë.

#### **Disa shembuj – Caktimi i avokatëve mbrojtës**<sup>229</sup>

Avokati mbrojtës (AM) 1: Gjyqtarët dhe prokurorët nuk i ndjekin gjithmonë rregullat në caktimin e avokatëve mbrojtës.

AM 2: Caktimet bëhen në bazë të preferencave personale të gjyqtarëve apo prokurorëve.

AM 3: Shpesh policia më thërret në çështjet e të miturve dhe unë jam i pranishëm në seancën e policisë, pastaj prokurori cakton dikë tjetër dhe unë nuk paguhem. Ose më cakton prokurori por pastaj nuk njoftohem për seancën e vleftësimit të arrestit dhe caktimit të masës së sigurisë, megjithëse jam i regjistruar në dosje si avokati mbrojtës dhe gjyqtari cakton dikë tjetër, një mik. Disa herë gjyqtari vendos të ndërrojë avokatin mbrojtës gjatë gjykimit. Nëse nuk të njej gjyqtari, nuk merr asnjë çështje; lista e dhënë nga Dhoma e Avokatisë varet plotësisht nga miqësitë.

<sup>227</sup> Komentari i KPrP, fq. 131.

<sup>228</sup> Komentari i KPrP, fq. 132.

<sup>229</sup> Deklaratat e avokatëve mbrojtës 1 dhe 2 janë cituar nga pyetësi për avokatët mbrojtës, ndërsa deklarata e AM 3 është marrë nga një intervistë të kryer më 29 mars 2006.



Shembujt e mësipërm paraqesin mungesë respekti për të pandehurin dhe tregojnë se avokati mbrojtës trajtohet më shumë si një formalitet, sesa si dikush që do të sigurojë në të vërtetë të drejtën e të pandehurit për një gjykim të drejtë. Për më tepër, ndryshimi i avokatit mbrojtës për preferenca personale shkel dispozitën sipas së cilës një avokat mbrojtës mund të zëvendësohet vetëm për shkaqe të përligjura.<sup>230</sup> Shqetësues është gjithashtu fakti që avokatët marrin përsipër përfaqësimin e një të pandehuri i cili ka qenë përfaqësuar më parë nga një avokat tjetër, pa u konsultuar më parë me këtë të fundit.<sup>231</sup> Në mënyrë që t'i jepet fund kësaj praktike, të pandehurve u duhet dhënë mundësia të zgjedhin avokatin mbrojtës nga lista e Dhomës së Avokatisë. Pasi të jetë zgjedhur avokati mbrojtës, ndryshimet duhen bërë me miratimin e të pandehurit, përveç rasteve kur mungesa e pajustificuar apo veprime të tjera të avokatit mbrojtës pengojnë seriozisht procedimin.

## 6. Tarifat e shpërblimit të avokatëve të caktuar nga shteti

Sipas ligjit të mëparshëm “Për avokatinë në Republikën e Shqipërisë”,<sup>232</sup> tarifat e shpërblimit për dhënie e ndihmës juridike ishin përcaktuar në rregulloren e vitit 1996.<sup>233</sup> Rregullorja përcakton shpërblimet *maksimale* në çështjet civile dhe penale për avokatët e caktuar privatisht dhe për ata të caktuar nga shteti. Gjithsesi, rregullorja nuk përjashton marrëveshjet midis palëve.<sup>234</sup> Ndërkohë që me hyrjen në fuqi të ligjit të ri “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë” u shfuqizua ligji i vjetër,<sup>235</sup> tarifat e shpërblimit për dhënie e ndihmës juridike nga avokatët të caktuar nga shteti sipas rregullore në zbatim të ligjit të vjetër, ende zbatohen. Rregullorja zbatohet pavarësisht se në maj të vitit 2005 u miratua një urdhër i përbashkët i cili përcakton tarifa shpërblimi shumë më të larta [urdhri i përbashkët i vitit 2005].<sup>236</sup>

Në vitin 2004, Ministria e Financave në përpjekje për të ulur kostot, nxori një udhëzim për gjykatat, sipas të cilit tarifat e shpërblimit për avokatët e caktuar nga shteti do të debitoreshin si kosto operative dhe jo si më parë, si paga. Në të njëjtën kohë u reduktuan fondet e akorduara për gjykatat për kosto operative. Për pasojë, avokatët e caktuar nga shteti paguhen vetëm nëse mbeten fonde pas pagesës së kostove të tjera operative siç janë uji, energjia elektrike, kancelaritë, dhe pajisjet e zyrës. Për më tepër, më 9 shkurt 2006, Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor nxori një udhëzim për të gjitha gjykatat “Për detajimin e fondeve aktuale buxhetore për vitin 2006”.<sup>237</sup> Me qëllim “menaxhimin më me efektivitet të fondeve”, gjykatat udhëzohen të:

<sup>230</sup> KPrP, neni 49 pika 6.

<sup>231</sup> Kjo është gjithashtu në kundërshtim me Kodin Etik të Avokatit, të miratuar më 12 nëntor 2005, neni 33.

<sup>232</sup> Ligji nr. 7827, datë 31 maj 1994, Për profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë, neni 4.

<sup>233</sup> Rregullore nr. 2 e Ministrisë së Drejtësisë, datë 21 mars 1996, “Për caktimin e tarifave të shpërblimit tavan për ndihmën juridike që japin avokatët” [Rregullore e vitit 1996].

<sup>234</sup> Rregullorja, neni 5.

<sup>235</sup> Ligji “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, neni 51.

<sup>236</sup> Shih më tej tarifat e shpërblimit për avokatët e caktuar privatisht.

<sup>237</sup> Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, nr. protokollit 23, datë 9 shkurt 2006, “Mbi detajimin e fondeve buxhetore korrente për vitin 2006”.

Unifikojnë pagesat për avokat të thirrur kryesisht nga gjykata, bazuar në rregulloren nr. 2, dt. 21 maj 1996 të Ministrisë së Drejtësisë: “Për caktimin e tarifave të shpërblimit tavan për ndihmën ligjore që japin avokatët”. Mbështetur në nenet 2 dhe 3 të kësaj rregulloreje, tarifat e pagesës për rastet kur avokati ngarkohet kryesisht nga gjykata për mbrojtjen e të pandehurit nuk duhet të kalojnë shumën

**3 000 lekë për një seancë gjyqësore.** Për zgjatjen e gjykimit mbi 2 seanca gjyqësore, masa e shpërblimit është **600 lekë për çdo seancë.**<sup>238</sup>

Për çështjet penale, rregullorja e vitit 1996 parashikon:

#### Neni 2

Shpërblimi për ndihmën juridike që japin avokatët në fushën penale do të jetë i diferencuar për krimet dhe kundërvajtjet penale:

a) për mbrojtjen e të pandehurit gjatë hetimit dhe gjykimit

- për krime 10 000 lekë
- për kundërvajtje penale 5 000 lekë

Kur çështja ndiqet me të pandehur në **gjendje arresti** shpërblimi rritet **50%** [theksimi me të zezë është shtuar].

b) në raste të zgjatjes së afatit të hetimit merret një shpërblim shtesë për çdo muaj:

- për krimet 2 000 lekë
- për kundërvajtje penale 1 000 lekë

c) për zgjatjen e gjykimit mbi 2 seanca si për krimet dhe për kundërvajtjet penale, masa e shpërblimit rritet 1 000 lekë për çdo seancë.

ç) për vazhdimin e mbrojtjes të këtyre çështjeve dhe në Gjykatën e Apelit merret një shpërblim prej 50% mbi tarifat e mësipërme, kurse për vazhdimin e përfaqësimit edhe në Gjykatën e Kasacionit<sup>239</sup> merret edhe një shpërblim tjetër për 60% të tarifës bazë.

d) për mbrojtjen në çështjet penale vetëm në Gjykatën e Apelit merret një shpërblim 50% të tarifës së shkallës së parë, kurse për mbrojtjen vetëm në Gjykatën e Kasacionit 60% të kësaj tarife.

e) përpilimi i kërkesave ankimore, me studim dosje, kundër vendimeve të shkallës së parë, shpërblehet me 40% të tarifës së caktuar për gjykimin në shkallë të parë, ndërsa përpilimi i kërkesave ankimore kundër vendimeve të formës së prerë të Gjykatës së Apelit shpërblehet me 50% të tarifës përkatëse.

f) për hartimin e kërkesave për ndjekje penale merret një shpërblim prej 1 500 lekë.

#### Neni 3

***Në rastet kur avokati ngarkohet kryesisht, shpërblimi caktohet nga gjykata dhe nuk mund të jenë më i madh se 60% të tarifave të mësipërme*** [theksimi me të zezë është shtuar].

#### Neni 6

Avokati është i detyruar t'i afishojë këto tarifa në vend të dukshëm në qendrën e përhershme të punës.

<sup>238</sup> Kështu siç është formuluar do të thotë se shpërblimi për një gjyq me tri seanca është 3 x 600 ose 1 800 lekë dhe jo 3 000 + 3 000 + 600 apo 6 600 lekë. Ndoshta kjo nuk është bërë me qëllim.

<sup>239</sup> Tani Gjykata e Lartë.

*Një shembull* – Sipas rregullores, një avokat i caktuar nga shteti që përfaqëson një të pandehur të paraburgosur, të dyshuar për kryerjen e një krimi, për një proces gjyqësor në shkallën e parë që zgjat 10 seanca do të shpërblehej në maksimum me 13 800 lekë [afërsisht 113 euro].<sup>240</sup> Për të vazhduar mbrojtjen në Gjykatën e Apelit shpërblimi do të ishte 19 800 lekë [afërsisht 162 euro], ndërsa për mbrojtjen e klientit deri në Gjykatën e Lartë shpërblimi do të ishte 23 400 lekë [afërsisht 192 euro]. Kjo duhet krahasuar me pagën e një gjyqtari të shkallës së parë në Shqipëri, e cila është 75 000 lekë [afërsisht 615 euro] në muaj, për 40 orë punë në javë, mesatarisht 176 orë në muaj.

Për të marrë tarifën e shpërblimit, avokati i drejtohet gjyqtarit apo prokurorit të çështjes dhe gjyqtari verifikon numrin e seancave, apo verifikon që avokati ka përfaqësuar të pandehurin gjatë hetimeve paraprake dhe bën llogaritjen e shpërblimit që i duhet paguar avokatit nga zyra e financës së gjykatës.

Intervistat e kryera në prill të vitit 2006 me funksionarë gjykatash dhe avokatë në Tiranë, Vlorë, Durrës, Shkodër, Gjirokastrë, Korçë dhe Kukës konfirmojnë gjithashtu se rregullorja e vitit 1996 vazhdon të zbatohet. Për më tepër, intervistat konfirmuan se avokatët mbrojtës të caktuar nga shteti shpeshherë nuk paguhen fare dhe si pasojë avokatët gjithnjë e më tepër refuzojnë të marrin përsipër çështje të caktuara nga shteti.<sup>241</sup>

Kështu, nëse shpërblimi prej 13 800 lekë për një çështje me dhjetë seanca në shkallë të parë duket i vogël, në fakt situata është edhe më e rëndë. Mospagimi, së bashku me faktin që tarifat janë shumë të ulta është absolutisht i papranueshëm dhe mund të shpjegojë deri në një farë mase, por nuk justifikon, mungesën e angazhimit që raportohet shpesh në lidhje me avokatët e caktuar nga shteti. Bazuar në atë që u diskutua më sipër, si përfundim, del se Shqipëria nuk i përmbush detyrimet e saj sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për të siguruar mbrojtje ligjore falas dhe efikase për personat me mjete të pamjaftueshme financiare.

Në një tavolinë të rumbullakët për ndihmën juridike falas, të organizuar në dhjetor të vitit 2005, Ministri i Drejtësisë shprehu shqetësimin e tij për nivelin e ulët të shpërblimeve (duke përmendur tarifën prej 3 000 lekë për çështje) për avokatët e caktuar nga shteti. Për të përmirësuar gjendjen, Ministri sugjeroi krijimin e një fondi të veçantë për ndihmën juridike falas, në bazë të kontributeve nga Ministria e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe donatorët ndërkombëtarë.<sup>242</sup>

<sup>240</sup>  $60\% \times [(1,5 \times 10\,000) + (8 \times 1\,000)]$ .

<sup>241</sup> Shih "E drejta për një mbrojtje efektive" – Shtojca 4.

<sup>242</sup> Tavolina e rumbullakët për ndihmën ligjore falas për të miturit u organizua në Tiranë, më 7 dhjetor 2005, nga Klinika Ligjore për të Miturit dhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë.

## 7. Tarifat e shpërblimit për avokatët e caktuar privatisht

Tarifa e shpërblimit të avokatit është një çështje e rëndësishme. Nga njëra anë, tarifat e avokatit mund të përcaktojnë nëse personat në vështirësi financiare do të jenë në gjendje të kërkojnë shërbimin e dhënë nga avokati, dhe nga ana tjetër pasqyrojnë prestigjin e këtij profesioni. Këto dy anë duhen balancuar mirë me njëra-tjetrën. Lidhur me këtë çështje, Kodi Etik i KASHLE shprehet si më poshtë: “Tarifa e avokatit duhet t’i tregohet klientit dhe kjo duhet të jetë e drejtë dhe e arsyeshme”.<sup>243</sup> Kjo pasqyrohet gjithashtu në nenin 28, pika 5, e Kodit Etikës të Avokatit në Republikën e Shqipërisë.

Të ardhurat e avokatëve nga proceset gjyqësore varen natyrisht edhe nga koha që ata shpenzojnë për çdo çështje dhe prandaj kjo lidhet ngushtë me efektivitetin e një sistemi të caktuar gjyqësor. Nëse proceset gjyqësore zhvillohen shpejt dhe nuk shpenzohet kohë për shkak të vonesave dhe të udhëtimeve të panevojshme, avokatët mund të marrin përsipër më shumë çështje, që do të thotë se ata do të marrin më pak para për çdo çështje dhe përsëri të fitojnë më shumë. Për personat që kanë nevojë për shërbime juridike, sidomos në çështjet penale ku të pandehurit i është hequr liria, është e rëndësishme që t’u ofrohen shërbime juridike të përbalueshme. Të pandehurit i duhet dhënë mundësia që të bëjë një zgjedhje të bazuar në informacion, gjë që përfshin edhe marrjen në konsideratë të tarifës së kërkuar në zgjedhjen e avokatit. Për personat me mjete të pamjaftueshme financiare, duhet të ketë një sistem të mbrojtjes falas i cili të respektojë parimin e *barazisë së armëve* që u diskutua në fillim të këtij kapitulli në raport me akuzën. Për më tepër, një sistem i ndihmës juridike duhet të jetë i tillë që të mos i vendosë personat me të ardhura të pakta ekonomike në disavantazh të konsiderueshëm në krahasim me ata që kanë mjete financiare për të paguar një avokat. Kjo do të thotë se ndonëse mund të mos jetë e mundur të garantohet pagesë e barabartë për avokatët që ofrojnë ndihmë juridike falas, diferenca e pagesës nuk duhet të jetë shumë e madhe, pasi mund të krijojë dy grupe avokatësh, të dorës së parë dhe të dorës së dytë, ndër të cilët grupi i avokatëve që ofrojnë ndihmë ligjore falas janë ata që “nuk janë aq të mirë sa t’ia dalin mbanë çështjes”.

### *Kuadri ligjor*

Sipas nenit 11 të ligjit për profesionin e avokatit, shpërblimi i avokatit për punën e kryer caktohet në një nga mënyrat e mëposhtme:

1. me marrëveshje ndërmjet tij dhe palës së mbrojtur ose të përfaqësuar prej tij;
2. nga gjykata apo prokuroria, kur ai
  - a. është caktuar kryesisht ose
  - b. kur të pandehurit i jepet ndihmë ligjore falas.

Masa e shpërblimit për këto raste përcaktohet me vendim të përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit Drejtues të Dhomës Kombëtare të Avokatisë (shih diskutimin më sipër për shpërblimin e avokatëve të caktuar nga shteti).<sup>244</sup>

3. me ligj.<sup>245</sup>

<sup>243</sup> Kodi Etik i KASHLE, neni 3.4.

<sup>244</sup> Ligji “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, neni 11, pika 1 (b). Shih gjithashtu edhe diskutimin më sipër për tarifën e avokatëve të caktuar nga shteti.

<sup>245</sup> Ligji “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, neni 11.

Në pikën 3 të nenit 48 përcaktohet gjithashtu se Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, pasi marrin mendimin e Ministrisë së Financave, caktojnë tarifën e shpërblimit të avokatëve për dhënien e *ndihmës juridike*. Nuk është e qartë nëse kjo pikë është një përforsim i nenit 11 apo një detyrim më vete.<sup>246</sup>

Sipas nenit 12, shpërblimet me përqindje apo tarifën në varësi të rezultatit të çështjes, nuk mund të kërkojnë gjatë procedimit por për to duhet të jetë rënë dakord paraprakisht.<sup>247</sup>

#### *Urdhri i përbashkët për shpërblimet*

Tarifat e shpërblimit *për çështjet civile dhe ato penale* caktohen në një urdher të përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë të miratuar në maj të vitit 2005. Urdhri i Përbashkët i referohet pikës 3 të nenit 48 të ligjit për profesionin e avokatit.<sup>248</sup>

Për çështjet penale tarifën e vendosura në urdhrin e përbashkët janë si më poshtë:

<b><u>Përfaqësimi në çështjet penale</u></b>	<b>lekë</b>
Dhënie e mbrojtjes për ndalimet e arrestimet deri në seancën e caktimit të masës së sigurisë	15 000
Ndihmë juridike për hetimet paraprake, deri në dërgimin e çështjes në gjykim	
a) Për kundërvajtje	20 000
b) Për gjykimet në shkallë të parë	50 000
<b><u>Ndihmë juridike në gjykatën e shkallës së parë</u></b>	
a) Për krimet që parashikohet dënim deri 5 vjet	30 000
b) Për krime që parashikohet dënim mbi 5 vjet	80 000
Shërbime juridike (përfaqësimi) në gjykatën e apelit	40 000
Shërbime juridike (përfaqësimi) në Gjykatën e Lartë dhe Kushtetuese	50 000
Përgatitje ankese ankimore dhe të tjera	10 000
Këshillime juridike për çdo orë	500 - 1 500
Shërbimi për të miturit do të jetë sa gjysma e tarifave të sipërme	
....	
Shërbimi për njerëzit në nevojë do të jetë 80% më i ulët se tarifa e sipërme	
....	
Tarifat e sipërme zbatohen vetëm kur nuk ka marrëveshje midis palëve për shpërblimin e shërbimit të avokatisë.	

<sup>246</sup> Shih më tej.

<sup>247</sup> Ligji "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë", neni 12.

<sup>248</sup> Urdhër i Ministrisë së Drejtësisë nr. 284/3, Protokoll 6/03/2005 (data është e vështirë të deshifrohet dhe mund të jetë edhe nr. 1284, Protokoll 16/05/2005) dhe Dhomës së Avokatëve, nr. 212, Protokoll 16/05/2005.

**Koment:** Duke i parë në kuadrin e urdhrin të përbashkët, lidhja midis nenit 11 dhe nenit 48 të ligjit për profesionin e avokatit duket e paqartë. Siç u përmend më sipër, neni 11 i ligjit për profesionin e avokatit rregullon mënyrën e përcaktimit të tarifave për shërbimet juridike d.m.th., nëpërmjet një marrëveshjeje, nëpërmjet një urdhri të përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë për avokatët e caktuar nga shteti, ose me ligj. Mirëpo neni 48 i ligjit për profesionin e avokatit u referohet tarifave për avokatët që ofrojnë “ndihmë juridike”, d.m.th., nuk përmend në mënyrë të veçantë avokatët e caktuar nga gjykata. Termi “ndihmë juridike” është përsëri termi që përdoret edhe në nenin 2, i cili përcakton shërbimet juridike që jepen nga avokati. Në pikën 3 të nenit 48 nuk thuhet se tarifat e përmendura do të zbatohen *vetëm* në mungesë të një marrëveshjeje siç kërkohet në nenin 11, apo që duhen vendosur tarifa *minimale*. Kështu, ndërsa në nenin 11 duket se renditen mënyrat se si përcaktohen tarifat për shërbimet juridike, neni 48 mund të interpretohet që i autorizon organet e renditur të vendosin tarifa për *çfarëdolloj* ndihme juridike. Nëse është kështu, ka një kontradiktë midis këtyre dy dispozitave pasi urdhri i përbashkët nuk është ligj, siç parashikohet në nenin 11 pika 3. Është gjithashtu e paqartë nëse urdhri i përbashkët është hartuar *me qëllimin* për të rregulluar tarifat e avokatëve të caktuar nga shteti. Kështu, sipas Drejtorit të Drejtërisë së Profesioneve të Lira, urdhri i përbashkët është i zbatueshëm si për avokatët e caktuar privatisht, ashtu edhe për ata të caktuar nga shteti. Kurse sipas Kryetarit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, urdhri i përbashkët përcakton tarifat *minimale* vetëm për avokatët e caktuar privatisht, ndërkohë që në të ardhmen do të hartohet një tjetër urdhër i përbashkët për avokatët e caktuar nga shteti. Përfundimisht, sipas Sekretarit të Përgjithshëm të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, urdhri i përbashkët përcakton tarifat fikse për avokatët e caktuar nga shteti dhe tarifat minimale për avokatët e caktuar privatisht.<sup>249</sup> Ndërkohë që është e rekomandueshme të përcaktohen tarifa fikse, statusi dhe qëllimi i urdhrin të përbashkët mbetet i paqartë. Nëse urdhri i përbashkët nuk parashikon tarifat për avokatët e caktuar nga shteti, Dhoma e Avokatisë dhe Ministria e Drejtësisë nuk kanë përmbushur detyrimin e tyre sipas nenit 11 të ligjit. Nga ana tjetër, nëse në urdhrin e përbashkët parashikohen tarifat për avokatët e caktuar nga shteti, atëherë është për t’u shqetësuar që Zyra për Administrimin e Buxhetit Gjyqësor nuk e zbaton atë.<sup>250</sup>

Urdhri dhe lista e tarifave bashkëngjitur urdhrin janë hartuar në mënyrë shumë të paqartë. Nuk tregohet se si janë llogaritur tarifat e sugjeruara. Siç do të diskutohet më tej, mënyra se si janë përcaktuar tarifat nuk është shumë e logjikshme. Ndarja sipas kategorive të krimeve, sidomos në fazën e hetimeve, është ngatërruese pasi ato përcaktohen si kundërvajtje penale dhe “proces gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë”. Duke ditur se, si krimet ashtu edhe kundërvajtjet penale gjykohen po në gjykatën e shkallës së parë, nuk është e qartë përse është vendosur kështu, por nënkuptohet që është fjala për “krimet”.<sup>251</sup> Pjesa e urdhrin “për tarifat” zë dy faqe dhe faqja e dytë rendit disa udhëzime të përgjithshme. Paragrafi i parë në faqen e dytë u referohet “njerëzve në nevojë”, por nuk tregon se si përcaktohet një njeri në nevojë dhe as nuk i referohet ndonjë ligji për asistencën sociale apo ndonjë baze tjetër të jashtme për përcaktim.

<sup>249</sup> Takim me Maksim Haxhinë, Kryetar i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, më 8 prill 2006, takim me Gjin Niklekën, Drejtor i Drejtërisë së Profesioneve të Lira, më 11 prill 2006 dhe takim me Virgjil Karajën, Sekretar i Përgjithshëm i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, 13 prill 2006.

<sup>250</sup> Letra e datës 2 shkurt 2006, diskutuar më sipër, është një tregues i qartë se rregullorja nuk zbatohet.

<sup>251</sup> KPrP, neni 13 dhe KP, neni 1.

Në urdhër nuk është e qartë nëse tarifat akumulohen. Sipas Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe Drejtorisë së Profesioneve të Lira, tarifët e përmendura nën titullin “Përfaqësimi në çështjet penale” *nuk akumulohen*, ndërsa tarifët nën titullin “Ndhimë juridike në gjykatën e shkallës së parë” akumulohen

*Tarifat gjysmë-akumuluese – një shembull:* Tarifa për përfaqësimin e një klienti *vetëm* në seancën e verifikimit/vleftësimit është 15 000 lekë [afërsisht 122 euro], ndërsa tarifa e përfaqësimit gjatë hetimit paraprak (ku mendohet se përfshihet edhe seanca e verifikimit/vleftësimit) deri në dorëzimin e kërkesës për procedim penal është 20 000 lekë [afërsisht 164 euro] për kundërvajtje penale dhe 50 000 lekë [afërsisht 410 euro] për “gjykim në shkallë të parë” (që mendohet të jenë veprat penale). Kjo do të thotë që një avokat që përfaqëson klientin në seancën e verifikimit/vleftësimit, në hetimin paraprak dhe gjykimin në shkallën e parë do të merrte 30 000 lekë [afërsisht 246 euro] nëse klienti akuzohet për një vepër penale që dënohet deri në 5 vjet dhe 80 000 lekë [afërsisht 656 euro] nëse krimi dënohet me më shumë se 5 vjet burgim. Për të vazhduar përfaqësimin në Gjykatën e Apelit, avokati do të merrte edhe 40 000 lekë [afërsisht 328 euro] të tjera dhe për përfaqësim në Gjykatën e Lartë edhe 50 000 lekë [afërsisht 410 euro] të tjera. Përfaqësimi i një klienti të akuzuar për një vepër penale që dënohet me më shumë se 5 vjet burgim, deri në Gjykatën e Lartë do të paguhej me 170 000 lekë [80 000 + 40 000 + 50 000/ afërsisht 1 393 euro].

Sipas Sekretarit të Përgjithshëm të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, tarifët akumulohen të gjitha.

*Tarifat që akumulohen – një shembull:* Tarifa për përfaqësimin e një klienti të arrestuar, të paraburgosur dhe të akuzuar për kryerjen e një veprë penale, në seancën e verifikimit/vleftësimit, për hetimin paraprak dhe gjykimin në shkallën e parë, në këtë rast do të ishte 145 000 lekë (15 000 + 50 000 + 80 000/ afërsisht 1 189 euro). Vazhdimi i përfaqësimit deri në Gjykatën e Lartë do të ishte 235 000 lekë (145 000 + 40 000 + 50 000/ afërsisht 1 926 euro).

Këto shifra duhen krahasuar me tarifën prej 23 400 lekë [afërsisht 192 euro] për avokatët e caktuar nga shteti në shembullin e paraqitur më sipër ku u diskutua rregullorja e vitit 1996 dhe tarifët për avokatët e caktuar nga shteti, si dhe me pagën prej 75 000 lekë [afërsisht 615 euro] të një gjyqtari të shkallës së parë. Siç u diskutua më sipër, avokatët kanë prirjen të shpenzojnë pak kohë me klientët e tyre, ndërsa dosjet e prokurorisë rrallë janë të plota.<sup>252</sup>

Pyetëtori i bërë me avokatët mbrojtës tregon se tarifët e mësipërme njihen mjaft mirë nga avokatët mbrojtës. Shumë avokatë thonë se ata aplikojnë tarifët e përcaktuara në urdhër, disa caktojnë tarifa që shkojnë nga 30 000 deri në 50 000 lekë. Disa vendosin tarifa më të ulta si p.sh., 15 000 apo 20 000 lekë, ndërsa disa të tjerë shkojnë edhe deri në 100 000 lekë. Meqenëse shifrat e tarifave nuk korrespondojnë saktësisht me urdhrin dhe meqenëse asnjë nga avokatët nuk përcaktoi tarifa të veçanta për shkallë

<sup>252</sup> Shih të drejtat gjatë paraburgimit; Studimi i dosjeve të prokurorisë.

të ndryshme të procesit, është e pamundur të nxirren përfundime në lidhje me tarifat e sakta të avokatëve. Megjithatë, përgjigjet tregojnë se tarifat janë të një niveli më të ulët sesa lejohet në Urdhër. Duke qenë se thuhet që urdhri cakton tarifat minimale dhe avokatët e caktuar privatisht kërkojnë më pak, ky fakt tregon se tarifat e vendosura janë shumë të larta.

Shifrat e mësipërme mund të krahasohen edhe me vendet e tjera, për shembull, me Suedinë apo me Lituaninë. Sipas statistikave të Bankës Botërore, të ardhurat kombëtare bruto për person në Suedi në vitin 2004 ishin 35 840 dollarë amerikanë, ndërsa fuqia blerëse ishte 29 880 dollarë amerikanë, duke e renditur Suedinë përkatësisht në vendin e 10-të dhe të 17-të në listën e 208 vendeve. Për Lituaninë të ardhurat kombëtare bruto për person ishin 5 740 dollarë amerikanë, ndërsa fuqia blerëse ishte 12 530 për të njëjtën periudhë, duke e renditur Lituaninë përkatësisht në vendin e 74-t dhe 65-të ndër vendet e renditura. Për Shqipërinë të ardhurat kombëtare bruto për person ishin 2 060 dollarë amerikanë, ndërsa fuqia blerëse ishte 5 070 dollarë amerikanë për të njëjtën periudhë duke e renditur Shqipërinë përkatësisht në vendin e 119-të dhe 121-të ndër vendet e renditura.<sup>253</sup>

Në Suedi, të gjithë personat e paraburgosur kanë të drejtë të përfaqësohen nga një avokat mbrojtës publik dhe mbrojtja nga një avokat mbrojtës privat në çështjet penale është një përjashtim që ndodh rrallë.<sup>254</sup> Avokati mbrojtës publik paguhet nga shteti, por nëse i pandehuri shpallet fajtor, atëherë ai urdhërohet të rimbursojë shtetin për shpenzimet e mbrojtjes. Masa e rimbursimit varet nga të ardhurat dhe gjendja ekonomike të të pandehurit. Nëse i pandehuri nuk ka mjete të mjaftueshme atëherë nuk lëshohet urdhri për rimbursim.<sup>255</sup> Avokati mbrojtës publik paguhet sipas tarifave të përcaktuara nga Administrata Kombëtare e Gjykatave në Suedi, dhe llogariten me tarifë për orë prej 1 029 koronash suedeze<sup>256</sup> [afërsisht. 108 euro], tarifë e cila është e lidhur me indeksin e përgjithshëm të çmimeve. Tarifat variojnë në varësi të kohës efektive të seancave gjyqësore, pavarësisht numrit të seancave të zhvilluara.<sup>257</sup>

Kështu, në një çështje me një të pandehur, me një seancë ku koha efektive e dëgjimit është 0-15 minuta, tarifa është 2 645 korona suedeze (afërsisht 277 euro), bazuar në supozimin se avokati mbrojtës ka punuar gjithsej dy orë e gjysmë për çështjen. Në rastet kur koha e seancës është 45-59 min, tarifa është 3 650 korona suedeze (afërsisht 382 euro), bazuar në supozimin se avokati mbrojtës ka punuar gjithsej 3.5 orë për çështjen, dhe kur seanca është 3 orë e 45 minuta, tarifa e avokatit është 7 350 korona

<sup>253</sup> <http://siteresources.worldbank.org/DATASTATISTICS/Resources/GNIPC.pdf> [vizituar më 12 qershor 2006]

<sup>254</sup> Kodi suedez i Procedurës Gjyqësore, Kapitulli 21, pika 3a, shih <http://www.sweden.gov.se/content/1/c4/15/40/472970fc.pdf> [vizituar më 1 qershor 2006].

<sup>255</sup> Kodi suedez i Procedurës Gjyqësore, Kapitulli 31, pika 1.

<sup>256</sup> Të gjitha shifrat për Suedinë nuk kanë të përfshirë t.v.sh.-në që është 25%.

<sup>257</sup> Siç do të shihet edhe në kapitullin për gjykime efikase, koha mesatare e seancës gjyqësore është 1.72 orë, vetëm 4.8% e rasteve kanë një zgjatje të seancës gjyqësore më tepër se 6 orë, dhe 1.3% zgjasim më tepër se 12 orë. Duke qenë se më pak se 5% e çështjeve zgjasin më tepër se 6 orë, do të ishte e vështirë të arrihej një mesatare prej 1.72 orësh, po të mos kishte një numër të madh çështjesh që zgjidhen në më pak se një orë. [http://www.dom.se/Publikationer/Statistik/domstolsstatistik\\_2004.pdf](http://www.dom.se/Publikationer/Statistik/domstolsstatistik_2004.pdf) [vizituar më 1 qershor 2006].



suedeze (afërsisht 767 euro), bazuar në supozimin se avokati mbrojtës ka punuar gjithsej shtatë orë.<sup>258</sup> Përveç tarifës së shpërblimit, një avokat publik ka të drejtën e pagesave shtesë për kohën e shpenzuar për udhëtime dhe kohën e pritjes [98 euro/orë] si dhe për shpenzime të tjera.<sup>259</sup> Në shumicën e çështjeve penale, avokati mbrojtës publik paguhet rreth 500 euro për procesin në shkallë të parë. Kjo duhet krahasuar gjithashtu edhe me pagën e një gjyqtari të shkallës së parë në Suedi që është 47 000 korona suedeze [afërsisht 4 922 euro] në muaj.

Në Lituanë, për momentin ekzistojnë dy sisteme paralele për avokatët e paguar nga shteti. Pritet që sistemi i parë (i ri) të zëvendësojë të dytin (sistemin e vjetër). Paga për një gjyqtar të shkallës së parë në Lituanë fillon me rreth 850 euro dhe shkon mesatarisht deri në 1 000-1 100 euro në muaj.

Sistemi i ri.<sup>260</sup> Avokatët mbrojtës apo mbrojtësit me punësim shtetëror merren vetëm me çështje penale kur i pandehuri ka kërkuar ndihmë juridike falas. Këta avokatë mbrojtës punojnë ekskluzivisht me raste të mbrojtjes falas dhe sipas ligjit ata ndalohen të bëjnë diçka tjetër. Ata marrin nga shteti një pagë mujore prej rreth 1 200 euro. Përveç pagës, ata rimbursohen për disa nga shpenzimet, si për shembull për udhëtimet apo kopjimin e dokumenteve.

Sistemi i vjetër.<sup>261</sup> Avokatët mbrojtës punojnë me çështje që kërkojnë mbrojtje falas rast pas rasti vetëm me dëshirën e tyre dhe me kërkesën e shtetit, d.m.th., të hetuesit apo prokurorit. Për këta avokatë mbrojtës shteti paguan rreth 8 euro në orë<sup>262</sup> për punën që është bërë. Megjithatë, ligji e kufizon numrin e orëve të pagueshme në varësi të çështjes. Për shembull, në rastet e veprave penale shumë të rënda një avokat mbrojtës nuk mund të paguhet më tepër se për 45 orë pune, për vepra penale të rënda jo më tepër se 40 orë pune dhe për vepra penale për shkak të pakujdesisë, jo më tepër se 30 orë pune. Për shkak të niveleve të ulta të pagesës, avokatët mbrojtës të cilët marrin përsipër çështje falas janë shpeshherë të vjetrit ose ata më pak të kualifikuarit, të cilët nuk i kushtojnë kohën dhe vëmendjen e duhur çështjeve të tyre. Nëse një i pandehur shpallet fajtor, ai duhet të rimbursojë shtetin për shpenzimet e mbrojtjes, por një kategori njerëzish kanë të drejtë të përfitojnë mbrojtje falas në çështjet penale.<sup>263</sup>

Tarifa e një avokati të caktuar privatisht është rreth 150-250 euro për një çështje të thjeshtë ku seanca kryesore nuk zgjat më tepër se një orë.<sup>264</sup>

<sup>258</sup> Sigurisht që ka një numër çështjesh që kërkojnë shumë më tepër kohë efektive dhe shumë më tepër punë nga ana e avokatit mbrojtës publik. Shih shënimin e mësipërm.

<sup>259</sup> Për më tepër shih [http://www.dom.se/Publikationer/Rattshjalp\\_och\\_taxor/Rattshjalp\\_och\\_taxor.pdf](http://www.dom.se/Publikationer/Rattshjalp_och_taxor/Rattshjalp_och_taxor.pdf) [vizituar më 1 qershor 2006].

<sup>260</sup> Vendim i qeverisë së Republikës së Lituaniës nr. 69, datë 22 janar 2001, “Për rregullat e pagesës për ndihmë juridike detyësore në Lituanë” (ndryshuar me vendim të qeverisë së Republikës së Lituaniës nr. 469, datë 26 prill 2005) [www.lrs.lt](http://www.lrs.lt) [vizituar më 14 qershor 2006].

<sup>261</sup> Ligji lituan nr. VIII-1591, datë 28 mars 2000, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti në Lituanë” shih gjithashtu KPrP të Lituaniës, neni 51 në [www.lrs.lt](http://www.lrs.lt) [vizituar më 14 qershor 2006].

<sup>262</sup> Tetë euro në orë është llogaritur në bazë të pagës mujore minimale të shumëzuar me 0.05; paga minimale mujore në Lituanë është rreth 160 euro në muaj.

<sup>263</sup> Ata janë: të miturit, personat të cilët për shkak të paaftësive funksionale nuk janë në gjendje të mbrojnë veten, personat që nuk dinë lituanisht, persona të cilët janë ndër disa të bashkëpandehur që kanë interesa konfliktuale dhe njëri prej tyre ka një avokat mbrojtës, personat që rrezikojnë burgim të përjetshëm, personat e gjykuar në mungesë, personat në rastet e ekstradimit, personat që marrin asistencë sociale, personat që janë në kujdestarinë e shtetit, personat që nuk janë të aftë të kryejnë një punë si dhe personat me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme (në këtë rast, mund të jetë falas ose me 50% rimbursim, në varësi të nivelit të të ardhurave apo të pasurisë).

<sup>264</sup> Takim me Tomas Stravinskas, avokat mbrojtës lituan, 15 qershor 2006.

Duke marrë parasysh sa më sipër, duket se shërbimet juridike në Shqipëri janë krahasimisht të shtrenjta për një person mesatar, ndërsa fitimet e një avokati privat shqiptar janë krahasimisht të larta.

## 7.1 Tarifat minimale të shpërblimit dhe Kodi Etik

Siç u diskutua më sipër, ligji për profesionin e avokatit rregullon mënyrën e shpërblimit të avokatëve, d.m.th., me marrëveshje apo më një urdhër të përbashkët. Ligji nuk përmban dispozita në lidhje me shpërblimet maksimale apo minimale dhe as nuk parashikon përcaktimin e këtyre masave në akte nënligjore. Në lidhje me këtë, urdhri i përbashkët i vitit 2005, parashikon që shpërblimet zbatohen në mungesë të një marrëveshjeje midis avokatit dhe klientit; *pra nuk përmenden shpërblime minimale apo maksimale*. Megjithatë, Kodi Etik i Avokatit i ndalon anëtarët të vendosin shpërblime më të ulta se ato të përmendura në urdhrin e përbashkët të vitit 2005. Në nenin 28, pikat 1, 2, 5 dhe 6 parashikohet:<sup>265</sup>

- 1) Avokati ka të drejtë të ketë një tarifë për shërbimet e tij. Tarifa duhet të përcaktohet në një marrëveshje me shkrim ndërmjet avokatit dhe klientit të tij. Në mungesë të marrëveshjes me shkrim tarifa duhet të përcaktohet në përputhje me normat e tarifave të parashikuara në Urdhrin e përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë . *Në të dy rastet, tarifa nuk duhet të jetë më e ulët se ajo minimale, e përcaktuar në normat e tarifave për këtë lloj shërbimi.*
- 2) Tarifa e një avokati duhet të jetë e arsyeshme dhe e drejtë. Faktorët që duhet të konsiderohen për të përcaktuar se sa e arsyeshme është një tarifë përfshijnë:
  - a) koha dhe puna e kërkuar, risia dhe vështirësia e çështjeve të përfshira dhe aftësitë e kërkuara për të kryer shërbimet ligjore;
  - b) kufizimet kohore të imponuara nga rrethanat;
  - c) natyra dhe kohëzgjatja e marrëdhënieve profesionale me klientin;
  - d) përvoja, reputacioni dhe aftësia e avokatit ose avokatëve, në kryerjen e shërbimeve;
- ....
- 5) Avokati duhet të ofrojë ndihmë ligjore falas për:
  - a) personat që janë në vështirësi financiare;
  - b) personat që mbështeten me ndihmë financiare;
- 6) Avokati mund të ofrojë shërbime pa pagesë për miqtë e ngushtë, të afërmit ose avokatë të tjerë.

Duke pasur parasysh se ligji për profesionin e avokatit u jep avokatëve të drejtë të pakufizuar për të rënë dakord mbi shpërblimet e tyre, mund të diskutohet ligjshmëria e dispozitës në Kodin Etik të Avokatit, i cili nuk është as ligj dhe as akt nënligjor, e cila parashikon kufizime. Ky është një fakt shqetësues sidomos duke marrë parasysh se shkeljet e Kodit Etik mund të çojnë në procedim disiplinor. Nga ana tjetër, Kodi i Etikës

<sup>265</sup> Kodi Etik i Avokatit, neni 28.

i detyron avokatët të ofrojnë ndihmë juridike falas për personat në vështirësi financiare dhe për personat që përfitojnë ndihmë sociale. Kodi u lejon gjithashtu avokatëve të ofrojnë shërbime juridike falas miqve të ngushtë, familjarëve dhe avokatëve të tjerë.<sup>266</sup> Nëse kjo do të thotë që cilitdo që nuk paguan dot *minimumin* mjaft të lartë do t'i jepet ndihmë juridike falas, atëherë kjo duket se është një barrë e madhe për avokatët. Kështu, do të ishte më mirë sikur të vendosej një shpërblim minimal në një nivel të ulët apo modest në mënyrë që të përfitojë një pjesë e madhe nga shërbimet juridike. Vendosija e masave minimale apo maksimale të shpërblimit duhen vendosur në ligjin për profesionin e avokatit, pasi një kod etike nuk mund të vendosë kufizime kur nuk i është autorizuar një gjë e tillë me ligj.

### *Shpërblimi me përqindje*

Siç u përmend më lart, ligji për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë e lejon në përgjithësi pagesën me përqindje me kusht që një gjë e tillë të jetë parashikuar në marrëveshje përpara gjyqit.<sup>267</sup> Kurse Kodi Etik i Avokatit i ndalon marrëveshjet *pactum de quota litis* por lejon “shpërblimin në varësi të rezultatit”, *me përjashtim të çështjeve penale dhe atyre familjare*.<sup>268</sup>

Shpërblimi me përqindje normalisht kuptohet si “shpërblim për shërbimet e avokatit nëse padia është e suksesshme apo zgjidhet nga gjykata në favor të palës përkatëse. Ky lloj shpërblimi llogaritet me përqindje në bazë të rikuperimit neto të klientit (25% të rikuperimit nëse zgjidhet çështja dhe 33% nëse fitohet çështja në gjyq)”.<sup>269</sup> Shprehja *pactum de quota litis*, e përdorur në Kodin Etik, është një shprehje në latinisht e cila përkthehet si “një marrëveshje për një pjesë të shumës në çështjen në fjalë”. Kjo do të thotë që shpërblimi me përqindje mund të konsiderohet si një *pactum de quota litis* ashtu siç mund të konsiderohet edhe si shpërblim në varësi të rezultatit. Kjo shprehje përdoret kështu edhe në Kodin Etik të KASHLE ku *pactum de quota litis* përshkruhet si “një marrëveshje midis një avokati dhe klientit të tij të bërë përpara përfundimit të një çështjeje ku klienti është palë, me anë të së cilës klienti merr përsipër të paguajë avokatin për një pjesë të rezultatit, pavarësisht nëse ky përfaqëson një shumë në para apo përfitim tjetër të arritur nga klienti me përfundimin e çështjes”.<sup>270</sup> Marrëveshjet për shpërblim të pastër me përqindje apo *pactum de quota litis* nuk lejohen sipas Kodit Etik të KASHLE. Gjithsesi, një marrëveshje që shpërblimi të jetë në proporcion me vlerën e çështjes në fjalë të marrë përsipër nga avokati, nëse kjo gjë është bëhet në përputhje me një klasifikim shpërblimesh të miratuar apo nën kontrollin e një autoriteti kompetent që e ka avokatin nën juridiksion, nuk do të konsiderohet si një *pactum de quota litis*.<sup>271</sup>

<sup>266</sup> Kodi Etik i Avokatit, neni 28, pika 5.

<sup>267</sup> Ligji “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, neni 12.

<sup>268</sup> Kodi Etik i Avokatit, pikat 3 dhe 4.

<sup>269</sup> *Black's Law Dictionary [Fjalori Black's Law]*, (contingent fee)

<sup>270</sup> Kodi Etik i KASHLE, neni 3.3.2.

<sup>271</sup> Kodi Etik i KASHLE, neni 3.3.3.

Duke parë që konceptet e mësipërm janë sinonimik, dispozitat e ndryshme dhe kontradiktore në ligjin për profesionin e avokatit dhe në Kodin Etik janë shqetësuese. Shpërblimet në varësi të rezultatit të parashikuara në Kodin e Etikës kuptohen gjithashtu si shtesa të *shpërblimeve minimalë*, duke e zgjeruar kështu ndalimin për të kërkuar shpërblim nën tarifën e parashikuara në urdhrin e përbashkët.<sup>272</sup> Për këtë arsye duket se qëllimi kryesor i vendosjes së masës së shpërblimeve për avokatët në urdhrin e përbashkët nuk është mbrojtja e klientëve që kërkojnë ndihmë juridike por kufizimi i konkurrencës midis avokatëve.

**Koment:** Përshtatshmëria e shpërblimeve me përqindje në një shoqëri ku profesioni i avokatit është kaq i ri, ku Dhoma e Avokatëve është e pafuqishme dhe ku besimi në profesionin e avokatit dhe në sistemin gjyqësor është i ulët, është një çështje që ka vend për diskutim. Nëse përdoret shpërblimi me përqindje, duhet përcaktuar qartë në ligj apo në akte nënligjore mënyra se si vendosen dhe çfarë përqindjesh mund të përdoren.

## 7. 2 Publikimi i tarifave të shpërblimeve

Ligji “Për mbrojtjen e konsumatorit” parashikon që kushdo që *reklamon* mallra apo shërbime është i detyruar t’i japë konsumatorit informacion të plotë në lidhje me kostot, shërbimin, dhe për të gjitha shërbimet që i ofrohen një konsumatori do t’i tregohet edhe kostoja përfundimtare.<sup>273</sup> Kodi Etik i detyron avokatët të paraqesin shpërblimet minimale të përcaktuara në urdhrin e përbashkët të vitit 2005,<sup>274</sup> por i ndalon ata të paraqesin tarifën “e veçanta”.<sup>275</sup> Arsyeja për këtë nuk është e qartë por mund të shërbejë për të minuar konkurrencën e pastër midis avokatëve dhe i privon personat në kërkim të ndihmës ligjore mundësinë për të zgjedhur ndërmjet avokatëve. Kodi shqiptar i Etikës mund të krahasohet me Kodin e Avokatëve në Mbretërinë e Bashkuar për shembull, në të cilin parashikohet “reklamimi dhe promovimi mund të përfshijnë:... deklarinë e tarifave dhe metodat e shpërblimit;...”.<sup>276</sup>

**Koment:** Pyetësi i kryer me të paraburgosurit tregon se të pandehurit kanë pak informacion për tarifën që duhet të paguajnë dhe se ato ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme. Kështu, *shumica* e të paraburgosurve nuk e dinin se çfarë shpërblimi kërkonte avokati i tyre; disa thanë se avokatët e caktuar nga shteti kishin kërkuar shpërblim dhe disa të tjerë thanë se avokatët u kishin kërkuar para për t’i liruar apo për të ulur dënimin.

<sup>272</sup> Kodi Etik, neni 28, pikat 2 dhe 3.

<sup>273</sup> Ligji nr. 9135, datë 11 shtator 2003, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, nenet 8 dhe 14.

<sup>274</sup> Kodi Etik i Avokatit, neni 4, paragrafi 2.

<sup>275</sup> Kodi Etikës i Avokatit, neni 40.

<sup>276</sup> Kodi Etik, pika 710.2 (b) <http://www.barcouncil.org.uk> [vizituar më 1 qershor 2006].

**Disa shembuj – Të pandehur që prononcohen për shpërblimet e avokatëve mbrojtës<sup>277</sup>**

**Një burrë i akuzuar për trafikim narkotikësh:** *Unë paguaj 5 000 lekë për seancë dhe pastaj do të ketë edhe një pagesë shtesë në varësi të rezultatit.*

**Një burrë i akuzuar për vrasje:** *Unë i kam paguar avokatëve të mi privatë 17-18 mijë euro dhe 50 000 lekë për avokatët e caktuar nga shteti. Më është dashur të shesë shtëpinë.*

**Një burrë i akuzuar për vrasje:** *Deri më sot (6 javë pas arrestimit) familja ime ka paguar 50 000 lekë.*

**Një burrë i akuzuar për shfrytëzimin e një të miture për prostitucion:** *Deri tani familja ime i ka paguar avokatit 40,000 lekë.*

**Një i mitur që mbahej në mënyrë të paligjshme:** *Avokati mbrojtës i kërkoi familjes sime 5 000 euro për të më liruar.*

**Një burrë i akuzuar për vrasje:** *50 000 lekë është normale për një çështje penale por ka që paguajnë më shumë se 1000 euro.*

**Një burrë i akuzuar për vrasje:** *Nuk ka çmime fikse. Unë kam paguar 30 ,000 lekë vetëm për prokurën. Më është ofruar një dënim më i ulët për 7 000 euro.*

## 8. Komente përmbyllëse

Megjithëse në Shqipëri e drejta për mbrojtje në procedimet penale është një hap mjaft i madh përpara, duhet thënë se mbetet ende shumë për t'u bërë në këtë fushë të sistemit gjyqësor penal në Shqipëri. Avokatët mbrojtës shpeshherë luajnë një rol shumë pasiv në procedimet gjyqësore dhe bëhen shpeshherë shkak për shtyrjen e seancave gjyqësore. Duket gjithashtu se gjykatat kanë më shumë prirjen të dëgjojnë akuzën se sa mbrojtjen, duke i vënë kështu avokatët në një situatë jo të favorshme dhe duke krijuar mungesë balancimi të parimit të *barazisë së armëve*. Kuadri ligjor dhe rregullator që rregullon profesionin e avokatëve është i papërshtatshëm dhe deri tani Dhoma Kombëtare e Avokatisë nuk e ka treguar veten si një organ i fortë dhe i pavarur për vetërregullimin e profesionit të avokatit siç parashikohet në ligjin për profesionin e avokatit. Një shqetësim i veçantë janë tarifatat për shërbimet juridike në përgjithësi dhe në veçanti tarifatat e shpërblimit për avokatët mbrojtës të caktuar nga shteti. Prandaj ekziston një nevojë urgjente për të rishikuar sistemin e mbrojtjes falas në mënyrë që të ruhet parimi i *barazisë së armëve* si dhe për të përmbushur detyrimin sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për garantimin e ndihmës juridike *efektive* falas në rastet kur të pandehurit nuk kanë mjetet e mjaftueshme për të paguar këtë shërbim.

<sup>277</sup> Këto shifra pasqyrojnë vetëm opinionet e të pandehurve të intervistuar. Siç duket nga përgjigjet, të pandehurve u kërkohen para edhe për qëllime korruptive, siç janë lirimi apo ulja e dënimit.

## Rekomandime

1. Bazuar në parimin se *drejtësia jo vetëm duhet dhënë, por edhe duhet të duket që jepet*, gjykatat duhet të bëjnë përpjekje për të garantuar se akuza dhe mbrojtja trajtohen në mënyrë të njëjtë dhe me respekt.
  - Për të përmirësuar bashkëpunimin ndërmjet avokatëve dhe gjyqësorit, si dhe për të rregulluar çështjet që kanë të bëjnë me parimin e *barazisë së armëve* si dhe mungesat e pajustificueshme të avokatëve dhe çështje të lidhura me to, mund të mblidhet një grup pune me kryetarët e gjykatave dhe anëtarë të Dhomave të Avokatisë.
2. Gjyqtarët duhet t'i mënjanojnë kontaktet jozyrtare në gjykatë apo diku tjetër me secilën nga palët, d.m.th., akuzën dhe mbrojtjen. E njëjta gjë vlen edhe për prokurorët dhe avokatët mbrojtës. Kjo gjë do të zvogëlonte mundësitë për marrëveshje korruptive.
3. Duhet ndryshuar KPrP dhe ligji për profesionin e avokatit për ta bërë të qartë se gjykatat janë të mirëpritura t'i raportojnë Dhomës së Avokatisë çfarëdolloj shkeljeje të Kodit Etik të Avokatit.
4. Në KPrP duhen parashikuar masa disiplinore për avokatët mbrojtës që nuk përmbushin detyrat e tyre profesionale, apo që pengojnë procedimin. Mundësia për të marrë masa *mund* të varet nga mosveprimi i Dhomës përkatëse të Avokatisë.
  - Masat disiplinore që mund të parashikohen përfshijnë detyrimin për të paguar (të gjitha apo pjesërisht) shpenzimet procedurale, gjoba dhe ndalimin për të vepruar si avokat në çështjen në fjalë apo përpara gjykatës në përgjithësi.
5. Në mënyrë që të rivendoset dhe të forcohet besimi dhe respekti për profesionin e avokatit në Shqipëri, Dhoma Kombëtare e Avokatisë duhet:
  - të sigurojë që Statuti dhe Kodi i Etikës të botohen menjëherë në *Fletoren Zyrtare*;
  - të sigurojë që përmbajtja e Statutit dhe Kodit të Etikës të njihet nga anëtarët nëpërmjet seminareve apo mënyrave të ndryshme;
  - të krijojë menjëherë komitetet disiplinore dhe të sigurohet që ankesat të trajtohen menjëherë dhe në mënyrë të drejtë dhe transparente;
  - vendimet duhen bërë publike dhe të botohen si precedentë, dhe për rastet e ngjashme vendimet duhet të jenë koherente;
  - të krijojë dhe të ofrojë programe të vazhdueshme trajnimi për anëtarët e dhomave të avokatisë për të siguruar një cilësi të lartë të përfaqësimit ligjor. Vëmendje e veçantë u duhet kushtuar çështjeve të drejtave të njeriut dhe Kodit Etik të Avokatit;
  - duhet parë mundësia që anëtarësimi i vazhdueshëm duhet të varet nga pjesëmarrja në programet e vazhdueshme të trajnimit;

- të rishikohet ligji për profesionin e avokatit, Statuti i Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe Kodi Etik i Avokatit për të garantuar se kuadri ligjor është koherent dhe ndjek standardet evropiane;
  - të sigurojë që Kodi Etik i Avokatit njihet dhe zbatohet nga të gjithë anëtarët e saj;
    - kjo gjë mund të bëhet, për shembull, me anë të një Komiteti për Etikën apo me anë të seminareve të rregullt mbi çështje të ndryshme.
6. I gjithë sistemi i ndihmës juridike falas dhe i mbrojtjes së detyruar (p.sh., në rastet e të miturve apo të pandehurve me të meta mendore) duhet rishikuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe Ministria e Drejtësisë.
- Sistemi i rishikuar i mbrojtjes ligjore falas duhet të jetë i bazuar si më poshtë:
    - I. Në një sistem që i garanton të pandehurve, të cilët nuk kanë mjete financiare, mbrojtje ligjore efikase në rrethana që nuk i vendos ata në disavantazh të konsiderueshëm përballë akuzës dhe të pandehurve të tjerë;
    - II. Në një sistem i cili ose bën dallim ndërmjet rasteve të mbrojtjes falas dhe mbrojtjes së detyruar, ose siguron mbrojtje falas për të dyja kategoritë. Nëse mbrojtja e detyruar nuk është falas, atëherë duhet krijuar një sistem për rimbursim nga ana e të pandehurve.
    - III. Në shpërblime të arsyeshme për avokatët që japin mbrojtje falas;
    - IV. Në kritere të përcaktuara qartë për dhënien e mbrojtjes falas;
    - V. Në një sistem për të vlerësuar situatën financiare të të pandehurit/dyshuarit që mendohet të ketë nevojë për mbrojtje falas;
    - VI. Të pandehurit t'i krijohet mundësia të zgjedhë ndërmjet avokatëve që marrin pjesë në sistemin e mbrojtjes falas;
    - VII. Kritere të përcaktuara qartë për zëvendësimin e avokatëve që ofrojnë mbrojtje falas;
    - VIII. Një metodë të qartë dhe të përmbledhur për të llogaritur tarifën për avokatët e caktuar nga shteti që ofrojnë mbrojtje falas; bazuar në orët e shpenzuara për çështjen, me kompensime shtesë për shpenzimet (për shembull) sipas sistemit suedez të përshkruar më sipër) ose bazuar në një sistem tarifash për veprimtari të ndryshme (për shembull, sistemi italian);
    - IX. PAGESA duhet bërë në bazë të një fature ku përcaktohen veprimet e ndërmarra, koha e shpenzuar dhe shpenzimet për çështjen;

- X. Zbatim koherent i sistemit të mbrojtjes ligjore falas në të gjithë vendin. Kjo mund të arrihet ose me anë të një autoriteti qendror (p.sh., Zyra për Administrimin e Buxhetit Gjyqësor) që trajton të gjitha pagesat ose të paktën rishikon të gjitha pagesat duke pasur mundësinë e ankimit për këtë çështje në veçanti.
7. Duhet ndryshuar urdhri i përbashkët për tarifën e shpërblimit nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe Ministria e Drejtësisë.
- i. Tarifën fikse duhen vendosur ose në bazë të orëve të shpenzuara për çështjen, duke shtuar edhe kompensimin shtesë për shpenzimet (për shembull sipas sistemit suedez të përshkruar më sipër) ose bazuar në një sistem tarifash për veprimtari të ndryshme (për shembull, sistemi italian).
  - ii. Tarifën duhet të jenë të drejta dhe të arsyeshme krahasuar me nivelin e kostove në Shqipëri dhe nivelin e pagave në përgjithësi (ku mund të merren parasysh pagat e gjyqtarëve).
  - iii. Duhet vendosur kritere të qarta se si llogariten tarifën e shpërblimit me përqindje dhe përqindjet e lejueshme duhen përcaktuar me ligj ose me akte nënligjore.
  - iv. Duhet miratuar tarifa (të arsyeshme) për avokatët e caktuar nga shteti në përputhje me ligjin për avokatinë. Tarifën duhen llogaritur në të njëjtën mënyrë si tarifën për avokatët e caktuar privatisht, dhe avokatët e caktuar nga shteti duhen paguar vetëm në bazë të një fature të veçantë.
8. Duhet ndryshuar ligji për profesionin e avokatit në mënyrë që të jetë e detyrueshme për avokatët të shpallin tarifën e tyre dhe mënyrën se si ato llogariten.



### III. STUDIUM I DY ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Në këtë kapitull do të analizohen dy çështje penale. Njëra është “Hakmarrja për Drejtësinë Shqiptare” që ka të bëjë me krimet më spektakolare të kryera në Shqipëri vitet e fundit. Pas një procesi të parë gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Tiranë, çështja iu kthye prokurorisë për hetime të mëtejshme dhe aktualisht “një proces i dytë” është duke u zhvilluar në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Çështja e dytë, së cilës këtu i referohemi si “Çështja e Avokatit”, është një çështje korrupsioni kundër një avokati që e ushtronte profesionin në Gjykatën e Rrethit Tiranë. Qëllimi i studimit të këtyre rasteve është që të tregohet me hollësi se si janë trajtuar këto çështje nga sistemi i drejtësisë penale shqiptare, si dhe të nxirren në pah disa probleme dhe mangësi që janë shqetësime të përgjithshme. Sado që këto dy raste dhe mënyra se si trajtohen nga prokuroria dhe gjykatat janë shumë të ndryshme, përsëri të dyja çështjet ngrenë probleme serioze dhe tregojnë se parimet e shtetit të së drejtës dhe parimet bazë të drejtësisë trajtohen në mënyrë shumë sipërfaqësore ose thjesht nuk zbatohen.

#### 1. Çështja “Hakmarrja për Drejtësinë Shqiptare”

*Shënim: Analiza e mëposhtme ka të bëjë me një proces gjyqësor që është në vazhdim në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda (GjKR). Megjithatë, analiza nuk merret me proceset që janë në shqyrtim, por vetëm me vendimet dhe faktet që çojnë në këtë gjyq. Veç kësaj, Prezenca e OSBE-së nuk ka asnjë lloj opinionioni nëse të pandehurit e kësaj çështjeje kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen.*

##### *Historiku i ngjarjes*

Në tetor 1996 filluan hetimet për një numër të madh armësh të grabitura, të cilat çuan në shumë vrasje, rrëmbime dhe krijimin e organizatës kriminale të quajtur “Hakmarrja për Drejtësinë Shqiptare”. Më pas, Organizata “Hakmarrja për Drejtësinë Shqiptare”, sipas akuzës, vendosi një bombë në një makinë, e cila shpërtheu jashtë supermarketit “Vefa”, duke shkaktuar katër të vdekur dhe shumë të plagosur. Krimet ndodhën midis viteve 1992 dhe 1996. Më 12 tetor 1996 u arrestuan pesë nga të dyshuarit, Leart Shyti, Kreshnik Spahiu, Enkeled Agaj, Pasho Novruzaj dhe Nikolin Novruzaj. Gjatë trazirave të marsit 1997, të gjithë këta të pandehur arritën të arratiseshin. Më 13 tetor 1998<sup>278</sup> në Gjykatën e Rrethit Tiranë u dorëzua dosja penale me 19 akuza kundër 11 të pandehurve. Procesi gjyqësor filloi më 24 dhjetor 1998. Të gjithë të pandehurit u gjykuan në mungesë. I pandehuri Gëzim Gjoni u arrestua më 19 maj 2003 dhe qëndroi në burg me këtë masë sigurie deri më 23 nëntor 2005, kur arresti në burg u ndryshua me arrest në shtëpi deri në dhënien e vendimit përfundimtar. Ai zgjodhi të mos ishte prezent në gjykim. Gjatë procedimeve Enkeled Agaj vdiq në rrethana të paqarta.

<sup>278</sup> Enkeled Agaj, Altin Arapi, Gentian Çaka, Gëzim Gjoni, Driton Hate, Nikolin Novruzaj, Pash Novruzaj, Leart Shyti, Orik Shyti, Roland Shyti dhe Kreshnik Spahiu.

Më 12 shkurt 2003 çështja u pushua nga gjykata në përputhje me nenin 387 të KPrP, pasi organi hetimor, duke iu referuar nenit 377 të KPrP, kishte kërkuar që aktet t'i kalonin prokurorit për hetime të mëtejshme. Gjatë gjykimit, të dy prokurorët që kishin ngritur akuzën në gjykatë, kishin hequr dorë nga çështja dhe ishin larguar nga vendi. Megjithatë, kërkesa që aktet t'i kalonin prokurorisë ishte bërë nga dy prokurorë të rinj. Kërkesa për të tërhequr aktet u dorëzua pas katër vitesh dhe 190 seancash gjyqësore, dhe pasi kishte përfunduar hetimi gjyqësor.<sup>279</sup> Prandaj, kërkesa u dorëzua në një kohë kur dukej qartë se kishte pak prova të pranueshme që vërtetonin fajësinë e të pandehurve në fjalë. Gjatë procesit gjyqësor u bë e qartë se të paktën një pjesë e hetimeve kishte parregullsi të rënda.

Pavarësisht nga kërkesa për tërheqjen e akteve, Gjykata e Rrethit Tiranë vendosi të pushonte çështjen, duke arsyetuar se meqenëse në bazë të ligjit prokurori tërheq *akuzën* dhe jo *aktet*, kërkesa duhet të konsiderohet si tërheqje e akuzave.<sup>280</sup> Më pas Gjykata vazhdoi me arsyetimin se meqenëse akuzat ishin tërhequr, shkaku për procedim penal kishte pushuar së ekzistuari, si rrjedhim çështja ishte pushuar sipas nenit 387 të KPrP. Sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Tiranë, shqyrtimi gjyqësor tregoi se veprat penale për të cilat ishte ngritur akuza kishin ndodhur por që nuk kishte prova të mjaftueshme për të fajësuar të pandehurit për kryerjen e këtyre veprave penale. Provat më të rëndësishme në këtë aspekt ishin së pari, ekspertiza balistike, e cila tregonte se të njëjtat armë ishin përdorur për kryerjen e shumë grabitjeve dhe së dyti, i ashtuquajtur i sekuestrimit i këtyre armëve në banesën me qira të njërit prej të pandehurve, Enkeled Agaj. Megjithatë, gjatë procesit gjyqësor, personat që duhet të kishin qenë të pranishëm gjatë sekuestrimit të armëve dhe që kishin firmosur raportin me shkrim, e mohuan që kishin qenë në banesën në fjalë ose që kishin qenë të pranishëm gjatë sekuestrimit. Disa nga dëshmitarët dëshmuan se mund ta kishin firmosur procesverbalin pasi kishin parë armët në rajonin e policisë në Tiranë. Si pasojë, procesverbali lidhur me sekuestrimin e armëve u shpall i pavlefshëm.

Gjatë hetimit në paraburgim, disa nga të pandehurit, në veçanti Nikolin Novruzaj, pranuan se kishin kryer disa prej krimeve për të cilat ishin akuzuar. Në këtë aspekt, Gjykata e Rrethit Tiranë konkludoi se nuk mund të quheshin si provë deklaratat e bëra përpara se ata të informoheshin për akuzat kundër tyre dhe të drejtën për të pasur avokat mbrojtës.<sup>281</sup> Lidhur me deklaratat e të pandehurve në fazat e mëvonshme të hetimit, Gjykata e Rrethit Tiranë, konstatoi se ato nuk ishin marrë në kundërshtim me ligjin, dhe si të tilla nuk mund të deklaroheshin si të pavlefshme. Meqenëse këto deklarata nuk ishin vërtetuar me prova të tjera ato nuk ishin të mjaftueshme për të provuar fajësinë e të pandehurit ose bashkëpunëtorëve të tij.<sup>282</sup> Si përfundim, dëshmia

<sup>279</sup> Nga këto, u zhvilluan përafërsisht 80 seanca. Pjesa tjetër u shty për shkak të mosnjoftimit të dëshmitarëve, mungesës së gjyqtarëve (25 seanca), mungesës së prokurorit (10 seanca) dhe mungesës së avokatit (4 seanca).

<sup>280</sup> KPrP, neni 377.

<sup>281</sup> KPrP, neni 37.

<sup>282</sup> KPrP, neni 151 paragrafi 4 dhe neni 152 paragrafi 3.

e njërit prej dëshmitarëve të mbrojtjes, një shofer dhe agjent i shërbimit sekret i cili dëshmoi se kishte marrë pjesë në dërgimin e armëve në shtëpinë me qira të njërit prej të pandehurve, u konstatua të ishte e pavërtetë.

Vendimi i Gjykatës së Rrethit Tiranë për pushimin e çështjes u apelua nga të dyja palët, si nga prokurori ashtu edhe nga mbrojtja. Gjykata e Apelit e prishi vendimin e Gjykatës së Rrethit dhe e ktheu për rigjykim nga një trup tjetër gjykues i Gjykatës së Rrethit Tiranë.<sup>283</sup> Si arsye për kthimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, Gjykata e Apelit argumentoi se Gjykata e Rrethit e kishte interpretuar gabim kërkesën për tërheqjen e akteve si tërheqje të akuzës dhe më pas e kishte konsideruar “gabimisht” mungesën e akuzës si arsye për të pushuar çështjen. Gjykata e Apelit në vijim argumentoi se për sa kohë Gjykata e Rrethit nuk arriti në përfundimin se të pandehurit nuk ishin fajtorë, Gjykata e Rrethit duhet të kishte vendosur transferimin e akteve në prokurori. Në vijim, Gjykata e Apelit u shpreh se ata nuk kishin të drejtë të kthenin aktet drejtpërdrejtë në prokurori, meqë neni 428 i KPrP shpreh qartë se si veprohet në rast se prishet një vendim i shkallës së parë. Gjykata e Apelit në përfundim la si detyrë që trupi i ri gjykues në Gjykatën e Rrethit Tiranë të respektojë kërkesën e prokurorit për kalimin e akteve në përputhje me nenin 377 të KPrP.

Vendimi duket sikur nuk është në përputhje me KPrP, neni 428 parashikon:

1. Gjykata e Apelit, pasi shqyrton çështjen, vendos:

a. lënien në fuqi të vendimit;

b. ndryshimin e vendimit;

c. prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes kur janë rastet që nuk lejojnë fillimin ose vazhdimin e procedimit ose kur nuk vërtetohet fajësia e të pandehurit;

ç. prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve gjykatës së shkallës së parë kur nuk janë respektuar dispozitat që lidhen me kushtet për të qenë gjyqtar ose ndihmësgjyqtar në çështjen konkrete, me numrin e gjyqtarëve dhe ndihmësgjyqtarëve që është i domosdoshëm për formimin e kolegjeve të caktuara në këtë Kod, me ushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori pjesëmarrjen e tij në procedim, me pjesëmarrjen e përfaqësuesit të të dëmtuarit akuzues dhe të mbrojtësit të të pandehurit, me shkeljen e dispozitave për paraqitjen e akuzave të reja, si dhe në çdo rast kur në dispozita të veçanta është parashikuar pavlefshmëria e vendimit.

Sidoqoftë, Gjykata e Apelit, në vendimin e saj, nuk shqyrtoi asnjëherë nëse ekzistonte ndonjë nga rrethanat për prishjen e vendimit të përmendur në paragrafin (ç) – d.m.th, shkelje të rënda procedurale. Në vend të kësaj dhe siç u përmend edhe më sipër, Gjykata e Apelit konstatoi se Gjykata e Rrethit Tiranë kishte interpretuar gabimisht kërkesën e prokurorit dhe si rezultat *mori një vendim të gabuar të cilin Gjykata e Apelit vendosi ta kthente mbrapsht*. Fakti që Gjykata e Rrethit Tiranë mori një vendim të gabuar sipas Gjykatës së Apelit *nuk është shkelje e rëndë procedurale dhe si rrjedhim nuk është arsye për të prishur vendimin siç është cilësuar në nenin 428*. Por Gjykata e Apelit e ka pasur fuqinë që thjeshtë të ndryshojë vendimin siç parashikohet në paragrafin (b). Ky vendim, megjithëse nuk ka aq lidhje me diskutimin e mësipërm, nxjerr në pah një problem tjetër të rëndësishëm në lidhje me vendimet e gjykatës shqiptare, d.m.th, arsyetime ligjore të nivelit të ulët dhe shpesh të pasakta.

<sup>283</sup> Shih nenin 15 paragrafi 1 i KPrP.

Apelimi i mbrojtjes u hodh poshtë meqë avokatët mbrojtës të cilët e dorëzuan apelimin nuk ishin të autorizuar për këtë gjë. Mbrojtja e ankimoi vendimin në Gjykatën e Lartë, e cila la në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit. Në 4 shtator 2003, një trup i ri gjykues në Gjykatën e Rrethit Tiranë vendosi të kalonte aktet në prokurori (në përputhje me udhëzimin e Gjykatës së Apelit). Në 23 mars 2005, procesi gjyqësor filloi përsëri, këtë herë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda (GJKR) në Tiranë.

Dy nga të pandehurit, Kreshnik Spahiu dhe Orik Shyti, u ishte garantuar azil në Zvicër për arsye të persekutimit politik nga shteti nëpërmjet çështjes “Hakmarrja për Drejtësinë Shqiptare”.<sup>284</sup> Një kërkesë për ekstradim nga Belgjika të të pandehurit të tretë, Altin Arapi, u refuzua gjithashtu duke iu referuar çështjes “Hakmarrja për Drejtësi Shqiptare”.<sup>285</sup>

#### *Analiza ligjore*

Trajtimi i çështjes “Hakmarrja për Drejtësinë Shqiptare” ngre shqetësime serioze lidhur me të drejtën e të pandehurve për një gjykim të drejtë. Në veçanti, ngre shqetësimin lidhur me të drejtën e tyre për t’u prezumuar të pafajshëm dhe për një gjykim brenda një kohe të arsyeshme.

#### *Në lidhje me legjislacionin*

Si rregull i përgjithshëm, një kërkesë për gjykimin e çështjes regjistrohet kur prokurori i cili drejton hetimin në fazën e paraburgimit konstaton se ka prova të mjaftueshme për të provuar fajësinë e të pandehurit/të pandehurve. Ky rregull pasqyrohet në nenin 331 të KPrP. Si përpjekje për të siguruar që proceset gjyqësore të zhvillohen brenda një afati kohor të arsyeshëm, legjislacioni shqiptar parashikon afate të ndryshme kohore që duhen respektuar.<sup>286</sup> Prandaj rregulla kryesore është që brenda tre muajve pasi i pandehuri është njoftuar për akuzat, prokurori duhet të vendosë nëse do ta dërgojë çështjen në gjykatë.<sup>287</sup> Kohëzgjatja mund të zgjasë tre muaj, ose në rastin e një hetimi të ndërlikuar, nuk mund të kalojë dy vjet.<sup>288</sup> Pas ndryshimit të këtij neni në shkurt 1999, u parashikua se pas afatit dyvjeçar, Prokurori i Përgjithshëm në raste të jashtëzakonshme miraton zgjatjen e afatit të hetimit paraprak edhe për një vit, duke zgjatur në këtë mënyrë afatin kohor të hetimit në paraburgim deri në jo më shumë se tre vjet.<sup>289</sup> Nuk mund të përdoren veprimet hetimore të kryera pas mbarimit të këtij afati, d.m.th, provat e marra pas mbarimit të këtij afati janë të papërdorshme.<sup>290</sup> Ka afate kohore shtesë që duhet të merren në konsideratë kur të pandehurve u është dhënë masa e sigurisë “arrest në burg”.<sup>291</sup>

<sup>284</sup> Kreshnik Spahiu dhe Orik Shyti: Vendimi nga Komisioni Zviceran i Apelit mbi Azilin, akti II/N462 528BS, 13 shtator 2004.

<sup>285</sup> Vendim i Ministrisë Belge të Drejtësisë, datë 17 shtator 2004. Ka informacion që më vonë Altin Arapit i është dhënë azil për të njëjtat arsye, por kjo gjë nuk është konfirmuar zyrtarisht.

<sup>286</sup> Këto rregulla janë diskutuar në Pjesën I-rë mbi Paraburgimin.

<sup>287</sup> KPrP, neni 323, paragrafi 1.

<sup>288</sup> KPrP, neni 324.

<sup>289</sup> Ligji nr. 8460, datë 11 shkurt 1999, “Për disa shtesa në ligjin nr. 7905, datë 21 mars 1996, ‘Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë’”.

<sup>290</sup> KPrP, 324 paragrafi 4.

<sup>291</sup> KPrP, neni 263.

Për sa i përket kërkesës për tërheqjen e akuzës, neni përkatës 377 përfshihet në Seksionin IV me titull “Akuzat e reja”, që tregon se kërkesa për tërheqjen e akuzës do të ishte e dobishme kryesisht kur del një fakt i ri në ngarkim të të pandehurve. Kështu, për shembull, neni 374 parashtron se kur dalin fakte të reja lidhur me veprat penale për të cilat nuk është paraqitur ndonjë kërkesë për gjykim, prokurori *tërheq dosjen për të vazhduar hetimet paraprake*.<sup>292</sup>

Neni 377, me titull “Kalimi i akteve prokurorit” parashikon se:

- Kur prokurori e tërheq akuzën dhe në gjendjen që janë provat vërtetohet se i pandehuri nuk ka faj ose del që ekziston një nga rastet e pushimit të çështjes, gjykata vendos pafajësinë e të pandehurit ose pushimin e çështjes. Në rast të kundërt, gjykata vendos kalimin e akteve prokurorit.<sup>293</sup>

Çështjet mund të pushohen në rast se:

- Ndjekja penale e çështjes nuk duhet të fillonte ose nuk duhet të vazhdojë, ose kur vepra penale është shuar. Gjukata vendos në të njëjtën mënyrë kur ekzistenca e një kushti procedimi apo e një shkakut që shuan veprën penale është e dyshimtë. Vendimi për të pushuar një çështje duhet të jetë i arsyetuar.<sup>294</sup>

Komentari i KPrP në njërin anë thekson se “kur prokurori e tërheq akuzën dhe kërkon t’i jepet dosja për të vazhduar hetimet, në bazë të nenit 377 të KPrP, gjykata, si rregull vendos kalimin e akteve prokurorit.” Më pas vazhdon me një citim të një Vendimi të Gjykatës së Lartë, i cili shpreh se gjykata mund ta refuzojë tërheqjen e akteve vetëm atëherë kur del qartë pafajësia e të pandehurit. Nga ana tjetër, Komentari shpreh se “është e nevojshme të kuptohet se kalimi i akteve prokurorit duhet të përbëjë një përjashtim dhe të përdoret rrallë ose mundësisht asnjëherë, sepse është një kohë e humbur, një zvarritje e procedimit...”.<sup>295</sup> Nuk ka asnjë referim lidhur me titullin e Seksionit, d.m.th. marrëdhënies ndërmjet kërkesës për tërheqjen e akuzave dhe akuzave të reja. Kuptimi dhe interpretimi i këtij neni mbetet i paqartë, duke mos marrë në konsideratë që në këtë seksion dalin akuza të reja, ndonëse titulli i nenit duket se tregon kalimin e akteve prokurorit si alternativën kryesore, neni në vetvete duket se e shpreh këtë si alternativë të fundit.

<sup>292</sup> Neni vijon të parashikojë se në qoftë se prokurori kërkon, gjykata mund të lejojë shqyrtimin në të njëjtën seancë kur i pandehuri jep pëlqimin dhe nuk dëmtohet shpejtësia e procedimit..

<sup>293</sup> KPrP, neni 377.

<sup>294</sup> KPrP, neni 387 dhe Vendimi Nr. 157 i Gjykatës së Lartë, datë 28.02.2002.

<sup>295</sup> Halim Islami, Artan Hoxha dhe Ilir Panda, *Komentari i Procedurës Penale* (Tiranë: Morava, 2003) [Komentari i KPrP] fq. 492.

Megjithatë, kjo thekson një problem tjetër brenda sistemit shqiptar të drejtësisë, që rrjedh nga fakti se një pjesë e madhe e legjislacionit është marrë dhe përkthyer nga sisteme të tjera ligjore. Për shembull, KPrP është një përkthim dhe përshtatje e Kodit italian të Procedurës Penale, ndërsa Kodi Penal është një përshtatje nga legjislacioni penal francez. Dykuptimësitë ekzistuese gjuhësore mund të rriten nga përkthimi dhe kuptimi i një neni nganjëherë mund të humbasë fare. Gjuha në vetvete është diçka e pasaktë – është në vetvete sfida më e madhe për çdo ligjvënës – dhe interpretimi i koncepteve të ndryshme varion në gjuhë të ndryshme, duke e bërë përkthimin e ligjeve nganjëherë një pengesë të pakapërcyeshme.<sup>296</sup> Një problem tjetër lidhur me marrjen e ligjeve nga jashtë dhe përkthimin e tyre është mungesa e punës përgatitore për të ndihmuar në interpretim, ose edhe në komentaret e përshtatshëm. Një mënyrë për të zgjidhur këtë do të ishte nëpërmjet jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, por ky proces është shumë i ngadalshëm meqenëse kuptohet se Gjykata e Lartë nuk mund të vendosë se cilat çështje do të apeloohen dhe cilat pyetje do të shtrohen para saj. E njëjta gjë vlen edhe për Gjykatën Kushtetuese, e cila ka gjithashtu një rol për të luajtur në këtë aspekt. Si përfundim, ka një nevojë urgjente për të rishikuar si Kodin e Procedurës Penale, ashtu edhe Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë.

#### *Në lidhje me faktet*

Konkluzioni i Gjykatës së Rrethit Tiranë lidhur me pranimin e deklaratave të të pandehurve gjatë hetimeve paraprake, lë vend për diskutim për disa arsye. Asnjë prej të pandehurve nuk përfaqësohej nga avokati mbrojtës gjatë marrjes në pyetje dhe ata ishin transferuar në vende të ndryshme që zakonisht nuk përdorehin për qëllime paraburgimi; për shembull, ata janë dërguar në Malin e Dajtit, në Vlorë dhe në Durrës për t'u marrë në pyetje dhe ka tregues që të pandehurit janë keqtrajtuar/torturuar gjatë marrjes në pyetje.

Duke marrë në konsideratë parregullsitë lidhur me sekuestrimin e armëve dhe deklaratat e të pandehurve, bashkë me mungesën e provave të tjera që lidhin të pandehurit me krimin për të cilin janë akuzuar, është e diskutueshme nëse ka pasur prova të mjaftueshme për të dërguar çështjen “Hakmarrja për Drejtësinë Shqiptare” në gjykatë në vitin 1998. Meqenëse padia u depozitua ditën që përfundoi afati maksimal dyvjeçar i hetimeve në paraburgim, e vetmja alternativë tjetër në dispozicion të prokurorit do të kishte qenë të tërhiqte akuzat ndaj të pandehurve. Duke marrë në konsideratë situatën e paqëndrueshme në Shqipëri në atë kohë si edhe shkallën e kriminalitetit në fjalë, është e kuptueshme që kjo mund të mos jetë dukur si një alternativë e mundshme apo si mënyrë të vepruari. Nga ana tjetër, prezumimi i pafajësisë kërkon që prokurori të provojë, brenda një kohe të arsyeshme, fajin e kujtdo që akuzohet se ka kryer një vepër penale. Pasojë e këtij parimi është që mossuksesi i prokurorit gjatë hetimit paraprak duhet të pasqyrohet tek ndjekja penale, jo tek të pandehurit.

<sup>296</sup> Shih p.sh., diskutimin lidhur me kuptimin e fjalës franceze “aussitôt” në krahasim me fjalën në gjuhën angleze “promptly”(menjëherë) në KEDNj, neni 5 paragrafi 3, në çështjen “Brogan dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar”, 29 nëntor 1988, paragrafi 59. [Si fjala në gjuhën frënge, ashtu edhe fjala në gjuhën angleze, kanë kuptim të përafërt me fjalën “menjëherë”].

Në legjislacionin suedez, për shembull, ky parim pasqyrohet në një dispozitë që shpreh se nëse tërhiqen akuzat nga organi hetimor për arsye se nuk ka baza të mjaftueshme për të besuar se i pandehuri është fajtor për veprën penale, pala e dëmtuar mund të marrë përsipër ndjekjen penale. Në rast se pala e dëmtuar nuk e merr përsipër ndjekjen penale, ajo mund të mos ngrejë akuzën ndaj të pandehurit dhe *me kërkesën e tij, i pandehuri ka të drejtë për një vendim pafajësie*.<sup>297</sup>

Po të mos ishte ndryshuar neni përkatës i KPrP në vitin 1999 për të shtuar edhe një vit tjetër të mundshëm hetimi me paraburgimin e të pandehurit, kërkesa për tërheqje nuk do të kishte vlerë për prokurorin, meqenëse çdo provë e mbledhur pas kësaj periudhe do të kishte qenë e papranueshme. Ndalimi me ligj i aplikimit të ligjit penal më pak të favorshëm për të pandehurin, zbatohet drejtpërdrejt vetëm për krimin dhe ndëshkimin.<sup>298</sup> Sidoqoftë, ndalimi mishëron gjithashtu një parim të përgjithshëm të interpretimit të ligjeve në lidhje me krimet ose procedurat penale në favor të të pandehurve.<sup>299</sup> Për më tepër, ligjet me dispozita procedurale zakonisht kanë ndikim mbi procedurat e nisura vetëm pas miratimit të ligjit, me qëllim që të sigurohet që palët të mund të parashikojnë atë që qëndron para tyre gjatë procedimeve. Kështu, për shembull, KPrP në dispozitën kalimtare të tij 525 shpreh se Kodi hyn në fuqi më 1 gusht 1995, por për çështjet penale që po hetohen tashmë ose që janë në shqyrtim e sipër nga gjykata, do të zbatohet kodi i vjetër deri më 1 mars 1996.<sup>300</sup>

Është interesant fakti që kjo pjesë e nenit nuk shfaqet në variantin shqiptar të Kodit të Procedurës Penale botuar nga Qendra e Publikimeve Zyrtare, por vetëm në përkthimin në gjuhën angleze të kodit<sup>301</sup>. Vëzhgimet e mëtejshme tregojnë se neni 2 iu shtua ligjit 7977, datë 26 korrik 1997, pas miratimit të KPrP më 21 Mars 1995. Neni 2 parashikoi se kodi i mëparshëm do të mund të zbatohet për procedime të nisura ose çështje penale që ndodhen në fazën e gjykimit kur u miratua kodi i ri, por jo më vonë se 15 nëntori i vitit 1995. Më pas ligji nr. 8027, datë 15 nëntor 1995, zgjati zbatueshmërinë e kodit të mëparshëm për çështje nën hetim ose pezull në gjykatë deri më 1 mars 1996. Që atëherë nuk ka pasur as shfuqizim të paragrafit, dhe as ndryshim të nenit. Prandaj ai është ende në fuqi, ndonëse i vjetruar, dhe duhet të përfshihet në botimin e Kodit.<sup>302</sup>

Për çështjen “Hakmarrja për Drejtësinë Shqiptare”, mund të argumentohet mbi baza të arsyeshme se meqenëse legjislacioni u ndryshua *pas përfundimit të hetimit në paraburgim dhe periudha maksimale e afateve të procedimit të paraburgimit pothuajse kishte përfunduar*, dhe pasi kishte përfunduar shqyrtimi gjyqësor, nuk do të ishte e

<sup>297</sup> Kodi suedez i Procedurës Gjyqësore (Rättegångsbalk 1942:740), Kapitulli 20, paragrafi 9 <http://www.sweden.gov.se/content/1/c6/02/77/78/30607300.pdf> [mundësuar më 11 korrik 2006]. Shih gjithashtu Kodin finlandez mbi Procedurën Penale (Lag om rättegången i brottmål 11.7.1997/689, neni 15.

<sup>298</sup> KEDNJ, neni 7, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 29.

<sup>299</sup> Shih, p.sh., nenin 3 të Kodit Penal.

<sup>300</sup> Shih gjithashtu nenin 618 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 317 të Kodit të Familjes; që theksojnë se për çështje të mbetura pezull do të zbatohet kodi i vjetër deri sa të hyjë në fuqi ligji i ri.

<sup>301</sup> Përkthimi është bërë në bazë të variantit të KPrP, botuar në Fletoren Zyrtare.

<sup>302</sup> Ky informacion është konfirmuar nga drejtorja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare, znj. Ardita Alsula, e cila tha se botimi i ardhshëm do të përfshinte paragrafin e harruar. [e-mail i datës 18 korrik 2005].

mundur të rihapeshin procedimet. Ky argument është edhe më i ngutshëm duke marrë parasysh të drejtën e të pandehurit për prezumim të pafajësisë dhe faktin se shtatë vite hetime, paraburgimi dhe proces gjyqësor nuk kanë mjaftuar për një vendim fajësie ndaj secilit prej tyre. Gjithashtu, vendimi për të vazhduar hetimet u heq të pandehurve të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

Duke parë kontekstin dhe kohën kur janë shqyrtuar veprat penale e kryera në çështjen “Hakmarrja për Drejtësinë Shqiptare”, ka mjaft interes nga ana e publikut lidhur me këtë çështje dhe për shkak të këtij interesi, ka edhe implikime politike. Megjithatë, shqyrtimi i kësaj çështjeje tregon se sistemi i drejtësisë penale të Shqipërisë nuk është ende aq i fortë dhe i pavarur sa të japë drejtësi në kohën e duhur për çështje si kjo dhe se mbetet shumë për të bërë që të plotësohen standardet evropiane në këtë fushë.



## 2. Çështja e Avokatit<sup>303</sup>

Më 12 shtator 2005, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë mori vendim për një çështje në të cilën kundër një avokati mbrojtës ishte ngritur akuza “korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, në përputhje me nenin 259 të Kodit Penal.<sup>304</sup> Avokati mbrojtës (më poshtë i quajtur Avokati) u deklarua i pafajshëm dhe sipas vendimit të gjykatës klientët e tij, ose më saktë prindërit e klientit të tij, me dëshirën e tyre, i kishin dhënë një shumë prej rreth 6 000 eurosh, por më vonë, ai e kishte kthyer mbrapsht këtë shumë.<sup>305</sup> Hetimi i çështjes nisi pas transmetimit në programin televiziv *Fiks Fare* të një bashkëbisedimi midis Avokatit dhe nënës së njërit prej klientëve të tij, ku Avokati shpjegonte si i kishte ofruar gjyqtarit 6 000 euro. Vendimi ngre disa shqetësime.

### *Procesi gjyqësor*

*Zhvillimi i seancave gjyqësore* – Procesi gjyqësor nisi në mars të vitit 2005. Nga 20 seanca të planifikuara për t’u zhvilluar në korrik, përpara pushimeve të verës, u zhvillua vetëm një numër i vogël prej tyre. Arsyeja përse nuk u zhvilluan seancat e tjera ishte kryesisht se prokurori ose kërkonte të shtyhej seanca për t’u përgatitur ose thjesht nuk paraqitej. Kështu, një seancë u shty për shkak të mungesës së të pandehurit ndërsa dy të tjerat u shtynë që prokurori të paraqiste kërkesat paraprake dhe provat me shkrim. Pas kësaj, një seancë u shty për shkak të mungesës së avokatit mbrojtës, katër seanca u shtynë për shkak të mungesës së dëshmitarëve dhe tri seanca u shtynë sepse trupi gjykues nuk ishte i plotë. Më pas, më 28 qershor pasi u paraqitën të gjitha provat, seanca u shty në mënyrë që palët të përgatisnin konkluzionet e tyre përfundimtare. Më tej u shtynë edhe pesë seanca të tjera; tri u shtynë sepse prokurori nuk kishte përgatitur konkluzionet e tij përfundimtare dhe dy u shtynë sepse prokurori nuk u paraqit. Asnjë arsye nuk u dha për mungesën e prokurorit dhe asnjë masë nuk u mor për të siguruar që gjykimi të përfundonte brenda një afati të arsyeshëm kohor. Në fakt, në disa raste përpara fillimit të seancave, prokurori rrinte në zyrën e kryegjyqtarit, ku zhvillohej pjesa më e madhe e seancave. Duke marrë parasysh veçantitë e çështjes dhe nocionin që “*drejtësia jo vetëm duhet dhënë, por edhe duhet të duket që jepet*”, kjo lloj sjelljeje si nga gjykata ashtu edhe nga prokuroria ngre shqetësime serioze në lidhje me trajtimin e kësaj çështjeje të veçantë. Më në fund, më 12 shtator 2005 u dha vendimi. Ky vendim nuk u rrëzua nga gjykata e apelit.

*Aspekte të tjerë procedurale* – Duke qenë se një vepër penale sipas nenit 259 të KP mund të dënohet me gjobë apo me burgim deri në tetë vjet, çështja duhet gjykuar me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë.<sup>306</sup> Megjithatë, seanca ku dëshmoi babai i klientit u

<sup>303</sup> Pjesë e këtij kapitulli është botuar edhe më parë, në një version të shkurtuar, në revistën gjashtëmujore *Studime juridike* (Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë), Nr. 2, 2005.

<sup>304</sup> “Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimiti i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga personi që ushtron funksione publike, për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet dhe me gjobë nga pesëqind mijë deri në tre milionë lekë”.

<sup>305</sup> Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Akt Nr. 719, Vendimi Nr. 858.

<sup>306</sup> KPrP, neni 13 paragrafi 3

drejtua nga një gjyqtar i vetëm, ndërsa seanca ku dëshmuar kolegët e Avokatit u drejtua nga një trup gjykues i përbërë nga tre gjyqtarë. Kjo padyshim nuk është pasqyruar në vendimin përfundimtar. Gjithsesi, përbën një gabim i rëndë procedural dhe si rrjedhim, vendimi duhet të jetë i pavlefshëm.<sup>307</sup>

#### *Vendimi i gjykatës*

Përveç se përmend cilësimin ligjor të veprës penale, pra korrupsion pasiv i ushtruar nga persona që ushtrojnë funksione publike, vendimi në çështjen e Avokatit nuk shpjegon shkakun e akuzës ose faktet që përbëjnë veprën penale.<sup>308</sup> Kështu, mungon një prej aspekteve më kryesore të vendimit përfundimtar dhe nuk është e qartë se cila ishte “çështja” që u shtrua gjykatës. Për rrjedhojë, nuk mund të arrihet asnjë përfundim edhe po të ishte e mundur që fakteve t’u jepej një cilësim tjetër ligjor.

Programi televiziv që u bë shkas për fillimin e hetimit penal as nuk u soll si provë dhe as nuk u përmend gjatë gjykimit. Dëshmitë e nënës dhe babait të klientit nuk janë paraqitur në mënyrë të saktë në vendimin e gjykatës. Në vendim thuhet se prindërit e klientit dëshmuar që i pandehuri nuk u kishte kërkuar atyre të holla, por ata ia kishin dhënë vetë me dëshirën e tyre. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri nuk ishte e pranishme në seancën ku u dëgjua dëshmia e nënës, kurse seanca ku dëshmoi babai i klientit u vëzhgua. Ai as nuk u pyet nëse Avokati kishte kërkuar të holla dhe as ai nuk e përmendi këtë çështje. Gjithsesi, ai tha se Avokati në disa raste u kishte thënë prindërve: “*gjyqtari e ka ngritur ‘shpatën’ paksa lart*”, “*Unë i kam ofruar gjyqtarit 6 000 euro*” dhe “*në mbrëmje vonë ne [avokati dhe gjyqtari] ramë dakord; të nesërmen e ndryshoi vendimin.*” Babai i klientit nuk u pyet nëse këto i kishte dëgjuar vetë apo ia kishte thënë bashkëshortja e tij. Në vendim nuk paraqitet asgjë nga këto. Gjyqtari që gjykoi çështjen ku ishte i përfshirë Avokati i klientit, nuk dëshmoi në gjyq, por dëshmia e tij e dhënë gjatë hetimeve paraprake u lexua pasi gjyqtari deklaroi se ishte sëmurë. As ky fakt nuk është pasqyruar në vendim. Duke marrë parasysh faktin se gjyqtari duket të ketë pasur probleme të përkohshme me shëndetin, është e diskutueshme nëse deklarata e tij gjatë hetimit duhej pranuar si provë.<sup>309</sup> Për më tepër, dëshmia e gjyqtarit dëshmitar gjatë hetimeve paraprake ku ai deklaroi se atij nuk i janë ofruar të holla nga i pandehuri apo nuk e ka diskutuar këtë çështje me të, konsiderohet e mjaftueshme për të provuar se i pandehuri nuk i ka thënë familjes së klientit të tij që gjyqtari kishte kërkuar të holla! Më e rëndësishme është se nuk vihet në diskutim që gjyqtari në fjalë mund të ketë pasur interes vetjak për të mos u implikuar në këtë çështje dhe se duke deklaruar ndryshe, gjyqtari do të inkriminonte veten e tij. Kështu, gjykata arriti në përfundimin se avokatit iu dhanë 6 000 euro pa përfshirjen e avokatit, dhe në shkëmbim të shërbimeve të tij si avokat mbrojtës i djalit të tyre.

<sup>307</sup> KPrP, neni 128, paragrafi 1 a.

<sup>308</sup> Për shembull: Në një datë të caktuar në zyrën e tij në Tiranë, Avokati X, i cili ushtron funksion publik kërkoj dhe mori 6 000 euro nga Y për të kryer apo për të mos kryer diçka që kishte të bënte me detyrën apo funksionin e tij. Shih gjithashtu edhe diskutimin më tutje në këtë kapitull në lidhje me formulimin e akuzave.

<sup>309</sup> KPrP, neni 369, shih gjithashtu nenin 364 në lidhje me mundësinë e pyetjes në shtëpi të dëshmitarëve.

*Funksioni publik*

Është gjithashtu shqetësuese që avokati akuzohet si *person* “që ushtron funksion publik” për veprime të lidhura me rolin e tij si avokat mbrojtës, por vendimi nuk diskuton nëse mund të ngrihet akuzë ndaj një avokati në bazë të këtij neni të Kodit Penal.

Ndonëse nuk ekziston një përkufizim botërisht i pranuar për funksionin publik, nëpunësin publik, ose postin publik, në përgjithësi kuptohet se termi i referohet aktiviteteve të lidhura me shtetin ose sovranin. Përkufizimi i këtyre termave ka një rëndësi thelbësore kur përcaktohet se kur shteti ose nëpunësit e tij mbajnë përgjegjësi penale ose ekonomike.

Fjalori i gjuhës shqipe bën këtë përcaktim për termin “publik”: “që i përket të gjithë popullit, që është i hapur për të gjithë, i të gjithëve; që lidhet me jetën me punën a me veprimtarinë e të gjithëve; që i shërben gjithë popullit; që mund ta përdorë kushdo; që administrohet nga shteti, i shtetit.”<sup>310</sup> Fjalori i gjuhës angleze në internet bën këtë përcaktim “i/e ekspozuar ndaj pikëpamjes së përgjithshme, i/e lidhur me të gjithë njerëzit, ose që ndikon të gjithë njerëzit, ose të gjithë zonën e një kombi apo shteti; i/e një qeverie ose në lidhje me një qeveri; i/e në shërbim të komunitetit ose kombit, ose lidhur me këtë shërbim; i/e njerëzve në përgjithësi ose lidhur me ta.”<sup>311</sup> Për sa i përket konceptit ligjor më specifik “funksion publik”, Fjalori i terminologjisë ligjore *Black’s Law Dictionary* përcakton si karakteristika themelore:

(1) autoritet i dhënë me ligj, (2) qëndrim për një kohë të caktuar në detyrë, dhe (3) autoritet për të ushtruar një pjesë të funksioneve sovraane të qeverisë; element kyç i një testimi të tillë është se ‘nëpunësi’ ushtron pushtet sovran. Elementet thelbësore për të përcaktuar pozicionin publik si ‘post zyrtar’ janë: pozicioni duhet të krijohet nga Kushtetuta, organi ligjvënës, ose nëpërmjet autoritetit të dhënë nga organi ligjvënës, një pjesë e pushtetit sovran të qeverisë duhet t’i delegohet pozicionit; detyrat dhe pushteti duhet të përcaktohen drejtpërdrejt ose menjëherë, nga organi ligjvënës ose nëpërmjet autoritetit të organit ligjvënës, detyrat duhet të kryhen në mënyrë të pavarur, jashtë ndonjë kontrolli tjetër më të lartë përveç ligjit, dhe posti duhet të ketë qëndrueshmëri dhe vazhdimësi.

‘Nëpunësi publik’ përcaktohet: person, i cili, pasi bën betimin, merr për një periudhë të caktuar detyrën e quajtur post, ku ai ose ajo ushtron me të drejtën e tij/të saj disa prej attributeve të sovranit, shërben për të mirën e publikut; person që ushtron funksion publik, ndonëse jo të gjithë personat e punësuar në sektorin publik janë nëpunës publikë, sepse pozicioni i nëpunësit publik kërkon ushtrimin pushtetit të sovranit, qoftë ky i madh apo i vogël.<sup>312</sup>

<sup>310</sup> Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 1998 (fjala: publik).

<sup>311</sup> <http://www.m-w.com/cgi-bin/dictionary?book=Dictionary&va=public> [vizituar më 14 korrik 2006]

<sup>312</sup> *Black’s Law Dictionary* [Fjalori i terminologjisë ligjore *Black’s*], botimi i gjashtë, tek fjalët “public office” dhe “public official”.

Në legjislacionin shqiptar nuk përcaktohen terma të tillë si funksion publik, post publik, detyrë publike, shërbim publik, por p.sh. Kushtetuta i referohet “organeve të pushtetit publik”,<sup>313</sup> gjithashtu mund të përdoren për orientim ligji “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive”<sup>314</sup> dhe ligji “Për shmangien e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”<sup>315</sup>, të cilët janë të zbatueshëm për persona brenda strukturës shtetërore. Nga ana tjetër, ligji “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, thotë shprehimisht se “avokatia është profesion i lirë, i pavarur, i vetërregulluar dhe i vetëdrejtuar.”<sup>316</sup> Sovrani nuk u ka deleguar avokatëve pushtet të pavarur.<sup>317</sup> Kjo duhet krahasuar me noterin publik, i cili është person i autorizuar nga shteti që të legalizojë nënshkrime, të bëjë njoftimin e kujtesje noteriale ose të akteve të tjera jashtëgjyqësore.<sup>318</sup> Sipas një vendimi të Gjykatës Kushtetuese, noterët përcaktohen, të paktën në disa aspekte, si persona që ushtrojnë funksione publike. Vendimi përcakton pushtetin e deleguar të shtetit si element bazë të “funksionit publik” dhe më pas në këtë drejtim, nxjerr në pah dallimet midis noterëve dhe avokatëve.<sup>319</sup>

Duhet parë dhe Kreu VIII i Kodit Penal (KP) i cili trajton krimet kundër autoritetit të shtetit dhe më hollësisht Seksioni I, nenet 235 – 247, dhe Seksioni II, nenet 248 – 260, të cilat trajtojnë përkatësisht “veprat penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga

<sup>313</sup> Kushtetuta e Shqipërisë, neni 15 paragrafi 2.

<sup>314</sup> Ligji Nr. 9049, datë 10 prill 2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa zyrtarëve publikë”, shih nenin 3 “Subjektet që mbartin detyrimin për deklarim”:

..., Presidenti i Republikës, deputetët e Kuvendit, Kryeministri, zëvendëskryeministri, ministrat e zëvendësministrat; nëpunësit civilë të nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues, sipas përcaktimit të nenit 11 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” ; prefektët, kryetarët e këshillave të qarqeve, kryetarët e bashkive, të njëjstive bashkiake dhe të komunave; drejtorët e drejtorive dhe komandantët e Forcave të Armatosura në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Shërbimin Informativ Shtetëror; prokurorët, gjyqtarët dhe përmbaruesit e të gjitha niveleve; drejtuesit e institucioneve të pavarura publike; drejtorët e përgjithshëm, drejtorët e drejtorive dhe shefat e sektorëve, (komisariateve) në qendër, rrethe e rajone, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe asaj të Doganave; anëtarët e inspektoratit të ulët të deklarimit dhe kontrollit të pasurisë; drejtuesit e të gjitha niveleve të strukturave të kthimit e kompensimit të pronave, të privatizimit dhe regjistrimit të pasurisë; drejtuesit e të gjitha niveleve të KRRT-ve; zyrtarët që zgjidhen dhe emërohen nga Kuvendi, Presidenti i Republikës, Kryeministri, ministrat ose personat e barazuar me ta; drejtuesit e shoqërive anonime me pjesëmarrje të kapitalit shtetëror mbi 50 për qind dhe mesatarisht me më shumë se 50 punëtorë; autoritetet që urdhërojnë dhe autorizojnë përdorimin e fondeve publike dhe që i prokurojnë ato; personat që ngarkohen me mbledhjen dhe vjeljen e të ardhurave të buxhetit, qendror e vendor; nëpunësit publikë që mbikëqyrin përdorimin e fondeve publike dhe ata që, sipas ligjit, shqyrtojnë dhe japin licenca.”

<sup>315</sup> Ligji nr. 9367, datë 7 prill 2005, neni 3 dhe 4.

<sup>316</sup> Ligji nr. 9109, datë 17 korrik 2003, “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, neni 1.

<sup>317</sup> Po aty, kapitulli II.

<sup>318</sup> Ligji Nr. 7829, datë 1 qershor 1994, “Për noterin”, shih pjesën II, në veçanti nenet 39 dhe 40.

<sup>319</sup> Vendimi Nr. 3 i Gjykatës Kushtetuese, 2005.

shtetasit” dhe “veprat penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga *punonjësit shtetërorë* ose *në shërbim publik*”. Këto krime shkelin *aktivitetin shtetëror* dhe në seksionin I shkelësit janë *shtetasit e zakonshëm*, ndërsa në seksionin II shkelësit janë *punonjësit shtetërorë* ose *në shërbim publik*.<sup>320</sup> Neni në fjalë, 259, është në Seksionin II dhe pavarësisht nga formulimi i nenit, duhet të ndëshkojë veprimet e *punonjësve shtetërorë* ose *në shërbim publik*.

Shembulli i mësipërm tregon se koncepti në shqip i “post publik” dhe “funksion publik”, nuk ndryshon nga kuptimi i përgjithshëm i këtyre koncepteve; një element kyç i konceptit është ajo që sovrani delegon një pjesë të autoritetit të pavarur vendimmarrës. Për të përfunduar, koncepti se avokati mbrojtës ushtron funksion publik nuk gjen mbështetje as në kuadrin ligjor shqiptar, as në atë ndërkombëtar. Si rrjedhim, është e qartë se akuza ndaj avokatit është e pabazuar. Një akuzë më e përshtatshme mund të ishte bazuar në nenin 245/1 paragrafi 2.<sup>321</sup>

Një shqetësim tjetër i lidhur me konceptin “funksion publik” është fakti se vendimi nuk përmend dhe nuk diskuton nëse avokati ushtron apo jo funksion publik. Në përputhje me parimin *juria novit curia* (gjykata njeh ligjin), mund të pritej se kjo do të ishte çështja e parë për t’u marrë në konsideratë para se të fillonte diskutimi nëse akuzat e paraqitura mbështeteshin apo jo në prova.

### Shqetësime të tjera

*Formulimi i akuzave* – Sipas nenit 383 të KPrP, vendimi i gjykatës përmban akuzën dhe parashtrimin e përmbledhur të rrethanave të faktit dhe provat mbi të cilat bazohet vendimi, si dhe arsyet për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta. Kërkesa për gjykim përmban parashtrimin e faktit, duke treguar nenet përkatëse të Kodit Penal si dhe burimet e provës dhe faktet të cilave ato u referohen.<sup>322</sup> Akuza i referohet krimit për kryerjen e të cilit akuzohet personi, p.sh. vrasje, grabitje. Megjithatë,

<sup>320</sup> Është për t’u theksuar se, për të emërtuar “punonjësit shtetërorë” përdoren shprehje të ndryshme. Ata referohen si *punonjës që kryen një detyrë shtetërore apo një shërbim publik* (nenet 239, 240), *personi që ushtron funksion publik* (neni 244), *personat që ushtrojnë funksione publike* (neni 245/1), *personi që ushtron funksione publike* (neni 248) dhe *personi që ushtron funksione publike* (neni 259).

<sup>321</sup> “Kërkimi, marrja ose pranimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për veten e tij ose për persona të tjerë, duke premtuar ose siguruar aftësinë për të ushtruar ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës nga persona që ushtrojnë funksione publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është kryer ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet dhe me gjobë nga pesëqind mijë deri në dy milionë lekë.”

<sup>322</sup> KPrP, neni 331.

pavarësisht nga cilësimi ligjor, një akuzë penale përmban fakte, d.m.th. *kur, ku, si, kush, çfarë, ...* të cilat së bashku përbëjnë veprën penale dhe mund të përmbliidhen nën elementët e krimit sipas nenit përkatës në ligj.<sup>323</sup>

*Për shembull:*

- Më 3 nëntor 2005, rreth orës 14.00, në Rugën e Durrësit, në Tiranë, XX kreu vrasjen me dashje të personit YY, duke e goditur atë disa herë në kraharor me një mjet me majë, duke i shkaktuar dëme fatale në organet e frymëmarrjes (KP, neni 76).
- Në mbremjen e datës 7 qershor 2005, në afërsi të fshatit Kamëz, XX së bashku me disa persona të pidentifikuar, grabitën me armë 24 pasagjerë dhe shoferin e një autobusi që udhëtonte nga Tirana në Shkodër, duke u marrë sendet personale. Veçanërisht XX, i cili, duke kërcënuar pasagjerët a,b,c,ç,d,dh dhe e se do t'i qëllonte me Kallashnikovin që kishte në dorë, u mori portofolat dhe telefonat celularë, ndërsa pasagjerëve j,k,l,ll,m,n,nj ,o,p,q,r,rr dhe s në të njëjtën mënyrë u mori valixhet ku kishin sende personale, si veshje apo artikuj të higjienës personale (KP, neni 140).
- Në korrik 2004, XX, YY, dhe ZZ, në bashkëpunim me njëri-tjetrin dhe për qëllime përfitimi material, bindën viktimat AA dhe BB të udhëtonin në drejtim të qytetit Bari në Itali, me premtimin se atje do të punonin si kameriere. Në Bari, personave AA dhe BB ua morën dokumentet e udhëtimit dhe u mbajtën të mbyllura në një bar të quajtur Amorina. XX dhe YY, pasi i përdhunuan nën kërcënimin e armës, i detyruan më forcë AA dhe BB të prostituonin në bar çdo natë, përveç ditëve të hëna, gjatë periudhës korrik 2004 dhe mars 2005, kur arritën të arratiseshin. AA dhe BB u detyruan të kryenin marrëdhënie seksuale me mesatarisht pesë klientë brenda një natë. XX, YY ose ZZ gjenin klientët dhe merrnin pagesën, 150 euro për klient (KP, neni 114/b).

Kufizimi i një akuze penale ka rëndësi të veçantë sepse siguron kuadrin e zhvillimit të një procesi gjyqësor. Kështu, prokurori duhet të provojë jo vetëm që është kryer *një* krim nga i pandehuri, por dhe që *ky* krim i veçantë, i përcaktuar në kohë, në vend dhe nga rrethana të tjera specifike, është kryer nga i pandehuri. Nga ana tjetër, i pandehuri do të ndërtojë mbrojtjen duke u mbështetur në bazën ligjore dhe *faktike* të akuzës ndaj tij. Gjykata duhet t'i përgjigjet pyetjes nëse akuza (faktet dhe cilësimi ligjor), e zbrërthyer nga prokurori dhe duke marrë parasysh mbrojtjen e paraqitur, është apo jo e provuar. Gjithashtu, është e nevojshme që gjykata të ketë dijeni për bazën faktike të akuzave në mënyrë që të vlerësojë nëse provat janë të nevojshme.<sup>324</sup> E fundit, por jo më pak e rëndësishme, e drejta për të mos u gjykuar dhe dënuar dy herë varet nga mundësia për të vendosur saktësisht faktin për të cilin gjykohet dhe dënohet personi.<sup>325</sup>

<sup>323</sup> Komisioni Evropian ka bërë një sqarim të kuptimit të nenit 6(3)(a) të Konventës Evropiane e cila garanton të drejtën e një personi të akuzuar për kryerjen e një vepre penale “të informohet menjëherë dhe me detaje në një gjuhë të cilën ai kupton, në lidhje me natyrën dhe shkakun e akuzës ndaj tij”. Komisioni Evropian shpjegon se “natyra” e akuzës i referohet karakterit ligjor ose klasifikimit të fakteve, ndërsa “shkaku i akuzës” i referohet fakteve që përbëjnë bazën e akuzës. Informacioni i dhënë duhet të përmbajë materialin e nevojshëm për t'i mundësuar të akuzuarit të përgatisë mbrojtjen, por jo domosdoshmërisht provat mbi të cilat bazohet akuza. [X kundër Belgjikës, (7628/76), 9 DR 169, 9 maj 1977; Ofner kundër Austrisë, 3 Yearbook 322, 19 dhjetor 1960].

<sup>324</sup> KPrP, neni 357.

<sup>325</sup> Kushtetuta, neni 34; KPrP, neni 7; KEDNJ, protokoll Nr.7, neni 4; Doktrina *res judicata* lidhet me këtë.

Në lidhje me sa u tha më lart është dhe koncepti *jura novit curia*. Pra, sipas nenit 375 të KPrP, me vendim përfundimtar gjykata mund t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori.<sup>326</sup> Megjithatë, në mënyrë që kjo dispozitë të jetë dhe e zbatueshme nga ana praktike duhen specifikuar faktet e akuzës. Këtu duhet theksuar se pas një ndryshimi që iu bë dispozitës në vitin 2002, gjykata nuk është shprehimisht e detyruar të njoftojë palët. Kjo mund të jetë në kundërshtim me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, të paktën sepse ndikon në mundësitë e të pandehurit për të mbrojtur vetveten në mënyrë efikase.<sup>327</sup>

Problemi i akuzave të formuluar keq në çështje penale është një problem i përgjithshëm që në Shqipëri haset si në kërkesat për gjykimin e çështjes, ashtu dhe në vendimet e formës së prerë.<sup>328</sup> Pra, kuptohet se akuzat lidhet vetëm me nenin që përcakton veprën penale në fjalë. Ndërsa vendimet e gjykatave rregullisht përcaktojnë vetëm veprën penale në fjalë, kërkesat për gjykim përmbajnë shpjegime të hollësishme në lidhje me ecurinë e hetimit, tregojnë veprën penale dhe nenin përkatës sipas të cilit akuzohet i pandehuri dhe më pas japin një shpjegim tjetër të gjatë, i cili përfshin një renditje të provave dhe arsyen përse prokurori kërkon shpalljen fajtor të të pandehurit. Nga ky shpjegim, mund ose jo të bëhet i mundur zbulimi i fakteve që përbëjnë veprën penale në fjalë.

Megjithëse në Shqipëri ka studiues të shquar dhe juristë shumë të kualifikuar në fusha të ndryshme, dhe shkollimi ligjor e niveli i sistemit të drejtësisë ka përjetuar përmirësime gjatë viteve të fundit, çështjet e diskutuara më lart janë shqetësuese. Ato tregojnë një nivel të pamjaftueshëm të njohjes së procedurave bazë dhe koncepteve ligjore, si dhe një nivel të pamjaftueshëm të përdorimit të gjuhës ligjore, si në kërkesat për gjykim, ashtu edhe në vendimet e gjykatave, duke reflektuar kështu boshllëqe në shkollimin ligjor në Shqipëri.

<sup>326</sup> Shih dhe Vendim Nr. 50 të Gjykatës Kushtetuese, 30.07.1999.

<sup>327</sup> Çështja “Chichlian dhe Ekindjian kundër Francës”. Raport i Komisionit, 16 mars 1989, Apel Nr. 10959/84.

<sup>328</sup> Fjala angleze “indictment” është e ngjashme me termin në KPrP “kërkesë për gjykimin e çështjes”, KPrP, neni 331.





#### IV. DHUNA NË FAMILJE<sup>329</sup> DHE SISTEMI GJYQËSOR PENAL<sup>330</sup>

*Një rast i dhunës në familje që ndodh rëndom mund të jetë një burrë që godet me shpullë apo i gjuan gruas së tij në fytyrë dhe në pjesët e sipërme të trupit, duke i shkullur flokët, duke e shkundur ndërkohë që e zë për krahësh apo për qafe dhe i gjuan në këmbë dhe në pjesët e poshtme të trupit. Pasoja të këtyre veprimeve janë zakonisht skuqje dhe nxirje në fytyrë, sy të nxirë, gjak nga goja, të nxira që tregojnë shenjat e duarve dhe të gishtërinjve të burrit mbi krahët dhe qafën e gruas, si dhe hematoma të theksuara dhe të fryra në pjesët e poshtme të trupit ku ai i ka gjuajtur me shkelma. Në disa raste rrahja paraprihet nga burri që i drejton armën gruas duke bërëtitur se do ta vrasë. Ndonjëherë ka thjesht kërcënime. Një gjë e tillë mund të ndodhë vetëm një herë në jetë, por mund të jetë edhe diçka që ndodh përditë, madje edhe çdo orë në jetën e miliona grave në të gjithë botën. Ka pastaj edhe raste të tjerë që janë të paimagjinueshme dhe janë shumë herë më keq...Me të drejtë, të jetuarit me dhunë të vazhdueshme në shtëpi është krahasuar me torturën ku sjellja e shkaktoarit ndryshon herë pas here duke kaluar nga dhuna në momente qetësie dhe anasjelltas.<sup>331</sup>*

### 1. Hyrje

- Dhuna ndaj grave përbën shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të grave dhe pengon apo mohon gëzimin e këtyre të drejtave dhe lirive;
- Dhuna ndaj grave është një manifestim i marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të pushtetit midis grave dhe burrave;
- Dhuna kundër grave është një nga mekanizmat shoqëror kyç, me anë të së cilit gratë detyrohen të jenë në një pozicion të nënshtuar në krahasim me burrat.<sup>332</sup>

Dhuna në familje është e përhapur në të gjitha shoqëritë dhe prek të gjitha gratë dhe vajzat e të gjitha moshave, pavarësisht nga pozita, statusi ekonomik dhe statusi social. Ndryshimi nga një vend tek tjetri ka të bëjë me përpjekjet e shtetit për të trajtuar dhe për të eliminuar dhunën ndaj grave.

<sup>329</sup> Termit “*dhuna në familje*” këtu i jepet një përkufizim i ngushtë i cili përcakton dhunën apo kërcënimet për dhunë të ushtruara nga bashkëshorti apo nga ish-bashkëshorti ndaj gruas apo ish-gruas së tij. Kjo do të thotë që përjashtohen nga përkufizimi format e tjera të dhunës brenda familjes, siç janë keqtrajtimi i fëmijës dhe dhuna ndërmjet anëtarëve të së njëjtës familje, përveç burrit dhe gruas, ashtu si edhe akte të tjera të dhunshme siç janë dhunimet e të drejtës së pronësisë dhe të drejtave ekonomike.

<sup>330</sup> Shih gjithashtu edhe studimin për dhunën në familje të përgatitur nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, *Për një zbatim sa më të mirë të ligjit në mbrojtje të viktimave të dhunës në familje nga organet e drejtësisë* (Tiranë: Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, 2005) dhe Trajtesa Juridike dhe Sociale për Mbrojtjen nga dhuna në familje; Botim i posaçëm, përgatitur në bashkëpunim nga revista juridike “Ligji, mundësi zhvillimi për gratë” dhe revista juridiko-shkencore “Jeta juridike” (Tiranë 2005).

<sup>331</sup> Përshkrimi bazohet në përvojën e autores si gjyqtare në Suedi dhe lidhet me çështjet që kanë të bëjnë me dhunën në familje.

<sup>332</sup> Preambula e Deklaratës mbi Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 20 dhjetor 1993 [http://www.unhchr.ch/huridocda/huridocda.nsf/\(Symbol\)/A.RES.48.104.En?Opendocument](http://www.unhchr.ch/huridocda/huridocda.nsf/(Symbol)/A.RES.48.104.En?Opendocument) [vizituar më 24 maj 2006].

Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) u miratua në vitin 1979 dhe Shqipëria e ratifikoi atë më 11 maj 1994.<sup>333</sup> Konventa e përcakton diskriminimin ndaj gruas si:

...çdo dallim, përjashtim, ose kufizim në bazë gjinie që ka për pasojë ose për qëllim të dëmtojë ose zhvlerësojë njohjen, gëzimin, ose ushtrimin nga gruaja, cilado qoftë gjendja e saj martesore, mbi bazën e barazisë së burrit dhe gruas, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në fushat politike, ekonomike, shoqërore, kulturore e civile ose në çdo fushë tjetër.<sup>334</sup>

Ndërkohë që Konventa hyri në fuqi më shpejt se çdo konventë tjetër e miratuar nga Kombet e Bashkuara, kjo konventë është njëkohësisht edhe konventa së cilës iu shtuan më shumë rezerva; do të thotë që shtetet palë kanë rezervuar të drejtën të mos respektojnë një ose më shumë dispozita të konventës. Disa shtete vendosën rezerva për nenin 2 (i cili dënon diskriminimin), megjithëse kushtetutat apo ligjet e tyre vendase e ndalojnë diskriminimin. Kjo do të thotë që të drejtat e njeriut për gratë dhe vajzat ende nuk konsiderohen të vetëkuptueshme dhe të njëjta me ato të burrave. Është gjithashtu për t'u theksuar se vetë Konventa nuk përmend dhunën gjinore apo dhunën në familje, pasi kjo nuk do të ishte pranuar nga shumë shtete. Edhe sot, pas 27 vjetësh, nuk ekziston një dokument ndërkombëtar detyrues që e njeh dhunën në familje si pjesë përbërëse e diskriminimit ndaj grave dhe dhunim i disa të drejtave themelore të njeriut, siç është e drejta e jetës dhe e dinjitetit njerëzor, si dhe e drejta e lirisë nga tortura dhe trajtimi degradues.

*Deklarata kundër dhunës* – Në mënyrë që të trajtonte edhe çështjen e dhunës ndaj grave, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara duke iu referuar CEDAW-t si dhe dokumenteve të tjera, më 20 dhjetor 1993 miratoi Deklaratën mbi Eliminimin e Dhunës ndaj Grave. Deklarata e përcakton dhunën ndaj grave si “çdo veprim dhune bazuar në gjini i cili shkakton apo mund të shkaktojë dëmtime fizike, seksuale apo psikologjike apo vuajtje për gratë duke përfshirë edhe kërcënime për veprime të tilla, shtrëngim apo heqje arbitrare të lirisë, të cilat ndodhin qoftë në publik apo në jetën private.”<sup>335</sup>

*Deklarata parashikon:* <sup>336</sup>

<sup>333</sup> Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 18 dhjetor 1979 dhe hyri në fuqi më 3 shtator 1981, shih <http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/text/econvention.htm#intro> [vizituar më 24 maj 2006].

<sup>334</sup> CEDAW, neni 1, përgatitur nga Chemonics International Inc., dhjetor 2005.

<sup>335</sup> Deklarata mbi Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, neni 2.

<sup>336</sup> Kjo pjesë në tekstin origjinal nuk është me germa të zeza. Këtu është bërë e tillë për ta vënë në dukje.

Neni 2

Dhuna ndaj grave kuptohet si diçka që përfshin këtë që vijon, por nuk kufizohet vetëm në të:

- (a) Dhunë fizike, seksuale apo psikologjike që ndodh në familje, duke përfshirë goditje, abuzim seksual të vajzave në shtëpi, dhunë lidhur me pajën, përdhunim martesor, dëmtim gjenital i femrës dhe praktika të tjera tradicionale të dëmshme për gratë, dhunë jo bashkëshortore dhe dhunë që ka të bëjë me shfrytëzimin;
- (b) Dhunë fizike, seksuale dhe psikologjike që ndodh brenda komunitetit të përgjithshëm, e cila përfshin përdhunimin, abuzimin seksual, ngacmimin dhe kërcënimin seksual në punë, në institucionet arsimore dhe tjetërkund, trafikimin e grave dhe prostitucion të detyruar;
- (c) Dhunë fizike, seksuale dhe psikologjike të kryer apo të falur nga Shteti kudo që ajo ndodh.

Neni 3

Gratë kanë të drejtë të gëzojnë mbrojtje të njëjtë të të gjithë të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në fushën politike, ekonomike, sociale, kulturore, civile apo në fusha të tjera. Në këto të drejta përfshijnë ndër të tjera:

- (a) E drejta për jetën;
- (b) E drejta për barazi;
- (c) E drejta e lirisë dhe sigurisë së personit;
- (d) E drejta për mbrojtje të barabartë nga ligji;
- (e) E drejta për të qenë i lirë nga çdo formë diskriminimi;
- (f) E drejta për të pasur standardin më të lartë të mundshëm në shërbimin mjekësor fizik dhe mendor;
- (g) E drejta për kushte të drejta dhe të favorshme pune;
- (h) E drejta për të mos iu nënshtruar torturës, ose trajtimit apo ndëshkimit mizor, çnjerëzor apo degradues.

Neni 4

Shtetet duhet ta dënojnë dhunën ndaj grave dhe nuk duhet të nxjerrin arsyetime zakonore, tradicionale, apo fetare për të mënjanuar detyrimet e tyre për ta eliminuar atë. Shtetet duhet të marrin menjëherë të gjithë masat e nevojshme për të zbatuar politika për të eliminuar dhunën kundër grave dhe për këtë ata duhet:

...

- (c) Të ushtrojnë kujdesin e duhur për të parandaluar, hetuar dhe, sipas legjislacionit vendas për të dënuar aktet e dhunës kundër grave, qofshin këto akte të shkaktuara nga shteti apo persona privatë;
- (d) Të hartojnë sanksione penale, civile, administrative dhe të punës në legjislacionin vendas për të dënuar dhe për të ndrequr dëmtimet që i shkaktohen grave që janë viktime të dhunës; grave që janë viktime të dhunës u duhet dhënë mundësi të kenë akses në mekanizmat e sistemit gjyqësor dhe sipas legjislacionit vendas të kenë mundësi korrigjimi të drejtë dhe efektiv për dëmtimin që u është shkaktuar; Shtetet gjithashtu duhet të informojnë gratë mbi të drejtat e tyre për të kërkuar rrugëzgjdhje me anë të mekanizmave të tillë;

...

- (h) Të parashikojnë burime të mjaftueshme në buxhetin e qeverisë për veprimtari që lidhen me eliminimin e dhunës ndaj grave;
- (i) Të marrin masa për të garantuar që nëpunësit e policisë dhe nëpunësit publikë përgjegjës për zbatimin e politikave për të parandaluar, hetuar dhe dënuar dhunën kundër grave, të trajnohen për t'u sensibilizuar në lidhje me nevojat e grave;

(j) ...

**(k) Të nxisin punën kërkimore, mbledhjen e të dhënave dhe përpilimin e statistikave në lidhje me përhapjen e formave të dhunës ndaj grave dhe të nxisin punën kërkimore mbi shkaqet, natyrën, rëndësinë dhe pasojat e dhunës ndaj grave si dhe mbi efektivitetin e masave të zbatuara për parandalimin dhe zhdëmtimin e rasteve të dhunës ndaj grave; statistikatat dhe rezultatet e kërkimeve do të bëhen publike;**

...

Ndërkohë që Deklarata nuk ka statusin e një konvente dhe si e tillë nuk është e detyrueshme për shtetet, është një deklaratë e fuqishme dhe paraqet pikëpamjet e pjesës më të madhe, në mos të të gjithë shteteve anëtarë të Kombeve të Bashkuara. Ajo është gjithashtu një mjet i dobishëm për cilindo shtet, i cili kërkon të trajtojë problemet e dhunës në familje dhe çfarëdolloj dhune tjetër ndaj gruas. Përkufizimi i dhunës ndaj gruas u theksua edhe një herë në Programin e Veprimit të miratuar në Konferencën e Katërt Botërore për Gratë, të mbajtur në Pekin nga data 4 deri më datë 15 shtator 1995.<sup>337</sup>

*Strategjitë tip* – Në vitin 1997, Komisioni i Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimit dhe për Drejtësinë Penale, në sesionin e tij të gjashtë në Vjenë, mori masa për të zbatuar Programin e Veprimit të Pekinit brenda fushës së vet të kompetencës dhe miratoi *Strategjitë tip dhe masat praktike për eliminimin e dhunës ndaj grave në fushën e parandalimit të krimit dhe në fushën e drejtësisë penale* (Strategjitë tip). Më vonë këto strategji u miratuan nga Asambleja e Përgjithshme si “Rezoluta mbi masat për parandalimin e krimit dhe për drejtësinë penale për të eliminuar dhunën ndaj grave”.<sup>338</sup> Strategjitë tip janë një sërë strategjish dhe masash të njohura ndërkombëtarisht në fushën e drejtësisë penale për të trajtuar dhunën ndaj grave në të gjitha format e saj.<sup>339</sup> Në bazë të këtyre strategjive, një numër organizmash ndërkombëtare në fushën e drejtësisë penale kanë hartuar Manualin e Burimeve, i cili ofron informacion të përmbledhur mbi përvojën e disa vendeve që kanë zbatuar me sukses Strategjitë tip.<sup>340</sup> Në shkurt të vitit 2006, Parlamenti Evropian miratoi gjithashtu edhe rezolutën mbi *Situatën aktuale në luftën kundër dhunës ndaj grave dhe veprimet në të ardhmen*.<sup>341</sup> Ndër të tjera, rezoluta rekomandon që shtetet të aplikojnë një politikë me tolerancë zero ndaj të gjitha formave të dhunës ndaj grave, të mbledhin të dhëna që janë të krahueshme dhe që përputhen me njëra-tjetrën lidhur me dhunën që ushtrojnë burrat ndaj grave, të garantojnë të drejtat e viktimës për mundësinë për t’u drejtuar organeve

<sup>337</sup> Raporti i Konferencës së Katërt Botërore për Gratë (A/CONF.177/20 dhe Add.1) kapitulli I, rezoluta I, shtojca II.

<sup>338</sup> Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 52/86, 12 dhjetor 1997, <http://www.un.org/ga/documents/gares52/res5286.htm> [vizituar më 24 maj 2006].

<sup>339</sup> Shih [www.icclr.law.ubc.ca](http://www.icclr.law.ubc.ca) [vizituar më 24 maj 2006].

<sup>340</sup> Strategjitë tip dhe Masa Praktike për Eliminimin e Dhunës kundër Grave në fushën e Parandalimit të Krimit dhe Drejtësisë–Manuali i Burimeve, mars 1999 <http://www.icclr.law.ubc.ca/Publications/Reports/VAWMANUA.PDF>.

<sup>341</sup> Rezoluta e Parlamentit Evropian A6-0404/2005, 2 shkurt 2006 [vizituar më 24 maj 2006].

të drejtësisë dhe për zbatim efektiv të tyre, duke përfshirë dispozitat për kompensim, si dhe ato për përjashtimin e intoksikimit si rrethanë lehtësuese.

*Grupi i Punës i Këshillit të Evropës* – Së fundmi, në zbatim të Planit të Veprimit të miratuar në Samitin e Tretë të Krerëve të Shteteve dhe Qeverive të Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës më 16 dhe 17 maj 2005, në vitin 2006 u ngrit një **Grup pune për të luftuar dhunën ndaj grave duke përfshirë dhunën në familje**. Grupi i punës i përbërë prej tetë ekspertësh ndërkombëtarë në fushën e parandalimit dhe luftës kundër dhunës ndaj grave, do të jetë përgjegjës për vlerësimin e përparimit në nivel kombëtar dhe për vendosjen e instrumenteve të matjes së zhvillimeve në nivel mbarë-evropian, me qëllim hartimin e propozimeve për veprim. Grupi i punës do të përgatisë gjithashtu një plan për një fushatë mbarë-evropiane në lidhje me luftën kundër dhunës ndaj grave duke përfshirë dhunën në familje, e cila do të nisë në vitin 2006.

## 2. Konteksti shqiptar

Më 30 mars 2006, *Amnesty International* (AI) botoi një raport mbi dhunën në familje në Shqipëri.<sup>342</sup> Në këtë raport, në Shqipëri ashtu si edhe në të gjithë botën, AI vëren se me mijëra gra janë të rrezikuara nga dhuna prej burrave apo partnerëve të tyre. Ato qëllohen, rrihen, goditen me shpulla e shkelma; disa përdhunohen; disa vriten. Shumë të tjera durojnë dhunën psikologjike, dhe kontrollin ekonomik dhe fizik. AI evidenton pengesat që i ndalojnë gratë për t'u drejtuar drejtësisë, ku përfshihet edhe justifikimi i dhunës si pjesë e “traditës shqiptare”, paaftësia e personave që zbatojnë ligjin t'u përgjigjen siç duhet grave që kërkojnë ndihmë, si dhe paaftësia e sistemit ligjor dhe e gjykatave për ta njohur dhunën kundër grave në familje (dhunën në familje) si veprë penale.

Shqipëria dhe vende të tjera të Ballkanit konsiderohen të kenë një shkallë mesatare të përhapjes së dhunës në familje, që do të thotë se rreth 30% e grave e perceptojnë vetën si viktima të dhunës në familje.<sup>243</sup> Ndërkohë që niveli i dhunës në familje në një vend është padyshim i rëndësishëm, akoma më e rëndësishme është se si e trajton ky vend problemin. Kjo do të thotë: Çfarë mundësish ka një grua që është viktimë e dhunës në familje, të gjejë mbrojtje dhe zgjidhje të përshtatshme kundër dhunës në familje dhe deri në çfarë mase përgjigjen shkaktarët përpara drejtësisë? Në Shqipëri mbetet ende shumë për të bërë në këtë drejtim.

<sup>342</sup> Amnesty International, *Shqipëri: Dhuna kundër grave në familje: “Nuk është turpi i saj”* (Londër, 30 mars 2006) [AI Index: EUR 11/002/2006] <http://web.amnesty.org/library/Index/ENGEUR110022006?open&of=ENG-ALB> [vizituar më 24 maj 2006].

<sup>343</sup> Shih p.sh., një artikull të botuar në Revistën Britanike Mjekësore *British Medical Journal*, të datës 20 korrik 2005, “Spousal Violence Affects One in Three Albanian Wives [Dhuna bashkëshortore prek një në tri gra shqiptare], <http://www.newswise.com/articles/view/513263/> [vizituar më 24 maj 2006].

Çështjet penale që kanë të bëjnë me dhunën në familje në Shqipëri janë të pakta dhe të rralla. Arsyet që jepen për këtë janë të ndryshme, por gjithsesi duket se gjithçka në fund të fundit e ka zanafillën tek mentaliteti i perceptuar patriarkal, i cili ende dominon në shoqërinë shqiptare. Një strategji për ta luftuar këtë mentalitet do të ishte që ligjvënësi dhe autoritetet shqiptare të mbanin një qëndrim të qartë kundër shprehjeve të padëshiruara të këtij mentaliteti, një prej të cilave është dhuna në familje, duke miratuar strategji për t'i trajtuar këto probleme. Megjithatë, përveç komisarariatit të policisë të Shkodrës, i cili duket se është vërtet i angazhuar për të luftuar dhunën në familje, asnjë nga gjykatat, prokuroritë apo drejtoritë e policisë, me të cilat programi për Zhvillimin e një Gjykimi të Drejtë ka qenë në kontakt, nuk ka pasur dhe madje as nuk e ka ndjerë nevojën për të pasur ndonjë strategji të veçantë për çështjen e dhunës në familje. Në fakt shumë prej tyre kanë treguar se dhunën në familje nuk e konsiderojnë një problem të rëndësishëm, i cili kërkon vëmendje të veçantë.

Parimi dominues për trajtimin e çështjeve të dhunës në familje në Shqipëri duket të jetë ai i *pajtim* të palëve.<sup>344</sup> Gjatë një takimi me OJQ-në “Shoqata e Grave me Probleme Sociale” (ShGPS) në Durrës, ku u diskutua për dhunën në familje dhe për çështje të lidhura me të, u ngritën shqetësime në lidhje me praktikën e disa gjyqtarëve për të shtyrë çështjet në mënyrë që të nxisnin gratë të tërhiqnin akuzat. Si pasojë, të tilla tërheqje ndodhin shpesh.<sup>345</sup> Megjithëse në raste të veçanta pajtimi edhe mund të jetë zgjidhja – veçanërisht duke pasur parasysh turpin shoqëror dhe rrethanat e vështira ekonomike që mund të vijnë si pasojë e një divorci në Shqipëri – ai gjithashtu mund ta detyrojë gruan të kthehet përsëri në atë lidhje abuzive dhe nuk e ndëshkon burrin për dhunën e ushtruar ndaj gruas, duke theksuar kështu mentalitetin mbizotërues.

Në janar të vitit 2003, Komiteti i Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave inkurajoi Shqipërinë të ndërmarrë me përparësi masa të gjithanshme për trajtimin e çështjes së dhunës ndaj grave në familje dhe në shoqëri dhe të njohë që kjo dhunë, përfshirë dhunën në familje, përbën një dhunim të të drejtave të njeriut tek gratë. Komisioni i bëri gjithashtu thirrje Shqipërisë që të miratojë ligje për dhunën në familje dhe të garantojë që dhuna ndaj grave të ndiqet dhe të dënohet me seriozitetin dhe shpejtësinë e duhur. Veç kësaj, iu bë thirrje autoriteteve të garantojnë që gratë, viktimat të dhunës në familje, të kenë mjetet për rrugëzgjdhje dhe mbrojtje, duke përfshirë urdhrat mbrojtës dhe mundësinë e marrjes së ndihmës juridike. Komiteti i CEDAW-t rekomandoi gjithashtu që Shqipëria të mbledhë në mënyrë sistematike të dhëna mbi dhunën ndaj grave, duke përfshirë edhe dhunën në familje.<sup>346</sup> Nga ana e autoriteteve shqiptare është ndërmarrë shumë pak apo aspak për sa i përket zbatimit të këtyre rekomandimeve.

<sup>344</sup> Shih diskutimin më tej lidhur me nenin 59 të KPrP dhe përpjekjen për pajtim të parashikuar në nenin 338.

<sup>345</sup> Takim, datë 24 maj 2005.

<sup>346</sup> Raporti i CEDAW-t, sesioni i 28-të, 13-31 janar 2003 (A/58/38), paragrafi 73 <http://daccessdds.un.org/doc/UNDOC/GEN/N03/468/20/PDF/N0346820.pdf?OpenElement> [vizituar më 24 maj 2006].

### 3. Dhuna në familje dhe legjislacioni penal shqiptar

Për qëllime të këtij raporti, termi *dhunë në familje* përkufizohet ngushtë për të treguar dhunën fizike, ku përfshihet edhe vrasja apo kanosje për ushtrim dhune që bashkëshorti apo ish-bashkëshorti ushtron ndaj bashkëshortes apo ish-bashkëshortes. Ndërsa legjislacioni shqiptar është në përgjithësi asnjë në lidhje me gjininë, nuk ka asnjë dispozitë të veçantë që dënon dhunën në familje. Për këtë arsye, aktet e dhunës në familje ndiqen dhe dënohen sipas dispozitave që nuk marrin parasysh marrëdhëniet midis viktimës dhe shkaktarit. Sidoqoftë, marrëdhënia merret parasysh në disa raste kur konsiderohen rrethanat rënduese. Veprimet e përsëritura të dhunës në familje edhe mund të merren parasysh si rrethana rënduese. Përvoja gjithsesi tregon se në praktikë kjo gjë ndodh rrallë.

Tabela e mëposhtme tregon dispozitat penale në Kodin Penal shqiptar që mund të përdoren për të trajtuar rastet e dhunës në familje dhe gamën e dënimeve të parashikuara. Më tej tregon nëse vepra penale ndiqet me iniciativën e prokurorit apo palës së dëmtuar (i dëmtuari akuzues) dhe nëse ndjekja penale varet nga apo jo nga kallëzimi i palës së dëmtuar, çështje të cilat do të trajtohen më tutje në këtë kapitull.

Neni	Vepra Penale	Dënimi	Ndjekja penale
76	Vrasja me dashje	10-20 vjet burgim	Prokuroria <sup>347</sup>
78	Vrasja me paramendim	15-25 vjet burgim	Prokuroria
79 b	Vrasja me dashje për arsye të cilësive të dukshme ose të njohura të viktimës (grua shtatzënë)	Jo më pak se 20 vjet burgim	Prokuroria
82	Vrasja e kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike (shkaktuar nga dhuna apo fyerje e rëndë)	Gjer në 8 vjet burgim	Prokuroria
84	Kanosja(kundërvajtje penale)	Gjobë ose 1 vit burgim	Prokuroria
86	Tortura, çnjerëzore apo poshtëruese	5-10 vjet burgim	Prokuroria
87	Tortura me pasoja të rënda	10-20 vjet burgim	Prokuroria
88	Plagosje e rëndë me dashje (që ka sjellë si pasojë gjymtimin, shëmtimin ose çdo dëmtim tjetër të përhershëm të shëndetit, ndërprerjen e shtatzënisë, ose ka qenë e rrezikshme për jetën në çastin e shkaktimit të saj)	3-10 vjet burgim Kur ka sjellë si pasojë vdekjen: 5-15 vjet burgim	Prokuroria
89	Plagosja e lehtë me dashje (që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se 9 ditë)	Gjobë ose gjer në 2 vjet burgim	<b>Mbi bazën e kallëzimit</b>

<sup>347</sup> Me këtë nënkuptohet që prokurori është i detyruar ta fillojë ndjekjen penale pavarësisht nëse ka kallëzim apo jo.

Neni	Vepra Penale	Dënimi	Ndjekja penale
90	Dëmtime të tjera me dashje (Kundërvajtje penale)	Gjobë <i>Paaftësi për punë deri në 9 ditë</i> : Gjobë ose gjer në 6 muaj burgim	<b>I dëmtuari akuzues</b>
99	Shkaktimi i vetëvrasjes	Gjobë ose gjer në 5 vjet burgim	Prokuroria
102	Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura	3-10 vjet burgim Pasoja të rënda për shëndetin: 5-15 vjet burgim Që shkaktojnë vdekje apo vetëvrasje: 10-20 vjet burgim	<b>Mbi bazën e kallëzimit</b>
104	Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me kërcënim me përdorimin e armës	5-15 vjet burgim	Prokuroria

### 3. 1. Dhuna në familje si vepër penale – analizë

Pika 9 (iv) e Strategjive tip i inkurajon shtetet që sipas kushteve, të nxjerrin dispozita që janë të ngjashme me ato për vepra penale të dhunshme.

#### *Natyrë sistematike dhe përsëritëse e dhunës në familje*

Në shumë martesë, dhuna në familje ndodh në mënyrë të përsëritur dhe gruaja mund të rrihet çdo muaj, javë, ditë, madje edhe çdo orë. Në rastet kur një nga incidentet e dhunshëm shkon në ndjekje penale dhe proces gjyqësor, ky incident mund të jetë i fundit në një varg të pafund veprimesh të dhunshme, që disa herë janë me qindra, që burri ushtron ndaj gruas. Ndërkohë që incidenti i cili më në fund çoi në ndërhyrjen e policisë mund të jetë lehtësisht i identifikueshëm në kohë dhe vend nga ana e viktimës, detajet e sakta dhe dallimet ndërmjet të gjitha incidenteve të tjerë mund të jenë të vështira për viktimën e traumatizuar. Për më tepër, natyra e rregullt dhe sistematike e sulmeve mund të shkaktojë dëmtim më të madh të vetëvlerësimit dhe personalitetit të gruas së dëmtuar, se sa mund të duket nga secili sulm në vetvete. Megjithatë kur kemi të bëjmë me disa vepra penale bashkë, ato normalisht dënohen veçmas dhe përsëritja e tyre përbën rrethanë rënduese, veprat penale lidhur me dhunën në familje, si p.sh., kanosja, plagosje e lehtë me dashje apo dëmtime të tjera me dashje, sipas kodit penal shqiptar kanë një vlerë të ulët penale, dhe është e vështirë të dënohen në masën e duhur sulmet sistematike mbi integritetin dhe vetëvlerësimin e gruas.

Për t'i trajtuar këto probleme, Suedia në vitin 1998 ka parashikuar një vepër të veçantë penale për dhunën në familje. Në Kreun 4, seksioni 4a i kodit penal suedez<sup>348</sup> parashikon:

<sup>348</sup> Kodi penal i Suedisë në anglisht: <http://www.sweden.gov.se/content/1/c6/02/77/77/cb79a8a3.pdf> [vizituar më 24 maj 2006].



Personi që kryen veprat penale të parashikuara në Kreun 3, 4 apo 6<sup>349</sup> kundër një personi tjetër, i cili ka apo ka pasur marrëdhënie të ngushtë me shkakтарin, do të dënohet për *dhunim të rëndë të integritetit* me burgim nga gjashtë muaj deri në gjashtë vjet, nëse aktet e kryera janë pjesë e një dhunimi të përsëritur të integritetit të atij personi dhe e dëmtojnë shumë rëndë vetëbesimin e tij.

Nëse aktet e përshkruara në paragrafin e parë kryhen nga një burrë kundër një gruaje me të cilën ai është apo ka qenë i martuar, apo ka bashkëjetuar në kushte të ngjashme me martesën, ai do të dënohet për *dhunim të rëndë të integritetit të gruas* me të njëjtin dënim.

Paragrafi i parë mbulon dhunën në familje në përgjithësi, ndërsa paragrafi i dytë mbulon dhunën në familje të kryer nga një burrë ndaj gruas me të cilën ai ka apo ka pasur marrëdhënie intime. Dispozita nuk ka për qëllim të trajtojë krimet e rënda, të cilat duhen ndjekur veçmas, ajo trajton rastet e dëmtimeve të lehta apo kanosjeve. Një kusht i nevojshëm gjithsesi, është që *aktet konsiderohen pjesë të një dhunim të përsëritur të integritetit të atij personi dhe që e dëmtojnë shumë rëndë vetëbesimin e këtij personi*. Në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit, gjykatat duhet të kenë parasysh veçanërisht *shpeshësinë dhe natyrën sistematike* të akteve të tilla. Me përfshirjen e kësaj vepre në Kodin Penal, një sërë veprash penale mund të dënohen më rëndë se sa më përpara. Kjo është një mënyrë për të treguar se shteti suedez e trajton seriozisht çështjen e dhunës në familje. Gjykata e Lartë suedeze gjithashtu, në një sërë precedentësh është shprehur që në rastet kur ka një seri veprash penale të ngjashme, kjo mund të shihet si një e tërë ku nuk është e nevojshme që secila nga veprat të përcaktohet sipas vendit dhe kohës së ndodhjes. Pas disa problemesh fillestare që u hasën me zbatimin e saj, dispozita që parashikon veprën e *dhunimit të rëndë të integritetit të gruas* ka rezultuar të jetë një mjet i dobishëm në luftën e shtetit suedez ndaj dhunës në familje.

#### *Vlera penale e “dhunës së përditshme në familje”*

Pika 9(a) në Strategjitë tip i inkurajon shtetet anëtare të garantojnë që dënimi i shkaktarëve të përputhet me objektivat e mëposhtme:

- (i) Të bëjë shkakтарët përgjegjës për veprimet e tyre të dhunës ndaj grave;
- (ii) Të ndalojë sjelljet e dhunshme;
- (iii) Të mbajë parasysh ndikimin që ka mbi viktimat dhe anëtarët e familjes dënimi u dhënë shkakтарëve që janë pjesë e familjes;
- (iv) Të parashikojë sanksione në përputhje me ato të krimeve të tjera të dhunshme.

Nëse i kthehemi edhe njëherë përshkrimit të skenarit tipik të dhunës në familje që jepet në fillim të këtij kapitulli, dëmtimet në shumicën e rasteve janë të tilla që nuk shkaktojnë paaftësi për punë. Për pasojë, shumica e rasteve të dhunës në familje do të klasifikoheshin si *dëmtime të tjera me dashje* sipas nenit 90 të Kodit Penal, që është një kundërvajtje penale e dënueshme vetëm me një gjobë. Nëse rrahja shkakton paaftësi

<sup>349</sup> Kreu 3; krime kundër jetës dhe shëndetit, kreu 4; krime kundër lirisë dhe paqes, kreu 6; krimet seksuale.

të përkohshme për punë deri në 9 ditë, përsëri klasifikohet si kundërvajtje penale e dënueshme me gjobë ose gjer 6 muaj burgim.<sup>350</sup> Nëse ka edhe kanosje, kjo do të çonte në një dënim të kombinuar i cili në shumicën e rasteve nuk është më tepër se disa muaj burgim. Ndërkohë që sulmi i përshkruar mund të mos shkaktojë paaftësi për punë, ai mund të shkaktojë dhembje trupi, hematoma, ënjtje dhe sy të nxirë. Sulmet e përsëritura mund të shkaktojnë gjithashtu çrregullime të stresit post-traumatik dhe dëmtime të riparueshme në vetëvlerësimin e gruas së rrahur.

*Plagosja e lehtë padashje* duhet të shkaktojë normalisht paaftësi për punë për më shumë se 9 ditë, një kohë mjaft e gjatë paaftësie. Raste të kësaj kategorie mund të jenë goditje të rënda të trurit, një apo disa artikulacione të thyera apo dëmtime të tjera serioze që nuk e dëmtojnë në mënyrë të përhershme shëndetin e personit. Këto vepra penale janë të dënueshme me gjobë apo deri në dy vjet burgim.

Pra, mund të arrihet në përfundim se si “dhuna e përditshme në familje” ashtu edhe rastet më të rënda të dhunës në familje kanë një vlerë shumë të ulët penale në Shqipëri. Nga njëra anë, dhuna sistematike dhe e përsëritur në familje për një kohë të gjatë konsiderohet nganjëherë si rrethanë lehtësuese në rastet kur gratë vrasin burrat e tyre, nga ana tjetër një kronologji e dhunës në familje nuk konsiderohet si rrethanë rënduese në rastet kur burrat akuzohen për veprime të dhunës në familje ndaj grave. Në fakt, në asnjë nga vendimet e gjyqësore për çështje të dhunës në familje që janë studiuar gjatë Programit për Zhvillimin e një Gjykimi të Drejtë, nuk diskutohet nëse ka pasur precedent të dhunës në familje.

### *Tortura*

Legjislacioni penal shqiptar, ashtu si edhe për vepra të tjera penale, nuk përcakton elementet e veprës penale të torturës. Neni përkatës thjesht parashikon që tortura dhe trajtime të tjera degraduese dhe çnjerëzore janë të dënueshme me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.<sup>351</sup> Neni i kodit penal shqiptar për torturën nuk është zbatuar për asnjë rast të dhunës në familje. Me torturë kuptohen normalisht veprimet që ndërmerren nga shteti apo në emër të shtetit për qëllime të caktuara dhe jo veprime të dhunës në familje. Megjithatë, duke pasur parasysh natyrën sistematike dhe të rëndë të dhunës në familje në disa raste, është diskutuar që dhuna në familje në këto raste të konsiderohet njësoj si tortura. Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Torturës, ku Shqipëria është shtet palë, e përcakton torturën si më poshtë:

<sup>350</sup> Është për t'u përmendur që në Komentarin e Kodit Penal nuk komentohet dallimi midis paragrafit të parë dhe të dytë të nenit 90. Paragrafi i dytë i nenit 90 komentohet vetëm në lidhje me nenin 89, d.m.th., vetëm nëse dhuna shkakton 9 ditë paaftësi për punë apo shkakton paaftësi më të gjatë. Në fakt, komenti i referohet më shumë termit “plagosje” sesa termi “rrahje” sikur paragrafi i dytë i nenit 90 të ishte pjesë e nenit 89 dhe jo e nenit 90. Ndërkohë që do të kishte më tepër kuptim të përfshihej paragrafi i dytë i nenit 90 në nenin 89 – *për të krijuar dy shkallë të plagosjes së lehtë me dashje* – gjithsesi kjo nuk është mënyra se si e ka zgjidhur çështjen ligjberësi. *Shih* Ismet Elezi, *E drejta penale: pjesa e posaçme* (Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Universitar, 2002), fq. 80.

<sup>351</sup> Duhet theksuar se në legjislacionin shqiptar, duket se tortura merret si veprim i një niveli mesatar.

Në kuptimin e kësaj Konvente, me termin “torturë” kuptohet çdo veprim, me anën e të cilit një personi i janë shkaktuar me dashje, dhembje ose vuajtje të rënda, fizike ose mendore, me synim për të marrë prej tij ose prej një tjetri informata ose pohime, për ta ndëshkuar për një veprim që ai ka kryer ose dyshohet që e ka kryer, për ta frikësuar atë ose për të bërë presion mbi një person tjetër, ose për çdo motiv tjetër të bazuar në një formë të çfarëdollojshme, kur një dhimbje e tillë ose vuajtje të tilla është shkaktuar nga një person zyrtar ose nga çdo person tjetër që vepron me një post zyrtar ose me nxitjen e tij ose me miratimin e tij të shprehur ose të heshtur. Ky term nuk përfshin dhimbjen ose vuajtjet, që janë pasojë vetëm e sanksioneve të ligjshme, që janë pjesë e pandarë e këtyre sanksioneve ose janë shkaktuar prej tyre.<sup>352</sup>

Në raportin e saj për Komisionin e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut në vitin 1996, Raportuesja Speciale e Kombeve të Bashkuara për dhunën ndaj grave e krahasoi dhunën ndaj grave në familje me torturën, duke përfshirë edhe dhunën e përdorur si mjet kontrolli dhe ndëshkimi. Ajo argumenton si më poshtë:

Sikurse tortura, dhuna në familje përfshin rëndom disa forma të vuajtjes fizike dhe/ose psikologjike, ku përfshihet edhe vdekja në disa raste. Së dyti, dhuna në familje, ashtu si edhe tortura, është një sjellje e qëllimshme që shkaktohet me dashje. Burrat që rrahin gratë partnere të tyre, i kontrollojnë impulset e tyre në vende të tjera dhe shënjestra shpeshherë kufizohet tek partneret e tyre apo fëmijët. Së treti, dhuna në familje në përgjithësi ushtrohet për qëllime të caktuara siç janë: dënimi, kërcënimi dhe ulja e personalitetit të gruas. Së fundi, ashtu si edhe tortura, dhuna në familje ndodh të paktën me përfshirjen e heshtur të shtetit, nëse shteti nuk ushtron kujdesin e duhur dhe nuk siguron mbrojtje të barabartë në parandalimin e abuzimit në familje. Ky argumentim pretendon që si e tillë, dhuna në familje mund të kuptohet si një formë torture.<sup>353</sup>

<sup>352</sup> Konventa kundër Torturës dhe Dënimeve a Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Degraduese, miratuar në Nju Jork më 10 dhjetor 1984, <http://www.ohchr.org/english/law/cat.htm> [vizituar më 24 maj 2006]

<sup>353</sup> Radhika Coomaraswamy, Raporti i Reporteres Speciale për Dhunën kundër Grave, shkaqet dhe pasojat e saj, 6 shkurt 1996, E/CN.4/1996/53, paragrafët 42-50, <http://www.unhcr.ch/Huridocda/Huridoca.nsf/TestFrame/c41d8f479a2e9757802566d6004c72ab?Opendocument> [vizituar më 24 maj 2006].

#### 4. Ndjekja penale e çështjeve që kanë të bëjnë me dhunën në familje

Strategjitë tip, paragrafi 7(b), nxisin shtetet të rishikojnë, vlerësojnë dhe redaktojnë procedurën penale në mënyrë të tillë që përgjegjësia kryesore për fillimin e ndjekjes penale të mos qëndrojë tek gruaja e dhunuar. Manuali kryesor shpjegon arsyet si më poshtë:

Në të kaluarën dhe ende në shumë legjislacione, veprimet e dhunshme ndaj grave trajtohen si çështje private. Kjo praktikë ndryshon nga trajtimi i veprave të tjera penale, që konsiderohen të jenë një shqetësim i mjaftueshëm për shtetin që të fillojë ndjekjen penale, në emër të viktimës dhe gjithë shoqërisë. Pjesërisht, kjo praktikë e kaluar ishte si përgjigje ndaj traditave lidhur me të drejtat e anëtarëve meshkuj të familjes dhe pronësisë ndaj grave. Ajo gjithashtu pasqyrore faktin se gratë, veçanërisht në situata familjare, shpesh hezitojnë të bashkëpunojnë nëse shohin partnerët e tyre të ndiqen penalisht e të futen në burg. Vendosja e përgjegjësisë për të proceduar tërësisht tek prokurori, synon ta mbrojë viktimën nga hakmarrja e autorit të dhunës duke i hequr viktimës të drejtën të vendosë për ngarkimin ose përjashtimin nga përgjegjësia penale. Është e rëndësishme, se kur procedohet kundër dëshirës së viktimës, kësaj të fundit t'i jepet ndihma e duhur dhe nëpunësit e policisë dhe prokurorët të jenë të trajnuar mirë në lidhje me natyrën dhe dinamikën e kësaj lloji dhune. Sidoqoftë, duhet të pranohet gjithashtu se suksesi i këtij qëndrimi mund të varet kryesisht nga aftësia e prokurorëve për të siguruar prova të tjera për veprën penale, pavarësisht nga dëshmia e viktimës.

*I dëmtuari akuzues* – Shumica e veprave penale në Shqipëri varen ekskluzivisht nga kallëzimi i palës së dëmtuar. Neni 59 i KPrP parashikon:

1. Ai që është dëmtuar nga veprat penale të parashikuara nga nenet 90, 91, 92, 112, paragrafi i parë, 119, 120, 121, 122, 125, 127, 148, 149 dhe 254 të Kodit Penal ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit.
2. Prokurori merr pjesë në gjykimin e këtyre çështjeve dhe, sipas rastit, kërkon dënimin e të pandehurit ose pafajësinë e tij.
3. Nëse i dëmtuari akuzues ose avokati i caktuar prej tij nuk paraqiten në seancën gjyqësore pa arsye, gjykata pushon çështjen.

Në bazë të paragrafit 1, duke marrë parasysh se viktimat kanë “të drejtë t’i drejtohen gjykatës dhe të marrin pjesë në gjykim” jep përshtypjen se këto çështje duhet të jenë në vartësi të prokurorisë, paragrafi 2 dhe 3 e bën të qartë se nuk kemi të bëjmë me këtë rast. Kjo konfirmohet gjithashtu nga Komentari i KPrP, që u referohet këtyre veprave penale si “vepra më pak të rëndësishme” dhe shpjegon se “njohja e akuzës mbi bazën e kallëzimit në Kodin e ri të Procedurës Penale është një zgjidhje e drejtë që do të ndihmojë në rritjen e efektivitetit të procedimit penal dhe në parandalimin e kriminalitetit.”<sup>354</sup>

Si rrjedhim, në këto raste nuk ka *hetime paraprahe* dhe përgjegjësia për të mbledhur prova bie tërësisht mbi të dëmtuarin akuzues. Prokurori merr pjesë në gjykim dhe

<sup>354</sup> Komentari i KPrP, fq. 141.

propozon masën e dënimit që duhet zbatuar. Më tej, gjykata është e detyruar ta caktojë seancën dhe t'u propozojë palëve zgjidhjen e çështjes me pajtim.<sup>355</sup>

Veprat penale të përmendura në nenin 59 janë:

Neni	Veprat penale
90	Dëmtime të tjera me dashje
91	Plagosja e rëndë nga pakujdesia
92	Plagosja e lehtë nga pakujdesia
112 para. 1	Dhunimi i banesës
119	Fyerja
120	Shpifja
121	Ndërhyrje të padrejta në jetën private
122	Përhapja e sekreteve vetjake
125	Mosdhënia e mjeteve për jetesë
127	Marrja e padrejtë e fëmijës
148	Botimi i veprës së tjetrit me emrin e vet
149	Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit
254	Shkelja e paprekshmërisë së banesës

Me përjashtim të veprave penale të kryera nga pakujdesia, e vetmja vepër që prek integritetin fizik të një personi i cili përfshihet në këtë grup veprash penale ekskluzivisht nën ndjekjen nga i dëmtuari akuzues është rrjedhimisht ajo që njihet si lloji më i zakonshëm i dhunës në familje, d.m.th, *dëmtime të tjera me dashje*.<sup>356</sup>

#### **Shembull – Mundësia për drejtësi për gratë, viktimat të dhunës në familje**

*Çështja nr. 16*<sup>357</sup>

Çështja ka të bëjë me një burrë të akuzuar për *dëme të tjera me dashje* dhe *dhunim të banesës*. Akuzat ishin bërë nga ish-bashkëshortja e të pandehurit. Në bazë të vendimit të gjykatës, i pandehuri u lirua nga burgu më 21 prill 2005, pas vuajtjes së dënimit për armëmbajtje pa leje. Palët ishin divorcuar para marrjes së dënimit dhe, në përputhje me marrëveshjen, e ndanë banesën e tyre në mënyrë të barabartë ndërmjet tyre.<sup>358</sup> Pas lirim të tij, i pandehuri shkoi në banesën e tyre. Sipas bashkëshortes së tij, d.m.th, e dëmtuara akuzuese, i pandehuri nuk pranoi të largohej nga shtëpia dhe e qëlloi të shoqen në fytyrë e në trup. Më pas, ajo paditi sërish në gjykatë ish-bashkëshortin e saj. Duke iu referuar faktit se nuk u paraqit as raport ekspertimi mjeko-ligjor për të provuar dëmtimet dhe as ndonjë dokumentacion për të vërtetuar pronësinë ligjore mbi shtëpinë nga i dëmtuari akuzues, çështja u pushua [padrejtësisht].

*Koment* – Duke supozuar se gruaja/e dëmtuara akuzuese tha të vërtetën kur e deklaroi dhunën që kishte pësuar, e vetmja arsye pse autori i dhunës nuk u soll para drejtësisë ishte mungesa e provave mbështetëse; në këtë rast kjo do të thotë një deklaratë mjekësore dhe/ose fotografi. Ndonëse kjo lloj prove mund të duket e qartë për një prokuror ose avokat mbrojtës, dhe merret lehtë, mund të duket si vështirësi e pakapërcyeshme për një person

<sup>355</sup> KPrP, neni 338.

<sup>356</sup> KP, neni 90.

<sup>357</sup> Shih Dhunën në familje – Shtojca 1.

<sup>358</sup> Nga vendimi nuk është e qartë nëse ish-bashkëshortët e ndanin bashkë shtëpinë.

pa kualifikim ose këshillim ligjor. Rezultati në këtë rast ishte që gruaja u la pa zgjidhje ligjore dhe autori i veprës penale mbeti pa u ndëshkuar për dhunën që ushtroi ndaj ish-bashkëshortes së tij. Kjo nuk do të thotë që autorët e supozuar të dhunës në familje duhet të deklarohen fajtorë pa prova; është një argument që të gjitha veprat penale lidhur me dhunën në familje të ndiqen nga prokuroria për të siguruar që këto krime të hetohen dhe ndiqen penalisht ashtu si duhet.

*Pushimi i padrejtë i çështjes* – Mungesa e provave nuk është arsye për pushimin e çështjes, por për deklarimin e të pandehurit të *pafajshëm*.<sup>359</sup> Pushimi i çështjes në një situatë ku nuk ka prova të mjaftueshme shkel prezumimin i pafajësisë dhe, duke marrë parasysh se procedimet në teori mund të rifillojnë me daljen e një prove të re, e drejta e të pandehurit për të pasur një vendim për çdo akuzë penale brenda një kohe të arsyeshme.<sup>360</sup>

*Ndjekja penale në varësi të kallëzimit* – Për një numër veprash të tjera penale, ndjekja penale mund të fillojë me kallëzimin e të dëmtuarit. Neni 284, paragrafi 1, i KPrP parashikon:

Për veprat penale të parashikuara nga nenet 89, 102, paragrafi i parë, 105, 106, 130, 239, 240, 241, 243, 264, 275 dhe 318 të Kodit Penal, ndjekja penale mund të fillojë vetëm me ankimin e të dëmtuarit, i cili mund ta tërheqë atë në çdo faze të procedimit.

Veprat Penale janë:

Neni	Vepra Penale
89	Plagosja e lehtë me dashje
102 para.	Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura
105	Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën
106	Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari
130	Shtërngimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesë
239	Fyerja për shkak të detyrës
240	Shpifja për shkak të detyrës
241	Shpifja ndaj Presidentit të Republikës
243	Goditjet ndaj pjesëtarëve të familjes së personit që kryen një detyrë shtetërore
264	Detyrimi për të marrë pjesë ose jo në grevë
275	Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike
318	Fyerja e gjyqtarit

Siç shihet edhe nga tabela, në dy prej dispozitave penale më të zakonshme në çështjet e dhunës në familje, d.m.th, plagosje e lehtë me dashje dhe përdhunim, ndjekja penale varet nga kallëzimi i gruas viktimë e dhunës. Përveç rastit kur ndjekja penale për çështje të dhunës në familje sjell për pasojë vdekjen, çështjet e tjera që lidhen me torturën, plagosjen e rëndë me dashje, kanosjen dhe përdhunim nën kërcënim të përdorimit të armës, varen tërësisht nga kallëzimi i gruas.

<sup>359</sup> KPrP, neni 387.

<sup>360</sup> KEDNj, neni 6 (1).

Një pasojë e dispozitave të mësipërme është se sipas skenarit të *dhunës së përditshme në familje* të përshkruar në fillim të këtij kapitulli, gruaja mban barrën e dërgimit të çështjes në gjykatë, e mbledhjes së provave, e kalimit nëpërmjet seancës e pajtimit, dhe e provimit të fajësisë së bashkëshortit. Në raste të tjera, ndjekja penale varet nga bashkëpunimi i saj, edhe pse ajo mund të jetë nën presionin e bashkëshortit dhe të të afërmeve për të tërhequr kallëzimin. Në të dyja rastet, nëse gruaja nuk e ndjek çështjen deri në fund, do të thotë më pak punë për gjykatën dhe prokurorin, dhe një nxitje për këto organe që të përpiqen të bindin gruan të pajtohet me bashkëshortin ose ta tërheqë kallëzimin. Nuk është çudi që duke pasur parasysh këto raste, çështjet penale lidhur me dhunën në familje në Shqipëri janë të pakta dhe të rralla. Pa punën dhe mbështetjen e OJF-ve të grave dhe strehëzave në Shqipëri, ato pak raste do të ishin sigurisht edhe më të pakta.

#### *Çështja e XX*<sup>361</sup>

Sipas XX, në korrik 2004, ajo është rrahur dhe keqtrajtuar nga bashkëshorti, në prani të së ëmës së saj. Ajo është rrahur përsëri të nesërmen pasi i ati i saj i kishte kërkuar bashkëshortit të mos e keqtrajtonte më dhe ta lejonte XX të kthehej në shtëpinë e prindërve, gjë të cilën bashkëshorti ia kishte ndaluar. Disa ditë më vonë, XX i kërkoi bashkëshortit një telefon për të folur me familjen e saj. Kjo gjë iu mohua me arsyen se ajo nuk mund të dilte nga shtëpia pa iu shëruar plagët. Më vonë, po atë ditë, XX arriti të largohej dhe të merrte mjekim. Një ditë më pas, plagët e saj u fotografuan. Sipas XX, arsyeja e keqtrajtimit ishte se ajo kishte refuzuar të pranonte kërkesën e bashkëshortit të saj për divorc. Megjithatë, në vend që të ankohej tek autoritetet përkatëse për dhunën e ushtruar, familja e XX ia mbushi mendjen asaj se ata duhej ta zgjidhnin vetë konfliktin mes tyre. Në tetor bashkëshorti paraqiti në gjykatë kërkesën për zgjidhjen e martesës. Zgjidhja e martesës u dha në nëntor dhe një javë më pas, XX denoncoi bashkëshortin e saj në prokurori për *heqje të paligjshme të lirisë*<sup>362</sup> dhe *plagosje të lehtë me dashje*.<sup>363</sup> Denoncimi e saj u shoqëruan me fotografitë, të cilat tregonin plagët e saj. Po atë ditë, kjo prokuroria e transferoi ankesën në një tjetër prokurori.

Në prill 2005, d.m.th, pesë muaj pasi XX kishte paraqitur ankimin, prokuroria e dytë e pushoi çështjen. Lidhur me akuzën për heqjen e paligjshme të lirisë, prokuroria pushoi hetimin e procedimit penal sepse konstatoi se “del qartë që fakti nuk ekzistonte”.<sup>364</sup> Lidhur me ankesën për plagosje të lehtë me dashje, vendimi thotë se veprat penale sipas nenit 90<sup>365</sup> të KP duhet paraqitur një kërkesë në gjykatë sipas nenit 59 të KPrP. Vendimi i prokurorit vazhdonte si më poshtë:

Në lidhje me pretendimet e kallëzueses se ndaj saj është ushtruar dhunë, mund të konsiderojmë deklaratimet e saj si provë. Por këto deklarime mbeten të vetmet prova pasi fotografitë (e sjella prej saj) nuk saktësohen nëse janë bërë në kohën që pretendohet se është ushtruar dhunë....Në mungesë të aktit mjeko-ligjor, mbetemi para dy fakteve që nuk vërtetohen....

<sup>361</sup> Për këtë çështje nuk ka pasur asnjëherë ndonjë vendim gjykatë. Kjo është arsyeja që nuk është përfshirë në studimet e bëra për vendimet e gjykatës për çështjet në lidhje me dhunën në familje.

<sup>362</sup> KP, neni 110.

<sup>363</sup> KP, neni 89.

<sup>364</sup> KPrP, neni 328, paragrafi 1.

<sup>365</sup> Dëmtime të tjera me dashje.

*Komente* – Fotografitë e dorëzuara në prokurori së bashku me ankimin penal tregojnë një grua ndaj së cilës është ushtruar dhunë, që është tipike në rastet e dhunës në familje. Kjo do të thotë, ato tregojnë një sy të nxirë, një fytyrë të mavijosur, hematoma në krahun e djathtë, hematoma në pjesën e sipërme të mesit dhe hematoma në këmbë. **Fotografitë tregojnë pa dyshim se gruaja në foto ka qenë viktimë e dhunës së ushtruar prej dikujt.** Ky “dikush-i” duhet të dalë përpara drejtësisë pavarësisht nga koha e saktë që është kryer vepra penale. Veç kësaj, duket qartë se fotot janë bërë nga dikush, i cili mund të merret si dëshmitar lidhur me kohën kur janë bërë fotografitë, gjendjen e personit në fotografi, etj. Në bazë të fotografive, në një fazë të mëvonshme mund të kërkohej një raport mjekoligjor. Pretendimet e XX po kështu tregojnë se dhuna është ushtruar disa here në prani të nënës së viktimës, e cila mund të thirrej si një tjetër dëshmitare. Pra, duket se bashkë me deklaratimet e XX, duhet të ketë pasur *fakte mëse të mjaftueshme* për të nisur një procedim penal për *plagosje të lehtë me dashje*, në vend të procedimit për *dëme të tjera me dashje*. Argumente të ngjashme mund të ngrihen lidhur me akuzën për heqje të paligjshme të lirisë, d.m.th, prindërit e XX duhet të dëgjoheshin dhe mund të ketë pasur edhe persona të tjerë, të cilët mund të kishin informacion në lidhje me këtë çështje. Si përfundim, mënyra se si ky ankim u trajtua, jep një arsye të fortë për të dyshuar që prokurori bëri gjithçka – bazuar apo jo në ligj – që mund të bënte për të shmangur procedimin penal të çështjes. Mosndjekja e çështjes nga prokuroria duhet të kërkojë sigurisht një shqyrtim të mëtejshëm nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme. Si përfundim, fotografitë tregojnë një person që i është nënshtruar një dhune me pasoja të dukshme. Pavarësisht se sa ditë paaftësie të përkohshme kishte shkaktuar dhuna e vazhdueshme, asnjë shoqëri nuk duhet t’i japë pandëshkueshmëri autorit të kësaj lloji dhune, duke e lënë procedimin penal të varet nga e dëmtuara. Duke vepruar kështu, do t’i lihej një barrë e rëndë të dëmtuarës dhe dërgohen sinjale të gabuara për nivele të pranueshme të dhunës në shoqëri.

## 5. Mundësitë për të kërkuar kompensim në rastin e çështjeve penale

Strategjitë tip, paragrafi 10(c), nxisin shtetet të sigurojnë brenda mundësive që gratë e dhunuara të kompensohen drejtë dhe në kohë përmes procedurave zyrtare dhe jozyrtare për dëmin e shkaktuar, duke përfshirë të drejtën për të kërkuar zhdëmtim ose kompensim nga kundërvajtësit ose shteti.

Viktima e dhunës në familje mund të pësojë forma të ndryshme dëmi. Këtu mund të përfshihen shpenzimet për shtrimin në spital, mjekimin, riaftësimin, dëmin në veshje ose sende të tjera; mund të ketë humbje të të ardhurave, por mbi të gjitha, mund të përjetojë dhimbje dhe vuajtje fizike apo shpirtërore. Një parim ligjor i njohur nga të gjithë është se çdo njeri i cili vuan dëme ose humbje për shkak të veprimeve të qëllimshme ose mosveprimeve të një personi tjetër, ka të drejtë dëmshpërblimi. Dëmshpërblimi synon të kthejë personin e dëmtuar në gjendjen që ishte para shkaktimit të dëmit. Ai shërben gjithashtu për të rikthyer dinjitetin e viktimës. Në familjen ligjore të së drejtës së precedentit (Common Law), kjo fushë e së drejtës quhet “torts” (e drejta mbi dëmin jashtëkontraktor). E drejta mbi dëmin jashtëkontraktor përcakton, midis të tjerave, nëse dëmi që i shkaktohet personit duhet apo nuk duhet të kalojë mbi një person tjetër. Disa nga pasojat e dëmtimeve apo vdekjes, si p.sh., shpenzimet mjekësore, mund të



kompensohen nëpërmjet pagesës së dëmit. Mund të shpaguhet, në pamundësi për të gjetur mënyra më të mira kompensimi, edhe pasojat jomonetare, siç janë dhimbja dhe vuajtja. Rreziku i detyrimit për të paguar për dëme të shkaktuara nga veprat penale mund të shërbejë, përveç ndëshkimit, edhe si faktorë të mëtejshëm parandalues ndaj kryerjes së krimeve kundër personit. Në jurisprudencën e saj, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut u referohet këtyre masave riparuese si “kompensim i drejtë”. Megjithatë kur shtete të ndryshme kanë zhvilluar pikëpamje të ndryshme mbi nivelet e kompensimit, si p.sh., niveli i lartë i shpërblimit në Shtetet e Bashkuara në krahasim me nivelin mjaft të moderuar në Suedi, mundësia e kompensimit të dëmeve të shkaktuara si rezultat i një vepre penale është një pjesë e rëndësishme e çdo sistemi ligjor.

KPrP të Shqipërisë njeh të drejtën e kërimit të kompensimit për çështjet penale sipas neneve 58 dhe 59. Neni 58 parashikon:

1. Personi i dëmtuar nga veprat penale ose trashëgimtarët e tij, kanë të drejtë të kërkojnë procedimin e fajtorit **dhe shpërblimin e dëmit [të shkaktuar]**.
2. Personi i dëmtuar që nuk ka zotësi juridike për të vepruar i ushtron të drejtat që i janë njohur me ligj nëpërmjet përfaqësuesit ligjor të tij.
3. I dëmtuari ka të drejtë të parashtojë kërkesa në organin procedues dhe të kërkojë marrjen e provave. Kur kërkesa e tij nuk pranohet nga prokurori, ai ka të drejtë të ankohet në gjykatë brenda 5 ditëve nga marrja dijani.

Neni 59 është cituar më parë kur është diskutuar ndjekja penale. Ai përsërit mundësinë që pala e dëmtuar të kërkojë dëmshpërblim për dëmin e shkaktuar.

Për dëme materiale, neni 61 parashikon se:

Ai që ka pësuar dëm material nga vepra penale ose trashëgimtarët e tij mund të ngrenë padi civile në procesin penal kundër të pandehurit ose të paditurit civil, për të kërkuar kthimin e pasurisë dhe shpërblimin e dëmit.

Si përfundim, Kodi Civil Shqiptar<sup>366</sup> parashikon se personi i dëmtuar nga vepra penale ka të drejtë të ngrejë padi civile për të kërkuar kompensimin material dhe moral të dëmit.

*Neni 608 i Kodit Civil parashikon:*

Personi që, në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin ose pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar.

Personi që ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj. Dëmi quhet i paligjshëm kur është rrjedhim i shkeljes ose i cenimit të interesave dhe i të drejtave të tjetrit, që mbrohen nga rendi juridik ose nga zakonet e mira.

<sup>366</sup> Ligji nr. 7850, datë 29 korrik 1994, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë.

Neni 625 parashikon se:

Personi që pëson një dëm, të ndryshëm nga ai pasuror, ka të drejtë të kërkojë të shpërblehet kur:

- a) ka pësuar një dëmtim të shëndetit ose është cenuar në nderin e personalitetit të tij;
- b) është fyer kujtimi i një të vdekuri dhe kërkohet nga bashkëshorti me të cilin ka bashkëjetuar deri në ditën e vdekjes ose nga të afërmit e tij deri në shkallën e dytë, përveç kur fyerja është kryer kur i vdekuri ka qenë gjallë dhe i është njohur e drejta shpërblimit të dëmit për fyerjen e bërë.

E drejta e parashikuar në paragrafin e mësipërm është e patrashëgueshme.

Pavarësisht nga këto mundësi për të kërkuar kompensim, kjo fushë e së drejtës duket mjaft e pazhvilluar në Shqipëri. Nuk kishte asnjë pretendim për kompensim në asnjë prej çështjeve penale të ndjekura nga Programi për Zhvillimin e një Gjykimi të Drejtë.

## 6. Studimi i rasteve të dhunës në familje në gjykatat shqiptare

Strategjitë tip, në paragrafin 13, inkurajojnë shtetet dhe aktorët e tjerë që sipas rastit, të zhvillojnë studime të krimit lidhur me natyrën dhe shtrirjen e dhunës ndaj grave dhe të mbledhin informacion mbi bazë gjinore për qëllime analizash dhe përdorimi, bashkë me të dhënat ekzistuese, për të analizuar nevojat, vendimmarrje dhe hartimin e politikave në fushën e parandalimit të krimit dhe në fushën e së drejtës penale, në veçanti lidhur me: format e ndryshme të dhunës ndaj gruas, shkaqet dhe pasojat e saj; marrëdhëniet ndërmjet viktimës dhe kundërvajtësit; dhe përdorimin e armëve të zjarrit, drogës dhe alkoolit në situata të ushtrimit të dhunës në familje. Siç u përmend më sipër, në raportin mbi Shqipërinë në vitin 2003, Komisioni i CEDAW-t i rekomandoi gjithashtu Shqipërisë të mbledhë të dhëna në mënyrë sistematike, për dhunën ndaj grave, duke përfshirë dhunën në familje. Megjithatë, të dhëna të tilla nuk ekzistojnë në Shqipëri.

Në fillim të fazës së dytë të PZhGjD, qëllimi ishte të ndiqeshin, ndër të tjera, çështje që kishin të bënin me dhunën në familje. Megjithatë, siç u përmend më sipër, raste të tilla janë tepër të rralla. Veç kësaj, informacioni për palët e treta varet nga njoftimi që bëhet nga prokurori, gjyqtari ose palët që përfshihen në proces. Prandaj, për të pasur një pamje se si shqyrtohen këto çështje nga sistemi i së drejtës penale, informacioni i mëposhtëm iu kërkua *gjykatave* nëpërmjet zyrave rajonale të OSBE-së:

Si pjesë e fazës së dytë të projektit, kemi si qëllim të trajtojmë çështje që kanë të bëjnë me dhunën në familje në një kuptim të ngushtë të fjalës, p.sh. *raste ku një burrë e ka kërcënuar, keqtrajtuar ose vrarë bashkëshorten ose ish- bashkëshorten e tij.*

Për të kuptuar më mirë se si shqyrtohen çështje të dhunës në familje, siç u përshkrua më sipër, nga gjykatat, ne do të kërkonim bashkëpunimin tuaj për të na siguruar kopje të vendimeve gjyqësore lidhur me rastet e dhunës në familje gjatë tre viteve fundit, d.m.th gjatë 2002, 2003, 2004 dhe 2005.

Ne do të donim të shikonim në mënyrë të veçantë vendime gjyqësore ku *i pandehuri është një person i cili është ose ka qenë i martuar me viktimën.* Ai mund të jetë akuzuar për shembull për veprat penale të parashikuara nga *nenet 76 – 78, 84 – 92 (jo 89/a), 102 ose 110 të Kodit Penal.*

Si përfundim, ne do të kërkonim bashkëpunimin tuaj për të na siguruar kopje të vendimeve gjyqësore në lidhje me rastet kur një grua ka vrarë *bashkëshortin e saj ose ish-bashkëshortin.*

Informacioni i mëposhtëm iu kërkuar Drejtorive të Policisë dhe Prokurorive të të njëjtave rrethe:

Si pjesë e fazës së dytë të projektit, kemi si qëllim të trajtojmë çështje që kanë të bëjnë me dhunën në familje në një kuptim të ngushtë të fjalës, p.sh. *raste ku një burrë e ka kërcënuar, keqtrajtuar ose vrarë bashkëshorten ose ish bashkëshorten e tij.*

Për të kuptuar më mirë se si shqyrtohen çështje të dhunës në familje nga sistemi drejtësisë në përgjithësi, ne po shqyrtojmë ankesat e bëra në polici/prokurori ku *i pandehuri është një person, i cili është ose ka qenë i martuar me viktimën.* Veprat penale mund të jenë parashikuar për shembull sipas *neneve 76 – 78, 84 – 92 (jo 89/a), 102 ose 110 të Kodit Penal...*

Ne jemi të interesuar për ankesat lidhur me rastet kur një grua ka vrarë *bashkëshortin e saj* ose ish-bashkëshortin, meqë ai ka lidhje me keqtrajtimitin që i ka shkaktuar së shoqes më parë.

Për sa i përket asaj që u tha më sipër, ne do të kërkonim bashkëpunimin tuaj për të na siguruar informacion me shkrim në lidhje me:

1. Sa ankime janë regjistruar lidhur me dhunën në familje gjatë tre viteve të fundit, d.m.th., 2002, 2003, 2004 dhe në fund në 2005?
2. Sa nga këto kërkesa ankimore kanë dërguar për ndjekje penale? dhe
3. Sa nga këto kërkesa ankimore janë dërguar për gjykim?
4. Sa nga këto kërkesa ankimore kanë të bëjnë me vrasjen e *bashkëshortit* gjatë së njëjtës periudhë kohe?
5. Cilat ishin arsyet që disa prej kërkesave ankimore nuk u dërguan për veprime të mëtejshme?

Siç vihet re, autoritete të ndryshme u pyetën për çështje kur një grua kishte vrarë bashkëshortin e saj. Arsyeja për këtë ishte për të parë se në çfarë shkalle ka qenë dhuna e ushtruar më parë kundër gruas, e cila për pasojë kishte vrarë bashkëshortin e saj.<sup>367</sup>

Statistikat e policisë, gjykatave dhe prokurorive nuk përmbajnë tregues të dhunës ndaj grave në përgjithësi ose të dhunës në familje në veçanti. Kjo do të thotë se çdo kërkesë për informacion në lidhje me çështje të kësaj natyre kërkon që organi përgjegjës të kryejë një punë kërkimore rast pas rasti. Duke marrë në konsideratë që shumë rajone policie, gjykata dhe prokurori ende nuk kanë sisteme të kompjuterizuara për menaxhimin e çështjeve, kjo gjë shpesh kërkon një kërkim joautomatik të dosjeve në gjykatë. Se sa i plotë kryhet ky kërkim, varet nga dashamirësia dhe ambicia e personit, të cilit i është caktuar detyra. Tabela më poshtë tregon disa nga rezultatet e studimit.

Rrethi	Policia	Prokuroria	Gjykata
<b>Tiranë</b>	U regjistruan 240 kallëzime <sup>368</sup> lidhur me dhunën në familje. Hetimi u zhvillua për 154 çështje; 5 çështje të dëmtimit të gruas nga bashkëshorti; 1 rast të vrasjes së gruas nga bashkëshorti dhe 2 raste të vrasjes së bashkëshortit nga e shoqja. <sup>369</sup>	Rastet e dhunës në familje nuk janë saktësuar në regjistrë sipas PT, <sup>370</sup> dhe për këtë arsye nuk ishte e mundur t'i jepej përgjigje pyetjeve të pyetësorit.	23 vendime gjyqësore të GjRr Tiranë <sup>371</sup> gjatë 2003-2005; 6 vendime në 2003; 9 vendime në 2004 dhe 8 vendime në 2005. Në 1 rast i pandehuri ishte grua.
<b>Durrës</b>	33 kallëzime; 2002 - u regjistruan 9 raste; 8 në 2003; 6 në 2004; 10 në 2005. 5 kishin të bënin me raste kur gruaja kishte kërcënuar, plagosur ose vrarë bashkëshortin e saj.	32 raste; 9 çështje në 2002; 7 në 2003; 9 në 2004; 7 në 2005. 6 çështje të pushuara, 1 nën procedim.	Asnjë përgjigje.
<b>Shkodër</b>	18 kallëzime në 2000-2005; 8 raste kur gruaja kishte vrarë bashkëshortin e saj. Statistikat tregojnë vetëm raste vrasjesh, p.sh., burri që vret gruan ose e kundërta	18 raste; 2002 - 3 raste; 2003 - 5 raste; 2004 - 7 raste dhe 2005 - 3 raste. Të gjitha rastet ishin dërguar në gjykatë.	13 vendime gjyqësore nga GjRr Shkodër; 2 vendime në 2002; 5 vendime në 2003; 3 vendime në 2004 dhe 3 vendime në 2005. Në 3 raste i pandehuri ishte grua.
<b>Kukës</b>	2 kallëzime. Të dyja rastet u hetuan dhe dërguan për gjykim në gjykatë.	U hetua dhe u dërgua për gjykim një rast në 2004.	1 vendim u shqyrtua nga GjRr Kukës në 2005. <i>Ky vendim nuk është një nga rastet e hetuara nga prokurori.</i>

<sup>367</sup> Shih Amnesty International, *Shqipëri: Dhuna kundër grave në familje: "Nuk është turpi i saj"*, fq. 42-47.

<sup>368</sup> Në bazë të përgjigjeve zyrtare të dhëna nga Drejtoria e Policisë Tiranë, një nga rastet ka të bëjë me vrasjen e vajzës nga i ati.

<sup>369</sup> Nuk është e qartë nga përgjigjet se me çfarë problemi kishin të bënin 148 rastet.

<sup>370</sup> Prokuroria e Rrethit Tiranë (PT).

<sup>371</sup> Gjykata e Rrethit (GjRr).

Rrethi	Policia	Prokuroria	Gjykata
Vlorë	11 kallëzime gjatë 2002-2005; 1 rast kur gruaja e vrau bashkëshortin.	U hetuan 6 raste; 1 rast në 2002; 1 rast në 2003 dhe 4 raste në 2005. Të gjitha rastet u dërguan për gjykim.	Asnjë përgjigje nga GJRr Vlorë. Gjykata, megjithatë, nxori një kopje të vendimit të vitit 2005. Çështja filloi me kallëzimin e të dëmtuarit akuzues në gjykatë.
Fier	18 kallëzime gjatë 2004-2005; 10 raste vrasjesh, 4 shkaktimi të vetëvrasjes dhe 4 raste të keqtrajtimit të gruas nga bashkëshorti. E paqartë nëse rastet kishin të bënin vetëm me dhunë bashkëshortore.	7 raste u hetuan gjatë periudhës 2002-2005; 3 çështje u çuan për gjykim.	Asnjë përgjigje por jo zyrtarisht, Prokuroria e Fierit deklaroi se ata nuk kishin pasur raste të dhunës në familje.
Gjirokastrë	4 kallëzime gjatë 2002-2005. Të gjitha rastet u dërguan për hetim dhe shqyrtim në gjykatë.	Asnjë përgjigje nga Prokuroria e Gjirokastrës	Gjykata e Rrethit Gjirokastrë nuk ka shqyrtuar asnjë rast të dhunës në familje gjatë periudhës 2002-2004.

#### Komente

Përgjigjet e marra tregojnë se pyetjet në shumë raste ishin keqkuptuar, duke rezultuar kështu në raportime të veprave penale të dhunshme nga personat e pyetur në përgjithësi, ose ishin përgjigje për periudha të tjera e jo për ato që u pyetën. Në disa raste, nuk ka pasur asnjë përpunje ndërmjet asaj që është raportuar nga organe të ndryshme, si policia, prokuroria apo gjykatat. Për shembull, Gjykata e Rrethit Lushnje paraqiti pesë vendime, por asnjë prej tyre nuk kishte të bënte me dhunë brenda familjes. Informacioni nuk ishte mbledhur sipas vitit ose llojit të veprës penale. U raportua vetëm një rast vrasjeje. Në disa raste nuk kemi marrë asnjë përgjigje. Duke marrë në konsideratë se çdo përgjigje varej nga kërkimi që bënte dikush aktualisht për dosje, doli që shumë çështje në fakt mungonin.

Mospërputhjet dhe pasiguritë e përshkruara më sipër e bëjnë të vështirë nxjerrjen e konkluzioneve, megjithatë mund të paraqiten disa komente.

*Tiranë* – është për t'u shqetësuar se pavarësisht nga 240 kallëzimet dhe 154 hetimet, gjatë kësaj periudhe janë marrë vetëm 23 vendime lidhur me dhunën në familje. Përgjigjja nga prokuroria tregon gjithashtu se dhuna në familje nuk është një çështje me përparësi.

*Durrës* – Përgjigjet nga policia dhe prokuroria përputhen në mënyrë logjike, gjë që është shenjë e mirë. Duke marrë parasysh numrin e çështjeve, është shqetësuese që Gjykata e Rrethit nuk dha as ndonjë përgjigje apo vendim.<sup>372</sup>

<sup>372</sup> Kjo mund të jetë si pasojë e mungesës së dëshirës për të bashkëpunuar të kryetarit të mëparshëm të komanduar të Gjykatës së Rrethit Durrës. Me emërimin e kryetarit të ri, z. Ervin Metalla, bashkëpunimi është përmirësuar në mënyrë të ndjeshme, dhe tani në bazë të të dhënave që kemi, ky bashkëpunim është i shkëlqyer.

*Shkodër* – Siç u përmend më sipër, në Shkodër duket se ka angazhim për të luftuar dhunën në familje dhe kjo duket tek shifrat mjaft koherente që jepen nga prokuroria dhe gjykata. Duke pasur parasysh se policia raportonte vetëm rastet e vrasjeve, nuk mund të nxirret asnjë konkluzion se sa kallëzime janë hetuar dhe dërguar për gjykim në gjykatë.

*Kukës* – Vlen të përmendet se nuk ka vendim gjykate për asnjë nga të dy rastet që pretendohet se janë hetuar dhe dërguar në gjykatë. Është gjithashtu për t'u shqetësuar se as policia, as prokuroria me sa duket nuk ka të dhëna lidhur me çështjet e ndjekura penalisht me iniciativë të prokurorisë, për të cilat gjykata ka marrë një vendim.

*Vlorë* – është për t'u shqetësuar se vetëm një në gjashtë raste që janë dërguar për gjykim në gjykatë, ka rezultuar e gjykuar dhe e përfunduar me vendimin përkatës.

*Fier* - është për t'u shqetësuar se asnjë nga tri rastet që është dërguar për gjykim në Gjykatë nuk ka përfunduar me vendim gjykate.

*Gjirokastrë* – është për t'u shqetësuar se asnjë nga katër rastet që është dërguar për gjykim në gjykatë nuk ka rezultuar me vendim gjykate.

## 7. Vendimet gjyqësore mbi dhunën në familje

Studimi është kryer gjatë një periudhe katërvjeçare, që nga fillimi i vitit 2002 deri në vitin 2005, dhe përfshin gjashtë gjykata: Tiranë, Durrës, Kukës, Shkodër, Vlorë, Fier dhe Gjirokastrë. Kërkesat u pasuan nga vënia në dispozicion të një totali prej 38 vendimesh gjyqësore. Përveç këtyre, një vendim u morr nga kërkimi në faqen e internetit të Gjykatës së Rrethit Fier, ndërsa një vendim tjetër u mor më parë nga Gjykata e Rrethit Durrës si përgjigje e kërkesës së përgjithshme për vendime nga kjo gjykatë. Si rezultat, numri i përgjithshëm i vendimeve është 40 nga gjashtë gjykata rrethi për katër vjet, ose mesatarisht 1.6 vendime për çdo gjykatë në vit.<sup>373</sup> Në krahasim, në Suedi, me një popullsi prej afërsisht 9 milion dhe ku niveli i dhunës në familje është raportuar të jetë i njëjtë me atë në Shqipëri,<sup>374</sup> nga gjykatat u shqyrtuan 5 096 incidente të dhunës në familje në 2004 (*goditje ose dhunim i rëndë i integritetit të gruas, p.sh., duke përjashtuar kërcënimet*). Meqenëse në Suedi ka 56 gjykata rrethi, kjo do të thotë se mesatarisht në vitin 2004 çdo gjykatë ka shqyrtuar 91 incidente/çështje të dhunës në familje.<sup>375</sup> Siç u tha edhe më sipër, mund të nxjerrim konkluzionin se niveli i moskallëzimit dhe mosndjekjes penale të çështjeve që kanë të bëjnë me dhunën në familje në Shqipëri është domethënës.<sup>376</sup>

<sup>373</sup> 40/4/6=1.6.

<sup>374</sup> Shih për shembull, Amnesty International, *Men's Violence Against Women in Intimate Relationships: an account of the situation in Sweden [Dhuna e Burrave Ndaj Grave në Marrëdhëniet Intime: një panoramë e situatës në Suedi]*, 19 prill 2004, fq. 21-27 [http://www2.amnesty.se/svaw.nsf/mvaw/\\$File/mvaw.pdf](http://www2.amnesty.se/svaw.nsf/mvaw/$File/mvaw.pdf) [vizituar më 2 qershor 2006].

<sup>375</sup> 91 herë 4 vite bëjnë 364 çështje për çdo gjykatë. Nëse Shqipëria, me përafërsisht një të tretën e popullsisë së Suedisë, do të kishte të njëjtin ritëm, do të arrinte deri në 121 (364/3) çështje për çdo gjykatë.

<sup>376</sup> Për më shumë informacion për sa u përket vendimeve, shih "Dhuna në familje" – Shtojca 1.

## 7. 1. Vërejtje të përgjithshme

Nga 40 vendime, 23 prej tyre janë nga Gjykata e Rrethit Tiranë, 13 nga Gjykata e Rrethit Shkodër dhe 4 të tjera nga Gjykatat e Rretheve Kukës, Fier, Vlorë dhe Durrës.<sup>377</sup> Në katër raste (nr. 22, 27, 33 dhe 34), i pandehuri ishte grua. Në 38 raste, i pandehuri u shpall fajtor, ndërsa dy çështje u pushuan – njëra për shkak të mungesës së provave<sup>378</sup>(nr. 16) dhe tjetra se viktima e tërhoqi akuzën (nr. 24).

I pandehuri pranoi akuzën në 35 raste nga 40 që ishin gjithsej. Të gjitha gratë e akuzuara pranuan akuzën. Në 27 raste u bë gjykim të shkurtuar. Nga 35 të pandehur meshkuj në çështjet që u gjykuan në themel, 31 pranuan akuzën, ndërsa 4 kërkuan pafajësinë (nr. 4, 16, 20 dhe 30). Nga këto, 34 u shpallën fajtor, ndërsa vendimi i 35-të ishte për një çështje të pushuar (padrejtësisht) siç u tha më sipër në këtë kapitull, që në fakt duhet të konsiderohet si një vendim pafajësie.

*Gjykimi i shkurtuar* – Me kërkesën e të pandehurit ose avokatit të tij, gjykimi mund të konsiderohet i shkurtuar, ku dënimi për të pandehurin zvogëlohet me një të tretën e tij. Gjykata vendos gjykimin e shkurtuar kur çmon se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet. Gjykimi i shkurtuar nuk kërkon që i pandehuri të pranojë akuzën.<sup>379</sup>

Të dyja çështjet e pushuara ishin filluar mbi bazën e kërkesës së të dëmtuarit,<sup>380</sup> që do të thotë se nuk ka pasur hetim paraprak dhe prokurori mori pjesë vetëm gjatë gjykimit dhe dha rekomandime në lidhje me masën e dënimit. Gjithsej ishin katër raste ku ankimi ishte bërë në gjykatë nga i dëmtuari akuzues; pa marrë parasysh dy çështjet e pushuara, të pandehurit pranuan akuzën në një rast dhe kërkuan pafajësinë në rastin tjetër.

## 7. 2. Rrethanat rënduese dhe lehtësuese

Në përcaktimin e dënimit, Kodi Penal parashikon se, përveç respektimit të kufijve të parashikuara për dënimet, gjykata merr në konsideratë rrezikshmërinë e veprës penale dhe të autorit të saj, nivelin e fajit dhe rrethanat lehtësuese e rënduese.<sup>381</sup> Më poshtë paraqitet një tabelë që tregon rrethanat rënduese dhe lehtësuese sipas Kodit Penal që mund të përdoren në rastet e dhunës në familje. Tabela tregon më tej rrethanat të cilave u referohemi në vendimet e studiuara të gjykatës dhe numrin e rasteve, në të cilin i referohet një rrethane të veçantë. Megjithatë, duke parë vendimet, nuk është gjithmonë e mundur të arrihet në përfundim nëse një rrethanë e caktuar është konsideruar si rrethanë rënduese apo lehtësuese. Shpesh herë vendimet shprehin vetëm se në përkufizimin e llojit dhe masës së dënimit, gjykata merr “në konsideratë rrethanat e mëposhtme”. Kjo

<sup>377</sup> Nr. 1-23: Gjykata e Rrethit Tiranë (GjRr); Nr. 24 Vlorë GjRr; Nr. 25: Kukës GjRr; Nr. 26-38: Shkodër GjRr; Nr.39: Fier GjRr; Nr. 40: Durrës GjRr.

<sup>378</sup> Shih “Shembull – Mundësia për të marrë drejtësi për gratë, viktima të dhunës në familje”.

<sup>379</sup> KPrP, nenet 403-406.

<sup>380</sup> KPrP, neni 59, veprat penale më të lehta trajtohen në bazë të ndjekjes penale nga i dëmtuari akuzues, shih gjithashtu nenin 284 për rastet kur ankimi bëhet në gjykatë nga i dëmtuari akuzues.

<sup>381</sup> KP, neni 47, paragrafi 2.

nuk është e kënaqshme, sepse e privon të pandehurin si edhe lexuesit e tjerë të vendimit nga mundësia për të kuptuar se si gjykata e ka marrë vendimin lidhur me një dënim të caktuar. Por e bën gjithashtu më të vështirë për instancat më të larta, punonjësit kërkimorë shkencor dhe persona të tjerë të interesuar për mënyrën se si përdoren rrethanat rënduese dhe lehtësuese dhe se sa ndikojnë ato në dënimin e dhënë.

Neni	Pasoja	Rrethanat	Çështjet
50 a	Rënduese	Vepër e kryer për motive të dobëta	
50 c	Rënduese	Vepër e kryer me egërsi dhe mizori	
50 ç	Rënduese	Vepër e kryer pas dhënies së një dënimi për një krim të kryer më parë	4
50 e	Rënduese	Vepër e kryer kundër një gruaje shtatzënë	
50 g	Rënduese	Vepër e kryer duke përfitur nga <b>marrëdhëniet familjare</b>	
50 h	Rënduese	Vepër e kryer <b>më shumë se njëherë</b>	1
50 i	Rënduese	Vepër e kryer <b>duke përdorur armë</b> etj.	1
18	Rënduese	Dehje bërë me paramendim për të kryer veprën penale	
–	Rënduese	Vepra penale është përhapur më shumë*	6
–	Rënduese	Kërcënimi është bërë në prani të fëmijëve*	1
48 b	Lehtësuese	Vepër e kryer nën ndikimin e tronditjes psikike të shkaktuar nga provokimi ose veprime të padrejta të viktimës apo të ndonjë personi tjetër	1
48 ç	Lehtësuese	Personi që ka kryer veprën tregon pendim të thellë	22/5
48 d	Lehtësuese	Kur personi ka zëvendësuar dëmin e shkaktuar nga vepra penale ose ka ndihmuar aktivisht për të zhdukur ose pakësuar pasojat e veprës penale	2
48 dh	Lehtësuese	Kur personi paraqitet në organet kompetente pas kryerjes së veprës penale	5
48 e	Lehtësuese	Kur marrëdhëniet ndërmjet personit që ka kryer veprën penale dhe të dëmtuarit janë normalizuar	8
49	Lehtësuese	Rrethana të tjera që justifikojnë lehtësimin e dënimit**	
18	Lehtësuese	Dehje e shkaktuar në rrethana të rastit dhe ka sjellë uljen e ekuilibrit mendor	4
53	Dënim nën minimum ose më i butë	Kur gjykata çmon që vepra dhe autori i saj paraqesin rrezikshmëri të pakët dhe janë të pranishme rrethana lehtësuese	1

\* Kryerja e një krimi në prani të fëmijëve ose fakti që një vepër penale është përhapur nuk konsiderohet rrethanë rënduese sipas KP. Megjithatë, shpesh ndodh që gjykatat edhe kur japin vendimin me burg ose paraburgim i referohen idesë që vepra penale në fjalë është bërë më e përhapur kohët e fundit.

\*\* Rrethana të tjera që justifikojnë një dënim më të lehtë: Arsyje familjare – 7 raste; Gjendje e vështirë ekonomike – 5 raste; i padënuar më parë – 3 raste; i pandehuri është punonjës police – 1 rast; e pandehura është një nënë me fëmijë të sapolindur/nënë me shtatë fëmijë – 1 për secilin rast; i pandehuri nuk e mban mend krimin për shkak të paqëndrueshmërisë mendore – 1 rast; i pandehuri pranoi akuzën – 1 rast; i pandehuri ka probleme me shëndetin – 1 rast; “i pandehuri është intelektual etj” – 1 rast.



### 7.2.1. Analiza të përdorimit të rrethanave rënduese dhe lehtësuese

Për sa u përket rasteve të dhunës në familje, rrethanat rënduese që mund të përdoren për të trajtuar fenomenin e veçantë të dhunës në familje, janë dispozita që parashikojnë akte të kryera duke përfutur nga marrëdhëniet familjare (50 g) ose kryerjen e veprës penale më shumë se një herë (50 h). Megjithatë, siç shihet edhe nga tabela, ka reference për këta faktorë të veçantë vetëm në një nga vendimet e shqyrtuara. Por edhe në atë vendim, nuk është e qartë se në çfarë drejtimi mund të ndikonte dënimin, d.m.th, si një rrethanë rënduese ose lehtësuese.

#### Vendimi nr. 36

I pandehuri ishte akuzuar për kanosje dhe armëmbajtje pa leje. Pas procedimit me gjykim të shkurtuar, ai u dënua me katër muaj dhe njëzet ditë burgim. Gjykata arsyeton se në “Ilojin dhe masën e dënimit, gjykata ka parasysh faktin se krimi në familje është bërë i zakonshëm dhe në rastin konkret shkak është bërë grindja e vazhdueshme e të pandehurit me bashkëshorten, çka ka çuar në ndarjen e tyre.”

Në renditjen e rrethanave lehtësuese, fakti që krimi ndodhi si rezultat i konfliktit në familje është përmendur disa herë, duke treguar kështu se kjo gjë nuk shihet si rrethanë rënduese, por si rrethanë lehtësuese.

#### Vendimi nr. 32

I pandehuri ishte akuzuar dhe dënuar për vrasje me dashje të mbetur në tentativë dhe për armëmbajtje pa leje. Në vendim është përmendur se i pandehuri e kishte keqtrajtuar shpesh bashkëshorten e tij. Megjithatë, kjo nuk është konsideruar si një rrethanë rënduese dhe fakti që vepra penale ndodhi si rezultat i konfliktit brenda familjes përmendet si një ndër rrethanat e tjera lehtësuese.

Ndërsa iu referuam rrethanave lehtësuese në 33 raste, rrethanave rënduese iu referuam vetëm për 12 raste. Rrethana rënduese e hasur më shpesh ishte një faktor që nuk parashikohej nga Kodi Penal, d.m.th, që vepra penale ishte më e përhapur ose e zakonshme (6 raste). Faktit se i pandehuri ishte dënuar më parë i është referuar në 4 raste. Për sa u përket rrethanave lehtësuese, ia vlen të përmendet se fakti që i pandehuri kishte qenë *punonjës policie*, ishte konsideruar si rrethanë lehtësuese në një rast (nr. 26). Në një rast tjetër (nr. 15), në vendim shkruhet “*në caktimin e masës së dënimit, gjykata ka parasysh rrezikshmërinë e vogël të veprës të personit, faktin se janë bashkëshortë (palët në të vërtetë ishin divorcuar para marrjes së vendimit), kanë një fëmijë, i pandehur ka qenë i padënuar më parë, është intelektual, etj.*”. Ndërsa rrezikshmëria e pakët e veprës penale dhe të autorit të saj janë rrethana lehtësuese sipas nenit 53 të KP, rrethanat e tjera të cilësuar si lehtësuese, p.sh, që i pandehuri është “intelektual, etj.”, nuk janë rrethana që do të justifikonin me të drejtë një dënim më të ulët, në veçanti jo për një rast si ai i dhunës në familje.

## 7. 2.2. Dehja si rrethanë lehtësuese

Strategjitë tip, paragrafi 7(e), u kërkojnë shtetet të sigurojnë heqjen e mundësive për t'iu shmangur të gjitha përgjegjësive penale për veprimet e dhunshme të ushtruara ndaj grave si rezultat i përdorimit të paramenduar të alkoolit ose narkotikëve në atë moment.

Dehja me paramendim për të kryer veprë penale është rrethanë rënduese, ndërsa dehja e shkaktuar në rrethana të rastit dhe çdo paqëndrueshmëri tjetër është faktor lehtësues. Në lidhje me këtë çështje të veçantë, Komentari i Kodit Penal thotë:

Në dehje të rastit kuptohet një gjendje e veçantë, dehje jo e zakonshme, por në një rast të shkëputur, e cila ka sjellë uljen e ekuilibrit mendor. Kjo rrethanë vërtetohet me raportin e ekspertit psikiatër dhe mbahet parasysh si rrethanë lehtësuese për zbutjen e dënimit ndaj personit që ka kryer veprë penale në gjendje të dehjes së rastit. Kështu p.sh. një person, i cili ndodhet në dasmën e mikut të tij, nga pija alkoolike është dehur dhe në këtë gjendje, duke dashur të qëllojë me pistoletë në ajër për shkak se i është ulur ekuilibri mendor, godet nga pakujdesia një person aty pranë dhe e plagos rëndë.<sup>382</sup>

Ndonëse është e kuptueshme se dehja me paramendim për të kryer veprë penale konsiderohet si *rrethanë rënduese*, është e papranueshme që “dehja e rastit” të konsiderohet si *rrethanë lehtësuese*. Në rrethana të veçanta, si ato të cilësuar në shembull, konsumimi i alkoolit nuk duhet të justifikojë ose pakësojë përgjegjësinë penale të një të pandehuri. Studime të shumta tregojnë se ka një lidhje të ngushtë midis konsumimit të alkoolit dhe krimit të dhunshëm. Jo më pak për shkak të kësaj, dehja me paramendim nuk duhet të pranohet si masë mbrojtëse ose si rrethanë lehtësuese.<sup>383</sup> Nëse personi ka tendencë të humbasë ekuilibrin mendor gjatë konsumimit të alkoolit, ai/ajo duhet ta frenojë veten nga konsumimi i tij.

Për sa u përket vendimeve të shqyrtuara nga ky studim, fakti se i pandehuri kishte qenë i dehur u konsiderua si rrethanë lehtësuese (nr. 3, 5, 23, 29 dhe 37). Në asnjë prej rasteve nuk ishte kryer ekspertizë mjeko-ligjore që të shpjegonte paqëndrueshmërinë mendore të shkaktuar nga dehja, as ndonjë analizë tjetër lidhur me “dehjen e rastit” dhe pse duhet të konsiderohet kjo si rrethanë lehtësuese.<sup>384</sup>

<sup>382</sup> Ismet Elezi, Skënder Kaçupi dhe Maksim Haxhia, *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë* (Tiranë: GEER, 2001), fq. 127.

<sup>383</sup> Për reference shtesë, *shih p.sh.*, Thor Norstrom, “Effects on criminal violence of different beverage types and private and public drinking” [Ndikimet mbi dhunën kriminale të pijeve të ndryshme dhe konsumit të alkoolit në mjedise private dhe vende publike]; *Addiction* [revistë për varësi nga alkooli apo droga], vëll. 93, nr. 5 (maj 1998), fq. 689. Është e lehtë të gjenden artikuj në internet me temën “alkooli dhe dhuna” [në anglisht: alcohol and aggression].

<sup>384</sup> Shih diskutimin e mësipërm lidhur me dehjen e vullnetshme si rrethanë lehtësuese.

*Vendimi nr. 37*

I pandehuri ishte akuzuar dhe dënuar për vrasjen me dashje të bashkëshortes së tij si dhe për armëmbajtje pa leje. Në bazë të vendimit, i pandehuri është kthyer në shtëpi në gjendje të dehur, ka debatuar me të shoqen, ka nxjerrë armën dhe ka qëlluar mbi të shoqen duke i shkaktuar vdekjen. Nuk ka diskutim dhe as që diskutohet të ketë pasur ekspertizë psikiatrike lidhur me “dehjen e pavullnetshme” të të pandehurit ose paqëndrueshmërinë mendore, apo arsye pse duhet të konsiderohet kjo si situatë e jashtëzakonshme, ku dehja e vullnetshme do të pranohej si arsye për të ulur dënimin. Në fakt, ky duket si një shembull parësor lidhur me situatën ku dehja e vullnetshme *nuk duhet* të përdoret si rrethanë lehtësuese. Me fjalë të tjera, kemi të bëjmë me një situatë ku i pandehuri është dehur me dëshirë dhe, ndoshta, edhe është dehur me paramendim e më pas ka kryer krimin.

**7.2.3. Kërcënimi kundrejt kërcënimit me armë**

I pandehuri është akuzuar për kërcënim të bashkëshortes së tij në 18 vendime gjyqësore. Ai është shpallur fajtor për armëmbajtje pa leje në gjashtë prej këtyre vendimeve, dhe në secilin rast kërcënimi ishte bërë me armën në fjalë. Përveç kësaj, fakti që kërcënimi ishte bërë me armë u konsiderua si faktor rëndues vetëm në njërin prej rasteve. Në të gjitha rastet e tjera, armëmbajtja pa leje thjesht u konsiderua si vepër penale e veçantë.

Vepra penale e kanosjes është përkufizuar si: *Kanosje serioze për vrasje ose për plagosje të rëndë që i bëhet një personi*.<sup>385</sup> Kanosja dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit, ndërsa përdorimi i armës në kryerjen e një krimi është rrethanë rënduese. Megjithatë, rrethanat rënduese mund të çojnë vetëm në dënim maksimal sipas nenit përkatës, në kundërshtim me rrethanat lehtësuese të cilat mund të çojnë në një dënim nën minimumin e mundshëm, ose në një dënim më të butë, p.sh., gjobë në vend të burgimit. Kjo do të thotë që *kërcënimi me përdorimin e armës* mund të dënohet me burgim maksimumi një vit. Dhe duhet të krahasohet me *marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me kërcënim me përdorimin e armës*, për shembull, që dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet, në kundërshtim me *marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura*, që dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet. Krahasimi mund të bëhet gjithashtu me një rast si ai i *vjedhjes me armë*, që dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet sikundër *vjedhja*, që dënohet me burgim nga tre muaj deri në tre vjet.<sup>386</sup> Kjo tregon se *kërcënimi me armë* “vlen” të dënohet me një shtesë dënimi prej dy deri në pesë vjet burgim kur shoqërohet me përdhunim, ndërsa *kërcënimi me armë* kur shoqërohet me vjedhjen “vlen” të dënohet me dhjetë deri në shtatëmbëdhjetë vjet më shumë burgim. Si rezultat, kërcënimi *tipik i dhunës në familje* kur përdoret arma nuk konsiderohet fare si krim, por si kundërvajtje penale, dhe nuk vlen aq sa për t’u ndëshkuar, ndërsa vjedhja e pronës me anë të kërcënimit me armë konsiderohet si një nga veprat penale më të rënda sipas Kodit Penal. Mospërputhja në masën e dënimit lidhur me përdorimin e armëve në kryerjen e një krimi, është shqetësuese.

<sup>385</sup> KP neni 84.<sup>386</sup> KP nenet 140 dhe 134.

Është tjetër çështje nëse kërcënimi me armë shpesh dënohet si dy vepra penale, d.m.th, si kërcënim dhe armëmbajtje pa leje. Siç shihet në shembullin e dytë më poshtë, armëmbajtja konsiderohet si vepër penale shumë më e rëndë se sa kërcënimi me të njëjtën armë. Edhe kjo është një mospërputhje, për të cilën është për t'u ardhur keq dhe tregon përsëri që integriteti personal i personit të trajtohet pa kujdes nga sistemi shqiptar i drejtësisë penale.

*Vendimi nr. 25*

Në këtë rast i pandehuri ishte akuzuar dhe shpallur fajtor për veprën penale të kanosjes dhe fyerjes. Kanosja që ishte drejtuar edhe ndaj ish-bashkëshortes së të pandehurit dhe ndaj vëllait të saj (gjë që nuk pasqyrohet në akuzë), ishte kryer me anë të thikës. Megjithatë, kjo nuk konsiderohet si rrethanë rënduese.

*Vendimi nr. 35*

Ky rast ka të bëjë me një person të akuzuar për kërcënimin e bashkëshortes dhe dy bijat e tij me një armë automatike, si dhe për armëmbajtje pa leje. Gjykata deklaroi fajtor të pandehurin për të dyja veprat penale dhe e dënoi atë me një vit e gjashtë muaj burgim për armëmbajtje pa leje dhe dy muaj burgim për kanosje me armë të bashkëshortes së tij dhe dy bijave të tij. Duke marrë parasysh që procesi u krye me gjykim të shkurtuar, bashkëshorti u dënua me një vit burgim.

#### 7. 2. 4. Armëmbajtja pa leje

Sipas nenit 278, paragrafi 2, i Kodit Penal, mbajtja e armëve, bombave, minave ose lëndëve plasëse pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me gjobë ose me burgim deri në shtatë vjet. Supozohet se qëllimi i këtij neni dhe i dispozitave të ngjashme është parandalimi i shpërndarjes së pakontrolluar të armëve në shoqërinë shqiptare. Në përputhje me të, ajo që duhet të dënohet me të drejtë është mbajtja e paautorizuar,<sup>387</sup> d.m.th, mbajtja si “diçka personale”, e jo thjesht si “mbajtje në dorë” e armës. Siç është diskutuar më sipër në këtë kapitull, kryerja e veprave penale me përdorimin e armës sanksionohet në dispozita të veçanta si *vjedhje me armë*<sup>388</sup> ose *marrëdhënie seksuale me kërcënim me përdorimin e armës*,<sup>389</sup> ose konsiderohet si rrethanë rënduese kur përkufizohet dënimi. Sidoqoftë, termi për fjalën në gjuhën angleze “possession”, në gjuhën shqipe është “zotërim”, ndërsa termi i përdorur në nenin 278, “mbajtja”, ka lidhje me foljen “mbaj”. Ndonëse kjo duket e papërshtatshme, eksperiencia e krijuar gjatë zbatimit të Programit për Zhvillim e një Gjykimi të Drejtë tregon se kjo është mënyra se si interpretohet dhe përdoret dispozita. Domethënë, pavarësisht nga fakti se cili e zotëron armën pa leje, ai që e mban atë në dorë në një moment të veçantë do

<sup>387</sup> *Black's Law Dictionary*, botimi 8-të., (Shën Paul, Minnesota [U.S.A.]: West Publishing Co., 2004), tek fjala “possession” (mbajtja/zotërimi): ” 1. Fakti i zotërimit ose mbajtjes së pronës në zotërim; ushtrimi i autoritetit suprem mbi pronën... 3. *E Drejta Civile*. Mbajtja ose përdorimi i diçkaje fizike me qëllim për ta mbajtur atë si pronar.... 4. ...Diçka që dikush e zotëron ose e kontrollon...”

<sup>388</sup> KP, neni 140.

<sup>389</sup> KP, neni 104.

të dënohet për të. Përveç kësaj, nuk është bërë kurrë ndonjë diskutim për sa i përket qëllimit kriminal për të mbajtur ose zotëruar një armë, në kundërshtim me qëllimin kriminal të kanosjes apo përdorimit të armës kundër dikujt. Kjo gjë, në të vërtetë, është një problem e shqetësimi i përgjithshëm brenda sistemit shqiptar të drejtësisë penale d.m.th, që qëllimi kriminal rrallë merret në shqyrtim kur jepet vendimi i gjykatës.

*Vendimi nr. 34*

Në këtë rast, e pandehura ishte akuzuar në fillim për vrasje, por ishte dënua përfundimisht për vrasje të kryer në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme. Vendimi fillon duke shpjeguar se e pandehura ishte akuzuar për vrasje me dashje të bashkëshortit me një automatik që, ai, viktima, mbante pa leje. Përveç kësaj dhe pa ndonjë lloj diskutimi lidhur me qëllimin kriminal të mbajtjes së armës, e pandehura përveç vrasjes së kryer me armë, u shpall fajtores edhe për armëmbajtje pa leje.

### 7.2.5. Të pandehurat

Nga vendimet e marra në shqyrtim, rezulton se katër prej këtyre vendimeve (nr. 22, 27, 33 dhe 34), kanë të bëjmë me të pandehura. Dy gra janë akuzuar për vrasje (nr. 22 dhe 34), por meqenëse gjykata e ndryshoi cilësimin ligjor të veprës së kryer nga vrasje me dashje në vrasje të kryer me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme në njërin prej këtyre rasteve (nr. 34), vetëm njëra prej grave u dënua për vrasje. Një grua u akuzua dhe u dënua për vrasje të kryer në kushtet e tronditjes së fortë psikike, shkaktuar nga dhuna ose fyerje e rëndë nga viktima, e shoqëruar edhe me armëmbajtje pa leje (nr. 27). Njëra nga gratë u dënua për plagosje të rëndë me dashje, pasi kishte goditur bashkëshortin me një thikë kuzhine (nr. 33). Të gjitha të pandehurat pranuan akuzën. Tri prej çështjeve u proceduan me gjykim të shkurtuar, që do të thotë se dënimi u shkurtua me një të tretën e tij (nr. 22, 27 dhe 33). Gruaja e akuzuar për vrasje u dënua me 12 vjet burgim, që u shkurtua me një të tretën e dënimit deri në 8 vjet burgim për shkak të procedimit me gjykim të shkurtuar (nr. 22). Gruaja e akuzuar për vrasje të kryer me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme u dënua me 4 vjet dhe 6 muaj burgim, dënim i cili u ul me një të tretën për shkak të procedimit me gjykim të shkurtuar (nr. 27). Gruaja e dënua për plagosje të rëndë me dashje u dënua me 3 vjet burgim për veprën penale, dënim që më pas u ul në 2 vjet për shkak të procedimit me gjykim të shkurtuar (nr. 33). Gruaja e akuzuar për vrasje të kryer me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme u dënua përfundimisht me 5 vjet dënim me kusht (nr. 34).

## 8. Analizë e mëtejshme të vendimeve që kanë të bëjnë me dhunën në familje

*Vendimi nr. 8* – I pandehuri u akuzua dhe dënua për kanosje të bashkëshortes së tij dhe u dënua me burgim, të barabartë me kohën e paraburgimit, d.m.th., me 3 muaj e 24 ditë. Sipas vendimit, i pandehuri ka qëlluar me grushta dhe shqelma ish-bashkëshorten e tij derisa kishin ndërhyrë fqinjët.

*Koment* – Duke parë vendimin, është i paqartë burimi i informacionit lidhur me plagosjen, por ia vlen ende të theksohet se i pandehuri nuk u akuzua për plagosje sipas nenit 89 ose 90 të Kodit Penal.

*Vendimi nr. 27* – Çështja ka të bëjë me një grua 20-vjeçare, LL, që kishte vrarë bashkëshortin e saj. LL u akuzua dhe u dënua për veprën penale të *vrasjes në gjendje të tronditjes së fortë psikike* dhe për veprën penale të *armëmbajtjes pa leje*. Gjatë procesit gjyqësor, LL u përfaqësua nga një avokat. Në bazë të vendimit, nga hetimi gjyqësor rezultoi se ndaj LL ishte ushtruar dhunë sistematike që në momentet e para të martesës dhe për shkak të dhunës sistematike fizike dhe psikike, LL kishte qenë e shtruar në spitalin psikiatrik në vitin 2001. Në vitin 2002 LL aborton<sup>390</sup> si pasojë e dëmtimeve fizike të shkaktuara nga dhuna e bashkëshortit. Më 22 qershor 2003, bashkëshorti e keqtrajtoi atë brutalisht për shkak të faktit se ishte shtatzënë. Më pas, ai ka marrë një automatik dhe e ka kërcënuar LL-në se do ta vriste. Pastaj e urdhëroi LL-në të zhishej dhe e përplasi në shtrat. Në këtë moment LL vuri re se arma ishte pranë dhe e mori me shpejtësi duke qëlluar mbi bashkëshortin e duke e lënë të vdekur në vend. Në caktimin e llojit dhe masës së dënimit gjykata mori parasysh gjendjen e vështirë ekonomike në të cilën jetonte LL-ja dhe ambientin ku ajo ka kryer krimin, si edhe *rrethanat që e kanë çuar atë në kryerjen e krimin*. Në bashkim të dënimeve për të dyja veprat penale dhe duke marrë parasysh gjykimin e shkurtuar, LL-ja u dënua me tri vjet burgim. Vendimi nuk u apelua.

*Koment* – Nga ky vendim, duket se pas keqtrajtimit të LL-së dhe kërcënimit me armë, bashkëshorti ishte gati ta përdhunonte atë. Në një rast të tillë, LL-ja veproi për mbrojtjen e nevojshme dhe nuk ka përgjegjësi penale.<sup>391</sup> Megjithë faktin se gjykata nuk e vuri në diskutim besueshmërinë e LL-së, nuk diskutohet e drejta e LL-së për të mbrojtur veten ndaj sulmeve të vazhdueshme dhe të rënda të integritetit të saj fizik. Ndonëse është kryesisht përgjegjësia e avokatit mbrojtës të argumentojë se LL-ja veproi për vetëmbrojtje në rrethana si ato që u përshkruan më sipër, prokurori dhe gjykata duhet të siguronin që LL-ja të mos dënohej për diçka për të cilën, sipas Kodit Penal, *nuk mban asnjë përgjegjësi penale*.

<sup>390</sup> Në vendim kjo është përshkruar gabimisht me diagnozën “abort progredient”. Një proces “progredient” është një term mjekësor gjerman që përdoret të përshkruajë një proces progresiv.

<sup>391</sup> KP neni 19 paragrafi 1: “Mbrojtja e nevojshme”: Nuk ka përgjegjësi penale personi që ka kryer veprën duke qenë i detyruar të mbrojtë jetën, shëndetin, të drejtat dhe interesat e tij ose të një tjetri, nga një sulm i padrejtë, i vërtetë e i çastit me kusht që, karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me rrezikshmërinë e sulmit.

Mospërputhja haptazi ndërmjet tyre përbën kapërcim të kufijve të mbrojtjes së domosdoshme.

Përveç kësaj, LL u dënua për armëmbajtje pa leje për një çështje ku është shpjeguar se si bashkëshorti më parë e kishte kërcënuar me të njëjtën armë dhe urdhëruar të zhvishej nën kërcënimin e së njëjtës armë. Vendimi *nuk* diskutohen se kujt i përkiste arma dhe nëse LL-ja kishte ndonjë qëllim kriminal në lidhje me *zotërimin ose mbajtjen* e armës. Bazuar në atë sa u tha më sipër, mund të argumentohet mbi baza të arsyeshme se ky vendim përfaqëson një mosfunksionim të drejtësisë ndaj LL-së dhe e vështirëson situatën e saj si viktimë pas keqtrajtimit të vazhdueshëm nga bashkëshorti.

*Vendimi nr. 34* – Çështja i përket të pandehurës DT, e cila u akuzua në fillim për vrasje me dashje dhe armëmbajtje pa leje. Sipas vendimit, më datë 24 korrik 2003, bashkëshorti i DT-së, në gjendje të dehur, kishte keqtrajtuar DT-në dhe djemtë e saj, që ishin 11 dhe 12 vjeç. Në një gjendje të tillë, dhe me qëllim të vriste djemtë e tij, bashkëshorti doli në kopsht të merrte automatikun, të cilin e kishte fshehur atje. Armën e mbante pa leje. Kur ai hyri në shtëpi, për të mbrojtur djemtë e saj, DT e ka shtyrë bashkëshortin, i cili është rrëzuar përtokë duke i rënë arma nga duart. DT ka kapur armën dhe e ka qëlluar viktimën duke e lënë të vdekur në vend. Gjatë procesit gjyqësor, DT shpjegoi se ajo ishte e bindur që bashkëshorti do t'i vriste djemtë dhe se ajo veproi për të mbrojtur djemtë e saj dhe veten ndaj sulmit të çastit të bashkëshortit të saj.

Në këtë rast, gjykata arriti në përfundimin se DT kishte vepruar *në kushtet e mbrojtjes së nevojshme*, por me vrasjen e bashkëshortit të saj, ajo kishte kapërcyer kufijtë e mbrojtjes së nevojshme. Duke marrë parasysh rrethanat në të cilat është zhvilluar ngjarja – me sa duket në gjendjen shumë të dehur të bashkëshortit – gjykata çmoi se DT këtë mbrojtje mund ta kishte realizuar edhe me mjete të tjera për ta paralizuar viktimën nga veprime të mëtejshme, por ajo nuk duhet ta kishte vrarë atë. Prandaj, mbrojtja e saj nuk ishte në përputhje me rrezikshmërinë e sulmit. Si rrjedhim, gjykata arsyetoi se DT kishte kapërcyer kufijtë e mbrojtjes së nevojshme dhe ka ndryshuar cilësimin ligjor të veprës penale në *vrasje e kryer me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme*.<sup>392</sup> Në vendim, gjykata vuri re se bashkëshorti kishte qenë i dhunshëm dhe e kishte keqtrajtuar DT-në gjatë gjithë kohës së martesës. Në masën dhe llojin e dënimit gjykata, midis rrethanave të tjera lehtësuese, ka marrë parasysh se vepra është kryer nën ndikimin e tronditjes psikike të shkaktuar nga provokime dhe veprime të padrejta të viktimës.<sup>393</sup> Prandaj, DT u shpall fajtores për *vrasje të kryer me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme* dhe për armëmbajtje pa leje, si edhe u dënua me pesë vjet burgim të pezulluar me kusht. Vendimi u apelua nga prokurori, por ai u la në fuqi nga gjykata e apelit.

*Koment* – Është pozitiv fakti që gjykata merr në konsideratë pretendimin e DT-së se ka vepruar për mbrojtje të nevojshme, si dhe të kaluarën e dhunshme. Për sa u përket akuzës dhe dënimit për armëmbajtje pa leje, sidoqoftë, është shqetësuese që gjykata vuri re qartë që arma *mbahej pa leje nga bashkëshorti i saj* dhe për këtë gjë ndëshkoi DT-në. Ashtu si

<sup>392</sup> KP, neni 19 paragrafi 2, shih shënimin e mësipërm, dhe neni 83.

<sup>393</sup> KP, neni 48 b.

edhe në rastin e mësipërm, po të mos kishte armë bashkëshorti, gjërat sigurisht që do të kishin rrjedhur krejt ndryshe për gruan e tij. Sidoqoftë, ajo nuk do të ishte dënuar *për faj të tij* për armëmbajtje pa leje.

## 9. Projektligji për dhunën në familje

Më 23 janar 2006, një koalicion i organizatave shqiptare jofitimprurëse (OJF), duke përfshirë OJF-të kryesore shqiptare të grave dhe fëmijëve, drejtuar nga Zyra Për Mbrojtjen e Qytetarëve (ZMQ), i paraqiti Parlamentit një projektligj *“Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”* (projektligji për dhunën në familje).<sup>394</sup> Projektligji u paraqit pas mbledhjes gjatë periudhës disa mujore në fund të vitit 2005, të më shumë se 20 000 firmave të shtetasve shqiptarë që mbështetën projektligjin. Projektligji ka si qëllim të parandalojë dhe të reduktojë dhunën në familje duke krijuar një rrjet të koordinuar për të mbrojtur, mbështetur dhe rehabilituar viktimat dhe fuqizuar gjyqësorin për marrjen e masave të mbrojtjes ndaj shkaktarëve të dhunës në familje.<sup>395</sup> Projektligji gjithashtu detyron autoritetet të “ndihmojnë autorët e dhunës me trajtime të ndryshme shëndetësore dhe sociale”, megjithëse theksi vihet tek viktimat.<sup>396</sup> “Masat mbrojtëse” përfshijnë masa për të larguar dhunuesin/en nga banesa dhe për ta ndaluar atë që t’i afrohet viktimës apo pjesëtarëve të familjes së viktimës.<sup>397</sup> Viktima dhe anëtarë të tjerë të familjes mund të vendosen në strehime dhe autori mund të marrë urdhër të mbështesë viktimën dhe anëtarë të tjerë të familjes. Prandaj, projektligji jep mundësi të përcaktuara në nenin 62 të Kodit të Familjes 2003, për largimin e bashkëshortit, që ushtron dhunë, nga banesa bashkëshortore.<sup>398</sup> Ligji ka një natyrë tërësisht civile por varet nga trajtimi i thyerjes së urdhrit të mbrojtjes, si një vepër penale ose në bazë të legjislacionit aktual, ose nëpërmjet hartimit të një dispozite të veçantë penale.

Projektligji për dhunën në familje dhe mbështetja e gjerë që ka marrë nga mbledhja e firmave, tregon që shoqëria shqiptare është gati të ndërmarrë hapa konkretë për të luftuar përhapjen e dhunës në familje. Në kohën që është shkruar ky raport, projektligji pritej të diskutohej në Parlament, por me aprovimin e saj, Shqipëria do të radhitet mes shumë vendeve të tjera të botës që kanë aprovuar ose ligje të veçanta ndaj dhunës në familje ose ligje të përgjithshëm ndaj saj, të cilët zbatohen gjithashtu në këtë fushë. Nëpërmjet ligjit kundër dhunës në familje, bëhet e qartë që dhuna në familje nuk është thjesht një çështje private. Ka kosto për publikun në përgjithësi, të cilat nuk janë vetëm financiare por edhe sociale. Kostoja për sistemin e shëndetit publik mbulon plagosjet, sëmundjet,

<sup>394</sup> Gjatë procesit të hartimit të projektligjit, Prezenca e OSBE-së ka paraqitur disa herë komente për projektligjin, shumë prej të cilave, por jo të gjitha, janë marrë parasysh.

<sup>395</sup> Projektligji për dhunën në familje, neni 2.

<sup>396</sup> Projektligji për dhunën në familje, neni 6, paragrafi 1 d.

<sup>397</sup> Projektligji për dhunën në familje, neni 12.

<sup>398</sup> Ligji nr. 9062, datë 8 maj 2003, Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë, neni 62: “Bashkëshorti ndaj të cilit ushrohet dhunë, ka të drejtë t’i drejtohet gjykatës me kërkesë për vendosjen si masë urgjente largimin e bashkëshortit, që ushtron dhunë, nga banesa bashkëshortore.”



tronditjet, çrregullimet nga stresi post-traumatik dhe efekte të tjera të dhunës me bazë gjinore janë në një masë të konsiderueshme.

Miratimi dhe zbatimi i duhur i projektligjit për dhunën në familje sigurisht përfaqëson një hap të rëndësishëm përpara dhe siguron mbrojtje e ndihmë për gratë që vuajnë nga dhuna në familje. Zbatimi i ligjit mund të shërbejë gjithashtu për të rritur ndjekjen e çështjeve të dhunës në familje duke siguruar mbrojtje për gratë që janë viktime të dhunës në familje. Megjithatë është e rëndësishme që kjo të shihet më shumë si hap i parë se sa si hap i fundit në luftë kundër dhunës në familje në Shqipëri dhe vlen për të forcuar kuadrin ligjor në luftë kundër dhunës në familje, që është një vepër penale.

## 10. Komente përmblyëse dhe perspektiva

Dhuna në familje vlerësohet se prek rreth 30 për qind të grave shqiptare, por kjo shifër nuk pasqyrohet në numrin e dënimeve për çështjet penale lidhur me dhunën bashkëshortore. Si rezultat, dhuna në familje nuk është denoncuar, hetuar, ndjekur dhe dënuar siç duhet. Pra, shumicës dërrmuese të autorëve të krimit u garantohet mosdëshkim, ndonëse ka pak korrigjime dhe mbrojtje për gratë që vuajnë nga dhuna e bashkëshortëve të tyre apo partnerëve të afërt. Mosdenoncimi i dhunës në familje është pasojë e traditave patriarkale, mungesës së ndërgjegjësimit dhe shpesh e pozitës së dobët të grave në shoqërinë shqiptare. Gratë që kërkojnë zhdëmtim, marrin pak ose aspak mbështetje nga autoritetet dhe fajësohen nga shoqëria për shkatërrimin e familjes së tyre. Mosndjekja e duhur penale dhe dënimi i ulët janë rezultate të shumë faktorëve.

Dhuna në familje shumë herë konsiderohet si e parëndësishme dhe një çështje që duhet të zgjidhet më mirë brenda familjes sesa me përfshirjen e autoriteteve. Familja konsiderohet më e rëndësishme se sa integriteti fizik dhe mendor e mirëqenia e një gruaje si individ. Nëpunësit e policisë, prokurorët, gjyqtarët dhe avokatët nuk janë të ndërgjegjësuar dhe trajnuar se si të trajtojnë çështjet që kanë të bëjnë me dhunën në familje. Nuk janë mbledhur prova për të mbështetur viktimat për ngjarjet, nuk është dhënë ndihmë psikologjike për gratë, dënimet janë të ulëta dhe nuk marrin parasysh incidentet e mëparshme ose vazhdimësinë e dhunës në familje.

Fakti që procedimi në shumicën e rasteve të dhunës në familje varet tërësisht nga gratë, është një ngarkesë shumë e rëndë dhe në praktikë mohon mundësinë e gjykimit të drejtë. Dënimet sipas Kodit Penal për çështjet e *dhunës së përditshme në familje* janë të ulta në krahasim me dënimet për vepra të tjera të rënda penale. As dënimet dhe as rrethanat rënduese të parashikuara në Kodin Penal nuk marrin parasysh natyrën e vazhdueshme të dhunës në familje ose ndikimin që mund të ketë pasur fakti se viktime mund të ketë vuajtur për vite të tëra nga dhuna e bashkëshortit. Siç është vënë re, nga 35 të pandehur në çështjet e gjykuara në themel, 31 prej tyre pranuan akuzën. Kjo gjë, e shoqëruar me numrin shumë të ulët të çështjeve lidhur me dhunën në familje, tregon se procedimi i dhunës në familje varet shumë nga “pjesëmarrja” e të pandehurit (mashkull). Kjo forcon edhe njëherë përshtypjen se mundësia për të dhënë drejtësi për gratë viktime të dhunës në familje është ende shumë larg.

## Rekomandime

### *Masa legislative*

1. Projektligji për dhunën në familje duhet të miratohet sa më parë që të jetë e mundur.
2. Kodi i Procedurës Penale duhet të ndryshohet për të siguruar që procedimi penal në të gjitha rastet e dhunës në familje, d.m.th., pavarësisht se sa e lehtë apo e rëndë është vepra penale, të mos varet nga gruaja viktimë e dhunës.
  - Kjo mund të bëhet ose duke krijuar vepër të veçantë të dhunës në familje bazuar mbi modelin suedez, e cila duhet të ndiqet kryesisht me iniciativë të prokurorisë, ose
  - duke i shtuar një apo dy nene KPrP, e duke i shtuar edhe përjashtime neneve 59 dhe 284 të KPrP, dhe duke theksuar se,
    - veprat penale të *plagosjeve të lehta me dashje, dëmtimeve të tjera me dashje dhe marrëdhënieve seksuale me dhunë me të rritura (si edhe vepra të tjera penale që mund të jenë të shpeshta në rastet e dhunës në familje)*, të shkaktuara nga ndonjë marrëdhënie ekzistuese apo të mëparshme intime, të ndiqen penalisht pavarësisht nga depozitimi i mundshëm i kallëzimit penal nga pala e dëmtuar.
3. Kodin Penal duhet të ndryshohet për të siguruar që dehja me dashje (ose e rastit) të mos cilësohet si rrethanë lehtësuese.
4. Kodin Penal duhet të ndryshohet për të bërë dallimin midis kanosjes dhe kanosjes me armë.
  - Për të ruajtur strukturën e Kodit Penal, kjo mund të arrihet duke shtuar një nen pas nenit 84 të quajtur “kanosja me armë”.
5. Neni 278 i Kodit Penal duhet të ndryshohet për të qartësuar se ky nen penalizon *posedimin* pa leje të armëve, e jo thjeshtë *përdorimin* apo *mbajtjen në dorë* të armës. Kjo gjë mund të bëhet gjithashtu me anë të një vendimi të Gjykatës së Lartë.
6. Duhet marrë në konsideratë fakti nëse pika dy e nenit 90 duhet kaluar në nenin 89.
7. Një përmbledhje e vlerës penale të krimeve të që ndodhin zakonisht në rastet e dhunës në familje<sup>399</sup> duhet bërë për të siguruar që ndëshkimet e dhëna të jenë në përputhje me dëmet e shkaktuara nga dhuna në familje dhe të kenë efekt shtrëngues.

<sup>399</sup> Shih diskutimin më sipër në këtë kapitull nën titullin “Dhuna në familje sipas legjislacionit penal shqiptar”.

- Kjo mund të bëhet ose duke krijuar një vepër të veçantë të dhunës në familje, duke marrë si bazë modelin suedez, ndjekja penale e së cilës të varet krejtësisht nga prokuroria, ose
- Duke rritur masën e dënimit siç është parashikuar për vepra penale të përhapura në rastet e dhunës në familje.
- Kjo duhet të shoqërohet me udhëzime për mënyrën e vlerësimit të krimit dhe se si shfrytëzohen rrethanat rënduese e lehtësuese si në rastin e dhunës në familje, duke marrë në konsideratë veprimet e përsëritura të dhunës në familje, natyrën sistematike të dhunës në familje, si edhe situatën lehtësisht të cenueshme të gruas që i nënshtrohet dhunës në familje.
- Në raste të rënda të dhunës në familje, prokurorët duhet të mendojnë për mundësinë e përdorimit të nenit të torturës.

#### *Masa të tjera*

8. Policia, prokuroria dhe gjykatat në Shqipëri duhet që, për qëllime statistikore, të mbledhin të dhëna për çdo rast të dhunës në familje/dhunës nga partneri dhe të ndërtojnë një sistem të menaxhimit të çështjeve me tregues për dhunën në familje/ dhunën ndaj partnerit.
9. Si institucion shtetëror përgjegjës për zbatimin e projektligjit për dhunën në familje, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta duhet të kryej një studim të plotë për mënyrën e trajtimit të dhunës në familje nga sistemi i së drejtës penale për të identifikuar dhe adresuar të metat që vërehen gjatë dhënies së drejtësisë dhe rrugëzgjdhjes grave, të cilat janë viktime të dhunës në familje.
10. Avokatët dhe OJF-të që ofrojnë shërbime juridike dhe mbështetje për gratë viktime të dhunës në familje duhet të inkurajojnë viktimat të kërkojnë kompensim për dëmet që kanë pësuar si gjatë procedimit penal ashtu edhe nëpërmjet një padie të veçantë (nga procesi penal) civile.
11. Policia duhet t'i inkurajojë viktimat e dhunës në familje për të kërkuar këshillim ligjor dhe mbështetje.
12. Oficerët e policisë, prokurorët, gjyqtarët dhe avokatët duhet të trajnohen vazhdimisht lidhur me fenomenin e dhunës në familje dhe pasojat e saj.

- Këto grupe duhet të trajnohen gjithashtu për mënyrën e shqyrtimit të çështjeve që kanë të bëjnë me dhunën në familje për të siguruar që viktimat të marrin ndihmën e nevojshme dhe autorët e dhunës të përgjigjen para drejtësisë dhe të dënohen.
- Arsimimi lidhur me çështjet e dhunës në familje duhet të bëhet pjesë e programeve në fakultetet e drejtësisë, Shkollën e Magjistraturës, Akademinë e Policisë, si dhe pjesë e trajnimeve të vazhdueshme që ofrohen nga Dhoma Kombëtare dhe Rajonale e Avokatisë.

## V. TRANSPARENCA DHE E DREJTA E INFORMIMIT

### 1. Hyrja dhe kuadri ligjor

Transparenca dhe e drejta e publikut për informim janë elemente kryesore në një shoqëri demokratike dhe shërbejnë për t'u dhënë medias, shoqërisë civile dhe organeve të tjera të interesuara mjetet për të vëzhguar me kujdes se si përdoren dhe drejtohen pushteti dhe burimet e tjera shtetërore.

E drejta për informim pasqyrohet në dokumente ndërkombëtare si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNj), Pakti Ndërkombëtar lidhur me të Drejtat Civile dhe Politike (PNDCP) dhe KEDNj.<sup>400</sup>

Neni 23 i Kushtetutës së Shqipërisë parashikon:

1. E drejta e informimit është e garantuar.
2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore....

Ligji “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”<sup>401</sup> (Ligji për informim) parashikon.

#### **Neni 3 – E drejta e Informimit**

Çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion për dokumentet zyrtare, që kanë të bëjnë me veprimtarinë e organeve shtetërore dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore, pa qenë i detyruar të shpjegojë motivet.

Autoriteti publik është i detyruar të japë çdo informacion në lidhje me një dokument zyrtar, përveç rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe.

Çdo informacion për një dokument zyrtar, që i është dhënë një personi, nuk mund t'i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur ky informacion përbën të dhëna vetjake të vetë personit, të cilit i është dhënë informacioni.

#### **Neni 4 – Kufizimi**

Nëse informacioni i kërkuar për një dokument zyrtar kufizohet me ligj, autoriteti publik i lëshon kërkuarit një deklaratë me shkrim, në të cilën tregohen arsyet e mosdhënies së informacionit dhe rregullat në bazë të të cilave ai mund ta kërkojë atë.

Nëse kufizimi është vetëm për një pjesë të të dhënave të dokumentit zyrtar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit.

<sup>400</sup> DUDNj - neni 19, PNDCP - neni 19 dhe KEDNj - neni 10.

<sup>401</sup> Ligji nr. 8503, datë 30 qershor 1999, “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”. Për komentet lidhur me këtë ligj nga organizata Article 19 [Artikulli 19] (organizatë e të drejtave të njeriut që merret me mbrojtjen dhe përkrahjen e lirisë së shprehjes dhe lirisë së informimit në botë), shih [http://www.osce.org/documents/html/pdftohtml/3760\\_en.pdf.html](http://www.osce.org/documents/html/pdftohtml/3760_en.pdf.html) [vizituar më 5 qershor 2006].

#### **Neni 6 – Detyrimi për cilësinë e shërbimit të informimit**

Autoriteti publik nxjerr rregullore dhe krijon lehtësi strukturore e praktike për marrjen nga ana e publikut, në mënyrë të saktë, të plotë, të përshtatshme e të shpejtë të informacionit për dokumentet zyrtare.

#### **Neni 9 – Dokumentet që Përgatiten Paraprakisht**

Në përputhje me ligjet, aktet nënligjore dhe rregullat e publikuara prej tij, autoriteti publik parapërgatit për shqyrtim apo kopjim, në pritje të kërkesës nga publiku, dokumente të tilla si:

- a) vendimet përfundimtare për një çështje të caktuar, përfshi qëndrimet e pakicës, si dhe urdhrat ose udhëzimet në zbatim të tyre;
- b) urdhrat dhe udhëzimet e brendshme që ndikojnë në marrëdhëniet e autoritetit publik me publikun;
- c) kopje të çdo dokumenti zyrtar, i cili i është dhënë më parë të paktën një personi, pavarësisht nga formati i tyre dhe që autoriteti publik beson se do të jetë me interes për persona të tjerë;
- ç) indeksin apo skedarët e dokumenteve zyrtare.

#### **Neni 10 – Afati për mospranimin e kërkesës**

Autoriteti publik vendos për mospranimin e plotë ose të pjesshëm të kërkesës brenda 15 ditëve nga depozitimi i saj. Në rastin e mospranimit të kërkesës, përgjigjja negative, e plotë ose e pjesshme, jepet e arsyetuar, me shkrim nga autoriteti publik.

#### **Neni 11 – Afati për përgjigje**

Autoriteti publik plotëson kërkesën brenda 40 ditëve nga depozitimi i saj, me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj parashikohet ndryshe.

#### **Neni 12 – Shtyrja e afatit**

Në rast se autoriteti publik e ka të pamundur plotësimin e kërkesës brenda afatit të parashikuar në nenin 11, për shkak të veçantisë së kërkesës ose të nevojës për t'u këshilluar me një palë të tretë, atëherë ai njofton me shkrim palën e interesuar, jo më vonë se shtatë ditë nga mbarimi i afatit të mëparshëm, për pamundësinë e realizimit të pjesshëm ose të plotë të kërkesës për informim, si dhe arsyet apo shkaqet që e kanë sjellë atë.

Në këtë rast, autoriteti publik i propozon palës së interesuar njërën nga zgjidhjet e mëposhtme:

- a) Caktimin e një afati të ri, i cili fillon në mbarim të afatit të mëparshëm dhe që nuk mund të jetë më shumë se 10 ditë, pa të drejtë përsëritje;
- b) përshtatjen e kërkesës nga ana e personit, në mënyrë të tillë, që të mund të respektohet nga ana e autoritetit publik afati i parashikuar në këtë ligj.

Personi i interesuar zgjedh njërin nga propozimet e mësipërme. Në rast se personi në fjalë nuk shpreh pëlqimin e vet para përfundimit të afatit të parë, autoriteti publik vendos shtyrjen e afatit.

#### **Neni 13 – Pagesat për shërbimin e informimit**

Për kryerjen e shërbimit të informimit për dokumentet zyrtare, nëse kjo kërkon shpenzime, autoriteti publik mund të vendosë tarifa, të cilat i përcakton paraprakisht.

Tarifat për shërbimet standarde ose për ato për të cilat është krijuar një përvojë bëhen publike. Tarifat për shërbimet e tjera përcaktohen rast pas rasti dhe i bëhen të njohura palës së interesuar në çastin e pranimit të kërkesës.

Tarifat nuk mund të jenë më të larta se kostoja për realizimin e shërbimit. Kjo kosto përfshin vetëm shpenzimet materiale për realizimin e shërbimit.

Të dhënat e përcaktuara në nenin 8 jepen pa pagesë.

Procedurat dhe vendimet për vendosjen e tarifave për shërbimin e informimit janë në vetvete dokument zyrtar, në kuptimin e këtij ligji.

Kështu, ligji parashikon se çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion pa qenë i detyruar të shpjegojë motivet e kësaj kërkesë dhe në vijim autoriteti publik duhet të organizohet në mënyrë të tillë që të lehtësojë për dhënien e informacionit në mënyrë të shpejtë. Personi që kërkon informacion ka të drejtë të marrë kopje të plota të dokumentit, ose nëse vetë personi e pranon atë, informacioni mund të jetë në një formë tjetër, qoftë edhe në formën gojore.

Vendimet përfundimtare për çështje të veçanta, p.sh., vendimet e gjykatës,<sup>402</sup> duhet të përgatiten paraprakisht në pritje të kërkesave nga publiku. Veç kësaj, duhet të përgatiten paraprakisht kopje të çdo dokumenti zyrtar i cili i është dhënë më parë të paktën një personi dhe për të cilin autoriteti publik beson se do të jetë me interes për persona të tjerë. Ligji për informim parashikon një afat 15-ditor për *refuzimin* e plotë ose të pjesshëm të kërkesës por një afat 40-ditor për *plotësimin* e kërkesës (kur kopjet paraprake nuk janë të detyrueshme).<sup>403</sup> Meqenëse kopjet e vendimeve dhe dokumenteve përfundimtare, të cilat i janë dhënë dikujt, duhet të përgatiten paraprakisht,<sup>404</sup> dhe meqenëse të gjitha vendimet gjyqësore u jepen palëve pjesëmarrëse në çështje, nuk aplikohet afati 40-ditor. Kopje të këtyre vendimeve duhet të jepen menjëherë sipas kërkesës.

Avokati i Popullit kujdeset për zbatimin e ligjit për informim.<sup>405</sup> Më 12 tetor 2005, Avokati i Popullit nxori disa rekomandime drejtuar Kryeministrit për rritjen e transparencës dhe zbatimin e ligjit për të drejtën për informim për dokumentet zyrtare, duke përgatitur një Rregullore tip.<sup>406</sup> Në rekomandimet, Avokati i Popullit vë re se, ndër

<sup>402</sup> Shënim: “Vendim përfundimtar ose gjykim përfundimtar” në krahasim me një vendim/gjykim “që ka marrë formë të prerë”. Një *vendim/gjykim përfundimtar* është një vendim i gjykatës për çështjen në themel ose ku gjykata shprehet për çështjen. Vendimi përfundimtar, normalisht mund të apelohej në një gjykatë të shkallës më të lartë. Vendimi/gjykimi *që ka marrë formë të prerë* është një vendim gjykate që nuk mund të ankimohet ose për shkak se ka mbaruar afati i animimit, ose sepse vendimi është marrë nga ndonjë gjykatë apeli, vendimet e së cilës nuk mund të apelohej, p.sh., Gjykata e Lartë ose Gjykata Kushtetuese në Shqipëri.

<sup>403</sup> Ligji “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, nenet 10-11.

<sup>404</sup> Ligji “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, neni 9.

<sup>405</sup> Ligji “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, neni 18. Shih gjithashtu ligjin nr. 8454, datë 4 shkurt 1999, “Për Avokatin e Popullit”.

<sup>406</sup> “Rekomandime për rritjen e transparencës dhe zbatimin e ligjit për të drejtën për informim për dokumentet zyrtare, duke përgatitur një Rregullore tip” [Rekomandime të AP], Avokati i Popullit, Republika e Shqipërisë; Nr. Prot. 177, Tiranë, më 12 tetor 2005.

arsye të tjera që krijojnë pengesa për zbatimin e së drejtës së informimit për dokumentet zyrtare, nëpunësit përgjegjës për të dhënë informacion dhe dokumente zyrtare, nuk trajnohen për çështje që kanë të bëjnë me marrjen e informacionit. Për të rregulluar këtë, nëpunësit duhet të ndërgjegjësohen që, si rregull, dosjet dhe dokumentet zyrtare, mund t'u bëhen të ditura *çdokujt*, mjaft që të mos shkelin të drejtën e personit tjetër dhe të mos përbëjë sekret shtetëror. Publiku i gjerë duhet të informohet dhe arsimohet për të drejtën e tij për informim dhe duhet t'i dijë procedurat administrative që përdor administrata publike.<sup>407</sup>

Për të unifikuar praktikat dhe procedurat e administratës publike lidhur me informimin, Avokati i Popullit, në bashkëpunim me USAID-in, hartoi një Rregullore tip për të drejtën e informimit. Në Rregulloren tip, shpjgohet kuptimi i dokumentit zyrtar, si dhe kufizimet në zbatimin e Rregullores tip. Veç kësaj, shpjgohet me hollësi se si duhen përpiluar kërkesat për informim. Miratimi i rregullores tip do të përmirësonte në shumë mënyra cilësinë e shërbimeve në dhënie të informacionit mbi dokumentet zyrtare. Megjithatë, veçojmë se, ajo nuk përfshin dokumente të tilla si vendime përfundimtare, kopje të të cilave duhet të përgatiten paraprakisht në bazë të kërkesave dhe të jepen menjëherë pas marrjes së një kërkesë jozyrtare ose një kërkesë në formë gojore.<sup>408</sup> Sidoqoftë, ekziston rreziku që Rregullorja tip të përdoret si argument për të mohuar marrjen e *menjëhershme* të këtij lloji informacioni.

*Koment:* Ndërsa nga njëra anë përgatitja paraprake e kopjeve të vendimeve përfundimtare lidhur me çështje të caktuara i shërben qëllimit të transparencës, nga ana tjetër nuk do të ishte praktike përgatitja e kopjeve të çdo vendimi gjykate pa patur kërkesë paraprake për to. Kjo gjë do të sillte kosto të panevojshme dhe do të kërkonte hapësirë fizike. Një interpretim pragmatik do të ishte që të përgatiteshin më përpara kopje të vendimeve me një interes të lartë publik, ndërsa kopje të vendimeve të tjera të përgatiten menjëherë sipas kërkesës.

---

<sup>407</sup> Rekomandime të AP, paragrafët 4, 8 dhe 9.

<sup>408</sup> Ligji “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, neni 9.



KPrP parashikon:

**Neni 105 – Marrja e kopjeve, ekstrakteve dhe vërtetimeve**

1. Gjatë procedimit dhe pas përfundimit të tij, cilido që ka interes mund të marrë, me shpenzimet e veta, kopje, ekstrakte ose vërtetime të akteve të veçanta.
2. Kërkesa shqyrtohet nga prokurori, për e aktet e hetimit paraprak, ose nga gjykata që ka dhënë vendimin për ato të shqyrtimit gjyqësor.
3. Lëshimi i kopjeve, ekstrakteve ose vërtetimeve nuk e heq ndalimin e publikimit.

**Neni 103 – Ndalimi i publikimit të aktit**

1. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve sekrete që lidhen me çështjen ose dhe vetëm i përmbajtjes së tyre nëpërmjet shtypit ose informacionit masiv.
2. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve josekrete deri në përfundimin e hetimeve paraprake.
3. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve të shqyrtimit gjyqësor kur gjykimi bëhet *me dyer të mbyllura*. Ndalimi i publikimit hiqet kur plotësohen afatet e caktuara me ligj për arkivat e shtetit ose kur ka kaluar afati prej dhjetë vjetësh nga data që vendimi ka marrë formën e prerë, por me kusht që publikimi të jetë autorizuar nga Ministri i Drejtësisë.
4. Ndalohet publikimi i gjeneraliteteve dhe i fotografive të të pandehurve dhe të dëshmitarëve të mitur, të akuzuar ose të dëmtuar nga vepra penale. Gjykata mund të lejojë publikimin vetëm kur e kërkojnë interesat e të miturit ose kur i mituri ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç.

Kështu, sipas KPrP, cilido që është i interesuar, mund të marrë kopje, ekstrakte ose vërtetime të akteve të veçanta. Sipas Komentarit të KPrP, “vërtetimi” konfirmon përmbajtjen e aktit ose të pjesëve të veçanta të tija.<sup>409</sup> Kjo u jep personave të interesuar të drejtën e plotë të informimit mbi përmbajtjen e akteve gjyqësore. Lëshimi i kopjeve, ekstrakteve ose vërtetimeve nuk e heq ndalimin e publikimit të aktit, prandaj ai që i ka marrë ato detyrohet të respektojë rregullat e caktuara në nenin 103 të Kodit të Procedurës Penale për *publikimin* e aktit.<sup>410</sup>

Asnjë nga aktet ligjore të sipërpërmendura nuk caktojnë mënyrën ose formën se si duhet të bëhet kërkesa d.m.th, nëse nevojitet kërkesë me shkrim. Megjithatë, kërkesa me gojë duhet të jetë e mjaftueshme, megjithëse për arsye praktike dhe veçanërisht kur kërkohet informacion për më shumë se një numër të kufizuar dokumentesh, mund të preferohet kërkesa me shkrim.

Për sa i përket afatit për mundësinë e plotësimit të kërkesës, afati brenda 15 ditëve është konsideruar në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare, ndërsa afati për plotësimin e kërkesës brenda 40 ditëve konsiderohet si afat kohe i gjatë, i papranueshëm.<sup>411</sup> Vendimet përfundimtare si dhe dokumentet e kërkuara përpara nga të

<sup>409</sup> Komentari i KPrP, fq. 181

<sup>410</sup> Komentari i KPrP, fq. 181

<sup>411</sup> Shih komentet nga organizata Article 19 [Artikulli 19], fq. 10-11 (shënimi 33). Është për t'u vënë re se komentet nuk bëjnë dallime midis afateve të mospranimit dhe atyre të plotësimit të kërkesës.

paktën një person, duhet të përgatiten paraprakisht dhe si rrjedhim të jepen menjëherë pas marrjes së kërkesës.

Si përfundim, një urdhër i Ministrisë së Drejtësisë lidhur me organizimin dhe funksionimin e administratës gjyqësore përsërit se gjykata duhet të krijojë kushte lehtësuese për marrjen e informacionit nga publiku në një mënyrë të saktë, të plotë dhe të shpejtë. Më tej parashikon që listat e gjyqeve të përgatiten dhe të bëhen publike.<sup>412</sup>

#### *Seanca gjyqësore publike dhe vendimet e gjykatës*

Një aspekt i transparencës dhe i së drejtës për informim, dhe një element thelbësor i të drejtës për një proces të rregullt, është e drejta e një gjykimi publik.<sup>413</sup> Kjo do të thotë se përveç se në raste të veçanta, ku ligji përcakton se kur zhvillohet gjykimi *in camera* (me dyer të mbyllura; pa praninë e publikut), kushdo ka të drejtë të paraqitet dhe të marr pjesë në seanca gjyqësore. E drejta për një gjykim publik është mbrojtje e domosdoshme për një proces gjyqësor të drejtë dhe të pavarur, si dhe një mjet për mbrojtjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Që e drejta për një gjykim publik të jetë efikase dhe praktike, datat e zhvillimit të seancave gjyqësore, si edhe ndryshimet përkatëse, duhet t'i bëhen të ditura publikut. Një aspekt tjetër i kësaj transparence është që gjykimet, d.m.th., vendimet gjyqësore përfundimtare, duhet të jepen publikisht.<sup>414</sup> Kjo mund të bëhet duke e lexuar gjykimin/vendimin gjyqësor në një seancë publike, duke e vënë vendimin në dispozicion të publikut (p.sh., duke i dhënë kopje kujt do që është i interesuar ose duke i publikuar vendimet në internet ose në fletore zyrtare), ose të dyja.

KPrP parashikon:

#### **Neni 339 – Publiciteti i seancës**

1. Seanca gjyqësore është publike, përndryshe quhet e pavlefshme.
2. Nuk pranohen në seancë të miturit nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe ata që janë në gjendje dehje, intoksikimi ose çrregullimi mendor.
3. Ndalohet prania në seancë e personave të armatosur, me përjashtim të pjesëtarëve të forcave të ruajtjes së rendit.

#### **Neni 340 – Rastet e gjykimit me dyer të mbyllura**

1. Gjykata vendos që shqyrtimi gjyqësor ose disa veprime të tij të zhvillohen me *dyer të mbyllura*:

<sup>412</sup> Urdhër i MD, nr. 1830, datë 3 prill 2001, “Për miratimin e Rregullores ‘Për organizimin dhe funksionimin e administratës gjyqësore’”, botuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, Nr. 17/2001 (prill, neni 24, paragrafët 7 dhe 8; shih gjithashtu nenin 5, paragrafi 4 dhe nenin 21, paragrafi 15.

<sup>413</sup> KEDNj, neni 6, paragrafi 1; Kushtetuta e Shqipërisë, neni 42, paragrafi 2.

<sup>414</sup> KEDNj, neni 6, paragrafi 1.

- a) kur publiciteti mund të dëmtojë moralin shoqëror ose mund të sjellë përhapjen e të dhënave që duhet të mbahen sekret në interes të shtetit, në qoftë se një gjë e tillë kërkohet nga organi kompetent;
- b) kur nga ana e publikut ka shfaqje që prishin zhvillimin e rregullt të seancës;
- c) kur është e nevojshme të mbrohet siguria e dëshmitarëve ose e të pandehurve;
- ç) kur gjykohet e nevojshme në pyetjen e të miturve
2. Vendimi i gjykatës për zhvillimin e seancës me dyer të mbyllura revokohet kur pushojnë shkaqet që e sollën atë.

#### **Neni 384 – Shpallja e vendimit**

1. Vendimi shpallet në seancë nga kryetari ose një anëtar i trupit gjykues me anë të leximit.
2. Shpallja vlen edhe si njoftim për palët që janë ose që duhet të konsiderohen të pranishme në seancë.

## **2. Realiteti shqiptar**

Më 7 qershor 2006, Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi (IDRA) dhe Casals & Associates, Inc., botoi përmbledhjen e rezultateve të sondazhit të vitit 2005 lidhur me korrupsionin në Shqipëri.<sup>415</sup> Sipas sondazhit, gjykatat janë vlerësuar si më pak transparente, ndërsa Forcat e Armatosura renditen si institucioni më transparent në Shqipëri.

### *Datat e zhvillimit të seancave gjyqësore*

Datat e zhvillimit të seancave gjyqësore shpallen në më të shumtën e rasteve në stendat e afishimit pranë hyrjes së gjykatave. Në bazë të kërkesës, kopje të datave të zhvillimit të seancave gjyqësore mund t'u jepen palëve të interesuara, të tillë si përfaqësuesve të medias, OJF-ve ose organizatave ndërkombëtare. Meqenëse datat e zhvillimit të seancave gjyqësore në shumë gjykata bëhen publike vetëm njëherë në javë, ose më rrallë, shtyrjet apo ndryshimet e seancave gjyqësore brenda kësaj periudhe nuk pasqyrohen në listat e shpallura. Kjo do të thotë se personat e interesuar duhet të pyesin në gjykatë me qëllim që të marrin vesh se kur do të zhvillohet seanca. Meqenëse gjykatat në Shqipëri nuk kanë atë lloj organizimi që t'u përgjigjen pyetjeve të publikut të gjerë me telefon, personat e interesuar mund të kenë nevojë të shkojnë në gjykatë çdo ditë për të mësuar, se kur do të zhvillohet seanca përkatëse. Listat e datave të seancave gjyqësore nuk tregojnë se në çfarë salle gjyqi do të zhvillohet seanca. Kjo gjë i detyron gjithashtu personat e interesuar të flasin me dikë në gjykatë për të mësuar se ku do të zhvillohet seanca.

<sup>415</sup> Korrupsioni në Shqipëri: Perceptime dhe Përvoja, Sondazhi 2005, Përmbledhje e Rezultateve [qershor 2006] <http://www.idra-al.org/pdf/shqip/IDRA - Korrupsioni ne Shqiperi - Permbledhje e Rezultateve.pdf> [vizituar më 8 qershor 2006]. Ky studim është analizuar gjithashtu në kapitullin për Korrupsionin.

Në Gjykatën e Rrethit Tiranë, ku seancat zhvillohen shpesh në zyrat e gjyqtarëve, cilido që dëshiron të marrë pjesë në një gjyq duhet të kontaktojë gjyqtarin që e ka çështjen në shqyrtim. Herë pas here, por jo gjithmonë, sekretarja është në gjendje të japë këtë informacion. Nganjëherë vëzhgues nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri janë informuar që seanca do të zhvillohet në një sallë gjyqi dhe vetëm në momentin e fundit informohen se do të zhvillohet në zyrën e gjyqtarit, dhe si përfundim mësojnë se ajo do të zhvillohet në sallën e gjyqit. Meqenëse ka hyrje të veçanta për në zyrat e gjyqtarëve dhe hyrje tjetër për në sallat e gjyqit, çdo ndryshim i detyron personat e interesuar të largohen nga godina e gjykatës dhe të hynë përsëri. Duke marrë në konsideratë që publiku zakonisht nuk lejohet të hyjë pas fillimit të seancës, kjo formë e ngatërruar mund të pengojë vërtet personat të marrin pjesë në seancë.

Në Gjykatën e Apelit Tiranë, listat e shpalljes së seancave gjyqësore afishohen në stendën që ndodhet jashtë godinës së gjykatës. Stenda e afishimeve ndahet në çështje civile dhe penale, por çështjet shpesh janë të përziera dhe është e vështirë të lexohen në stendë. Shpallja një herë në muaj e datave të seancave gjyqësore ka si pasojë që, në ato raste kur ka ndryshime të datave, këto data nuk bëhen publike në stendën e afishimit gjatë kësaj kohe, duke i detyruar personat e interesuar t'i drejtohen gjykatës për informacion. Rojet në hyrje nuk janë në dijeni të datave të përditësuara ose të ndryshuara dhe i referohen vetëm stendës. Gjykata nuk ka faqe të saj në internet dhe nuk ka zyrë të marrëdhënieve me publikun. Nuk ka zyrë informacioni dhe nuk mund të merret informacion pa caktuar më parë takim (ose pa njohje personale), prandaj është praktikisht e pamundur të gjinden datat e sakta të seancave gjyqësore në këtë gjykatë. Kryesekretarja është provuar që nuk ka dëshirë të japë informacion lidhur me datat e seancave gjyqësore.

Nga Kukësi, është njoftuar herë pas here se datat e seancave gjyqësore nuk bëhen publike ose ato bëhen publike me vonesë.

**Shembull – Datat e seancave gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Kukës**

- Lista e datave të seancave gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Kukës nuk ishin shpallur për publikun ose ishin shpallur me vonesë për datat e mëposhtme:
  - Nuk ishte shpallur asnjë datë ndërmjet fillimit të korrikut dhe 17 tetorit 2005.<sup>57</sup>
  - Nuk ishte shpallur asnjë datë ndërmjet 6 dhjetorit 2005 dhe 31 janarit 2006.
  - Nuk ishte shpallur asnjë datë ndërmjet 15 dhe 28 shkurt 2006.
  - Listat e seancave gjyqësore shpesh nuk janë të sakta për sa i përket datës dhe orës së seancave gjyqësore, si dhe për sa i përket akuzave.

<sup>416</sup> Periudha e pushimeve zgjati nga 20 korrik deri në 5 shtator 2005.

*Faqet e gjykatave në internet*

Gjykata e Lartë; Gjykata Kushtetuese; Gjykatat e Rretheve Tiranë, Shkodër, Fier, Vlorë dhe Kavajë; si dhe Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda kanë faqen e tyre të publikuar në internet.<sup>417</sup> Informacioni në këto faqe interneti ndryshon nga një gjykatë tek tjetra.

<b>Gjykata/ Faqja në internet</b>	<b>Kalendari i çështjeve</b>	<b>Kontakte</b>	<b>Vendime gjqësore</b>
<b>Gjykata e Lartë</b>	Po	Vetëm një adresë e-mail-i	Po, sipas faqes në internet, që nga viti 1999.
<b>Gjykata Kushtetuese</b>	Jo	Jo	Po, sipas faqes në internet, që nga viti 1992.
<b>Gjykata e Rrethit Tiranë</b>	Po, por e vështirë për të marrë informacion. Po të klikosh mbi “Datën e gjyqit penal” hapet një faqe me çështjet në gjykim. Është e mundur të gjendet data e seancës për çdo çështje. Çuditërisht nëse dikush klikon “Një vendim penal” hapet një faqe që rendit datat dhe çështjet e gjyqeve për një periudhë një-javore përlllogaritur nga data e futjes së informacionit. Kjo i ngatërron njerëzit dhe e bën të vështirë marrjen e informacionit nga një përdorues pa përvojë.	Komunikim me kryetarin, me Nënkryetarin dhe Kancelarin. Jepen numrat e telefonave të tyre të brendshëm por nuk jepet numri fiks i gjykatës.	Po, por e vështirë për t’i gjetur. Në vend që të klikohet mbi “Një vendim penal”, klikohet “Arkivi”. Duket gjithashtu se jo çdo vendim është i pasqyruar.

<sup>417</sup> Gjykata e Lartë <http://www.gjykataelarte.gov.al/> [vizituar më 8 qershor 2006]

Gjykata Kushtetuese <http://www.gjk.gov.al/> [vizituar më 8 qershor 2006]

Gjykata e Rrethit Tiranë <http://gjykata.altirana.com/> [vizituar më 12 qershor 2006]

Gjykata e Rrethit Shkodër <http://shkoder.gjykata.info/> [vizituar më 12 qershor 2006]

Gjykata e Rrethit Fier <http://fier.gjykata.info/> [vizituar më 13 qershor 2006]

Gjykata e Rrethit Vlorë <http://vlore.gjykata.info/> [vizituar më 13 qershor 2006]

Gjykata e Rrethit Kavajë <http://kavaje.gjykata.info/> [vizituar më 13 qershor 2006].

Gjykata/ Faqja në internet	Kalendari i çështjeve	Kontakte	Vendime gjyqësore
<b>Gjykata e Rrethit Shkodër</b>	Po, por hasen të njëjtat vështirësi si me faqen e internetit të Gjykatës së Rrethit Tiranë.	Komunikim online me kryetarin dhe kancelarin. Nuk ka informacion për t'u lidhur me persona të tjerë.	Po, por hasen të njëjtat vështirësi si me faqen e internetit të Gjykatës së Rrethit Tiranë. Nuk janë të pasqyruara të gjitha vendimet.
<b>Gjykata e Rrethit Fier</b>	Po	Komunikim online me kryetarin dhe kancelarin. Nuk ka informacion për t'u lidhur me persona të tjerë.	Po
<b>Gjykata e Rrethit Vlorë</b>	Jo	Komunikim online me kryetarin dhe kancelarin. Nuk ka informacion për t'u lidhur me persona të tjerë.	Po, por hasen të njëjtat vështirësi si me faqen e internetit të Gjykatës së Rrethit Tiranë. Nuk janë të pasqyruara të gjitha vendimet.
<b>Gjykata e Rrethit Kavajë</b>	Po, por renditen vetëm seancat e <i>kaluara</i> gjyqësore dhe jo ato që do të zhvillohen.	Jo	Po, por hasen të njëjtat vështirësi si me faqen e internetit të Gjykatës së Rrethit Tiranë. Nuk janë të pasqyruara të gjitha vendimet.
<b>Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda</b>	Jo. Sipas faqes në internet, lista javore e çështjeve do të pasqyrohet "së shpejti".	Po, informacion i plotë kontakti me adresën, numrat e telefonit dhe faksit, adresën e e-mail-t dhe një hartë që tregon vendndodhjen e gjykatës.	Jo. Sipas informacionit në faqen e internetit, çështjet në gjykim dhe çështjet e përfunduara do të pasqyrohen "së shpejti".

Siç mund të shihet, nga tetë gjykata me faqe në internet, vetëm pesë prej tyre rendisin datat e seancave gjyqësore. Megjithatë, gjetja e këtyre datave është e ndërlikuar dhe lind pyetja nëse një përdorues pa përvojë mund t'i gjejë datat e seancave gjyqësore. Vetëm njëra nga faqet e internetit, ajo e GjKR, rendit informacion të plotë kontakti. Ndonëse konsiderohet si përmirësim bërja publike e një pjese të informacionit të kontaktit, duket

shumë e vështirë nga ana praktike për çdo person të interesuar të shohë se cilat çështje do të gjykohen në një ditë të caktuar, do t'i duhej t'i dërgonte gjykatës një mesazh elektronik dhe është e dyshimtë që është vendosur një sistem për t'iu përgjigjur këtyre kërkesave në kohën e duhur.

### *Mundësia e marrjes së informacionit nga gjykatat dhe prokuroritë*

Si pjesë e Programit për Zhvillimin e një Gjykimi të Drejtë, gjykatave që janë objekt studimi i Programit të OSBE-së në rrethe, u janë kërkuar kopje të vendimeve përfundimtare gjyqësore, disa vendime të caktimit të masës së sigurisë të arrestit në burg dhe disa kopje të kërkesave për gjykim / kërkesë-padive. Prokurorive u është kërkuar të lejojnë vëzhgimin e disa dosjeve pas përfundimit të çështjeve.<sup>418</sup> Si rrjedhojë, gjykatave u janë kërkuar kopje të të gjitha vendimeve gjyqësore lidhur me dhunën në familje për një periudhë kohe të caktuar, ndërsa prokurorive dhe komisarivateve të policisë u është kërkuar informacion për gjykatat lidhur me numrin e çështjeve ose kallëzimeve për dhunë në familje që ato kanë shqyrtuar gjatë të njëjtës periudhë kohe.<sup>419</sup>

### *Vendimet gjyqësore*

Në shumicën e rasteve, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka marrë kopjet dhe informacionin që ka kërkuar. Njanjëherë informacioni është siguruar menjëherë, njanjëherë vetëm pas disa vonesave të konsiderueshme dhe përsëritjes së kërkesës. Shumica e gjykatave që mbulon ky studim, duken deri diku të ambientuara me dhënie e kopjeve të vendimeve përfundimtare gjyqësore, por jo kërkesave për vendime gjyqësore që kanë të bëjnë me një fushë të caktuar, si p.sh., me dhunën në familje. Asnjë nga gjykatat nuk kishte ndonjë organizim të veçantë për të lehtësuar dhënie e këtij informacioni.

Megjithatë, disa gjykata nuk kanë lejuar dhënie e kopjeve të vendimeve gjyqësore. Kështu, ish-kryetari i komanduar i Gjykatës së Rrethit Durrës theksoi se kopjet jepen vetëm për vendime të çështjeve civile, ndërsa për çështjet penale, kopjet u jepen vetëm të pandehurit dhe avokatit mbrojtës.<sup>420</sup> Arsyeimi për këtë ishte që të pandehurit mund të vihen në siklet nëse vendimi i jepen dikujt tjetër në dorë. Kryetari i komanduar më pas theksoi se kishin kufizuar mundësinë e avokatëve për të marrë dosjet, meqenëse ata mund të hiqnin provat! Me emërimin e Kryetarit të ri të Gjykatës së Rrethit Durrës, situata është përmirësuar ndjeshëm.<sup>421</sup>

Kryetarët e dy Gjykatave të Rrethit Tropojë dhe Kukës shprehën qëndrime të njëjta me atë të kryetarit të komanduar në Durrës. Të dy theksuan se ata nuk i jepnin askujt kopje të vendimeve përveç të pandehurit dhe avokatit mbrojtës.<sup>422</sup> Megjithëse kërkesat për

<sup>418</sup> Kërkesat u dërguan në Gjirokastrë, Vlorë, Fier, Lushnje, Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Kukës, si edhe në Prokurorinë e Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Një kopje e kërkesës iu dërgua Prokurorit të Përgjithshëm me shpjegimin se vëzhgimi nuk ishte për të marrë informacion të veçantë, por për të parë kopjet e vendimeve të gjykatës që mbaheshin në prokurori. Shih gjithashtu kapitullin 1, paragrafi 14.1: Studimi i dosjeve të prokurorisë.

<sup>419</sup> Shih gjithashtu Kapitullin IV, Dhuna në familje dhe sistemi i së drejtës penale.

<sup>420</sup> Takim me kryetarin e komanduar të Gjykatës së Rrethit Durrës, Rexhep Bekteshi, në 24 maj 2005.

<sup>421</sup> Ervin Metalla u emërua Kryetar i Gjykatës së Rrethit Durrës në fillim të nëntorit 2005.

<sup>422</sup> Takim me Kryetarin e Gjykatës së Rrethit Tropojë, Kujtim Dusha, në 30 maj 2005 dhe me Kryetarin e Gjykatës së Rrethit Kukës, Granit Qypi, në 31 maj 2005.

marrjen e vendimeve gjyqësore nuk janë mohuar shprehimisht në Gjykatën e Rrethit Shkodër, ka qenë e vështirë marrja e tyre. Një kërkesë e bërë kohët e fundit për një kopje të një vendimi gjyqësor, i cili nuk ishte bërë publik në faqen e internetit të gjykatës, nuk u pranua me arsyetimin se vendimi ishte apeluar, dhe si rrjedhim nuk ishte i formës së prerë, që sipas sekretares së gjykatës nënkuptonte që kopje të këtij vendimi nuk mund të jepeshin.<sup>423</sup>

Gjykata e Apelit Tiranë ka mohuar vazhdimisht mundësinë e marrjes së kopjeve të vendimeve gjyqësore nga përfaqësues të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri me arsyetimin se ata nuk i japin kopje askujt. Kjo ka ndodhur pavarësisht nga fakti se kjo gjykatë në shumë raste të tjera ka dhënë vendime në bazë të kërkesave. Pas kërkesave të përsëritura, ka qenë e mundur të merren të gjitha vendimet gjyqësore të kërkuara. Është krijuar përshtypja se informacioni është dhënë pas njëfarë kohe për shkak se e kërkonte OSBE-ja. Si rrjedhim, është e pamundur nxjerrja e konkluzioneve për mënyrën se si merren në shqyrtim kërkesat e një qytetari të zakonshëm.

Nga GjKR, është kërkuar marrje e vendimeve gjyqësore, dosjeve dhe kopjeve të padive për çështje të përfunduara dhe në proces. Nuk ka pasur probleme për marrjen e kopjeve të vendimeve ndonëse, nganjëherë vendimet nuk ishin të të gatshme në formë të shkruar dhe u vunë në dispozicion vetëm pas një vonese të konsiderueshme. Për sa i përket kërkesës për marrjen e kërkesë-padive dhe dosjeve gjyqësore, Kancelari i gjykatës u përgjigj me shkrim, duke sqaruar se kopjet mund të konsultoheshin vetëm pas kontaktit me arkivin dhe aprovimin nga Kryetari.<sup>424</sup> Për çështje që gjykoheshin nga GjKR, kopjet e kërkesë-padive dërgoheshin me miratimin e gjyqtarit të çështjes. Çmimi për çdo faqe të fotokopjuar është 10 lekë.<sup>425</sup> Për sa u përket çështjeve që apelohe, vëzhguesit e OSBE-së iu drejtuan gjykatës që merrte çështjen në dorëzim. Pas analizës së kërkesë-padisë dhe vendimit për një çështje të veçantë, vëzhguesit kërkuan mundësinë për të parë dosjen gjyqësore.<sup>426</sup> Dukej qartë se nuk kishte ndonjë praktikë apo strukturë të ngritur për shqyrtimin e kërkesave të tilla dhe vëzhguesve iu tha se gjatë vitit të punës të GjKR-së (që kishte mbaruar në kohën që u bë studimi), nuk ishte bërë asnjë kërkesë e tillë në gjykatë gjatë kësaj kohe. Përveç kësaj, ishin bërë përpjekje për të lehtësuar studimin e dosjes. Mund të thuhet se mundësia që u ofrua nga GjKR ishte e kënaqshme, të paktën për Prezencën e OSBE-së në Shqipëri, duke marrë në konsideratë situatën logjistike të gjykatës, e cila deri para pak kohësh ndante ambientet me Gjykatën e Rrethit Tiranë, e cila është pajisur shumë më mirë.<sup>427</sup>

Për sa i përket të drejtës për të parë dosjet gjyqësore në Gjykatën e Apelit Tiranë, vëzhguesve iu tha se vetëm avokati mbrojtës mund të shohë një dosje penale, ndërsa çdo palë tjetër e interesuar mund të shohë një dosje civile.<sup>428</sup>

<sup>423</sup> Vendimet e Gjykatës janë publike nga momenti që ato shpallen dhe pavarësisht nëse ato kanë marrë formë të prerë. Kopjet duhet të përgatiten para marrjes së kërkesave nga publiku

<sup>424</sup> Letër nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, 13 prill 2005.

<sup>425</sup> Siç parashikohet në KPrP, neni 105, paragrafi 1.

<sup>426</sup> Për sa u përket dosjeve të studiuara, shih "Të drejtat gjatë paraburgimit".

<sup>427</sup> GjKR është transferuar në mjediset e saj.

<sup>428</sup> Takim, 5 maj 2005, me Kryetarin e Gjykatës së Apelit Tiranë, Muharrem Kushe.



*Vendimet gjyqësore të disponueshme në internet*

Siç mund të shihet nga tabela më sipër, gjashtë prej faqeve në internet japin mundësi për njohjen me disa prej vendimeve gjyqësore, por jo me të gjitha, si një dokument në Microsoft Word. Për disa vendime, vetëm dispozitivi është bërë publik në internet.

Bërja publike e vendimeve gjyqësore në internet tregon një përmirësim të dukshëm dhe i jep publikut të gjerë mundësi të shikimit të vendimeve gjyqësore në një shkallë të gjerë. Kjo në vetvete mund të shërbejë për të përmirësuar nivelin e shkrimit dhe arsyetimit ligjor, si edhe të rrisë ndjeshëm nivelin e transparencës dhe përgjegjësinë e gjyqtarëve. Sidoqoftë, për këtë qëllim, është e rëndësishme që të ketë rregulla të qarta që specifikojnë kriteret për të mundësuar bërjen publike të vendimeve në internet. Për shembull, duhet të përcaktohet se në çfarë mase duhet të bëhen publike në internet të dhënat personale të të pandehurve, të dëshmitarëve dhe të pjesëmarrësve të tjerë në gjykim. Për më tepër, duhet të sigurohet që faqet në internet të gjykatave të mos kërkohen me emër të të pandehurit apo me emër të ndonjë pjesëmarrësi tjetër në gjykim, gjë me të cilën mund të abuzohet lehtë. Faqet në internet gjithashtu duhet të punohen më tej për të qenë transparente dhe të përdoren me lehtësi.

Ndonëse një vendim gjykate, duke përfshirë emrat e pjesëmarrësve në procesin gjyqësor, është dokument publik dhe si i tillë, i disponueshëm për këdo që bën kërkesë, qëllimi i publikimit të vendimeve në mënyrë të plotë mund të arrihet pa dhënë emrat e plotë të personave që marrin pjesë në procesin gjyqësor. Shqetësimet për sigurinë dhe integritetin e personave duhet të peshohen në mënyrë të përshtatshme përkundrejt të drejtës për informim. Në Suedi, kjo është zgjidhur duke dhënë vetëm inicialet e të pandehurve dhe personave të tjerë pjesëmarrës në procesin gjyqësor në versionin e vendimeve që gjenden nëpërmjet internetit. Megjithatë, informacioni i plotë do të vihej në dispozicion në bazë të kërkesës së kujtdo të interesuar, me përjashtim të rasteve kur informacioni është i fshehtë për arsye të ligjshme.

*Prokuroritë*

Marrja e informacionit lidhur me dosjet penale u kërkua vetëm për çështjet ku hetimi kishte përfunduar dhe çështja ishte gjykuar, dhe ishte marrë vendimi në gjykatë. Kërkesa për informim kufizohej më pas për atë pjesë të dosjes së prokurorit që dërgohet në gjykatë së bashku me kërkesën për gjykim, e cila është një dokument zyrtar.<sup>429</sup> Asnjë nga prokuroritë që iu kërkua ky informacion për të parë dosjen e prokurorit, nuk kishte marrë më parë një kërkesë të tillë. Kjo çështje më parë ishte diskutuar me kryeprokurorin e Prokurorisë për Krime të Rënda.<sup>430</sup> Ndonëse përgjigjja e tij e parë ishte se neni 105 i KPrP i referohej vetëm të drejtës së *palëve të interesuara*, siç është avokati mbrojtës, ai pranoi se në *parim* neni kishte hapësirë të gjerë për veprim. Para se të shprehej i gatshëm për të dhënë informacionin e kërkuar, ai u kërkoi vëzhguesve të njoftonin Prokurorin e Përgjithshëm. Ndonëse kjo nuk është një procedurë e parashikuar në ligj, Prokurorit të Përgjithshëm iu dërgua një letër informimi. Pas kësaj, u garantua mundësia

<sup>429</sup> KPrP, neni 332.

<sup>430</sup> Takim, 27 janar 2005.

për të parë dosjet në Prokurorinë e Krimeve të Rënda. Mundësia për të parë dosjet në Prokuroritë e Rretheve Durrës, Fier, Gjirokastrë, Lushnje, Tiranë dhe Vlorë u garantua pa hezitim. Pavarësisht se prokuroritë nuk e kishin praktikë marrjen e kërkesave të tilla dhe pavarësisht nga mungesa e strukturës për lehtësimin e dhënies së informacionit mbi dosjet, prokuroritë u vunë në dispozicion dhe dhanë ndihmesën e tyre për këqyrjen e këtyre dosjeve.

Një kërkesë për këqyrjen e disa dosjeve të veçanta, u dorëzua në Prokurorinë e Rrethit Kukës më 9 janar 2006. Në takim, Kryeprokurori i rrethit Kukës u përgjigj se vetëm palët pjesëmarrëse në një çështje mund të marrin informacion lidhur me dosjen e prokurorit. Më pas, prokuroria plotësoi formularët, të cilat ishin dërguar si pjesë e kërkesës. Pas disa përpjekjeve për të pasur mundësi drejtpërsëdrejti për të këqyrrur dosjet, kryeprokurori u përpoq të këshillohej me Prokurorin e Përgjithshëm, por kjo nuk u arrit. Pas diskutimeve të mëtejshme, u dorëzua një kërkesë e re për mundësinë e këqyrjes së drejtpërdrejtë të dosjeve. Një kopje e kësaj kërkesë iu dërgua Prokurorit të Përgjithshëm. Pas një sërë kontaktesh të tjera dhe pasi kryeprokurori ishte këshilluar me kolegët e tij në Shkodër, më në fund, më 22 shkurt 2006 u dha e drejta për të këqyrrur këto dosje. Reagimet ishin shumë të ngjashme me ato të Prokurorisë së Rrethit Shkodër. Pas shumë takimeve me kryeprokurorin dhe pasi ai ishte këshilluar me Prokurorin e Përgjithshëm, si edhe me Prokurorinë e Rrethit Kukës, u lejua këqyrja e dosjeve.

#### *Seancat gjyqësore*

Proceset gjyqësore në Shqipëri, në përgjithësi, zhvillohen me dyer të hapura dhe ka shumë pak incidente të denoncuara ku personat që janë të interesuar të marrin pjesë në një seancë gjyqësore, t'u jetë mohuar *shprehimisht* hyrja. Megjithatë, veçanërisht në Tiranë, seancat gjyqësore zhvillohen më shpesh në zyrat e gjyqtarëve se sa në sallat e gjyqit. Kjo është shqetësuese jo vetëm për shkak të hapësirës së kufizuar në zyrat e gjyqtarëve që kufizon ndjeshëm personat e interesuar të ndjekin seancën. Që kjo gjë ndodh në praktikë, është vërejtur në shumë raste. Në rastin më të mirë, zyrat e gjyqtarëve pajisen me disa karrige më shumë (të formave dhe madhësive të ndryshme), por nuk ka hapësirë për prokurorin dhe avokatin që të hapin letrat e tyre ose të mbajnë shënime gjatë zhvillimit të seancës. Mundësia e palëve për të hyrë në zyrat e gjyqtarëve është gjithashtu shqetësim, sepse lehtëson kontaktet e padëshirueshme midis palëve dhe gjykatës, të cilat mund të përdoren për qëllime korruptive ose si presion mbi gjyqtarin. Si përfundim, seancat gjyqësore në zyrat e ngarkuara të gjyqtarëve, nganjëherë me palët e kërrusura mbi letrat e tyre që u rrëshqasin nga prehri, kontribuojnë pak në ruajtjen e solemnitetit të seancës gjyqësore dhe respektin që duhet të kenë palët dhe publiku për gjykatën si institucion i drejtësisë.

Nga Kukësi, është raportuar se anëtarët e familjes së personave të gjykuar për çështje penale nuk kanë qenë në dijeni për të drejtën e marrjes pjesë gjatë zhvillimit të gjyqimit.

Një problem i një natyre tjetër është se seancat gjyqësore rrallëherë fillojnë në orarin e caktuar dhe se ato shpesh herë shtyhen. Meqenëse, në shumicën e rasteve nuk ka ambiente pritjeje pranë sallave të gjyqeve, njerëzit presin, nganjëherë me orë të tëra, jashtë godinës së gjykatës. Në Gjykatën e Rrethit Tiranë, nga ana tjetër, korridoret jashtë zyrave të gjyqtarëve janë të mbushura me njerëz që presin gjykimin e çështjes ose të takojnë gjyqtarin apo sekretaren. Kjo është pa dyshim e pakënaqshme nga pikëpamja e sigurisë. Ajo krijon gjithashtu një mjedis pune kaotik për gjyqtarët të cilët kanë nevojë për qetësi për të hartuar vendimet e tyre.

Gjykata e Apelit në Tiranë rrethohet nga një gardh dhe personat që dëshirojnë të ndjekin seancat nuk lejohen të hyjnë derisa sekretarja e çështjes të dalë dhe të njoftojë fillimin e seancës. Ambienti është zakonisht i mbushur me njerëz dhe në të paktën një rast, nuk pati njoftim për fillimin e seancës, ose njoftimi u dha në një mënyrë të tillë që nuk u dëgjua nga të pranishmit. Kur u kërkua shpjegim për këtë seancë, vëzhguesve iu tha se ajo ishte zhvilluar, dhe se nuk ishte mbajtur me *dye të mbyllura*, por nuk kishin marrë pjesë mjetet e informacionit masiv ose publiku i gjerë.<sup>431</sup> Ka ndodhur edhe që është bërë njoftimi për seancën, por vëzhguesit që kanë shkuar drejt sallës së gjyqit, nuk kanë hyrë dot brenda – bashkë me shumë të tjerë të interesuar nga publiku – me arsyetimin se seanca tashmë kishte filluar. Me fjalë të tjera, nuk kishte kohë të mjaftueshme që njerëzit të hynin në sallën e gjyqit. Në raste të tjera është vënë re që përfaqësues të OSBE-së, por jo të mjeteve të informimit masiv, janë lejuar të hyjnë brenda. Ndërsa në disa raste të tjera, vëzhguesit janë pyetur se përse donin të merrnin pjesë në seancë, e më pas sekretarja ka shkuar të pyesë kryetarin e gjykatës përpara se t'i lejonin të hynin brenda. Kjo është perceptuar si një nga gjykatat në Shqipëri që jep më pak mundësi për të ndjekur seancat gjyqësore.

### 3. Vërejtje përfundimtare

Kompjuterizimi i disa gjykatave kryesore në vend dhe krijimi i faqeve në internet ku vendimet e gjykatave hidhen në mënyrë të plotë, është një hap i rëndësishëm përpara për një sistem gjyqësor më transparent në Shqipëri. Megjithatë, mbetet shumë për t'u bërë për t'u dhënë mjeteve të informimit masiv dhe publikut të gjerë një pamje më të gjerë e të plotë të sistemit shqiptar të drejtësisë, e cila është e domosdoshme në një shoqëri demokratike që bazohet në respektin për të drejtat e njeriut dhe shtetin e së drejtës. Prandaj, gjykatat dhe prokuroritë duhet të vendosin rregulla të brendshme, si edhe të krijojnë struktura për t'u përgjigjur me kujdes kërkesave për mundësinë e marrjes së informacionit. Publiku i gjerë duhet të ndërëgjegjësohet për të drejtën e marrjes pjesë në seancat gjyqësore dhe të drejtën për të marrë informacion për vendimet gjyqësore, si edhe informacion rreth dokumenteve të tjera zyrtare në gjykata dhe prokurori.

<sup>431</sup> Seancë më 1 shkurt 2006, çështje lidhur me konfliktin e Zogut të Zi.

## **Rekomandime**

1. Rekomandimi tip i hartuar nga Avokati i Popullit duhet të shërbejë si bazë për krijimin e akteve nënligjore lidhur me të drejtën për informim.
2. Të gjithë nëpunësit publik duhet të marrin trajnim të detyrueshëm në lidhje me të drejtën e informimit lidhur me dokumentet zyrtare.
3. Të gjithë personat që punojnë në gjykata ose prokurori duhet të trajnohen në mënyrë specifike për të drejtën e informimit lidhur me vendimet gjyqësore dhe dokumentet e tjera të gjykatave/prokurorive.
4. Përmes fushatave të ndërgjegjësimit publik, publiku i gjerë duhet të ndërgjegjësohet për të drejtën e pjesëmarrjes në seanca gjyqësore dhe për marrjen e informacionit lidhur me dokumentet publike.
  - Publiku i gjerë duhet të inkurajohet gjithashtu të kërkojë informacion nëpërmjet kanaleve zyrtare.
5. Çdo gjykatë dhe prokurori duhet të ketë struktura të përcaktuara për t'iu përgjigjur kërkesave për informacion.
  - Kjo mund të bëhet ose duke caktuar një nga nëpunësit e gjykatës/prokurorisë si pikë kryesore kontakti, ose duke emëruar një zëdhënës/nëpunës shtypi ose duke ngritur një zyrë informacioni brenda gjykatës/prokurorisë.
6. Nëpërmjet faqeve të internetit dhe/ose stendave të afishimit pranë gjykatave/prokurorive, publiku i gjerë duhet të informohet për mënyrën e marrjes së kopjeve të vendimeve gjyqësore dhe për marrjen e dokumenteve të tjera të gjykatës/prokurorisë.
7. Informacioni i kontaktit për çdo gjykatë dhe prokurori, duke përfshirë numrat e telefonit dhe adresën e e-mail-it, duhet të vihet në dispozicion të publikut të gjerë me anë të numërorëve telefonikë të përditësuar dhe të faqes së internetit të Ministrisë së Drejtësisë. Gjykatat me faqe interneti duhet të bëjnë publik në internet informacionin e kontaktit.
8. Listat e seancave gjyqësore duhet të përditësohen çdo ditë dhe për çdo seancë, duhet të përcaktohet salla ku ajo do të zhvillohet.
9. Stendat e afishimit, ku pasqyrohen datat e seancave gjyqësore, duhet të organizohen në një mënyrë të qartë dhe të kuptueshme.
10. Gjykatat me faqet e tyre në internet, duhet të bëjnë publike datat e sakta të seancave gjyqësore dhe kërkimi në këto faqe të jetë sa më i lehtë.

11. Gjykatat/prokuroritë me faqe interneti duhet të analizojnë, të përditësojnë dhe t'i ndërtojnë faqet e tyre të internetit në mënyrë të tillë që informacioni i dhënë të gjendet lehtë dhe pa vështirësi për përdoruesin.
  - Megjithatë, kriteri i kërkimit në faqet e internetit të gjykatave, nuk duhet të jetë me emër të të pandehurit apo ndonjë pjesëmarrësi tjetër në gjykim.
12. Inspektorët pranë Drejtorisë së Inspektimit në Ministrinë e Drejtësisë, gjatë inspektimeve të tyre, duhet të kenë parasysh çështje që kanë të bëjnë me transparencën.
  - Duhet të vlerësohet mënyra e bërjes publike dhe përditësimit të datave të seancave gjyqësore, si dhe informacionit të kontaktit.
  - Duhet të vlerësohet mundësia e hyrjes së shpejtë në faqet e të internetit të gjykatave dhe prokurorive, si dhe përdorimit të tyre me lehtësi.



## VI. KORRUPSIONI BRENDA SISTEMIT SHQIPTAR TË DREJTËSISË

Korrupsioni – shpërdorimi i pushtetit të besuar për përfitime personale – ka një efekt shumë pengues për zhvillimin e mjedisit ekonomik, social dhe politik, në të cilin ndodh. Korrupsioni shfaqet në çdo sistem social dhe në të gjitha nivelet e tij. Ai ndodh si në vendet e industrializuara po ashtu dhe në ato në zhvillim.

Korrupsioni, deri kohët e fundit, është mbrojtur si një mënyrë efikase për të shmangur rregullat tepër burokratike me të cilat nuk mund të manovrohet. Pretendohej se korrupsioni mund të inkurajojë efikasitetin ekonomik, të luajë rol rishpërndarës dhe madje të shërbejë si mjet për integrimin kombëtar.

Pikëpamje të tilla dhe besimi se korrupsioni është thjesht një fazë e zhvillimit, nuk besohen më as nga analistë ekonomikë as nga ata politikë. Me të vërtetë, njohja dhe përcaktimi i kostos, dhe pasojat e korrupsionit që nga mesi i viteve 1990, ka luajtur një rol të rëndësishëm në përfshirjen e korrupsionit në programet kombëtare dhe ndërkombëtare.<sup>432</sup>

### 1. Korrupsioni si vepër penale

Korrupsioni i personit që ushtron funksion publik është shpërdorimi i funksionit publik për përfitime vetjake. Veprat penale që lidhen me korrupsionin përfshijnë shpërdorimin e detyrës; kërkimin, dhënien dhe marrjen e ryshfetit (mitëdhënien dhe mitëmarrjen); si edhe shpërdorimin e fondeve publike.<sup>433</sup> Korrupsioni brenda sistemit gjyqësor trajtohet në nenet 319 dhe 319/a të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, i cili parashikon:

#### **Neni 319 – Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë**

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, gjyqtarit, prokurorit ose çdo punonjësi tjetër të organeve të drejtësisë, për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga një vit deri në katër vjet dhe me gjobë nga katërqind mijë deri në dy milion lekë.

#### **Neni 319/a – Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë**

Kërkimi apo marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi, që vjen nga përfitimi i parregullt, nga gjyqtari, prokurori ose funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë, për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me

<sup>432</sup> Cituar nga Transparency International Anti-Corruption Handbook: National Integrity Systems in Practice (Introduction)[ Transparency International, Manual kundër Korrupsionit: Sistemet kombëtare të integritetit në praktikë] (Hyrje) <http://www.transparency.org/ach/introduction.html> [vizituar më 13 qershor 2006].

<sup>433</sup> KP, nenet 244, 245, 245/1, 248, 250, 256, 259, 260, 319, 328.

detyrën e funksionin e tij, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet dhe me gjobë nga tetë qind mijë deri në katër milionë lekë.

Si rrjedhim, përbën vepër penale për një gjyqtar, prokuror ose funksionar tjetër brenda organeve të drejtësisë, të kërkojë ose të marrë çdo lloj shpërblimi, dhurate ose përfitimi për kryerjen ose moskryerjen e një veprimi. Po kështu, përbën vepër penale kur një person, p.sh., një palë, avokat mbrojtës apo çfarëdolloj njeri tjetër të interesuar për çështjen, t'i ofrojë ose t'i japë shpërblime të tilla një gjyqtari ose prokurori në mënyrë që të kryejë ose mos kryejë një veprim. Kjo do të thotë se çfarëdolloj dhurate apo përfitimi, sado i vogël qoftë, si një kafe e ofruar për të ndikuar te një gjyqtar apo prokuror, përbën vepër penale. Sigurisht, një kafe, në shumicën e rasteve, është e pamjaftueshme për të korruptuar një person, por mund të jetë hapi i parë për të arritur një marrëveshje korruptive. Në fakt ka dy, dhe nganjëherë tri vepra penale: ajo që kryhet nga personi që jep shpërblimin, ajo që kryhet nga ndërmjetësi, p.sh., avokati mbrojtës, si dhe ajo që kryhet nga gjyqtari ose prokurori që merr shpërblimin.

## 2. Perceptimi i korrupsionit në Shqipëri

Në 2003, Shqipëria, me 2.5 pikë, u rendit në vendin e 92-të nga 133 vende të marra në studim për Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit nga Transparency International (IPK).<sup>434</sup> Rezultati varion nga 10 deri në 1, ku niveli më i lartë 10 tregon se niveli i perceptuar i korrupsionit është zero dhe niveli më i ulët 1 tregon se korrupsioni perceptohet sikur dominon shtetin. Në vitin 2003, Finlanda, me një rezultat prej 9.7 perceptohej si vendi më pak i korruptuar, ndërsa Bangladeshi me rezultatin 1.3 perceptohej si vendi më i korruptuar. Në vitin 2004, Shqipëria renditej në vendin e 108-të nga 145 vendet e marra në studim, me po aq pikë sa në vitin 2003. Në vitin 2005, Shqipëria u vlerësua me 2.3 pikë, bashkë me Nigerinë, Rusinë dhe Sierra Leonen dhe u rendit në vendin e 127-të ndër 158 vendet e anketuara. Islanda, me 9.7 pikë arriti rezultatin më të lartë, ndërsa Çad-i me 1.3 pikë, arriti më të ultin. Shqipëria arriti rezultatin më të ulët në krahasim me vendet e tjera evropiane. Vendi evropian i renditur një vend më sipër ishte Republika ish-Jugosllave e Maqedonisë, e cila u rendit në vendin e 102-të me një rezultat prej 2.7 pikësh. Shqipëria pra perceptohet si vendi më i korruptuar evropian dhe niveli i perceptuar i korrupsionit që atëherë nuk është përmirësuar, por ka rënë gjatë tri viteve të fundit, periudhë gjatë së cilës, Shqipërinë ka rënë nga vendi i 92-të në të 127-in. Shprehur në një mënyrë që ka më shumë kuptim nga ana statistikore (duke parë rritjen në përgjithësi të numrit të vendeve të anketuara), pak më pak se 31% e vendeve në vitin 2003 u renditën më poshtë se Shqipëria, ndërsa në vitin 2005 pak më pak se 20% ishin më keq.

Qeveria e re që erdhi në fuqi pas zgjedhjeve të korrikut të vitit 2005, u angazhua të trajtonte nivelet tipike të korrupsionit brenda shoqërisë shqiptare. Kështu, në mars të

<sup>434</sup> Shih <http://www.transparency.org/surveys/index.html#cpi> [vizituar më 13 korrik 2006].



vitet 2006, Grupi mbikëqyrës i firmave piramidale paditi kryetarin e mëparshëm të tij, Farudin Arapin dhe kompania shtetërore e telekomunikacioneve filloi hetimin ndaj ish-punonjëseve të saj – të gjithë me akuzën e korrupsionit. Komisioni i Venecias i Këshillit të Evropës dha mendimin e tij lidhur me projektvendimin e qeverisë për dorëheqjen nga imuniteti të deputetëve me qëllimin e ndjekjes penale për korrupsion - një vendim që ishte gjerësisht në përputhje me mendimin e qeverisë.<sup>435</sup> Në prill 2006, Kontrolli i Lartë i Shtetit kritikoi qeverinë e mëparshme lidhur me parregullsitë në prokurime, dhe më pas Kuvendi miratoi ligjin “Për bashkëpunimin e publikut në luftën kundër korrupsionit”, ku qytetarët mund të tregojnë hapur rastet e dyshuara të korrupsionit. Për më tepër, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kërkuar ndjekjen penale për dhjetëra raste.

### 3. Korrupsioni brenda sistemit shqiptar të drejtësisë

Më 7 qershor 2006, Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi (IDRA) dhe Casals & Associates, Inc., paraqitën rezultatet e sondazhit të vitit 2005 lidhur me korrupsionin në Shqipëri.<sup>436</sup> Sipas këtij sondazhi, Shqipëria ende konsiderohet si një vend me nivel të lartë korrupsioni, megjithëse është pakësuar disi në krahasim me vitin e kaluar. Deputetët, nëpunësit në dogana, nëpunësit e tatimeve, mjekët dhe *gjqytarët* konsiderohen si më të korruptuarit, ndërsa Presidenti i Republikës, udhëheqësit fetarë dhe ushtarakët konsiderohen si më të ndershëm ndër 17 institucionet dhe grupet për të cilat është pyetur në sondazh. Meqenëse “transaksionet e korrupsionit”, si p.sh., ryshfetet, kërkojnë dy palë që të realizohen, atë që jep dhe atë që merr, sondazhi trajton qëndrimet e publikut ndaj korrupsionit. Në këtë aspekt, është interesante të vihet re se sondazhi tregon se personi që merr ryshfetin gjykohet gjithnjë më rëndë se ai që e jep atë. Kështu, për shembull, 68% e të intervistuarve mendojnë se një student që i jep mësuesit një dhuratë me shpresën për të marrë një notë më të mirë, ose nuk është i korruptuar ose është i justifikuar, dhe 77% mendojnë se për rastin e një nëne që paguan ryshfet për të marrë një certifikatë lindjeje për një nga fëmijët e saj, ajo nuk është e korruptuar ose është e justifikuar.<sup>437</sup> Për sa u përket krimit dhe administrimit të drejtësisë, sondazhi tregon se më pak se gjysma e viktimave e raportojnë krimin dhe se arsyeja e përmendur më shpesh nga ata që nuk raportojnë është se “nuk ia vlen”. Kjo reflekton, mes të tjerash, mungesë besimi në sistemin e drejtësisë.<sup>438</sup> Pak më shumë se gjysma e gjyqtarëve të intervistuar mendojnë se korrupsioni në sistemin gjyqësor shqiptar është një problem serioz dhe se avokatët i takojnë ata jashtë gjykatës për të

<sup>435</sup> Shih [http://www.venice.coe.int/docs/2006/CDL-AD\(2006\)005-e.asp](http://www.venice.coe.int/docs/2006/CDL-AD(2006)005-e.asp) [vizituar më 21 gusht 2006].

<sup>436</sup> Korrupsioni në Shqipëri: Perceptime dhe Përvoja, Sondazhi 2005, Përmbledhje e Rezultateve [qershor 2006] (Korrupsioni në Shqipëri). <http://www.idra-al.org/pdf/shqip/IDRA - Korrupsioni ne Shqiperi - Permbledhje e Rezultateve.pdf> [vizituar më 8 qershor 2006]. Ky studim është diskutuar gjithashtu në kapitullin “Transparenca dhe e drejta e informimit”.

<sup>437</sup> Korrupsioni në Shqipëri, fq. 11-12.

<sup>438</sup> Korrupsioni në Shqipëri fq. 14 [në variantin e sondazhit në gjuhën shqipe, termi “administration of justice” është përkthyer “drejtësia” (shënim i red.)].

ndikuar në vendimet. Gjyqtarët e pranojnë se, si ata, ashtu edhe avokatët, nuk shihen në dritë pozitive nga publiku; të dyja kategoritë marrin vlerësime mesatare shumë poshtë mesit të shkallës nga 0-100.<sup>439</sup>

### *Incidente të korrupsionit*

Gjatë zhvillimit të PZhGjD, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka ndeshur raste të shumta të vlerësimeve pak a shumë të besueshme të korrupsionit brenda sistemit të drejtësisë. Në disa raste, ka qenë e qartë se personi i cili shpaloj historinë, thjesht ka qenë i bindur se e ka “humbur” çështjen sepse gjykata ose prokurori ka qenë i korruptuar, pa qenë në gjendje të provojë në ndonjë mënyrë thëniet e veta. Në shumë raste të tjera, historitë dukeshin si mjaft të besueshme dhe personi që jepte informacionin nuk kishte arsye për të dhënë informacion të pasaktë. Më poshtë vijojnë disa shembuj të incidenteve [të vogla dhe të mëdha] të korrupsionit për të cilat Prezenca e OSBE-së është vënë në dijeni dhe që duken të besueshme, p.sh., ato bazohen në vëzhgimet ose eksperiencën e vet informatorit. Sidoqoftë, nuk synohet që të vërtetohet se këto incidente kanë ndodhur në të vërtetë, por vetëm të përshkruhet në detaje një pjesë e pamjes së përgjithshme të sistemit të korruptuar të drejtësisë. Për sa i përket korrupsionit brenda sistemit të burgjeve, në një raport të botuar kohët e fundit nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor dhe Poshtëruës, shpreh “shqetësimin serioz se shumë persona të burgosur të intervistuar, jo vetëm që shprehen mosbesim të thellë tek sistemi i drejtësisë, por edhe perceptimin e tyre se gëzimi i të drejtave të të ndaluarve brenda institucioneve të policisë dhe burgjeve, të cilat bazohen në ligj, mund të gëzohen vetëm në këmbim të ryshfetit.”<sup>440</sup>

<sup>439</sup> Korrupsioni në Shqipëri fq. 15.

<sup>440</sup> Raporti i Këshillit të Evropës drejtuar qeverisë shqiptare në kuadrin e vizitës e kryer në Shqipëri nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor dhe Poshtëruës (KPT), nga 23 maj deri me 3 qershor 2005, KPT/Inf (2006) 24, Strasburg, 12 korrik 2006 <http://www.cpt.coe.int/documents/alb/2006-24-inf-eng.pdf> [vizituar më 20 korrik 2006].

	<b>Shembuj të ndodhive të korrupsionit brenda sistemit të drejtësisë</b>
1	Y u akuzua për vjedhje me armë. Nëpërmjet ndërmjetësit, një i afërm i Y-së iu afrua gjyqtarit dhe i ofroi një Mitsubishi të re në shkëmbim të një dënimi më të ulët. Gjyqtari pranoi por theksoi se ai nuk do të premtonte pa e parë makinën me sy. Makina u soll para gjykatës, dhe më pas gjyqtari e pranoi makinën dhe i dha të pandehurit dënim shumë të ulët.
2	Një person hyri në zyrën e gjyqtarit dhe i dorëzoi sekretares së gjykatës disa dokumente për regjistrimin e një personi juridik. Kur personi e dorëzoi dosjen tek sekretarja, disa kartëmonedha 500 lekëshe ranë në tokë. Personi i tha sekretares se ishte thjesht një kafe për gjyqtarin. Ky person vinte çdo ditë tek e njëjta zyrë e gjyqtarin, ndonëse sistemi i shortit duhet ta drejtonte atë tek gjyqtarë të ndryshëm, sepse kishte shumë gjyqtarë që merreshin me çështje tregtare.
3	X dhe Y u gjykuan me akuzat e kultivimit të lëndëve narkotike dhe trafikimit. Ata rrezikonin dënime të larta me burg. Pas shumë muajsh, të afërmit e tyre të pasur njohën të afërm të gjyqtarit që kishte çështjen në dorë. Me anë të këtyre të njohurve, ata i ofruan gjyqtarit 20 000 dollarë amerikan si edhe bizhuteri, orë dhe telefona celularë. Gjyqtari e pranoi ryshfetin dhe dërgoi një ndërmjetës të merrte “dhuratat”. Të pandehurve iu dhanë dënime të ulta dhe menjëherë pas kësaj, ata u liruan meqenëse dënimi i tyre ishte plotësuar me kohën e kaluar në paraburgim.
4	Njëra nga palët e çështjes hyri në zyrën e gjyqtarit për të marrë vesh se kur do të zhvillohej seanca tjetër gjyqësore. Pasi u vu në dijeni për datat, personi i tha gjyqtarit se ai do të udhëtonte jashtë vendit dhe e pyeti gjyqtarin se çfarë dëshironte që t’i sillte. Gjyqtari e porositi për veshje.
5	Një sekretare takoi një person në korridorin e gjykatës. Personi e pyeti sekretaren se si të ngrinte një padi, dhe nëse sekretarja njihnte ndonjë avokat. Personi e pyeti gjithashtu për regjistrimin e një personi juridik. Sekretarja e shoqëroi atë tek zyra e gjyqtarit dhe përgatiti dokumentet. Kur sekretarja mbaroi, personi i dha para sekretares.
6	Një avokat mbrojtës: Unë duhet të paguaj për çdo gjë. Sot, për shembull, unë nuk kisha para t’i jepja policit roje në hyrjen e sallës së gjyqit dhe për këtë nuk më lejuan të hyj brenda dhe më trajtuan shumë keq. Nëse gjyqtari urdhëron të lirohet një nga klientët e mi nga paraburgimi, mua më duhet të paguaj për të zbatuar vendimin drejtuar institucioneve të paraburgimit.
7	X nga një fshat ku jeton “minoriteti grek” bëri një kërkesë në gjykatë për të marrë kombësi greke, meqë të dy prindërit e tij e kishin nënshtetësinë greke të pasqyruar në pasaportat e tyre. Gjyqtari e shtyu çështjen pa arsye. X konstatoi se ai dhe gjyqtari kishin një të afërm të përbashkët. Duke shfrytëzuar këtë lidhje, X i ofroi 50 000 lekë gjyqtarit. Gjyqtari dha vendimin në favor të tij në një seancë gjyqësore që zgjati vetëm një minutë.
8	Bashkëshorti i një personi ndaj së cilit është dhënë masa e sigurisë e arrestit në burg: <i>Bashkëshorti më tha se ai duhej të paguante gjyqtarin 1 000 euro në këmbim të lirim të tij.</i>
9	X, një kriminel i njohur dhe i pasur, u arrestua nga policia pas një tentative për vrasje ku viktimi u plagos. Të afërmit e X-it i ofruan 10 000 euro Oficerit të Policisë Gjyqësore (OPGj) për të fshehur ose shkatërruar provat dhe për ta paraqitur incidentin si një vepër e kryer në kushtet e mbrojtjes së nevojshme. Në fillim OPGj e refuzoi ofertën, por pas presionit të ushtruar nga ndërmjetësi, ai e pranoi “dhuratën.” Në fakt Gjykata dha vendimin se i pandehuri kishte vepruar në kushtet e mbrojtjes së nevojshme dhe e dënoi X vetëm me 5 vjet burg. <sup>59</sup>

<sup>441</sup> Dënimi minimal për vrasje me dashje është 10 vjet burgim, por dënimi për tentativë për vrasje, në varësi të rrethanave, mund të ulet nën minimumin e parashikuar, KP, nenet 76 dhe 23.

	<b>Shembuj të ndodhive të korrupsionit brenda sistemit të drejtësisë</b>
10	Një avokat hyri në zyrën e gjyqtarit dhe e falënderoi atë për vendimin gjyqësor dhe u përpoq t'i ofronte gjyqtarit një kafe. Gjyqtari nuk e pranoi, kështu avokati vendosi një pusullë ku dukej të kishte 5 000 lek mbi tavolinën e gjyqtarit, të cilën ai e pranoi.
11	Familja A paditi familjen B për konflikt pronësie mbi tokën ku familja B (pronar i ligjshëm) po ndërtonte dy blloqe pallatesh. Pavarësisht nga thjeshtësia e çështjes, e cila kërkonte vetëm verifikimin e dokumenteve, trupi gjyqësor i përbërë nga tre gjyqtarë e shtyu seancën për të bërë presion mbi familjen B. Familja B iu premtoi tri apartamente në ndërtesë gjyqtarëve nëpërmjet një ndërmjetësi. Gjyqtarët vendosën në favor të familjes B.
12	Një person: Nuk ka shpresë për sistemin gjyqësor shqiptar. Unë kisha një konflikt pronësie dhe meqenëse e dija që pala tjetër do t'i jepte rryshfet gjyqtarit, unë e pagova atë me 10 000 dollarë për të marrë një vendim në favorin tim; ky ishte gjithashtu vendim i drejtë.
13	Një i arrestuar: Më kanë thënë se mund të marr një dënim më të ulët për 5 000 euro.
14	Familja A, e përfshirë në industrinë e ndërtimit, kishte konflikt pronësie me familjen B (pronar i ligjshëm). Gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, dukej sikur familja B po e fitonte çështjen. Familja A i ofroi një dyqan në një godinë të ndërtuar së fundi gjyqtarit, i cili e pranoi dhe vendosi në favor të familjes A.
15	Y u akuzua për trafikim të qenieve njerëzore dhe u dënua me 3 vjet burgim në mungesë. Avokati mbrojtës i Y-së e apeloj vendimin. Sidoqoftë, Y dhe avokati i tij mbrojtës, nuk i korruptuan dot gjyqtarët e Gjykatës së Apelit. Në vend të tyre Y pagoi prokurorin 1 000 dollarë me anë të një ndërmjetësi. Gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor në Gjykatën e Apelit, prokurori nuk paraqiti provat e duhura dhe hodhi baltë mbi punën e kolegut të Gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e Apelit e kundërshtoi vendimin e Gjykatës së Rrethit dhe e uli dënimin në një gjobë prej 200 000 lekësh.
16	Një notere hyri në zyrën e gjyqtarit dhe i dha shumë dhurata që vinin nga Italia. Noterja dhe gjyqtari bashkëpunonin ngushtë. Kur e pyetën rreth procedurave të regjistrimit të një personi juridik, gjyqtari u thoshte personave të kontaktonin ndonjë noter. Megjithatë, gjyqtari pranonte si të rregullta vetëm ato formularë që ishin hartuar pikërisht nga ajo notere me të cilën bashkëpunonte, prandaj njerëzit nuk kishin mundësi zgjedhjeje vetëm të shkonin tek ajo.
17	Të afërmit e trafikantit, që ishte në burg, iu afruan gjyqtarit të çështjes me 50 000 euro për të liruar trafikantin. Gjyqtari nuk pranoi dhe i kërcënoi se do t'i denonconte të afërmit në polici. Menjëherë pas kësaj, trafikanti u dënua me shtatë vjet burg. Vendimi u apeluar. Avokati mbrojtës i trafikantit arriti të kontaktonte me viktimën e trafikantit, dëshmitaren kryesore të çështjes, dhe i dha asaj 30 000 euro. Pas kësaj, avokati mbrojtës iu afrua gjyqtarit të apelit, i shpjegoi çdo gjë dhe i dha atij 20 000 euro. Brenda javës, trafikanti u lirua dhe akuzat ranë për shkak të tërheqjes së dëshmisë nga dëshmitari.
18	Një avokat mbrojtës po priste jashtë zyrës së gjyqtarit për fillimin e një seance lidhur me deklarinimin e trashëgimisë. Pasi kishte pritur më shumë se gjysmë ore, avokati trokiti në derë. Gjyqtari i bërtiti avokatit të priste meqenëse duhej të bënte një telefonatë të rëndësishme dhe nuk kishte më impulse në celularin e saj. Avokati doli jashtë dhe bleu tri karta telefoni për gjyqtarin. Ai ia dha kartat gjyqtarit dhe u ftua të hynte në zyrë. Seanca mbaroi për dhjetë minuta.

	<b>Shembuj të ndodhive të korrupsionit brenda sistemit të drejtësisë</b>
19	<p>Një person: çështjet lidhur me korrigjimin e akteve të gjendjes civile për sa i përket datëlindjes ose vërtetimit të faktit për vjetërsi në punë janë shumë të shpeshta, por vetëm disa gjyqtarë merren me to. Për të caktuar një gjyqtar të shqyrtojë një çështje, kancelari paguhet nga 500 deri në 1 000 euro. Madhësia e ryshfetit varet nga çështja. Imigrantët duhet të paguajnë afërsisht 1 000 euro për korrigjimin e akteve të gjendjes civile për sa i përket datëlindjes.</p>
20	<p><i>Bisedë ndërmjet atij që duket si avokat mbrojtës (AM) dhe anëtarit të familjes (AF) të njërit prej klientëve të avokatit mbrojtës, e regjistruar në një telefon celular një mëngjes në autobus urban në Tiranë:</i></p> <p><i>AM:</i> Mos ki merak, do të rregulloj unë gjithçka. Unë të garantoj që ai [<i>klienti</i>] do të dënohet vetëm me kohën e paraburgimit dhe do të lirohet në sallën e gjyqit. Ju jepni paratë dhe ai lirohet.</p> <p><i>FM:</i> Shkëlqyeshëm, sa duhet të paguajmë?</p> <p><i>AM:</i> Epo, varet..., ju e dini... gjyqtarët. Unë duhet të flas me gjyqtarët, dhe më pas shohim.</p> <p><i>FM:</i> Në rregull, po më thuaj afërsisht sa?</p> <p><i>AM:</i> Ta thashë, varet nga gjyqtarët, nga provat e mbledhura, nga situata...</p> <p><i>FM:</i> Po ti e di me përafërsi, apo jo?</p> <p><i>AM:</i> E ke parasysh L-në, djalin e M-së? Ai u lirua menjëherë. E lirova unë se fola me gjyqtarët, dhe ai nuk pagoi aq shumë duke marrë parasysh se çfarë kishte bërë. Nuk është gjë fare, është qesharake, ti e di. Ore, ka edhe raste kur njerëzit mendojnë se mund të dalin nga burgu për shuma shumë të vogla, por kjo nuk është e mundur, o mik. Ti e njeh S-në, donte të paguante gjyqtaren 50 000 për të liruar të birin. I biri kishte vjedhur një motoçikletë. Por gjyqtarja, sigurisht, nuk mund të pranonte. Ajo qeshi dhe tha “Nuk lirohet njeri për 50 000. Me 50 000 mund të bësh qejf, të hash një darkë, por nuk nxirren njerëzit nga burgu me aq lekë.” Prandaj i biri i S-së është akoma në burg...</p> <p><i>FM:</i> Atëherë sa duhet të paguajmë ne?</p> <p><i>AM:</i> Epo, o mik, unë ta thashë, varet nga gjyqtarët... Por unë të garantoj se nëse po paguat aq sa do gjyqtari, ai do të lirohet menjëherë, do të dalë ... menjëherë. Po G-në e njeh ti?</p> <p><i>FM:</i> Jo, nuk e njoh. Por sa mund të kërkojnë, më thuaj një shumë minimale, që të fillojmë të mbledhim paratë.</p> <p><i>AM:</i> Mos u shqetëso. Ku e kisha fjalën ..., po, djali i G-së. Ai u dha gjyqtarëve aq sa kërkuan dhe ai qëndroi në burg edhe tre muaj më shumë, vetëm tre muaj. Nuk është asgjë, është qesharake, jo tre vjet, tre muaj. Dhe ai duhet të dënohej të paktën katër vjet... Por jo, ai u lirua pas tre muajsh. Unë të thashë, MOS u shqetëso. Unë të garantoj që ai do të lirohet menjëherë... S’më beson ti mua tani?</p> <p><i>FM:</i> Të besoj ore, si s’të besoj, por ne ashtu kemi ca probleme financiare. Na duhet të fillojmë të sigurojmë paratë për gjyqtarët, siç the ti... Ne duam t’u japim sa të kërkojnë, por mund të na duhet të marrim ca borxh, prandaj të lutem më thuaj një minimum.</p> <p><i>AM:</i> Mirë, në rregull... pesë (<i>AM tregon pëllëmbën e dorës me pesë gishtërinjtë e hapur</i>), minimumi është pesë, prandaj përgatituni, mirë?</p> <p><i>FM:</i> (<i>i shqetësuar</i>): Po... në rregull...eh... në rregull... po... mos ki merak.</p> <p><i>AM:</i> Mos harro, unë të garantoj që lirohet menjëherë. Por në fillim duhet të flas me atë gjyqtarin, pastaj do të flasim prapë bashkë, he?</p> <p><i>FM:</i> Epo mirë, po, patjetër, do të flasim.</p>

#### 4. Përpjekjet për t'u ballafaquar me korrupsionin brenda sistemit të drejtësisë

Pavarësisht nga premtimi i qeverisë për të luftuar korrupsionin, përpjekjet kundër korrupsionit brenda gjyqësorit deri tani nuk i kanë tejkaluar ndryshimet e ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, si edhe ndryshimet e propozuara të ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Ia vlen të theksohet se pavarësisht nga niveli shumë i lartë i perceptuar i korrupsionit brenda sistemit të drejtësisë, nuk është ndërmarrë asnjë veprim konkret për të ndaluar atë me anë të miratimit të një plani të veprimit ose me kërkesën që kryetarët e gjykatave të miratojnë një plan veprimi, ose të raportojnë masat konkrete që po planifikojnë të ndërmarrin për të luftuar korrupsionin brenda gjykatave të tyre. Gjatë vizitave në prokurori dhe në gjykata të rrethit e të apelit në Tiranë, Durrës, Vlorë, Gjirokastrë, Shkodër, Kukës dhe Tropojë në pranverën e vitit 2005, kryeprokurorët dhe kryetarët e gjykatave, duke iu referuar nivelit të ulët të besimit në sistemin shqiptar të drejtësisë, u pyetën nëse kishin ndonjë strategji kundër korrupsionit dhe se si e kanë trajtuar ata korrupsionin brenda institucionit të tyre. Përgjigjet ishin të ndryshme, nga ajo se korrupsioni brenda institucionit të tyre në veçanti ishte i pamundur, në atë që kishte me të vërtetë mundësi për përmirësim. Megjithatë, asnjë nuk kishte ndonjë strategji ose plan konkret për të zgjidhur këtë çështje.

Raporti vjetor i paraqitur nga Prokurori i Përgjithshëm në 8 maj 2006 tregon se në vitin 2005 janë ndjekur penalisht 422 procedime lidhur me korrupsionin, në krahasim me 433 çështje të ndjekura në vitin 2004.<sup>442</sup> Megjithatë, gjatë vitit të kaluar, shumë pak çështje të rëndësishme lidhur me korrupsionin janë sjellë në vëmendjen e publikut. Për sa u përket çështjeve që kanë tërhequr vëmendjen e publikut, p.sh., ato që përmenden në njoftimin për shtyp të Prokurorit të Përgjithshëm më 28 mars 2006, ia vlen të përmendet se shumë çështje kanë të bëjnë me shpërdorimin e detyrës dhe jo me dhënien apo marrjen e ryshfetit.<sup>443</sup> Është për t'u theksuar se nga pesë rastet e specifikuar si korrupsion, katër bazoheshin në atë që është gjetur nga programi televiziv *Fiks Fare*. Ndërkohë që një numër nëpunësish shtetëror kanë qenë të implikuar, duke përfshirë edhe dy shefa policie, gjatë vitit të kaluar asnjë prokuror apo gjyqtar nuk ka dalë para drejtësisë me akuzën e korrupsionit. Ka pasur diskutime lidhur me emërimin e ish-Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Lushnje, Artan Gjermani, në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, emërimin e Kryetares së Gjykatës së Apelit në Vlorë, Gjinovefa Gaba në Gjykatën e Lartë dhe Komisionin Hetimor për Prokurorin e Përgjithshëm, Theodhori Sollaku. Veç kësaj, sidoqoftë, në vitin 2006 asnjë akuzë nuk është ngritur ndaj anëtarëve të gjyqësorit apo prokurorisë. Megjithatë, edhe për çështjet që përmendëm, shumë pak prova kanë dalë në dritë gjatë kohës së shkrimit të këtij raporti.

<sup>442</sup> Informim i Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2005, 8 maj 2006 <http://www.pp.gov.al/alb/shtypi/FJALIM%20KUVEND.html> [vizituar më 14 qershor 2006].

<sup>443</sup> <http://www.pp.gov.al/alb/shtypi/zyrtaretekorruptuar.html> [vizituar më 14 qershor 2006].

Arsyet për këtë janë sigurisht të shumta. Në një marrëveshje korruptive, secila palë ka interesa për të mbrojtur. Edhe nëse njëra palë e marrëveshjes së paligjshme nuk i përmbahet asaj, ka pak gjasa që ndonjëra prej tyre të denoncojnë krimin. Veç kësaj, nëse sistemi i drejtësisë është aq i korruptuar sa duket, çdo person që punon në gjykatë apo prokurori, si dhe çdo avokat mbrojtës, ose është përfshirë vet në korrupsion, ose njeh dikë i cili ka dhënë ose ka marrë rryshfet. Një raportim brenda sistemit do të bënte që çdokush në atë vend pune t'i kundërviej denoncuesit dhe ai/ajo vetë do të kthehej në shënjestër për pasojë. Ndonëse transferimi i një shume të madhe parash ndoshta do të linte gjurmë në mënyrën se si jeton dhe shpenzon paratë marrësi, një e ardhur e vazhdueshme e shumave të vogla nuk lë shumë gjurmë dhe rasti korruptiv i një individi mund të jetë shumë i vështirë për t'u provuar. Çështjet penale lidhur me korrupsionin që ngrihen kundër anëtarëve të gjyqësorit dhe prokurorisë do të ndiqeshin penalisht dhe gjykoheshin nga prokurorë dhe gjyqtarë të cilët mund të kenë marrë vet rryshfete ose janë të ndërgjegjshëm për kolegët ose miqtë e tyre të ngushtë të cilët kanë marrë ose dhënë rryshfete.

## 5. “Një mjedis i favorshëm për korrupsionin”

Simboli i drejtësisë, Zonja e Drejtësisë me sy të lidhur dhe me peshore në dorë, tregon se të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe se të bërit drejtësi, do të thotë vendosja në peshore e interesave të kundërta. Ajo është me sy të lidhur në mënyrë që mos të bëj dallim midis të ziut dhe të bardhit, të pasurit dhe të varfrit, të riut dhe të moshuarit, femrës dhe mashkullit, ose mikut dhe armikut. Në peshore ajo duhet të peshojë vetëm provat dhe faktet e paraqitura në çështje përkundrejt legjislacionit përkatës ose jurisprudencës. Në mënyrë që gjyqtari të kryejë detyrën si Zonja e Drejtësisë, ekzistojnë rregulla në lidhje me konfliktin e interesave që kërkojnë se kur gjyqtari duhet të heqë dorë nga gjykimi i çështjes.<sup>444</sup> Rregulla të ngjashme ka edhe për prokurorët.<sup>445</sup> Një gjyqtar duhet të mbajë distancë me palët dhe të marrë në konsideratë vetëm faktet e çështjes. Në përputhje me këtë, çdo kontakt jashtë sallës së gjyqit me çdonjërin nga palët duhet të shmanget. Ky parim pasqyrohet gjithashtu në Kodin Etik të KASHLE, i cili parashikon që një avokat nuk duhet “të kontaktojë gjyqtarin pa njoftuar më parë avokatin e palës tjetër”.<sup>446</sup> Në Kodin e Etikës Gjyqësore që zbatohet në Shqipëri thuhet se gjyqtari dhe anëtarët e familjes së tij “nuk duhet të pranojnë dhurata, favore, privilegje ose premtime për ndihmë materiale nga një person që ka interes direkt ose indirekt në një çështje që gjyqtari do të shqyrtojë”.<sup>447</sup> Veç kësaj, Kodi i Etikës Gjyqësore ndalon gjyqtarët të marrin parasysh bisedime të njëanshme apo të bëra pa prezencën e palëve,<sup>448</sup> siç ndodh rëndom në marrëveshjet korruptive.

<sup>444</sup> KPrP, nenet 15-18.

<sup>445</sup> KPrP, neni 26.

<sup>446</sup> Kodi Etik i KASHLE, paragrafi 4.4, shih gjithashtu Kodin Etik të Avokatit, neni 29.

<sup>447</sup> Kodi i Etikës Gjyqësore, rregulli 23.

<sup>448</sup> Kodi i Etikës Gjyqësore, rregulli 9.

Megjithatë, në shkelje të plotë të këtij parimi, në Shqipëri palët e çështjeve shpesh shihen që u afrohen gjyqtarëve ose prokurorëve; prokurorët ose palët e tjera në një çështje janë parë ulur në zyrat e gjyqtarëve ose të hyjnë në sallat e gjyqit së bashku me gjyqtarët. Avokatët mbrojtës janë parë duke pirë kafe me gjyqtarët. Palët iu dorëzojnë dokumentet drejtpërdrejt gjyqtarëve dhe jo nëpërmjet sekretarisë së gjykatës. Në Tiranë, seancat zhvillohen çdo ditë në kushte jozyrtare në zyrat e gjyqtarëve. Të gjitha këto janë shembuj të lidhjeve të papërshtatshme dhe të panevojshme ndërmjet anëtarëve të gjyqësorit apo prokurorëve dhe palëve ose përfaqësuesve të tyre ligjorë të çështjeve. Ndonëse shumica e këtyre kontakteve mund të mos kenë pasoja penale, ato ndikojnë në krijimin e përshtypjes së një gjyqësori që është më i hapur se duhet ndaj kontakteve të papërshtatshme. Sigurisht, shumë marrëveshje dhe veprime korruptive, në veçanti ato më fitimprurëset, nuk bëhen në gjykata apo në zyrat e gjyqtarëve por jashtë dhe nëpër kanale të tjera, dhe me anë të ndërmjetësve të zgjedhur.

## 6. Vërejtje përfundimtare

Ndërsa korrupsioni brenda sistemit të drejtësisë perceptohet të jetë shumë i lartë dhe pengon seriozisht funksionimin e sistemit të drejtësisë, pak masa konkrete janë marrë për të ndaluar këtë problem. Për të arritur në fundin e të përbashkët të ekzistencës e korrupsionit aktual, dhe atij të perceptuar brenda sistemit të drejtësisë duhet të merren masa të vendosura. Si hap i parë do të ishte t'i jepej fund menjëherë kontakteve/lidhjeve të papërshtatshme ndërmjet anëtarëve të gjyqësorit dhe palëve në proces ose përfaqësuesve të tyre. Veç kësaj, çdo gjykatë dhe prokurori duhet t'i kërkohej të ndërtojë strategji konkrete dhe të marrë masa konkrete për të luftuar korrupsionin brenda institucionit përkatës. Një mënyrë e mundshme mund të ishte përmes një "projekti pilot", ku një gjykatë dhe një prokurori, nëpërmjet planeve strategjike, masave konkrete dhe mekanizmave strikt në vijim, angazhohen të kthehen në "zona pa korrupsion". Projekti do të kërkonte gjithashtu një bashkëpunimin të ngushtë me Dhomën e Avokatisë. Çdo strategji e parashikuar do të duhej të merrte gjithashtu parasysh nivelet e pagesës dhe përfitimeve të tjera të stafit brenda sistemit të drejtësisë në përgjithësi dhe të gjyqtarëve<sup>449</sup> në veçanti. Një nivel i përshtatshëm i pagesës dhe përfitimeve të tjera është ndoshta një nga mënyrat më efikase për të "imunizuar" punonjësit nga korrupsioni.

<sup>449</sup> Në veçanti për gjyqtarët që punojnë jashtë vendbanimit të tyre, duhet të shikohet mundësia e dhënies së strehimit si një përfitim i mundshëm jomonetar.



## Rekomandime

1. Ministria e Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm dhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë duhet të miratojnë një strategji të përbashkët kundër korrupsionit brenda sistemit të drejtësisë. Strategjia duhet të përfshijë mekanizma striktë monitorimi të caktuar të vazhdueshëm.
2. Gjykatave dhe prokurorive duhet t'u kërkohet të miratojnë strategji dhe të ndërmarrin masa konkrete për të adresuar korrupsionin.
  - Gjykatat dhe prokuroritë duhet të bëjnë publike strategjitë e tyre kundër korrupsionit në stenda afishimi ose vende të tjera ku ato të jenë mjaft të dukshme për publikun e gjerë.
  - Gjykatat/prokuroritë që kanë faqe interneti, duhet të bëjnë publike strategjinë e tyre kundër korrupsionit në faqen e tyre në internet.
3. Së bashku me strategjitë kundër korrupsionit, gjykatat/prokuroritë duhet të bëjnë publike informacionin lidhur me sjelljen dhe veprimet që dyshohen ose konsiderohen si korrupsion. Duhet të jepet gjithashtu informacion lidhur me personat e kontaktit si mënyrën e procedimit kur vihen re ose dyshohet për praktika korruptive.
4. Publiku i gjerë duhet të informohet me anë të fushatave publike të ndërgjegjësimit rreth korrupsionit brenda sistemit të drejtësisë; d.m.th., duhet të informohet për veprimet dhe sjelljet që janë ose mund të dyshohen si korruptive.
5. Gjyqtarët duhet të trajnohen për të hartuar vendime të qarta, të përmbledhura dhe të arsyetuara mirë, në mënyrë që të jenë të aftë të bindin si palët ashtu edhe të interesuarit e tjerë se vendimet e marra janë bazuar vetëm në faktet dhe provat e paraqitura gjatë procesit gjyqësor.
6. Përpjekje duhet të bëhen në vazhdimësi për t'i vënë vendimet gjyqësore në dispozicion të publikut, duke i bërë ato publike në faqen e internetit ose duke i vënë ato *lehtësisht* në dispozicion sipas kërkesave.
7. Inspektimet e kryera në gjykata nga Ministria e Drejtësisë dhe nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë duhet të marrin në konsideratë mënyrën se si gjykatat zbatojnë masat kundër korrupsionit.
8. Çdo gjykatë dhe prokurori duhet të marrë masa të menjëhershme për të ndaluar kontaktet e papërshtatshme dhe jozyrtare ndërmjet gjyqtarëve/prokurorëve dhe palëve në konflikt.<sup>450</sup>

<sup>450</sup> Palët në një çështje penale janë, nga njëra anë prokurori dhe nga ana tjetër i pandehuri/të pandehurit.

9. Çdo tregues për korrupsion duhet të merret seriozisht dhe të trajtohet në mënyrë transparente dhe të kujdesshme.
10. Niveli i pagave të punonjësve brenda sistemit të drejtësisë duhet të rritet.
11. Duhet parë mundësia për të përzgjedhur një gjykatë dhe një prokurori “pa korrupsion”, si projekt pilot.

## VII. GJYKIME EFIKASE DHE ÇËSHTJE LIDHUR ME DËSHMITARËT

Në këtë kapitull do të paraqiten dy punime që janë paraqitur më parë në kontekste të ndryshme.<sup>451</sup> I pari, “Gjykime efikase”, i është paraqitur Ministrisë së Drejtësisë më datë 25 nëntor 2005 pas një diskutimi lidhur me vonesat të proceseve gjyqësore. I dyti, “Mbi paprekshmërinë e dëshmitarëve dhe çështje të tjera” është paraqitur në Grupin e Punës së Konsorciumit Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Dëshmitarëve, më datë 16 mars 2006.

### 1. Gjykime efikase

Sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, gjithkush ka të drejtë të gjykohet brenda një periudhe të arsyeshme kohore.<sup>452</sup> Për të përcaktuar një kohëzgjatje të arsyeshme, merren parasysh kompleksiteti i çështjes, sjellja e të pandehurit, sjellja e autoriteteve gjyqësore dhe administrative të shtetit si dhe interesat e të pandehurit. Gjykatat kanë për detyrë që të bëjnë të mundur evitimin e vonesave të panevojshme të gjykimeve nëpërmjet gjithë pjesëmarrësve në procedim.<sup>453</sup> Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë parashikon se gjykatat duhet të përfundojnë shqyrtimin gjyqësor në një seancë të vetme dhe nëse kjo nuk është e mundur, atëherë gjykata vendos që të vazhdojë ditën e mëpasme të punës dhe vetëm për arsye të veçanta, shqyrtimi gjyqësor mund të shtyhet deri në pesëmbëdhjetë ditë.<sup>454</sup> Kjo është në përputhje me parimin e “gjykimit të pandërprerë”, i cili ka si qëllim prezantimin e plotë dhe koherent të fakteve përpara trupit gjykues të çështjes, duke lehtësuar kështu vlerësimin nga ana e trupit gjykues të materialeve të paraqitura përpara tij.<sup>455</sup> Kohëzgjatja e gjykimit, përveç pasojave në aspektin e të drejtave të njeriut, ka gjithashtu edhe pasoja të konsiderueshme ekonomike. Në njërën anë, rritja e përpjekjeve për të siguruar pjesëmarrjen e të gjithë personave të përfshirë mund të kërkojë më shumë shpenzime, por nga ana tjetër proceset gjyqësore më të shkurtra dhe më efikase do t’i ulnin shpenzimet në mënyrë të konsiderueshme për të gjithë palët e përfshira dhe, në këtë mënyrë do të krijohej mundësia që burimet të përdoshin për të gjykuar më shumë çështje.

Gjithsesi, duket se KPrP nuk krijon në fakt lehtësi për kryerjen e gjykimeve të pandërprera. Palëve u kërkohet ta depozitojnë listën për thirrjen e dëshmitarëve dhe

<sup>451</sup> Për këtë botim, të dy tekstet janë redaktuar.

<sup>452</sup> Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 6 dhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 42 paragrafi 2.

<sup>453</sup> Shih, p.sh., çështjen “Vernillo kundër Francës”, 20 shkurt 1991, paragrafi 38.

<sup>454</sup> KPrP, neni 342.

<sup>455</sup> Procedura Penale, fq. 471 dhe Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë, Nr. 6, 11 nëntor 2003.

ekspertëve, të paktën pesë ditë para datës së caktuar për gjykim.<sup>456</sup> Kjo periudhë kohore është e pamjaftueshme për të njoftuar dhe për të sjellë dëshmitarët në gjykatë, sidomos duke pasur parasysh regjistrat e gjendjes civile që janë të papërshtatshëm, si dhe sistemin joefikas postar shqiptar. Për më tepër, duket se palët mund të kërkojnë “në mënyrë zyrtare” marrjen e provave, të cilat përcaktohen nga gjykata nëse pranohen ose jo, vetëm pasi të jetë hapur shqyrtimi gjyqësor.<sup>457</sup> Kështu, në raste të veçanta ku kërkohet dëgjimi i dëshmitarëve dhe ekspertëve, përfundimi i shqyrtimit gjyqësor në një seancë apo edhe ditën pasuese duket i pamundur.

Për pasojë, pavarësisht nga parimi i gjykimit të pandërprerë, shpeshherë seancat kryesore në Shqipëri vazhdojnë për periudha të zgjata dhe ka raste kur duhen vite që të përfundojnë. Proceset gjyqësore përfundojnë vetëm me një seancë në raste shumë të rralla dhe në vend që të vazhdojnë ditën e mëpasme të punës, shqyrtimi gjyqësor shtyhet për periudhën maksimale të lejuar, d.m.th., pesëmbëdhjetë ditë, dhe kjo gjë nuk bëhet si përjashtim por si rregull. Për më tepër, ndonjëherë seancat bëhen vetëm për të lajmëruar se dikush ose diçka mungon dhe shqyrtimi gjyqësor shtyhet edhe për dy javë të tjera.

Për të dhënë një shembull nga vendet e tjera, më poshtë janë renditur disa statistika të dhëna nga autoritetet gjyqësore suedeze.

*Çështjet Penale në gjykatat e rretheve në Suedi për vitin 2004<sup>458</sup>*

Numri total i çështjeve penale paraqitur në gjykatë	68 512
Numri total i çështjeve penale për të cilat është marrë vendim	65 070
Përqindja e çështjeve me më shumë se një të pandehur	11,1 (%)
Numri i të pandehurve për çështje	1,03
Përqindja e çështjeve ku është mbajtur seancë verifikim/vleftësimit	14,6
Përqindja e çështjeve ku shqyrtimi gjyqësor ka zgjatur më shumë se 6 orë*	4,8
Përqindja e çështjeve ku shqyrtimi gjyqësor ka zgjatur më shumë se 12 orë	1,3
Koha mesatare e shqyrtimit gjyqësor (orë/çështje)	1,72**

*Komente:*

\* Një seancë e plotë ditore konsiston në 6 orë shqyrtimi gjyqësor.

\*\* Një numër i madh seancash në çështjet ku i pandehuri pranon akuzën dhe ku nuk paraqiten fakte gojore, nuk zgjasin më shumë se 15 minuta.

Arsyet për gjykimet e zgjata në Shqipëri janë të shumanshme dhe ndërsa disa nga këto mund të jenë të lehta për t’u kapërcyer, të tjerat kërkojnë ndryshime të thella dhe duan kohë që të arrihen.

<sup>456</sup> KPrP, neni 337, paragrafi 1.

<sup>457</sup> KPrP, neni 357.

<sup>458</sup> Statistikat e Gjykatës, Statistikat zyrtare të Suedisë, pjesë të marra nga tabela 17, fq. 19. [http://www.dom.se/dom/DVhemsida/Domstolsstatistik/domstolsstatistik\\_2004.pdf](http://www.dom.se/dom/DVhemsida/Domstolsstatistik/domstolsstatistik_2004.pdf) [vizituar më 15 korrik 2006]

## 1.1. Shkaqet

Gjatë vëzhgimeve të seancave gjyqësore, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka identifikuar një sërë shkaqesh për vonesat në shqyrtimin gjyqësor të çështjeve penale.

- Mosgjetja/moslajmërimi i personave
- Mosparaqitja e personave të lajmëruar
- Mossjellja e të paraburgosurve në gjykatë nga ana e policisë
- Mosparaqitja e avokatëve mbrojtës, përndryshe moskryerja e detyrave të tyre
- Mosparaqitja e prokurorëve, përndryshe moskryerja e detyrave të tyre
- Mungesa e planifikimit/përgatitjes dhe zhvillimi i traditës për seanca gjyqësore të zgjatura
- Zgjatja pa arsye e hetimeve paraprake

Më poshtë ne sugjerojmë disa mënyra për t'i kapërcyer këto pengesa.

## 1.2. Rrugëzgjdhjet

### Njoftimet

*Gjendja Civile dhe Sistemi i Adresave* – Sistemi i papërshtatshëm i gjendjes civile si dhe ai i adresave në Shqipëri përbëjnë pengesa të mëdha për njoftimin e personave të përfshirë në proceset gjyqësore. Prezenca e OSBE-së është përfshirë aktualisht në një dialog me Ministrinë e Punëve të Brendshme për zhvillimin e një projekti, i cili synon dhënien e asistencës teknike autoritete përkatëse shqiptare në procesin e modernizimit të Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile dhe sistemit administrativ të adresave. Ky është një projekt i përmasave të mëdha, i cili duhet kohë që të zbatohet dhe atëherë do të lehtësonte shumë njoftimin e personave që duhet të marrin pjesë në procesin gjyqësor. Në përfundim, duhet krijuar një sistem më i mirë i regjistrimit të numrave të telefonit ku të përfshihen edhe numrat e telefonave celularë.

*Policia dhe Prokuroria* – Të parët që vihen në kontakt me personat e përfshirë në gjykimet penale, janë policia dhe prokuroria. Për të bërë të mundur që njoftimi i personave që duhet të paraqiten në procesin gjyqësor të jetë një proces i suksesshëm, policia dhe prokuroria duhet të përpiqen më shumë për të mbledhur informacion të dobishëm, të detajuar dhe të plotë me qëllim lajmërimin e personave që marrin në pyetje. Informacioni i vlefshëm për këtë qëllim do të ishte p.sh., adresa e detajuar, numra telefoni ku mund të kontaktohet personi në fjalë, përfshirë edhe numra celulari apo numra telefoni të të afërmeve, adresa dhe numra telefoni të qendrës së punës si dhe çfarëdolloj informacioni tjetër për të bërë të mundur lajmërimin e personave.

*Rregullat e njoftimit* – Mënyra më e thjeshtë për të njoftuar dikë është nëpërmjet shërbimit të thjeshtë postar, ku bashkë me njoftimin vendoset edhe një kërkesë për ta ridërguar të firmosur dëftesën e njoftimit, e cila ndodhet bashkëngjitur me të. Një

mundësi tjetër është me postë rekomandë (të porositur) me lajmërim marrjeje. Gjithsesi, rregullat për përdorimin e postës për njoftime janë të paqarta dhe duhen rishikuar.<sup>459</sup> Duhet bërë një analizë për të parë nëse rregullat aktuale lidhur me njoftimet zbatohen me efektivitet. Kjo analizë pra të jetë një vlerësim për të parë nëse përdoren siç duhet telefoni, telegrami, faksi apo mjete të tjera teknike për lajmërimin e dëshmitarëve.<sup>460</sup> Duhet parë edhe nëse pas një njoftimi fillestar për procesin dhe akuzën, palët (d.m.th., i pandehuri dhe palët e dëmtuara) mund të njoftohen në mënyra “më të thjeshta” sesa në njoftimin e parë si p.sh. nëpërmjet shërbimit thjeshtë postar apo mjeteve teknike.<sup>461</sup> Duket se ligji e përmend një gjë të tillë; ai i referohet rregullës së “njoftimit të parë”<sup>462</sup> dhe më tej detyron të pandehurin por jo palët private që të njoftojnë autoritetet e procedimit në rast ndryshimi të adresës.<sup>463</sup> Megjithatë ligji nuk e shpjegon se si duhet apo mund të bëhen njoftimet e mëvonshme. Duhet të mendohet gjithashtu për mundësinë e njoftimit me anë të *agjencive private të njoftimeve*, si një alternative ndoshta më efikase se ftuesit gjyqësor apo policia gjyqësore, në rastet kur lajmërimi nuk arrin të bëhet me njoftim të rregullt. Nëse lind nevoja, agjentët që bëjnë njoftimet mund të thirren për të dëshmuar në gjyq dhe agjencitë natyrisht që do të mbajnë përgjegjësi për dëmet që shkaktojnë nga mospërbushja e detyrimeve kontraktuale.

Kur njoftimi bëhet nga punonjësit e gjykatës, nga policia gjyqësore, apo nëpërmjet shërbimit postar me lajmërim marrjeje, personit të lajmëruar i duhet kërkuar të konfirmojë informacionin e kontaktimit dhe të japë informacion shtesë, sidomos numra telefoni.

Njoftimi duhet të përcaktojë gjithashtu pasojat që vijnë nga moszbatimi i urdhrorit; d.m.th., që mosparaqitja përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj,<sup>464</sup> dhe se personi mund të shoqërohet edhe me forcë nga policia.<sup>465</sup>

*Mosparaqitja e personave të lajmëruar apo mospërbushja e detyrave të tyre*  
*Mosparaqitja e dëshmitarëve* – Sapo të jenë njoftuar dëshmitarët, duhen bërë përpjekje që ata të paraqiten në kohën e duhur. Në rastet kur disponohen numra telefoni, ftuesit gjyqësorë duhet të konfirmojnë me anë të telefonit që personat e thirrur janë të informuar për orën dhe vendin se ku duhet të paraqiten. Aktualisht e vetmja mënyrë për t’u vënë

<sup>459</sup> Aktualisht KPrP, neni 132 paragrafi 1 thotë vetëm që njoftimi i akteve bëhet nga ftuesi gjyqësor ose nëpërmjet shërbimit postar. Pra, është e paqartë se cilat janë saktësisht kushtet për njoftimin me anë të postës.

<sup>460</sup> KPrP, neni 133.

<sup>461</sup> P.sh., në Suedi pasi personi ka marrë njoftimin e parë lidhur me procedimin, i cili përfshin informacion edhe për “njoftimin e thjeshtë”, njoftimet e mëpasshme bëhen me anë të postës së rregullt. Në Shqipëri, ku jo gjithmonë mund të mbështetesh tek shërbimi postar, mund të konsiderohen mënyra të tjera si p.sh. telefoni, mesazhe të shkurtra celulari (sms) apo edhe posta elektronike.

<sup>462</sup> KPrP, neni 133, paragrafi 1, 2 dhe 3, neni 142.

<sup>463</sup> KPrP, neni 140 paragrafi 6.

<sup>464</sup> KP, neni 310.

<sup>465</sup> KPrP, neni 164.

në kontakt me gjykatën është të shkohet atje personalisht. Për ta bërë komunikimin më të lehtë, numrat e telefonit të gjykatës dhe emrat e personave të kontaktit duhen vendosur në të gjitha format me të cilat komunikon gjykata dhe të jenë të disponueshme për publikun e gjerë. Kjo gjë do të bëjë të mundur që personat ta lajmërojnë gjykatën për vonesa të paparashikuara dhe në këtë mënyrë gjykata të ketë mundësi të vendosë orare të tjera apo të marrë masa për të parandaluar vonesat e panevojshme.

Siç u përmend edhe më sipër, mosparaqitja e dëshmitarëve në gjyq përbën kundërvajtje penale. Për ta zbatuar këtë rregull duhen filluar procedura të reja të cilat kërkojnë më shumë kohë dhe burime. Në vend të kësaj mund të shihet mundësia e vënies së gjobave nga ana e gjykatës për ata persona që nuk paraqiten pa shkaqe të arsyeshme dhe ekzekutimi i gjobave duhet të jetë i shpejtë.

Për më tepër, duke qenë se shpeshherë dëshmitarët kanë frikë të dëshmojnë, përveç programit për mbrojtjen e dëshmitarëve të parashikuar në ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, duhen marrë masa të tjera për të bërë të mundur pjesëmarrjen e tyre [të sigurtë]. Kështu për shembull, çdo gjykatë mund të caktojë një nëpunës/sekretar si person kontakti që do të ketë si detyrë informimin e dëshmitarëve për procesin gjyqësor. Kur lind nevoja, personi i kontaktit mund të takohet me dëshmitarin në gjykatë dhe të sigurojë që dëshmitari nuk përballet me të pandehurin apo me persona të tjerë. Personi i kontaktit për dëshmitarët mund të lajmërojë edhe gjykatën/policinë/prokurorinë kur lind nevoja për masa të tjera si, për shembull, seancë me dyer të mbyllura apo seancë për dëgjimin e dëshmitarit pa praninë e të pandehurit dhe/apo personave të tjerë.

*Mosparaqitja e avokatit mbrojtës* – Një nga shkaqet më të shpeshta për shtyrjen e proceseve gjyqësore është mosparaqitja e avokatëve mbrojtës pa pasur arsye të përligjura. Ka tregues se disa avokatë mbrojtës e përdorin shtyrjen si një teknikë mbrojtjeje.<sup>466</sup> Nëse kjo ka të bëjë me faktin se paraburgimi llogaritet si një ditë e gjysmë në llogaritjen e kohës së burgimit<sup>467</sup> apo për të plotësuar afatin maksimal të paraburgimit<sup>468</sup> apo për qëllime të tjera, kjo mbetet ende një pyetje pa përgjigje.

Përveç një dispozite në lidhje me drejtimin e seancës,<sup>469</sup> KPrP nuk përmban asnjë dispozitë në lidhje me masat disiplinore për avokatët mbrojtës.<sup>470</sup> Përkundrazi, KPrP krijon mundësi për pezullimin e afateve për të pandehurin për veprime nga avokati

<sup>466</sup> Shih gjithashtu gjykimin e çështjes “Balliu kundër Shqipërisë”, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 16 qershor 2005.

<sup>467</sup> KPrP, neni 238, paragrafi 2 dhe KP neni 57.

<sup>468</sup> KPrP, neni 263.

<sup>469</sup> Neni 341, i cili krijon mundësinë për gjobitjen e kujtosi si p.sh., për pengesë të zhvillimit të rregullt të seancës, por duket se nuk mund të përdoret për situatat përshkruar më sipër.

<sup>470</sup> P.sh, pushimin apo gjobitjen e avokatit mbrojtës, apo detyrimin i avokatit mbrojtës të paguajë pjesë të shpenzimeve procedurale.

i tij mbrojtës.<sup>471</sup> Megjithëse kjo dispozitë ka për qëllim të parandalojë të pandehurit dhe avokatët mbrojtës ta përdorin shtyrjen si një taktikë për qëllimet e shpjeguara më sipër, kjo situatë mund të çojë në “ndëshkimin” e të pandehurit për një veprim që i përket vetëm avokatit mbrojtës. Me këtë dispozitë abuzohet rregullisht duke pezulluar afatet për të gjithë të pandehurit kur mungon vetëm njëri nga avokatët mbrojtës, duke “ndëshkuar” kështu të pandehurit për veprime që nuk kanë lidhje me ta.<sup>472</sup> Për sa i përket disiplinimit të avokatëve mbrojtës, Dhoma Kombëtare e Avokatisë është organi i plotfuqishëm për nxjerrjen e masave disiplinore.<sup>473</sup> Deri tani, megjithë raportet e shumta nga ana e gjykatave, Dhoma e Avokatisë nuk ka marrë asnjë masë disiplinore.<sup>474</sup>

Me qëllim që t’i vihet kufi praktikës së avokatëve mbrojtës për ta përdorur vonesën e procedimeve pa arsye të ligjshme, në KPrP duhen parashikuar masa disiplinore. Masat që mund të vihen janë për shembull, detyrimi për të paguar [një pjesë apo të gjitha] shpenzimet procedurale, gjoba, t’i ndalohej pjesëmarrja si avokat mbrojtës për çështjen aktuale ose në përgjithësi përpara gjykatës në fjalë. Megjithatë, masa e parë dhe kryesore është që gjykata t’ua bëjë shumë të qartë të gjitha palëve se nuk do të tolerohen më zvarritjet e procedimeve dhe në rastet ku vonesat nuk justifikohen objektivisht, do të merren masa disiplinore. Avokatëve mbrojtës u duhet bërë e qartë gjithashtu se fakti që ata marrin përsipër më shumë çështje se mund të mbajnë, kjo nuk është arsye për të vonuar shqyrtimet gjyqësore. Nëse një vonesë e pajustificuar mund të ndëshkohet me gjobë, disa vonesa të tilla duhet të çojnë në detyrimin për të paguar shpenzimet procedurale. Abuzime sistematike dhe të përsëritura duhet të bëjnë që avokatit t’i ndalohej të vazhdojë të jetë avokat mbrojtës i çështjes në fjalë dhe nëse një avokat mbrojtës ka një histori të zvarritjes së proceseve gjyqësore, atëherë atij i duhet ndaluar të dalë përpara gjykatës në fjalë.

Në mënyrë që të inkurajohet Dhoma e Avokatisë në përmbushjen e përgjegjësive të saj si organ disiplinor, masat që do të parashikohen në KPrP, duhet të bëhen në varësi të përshtatshmërisë së masave të ndërmarra nga Dhoma e Avokatisë. Një tjetër mundësi është t’i bëhet e qartë Dhomës së Avokatisë se nëse nuk i përmbush përgjegjësitë e saj disiplinore, atëherë kompetenca për të vendosur masa disiplinore t’i kalojë gjykatës.

Duhet të parashikohet gjithashtu mundësia për të vënë masa disiplinore në raste të tjera kur avokatët mbrojtës nuk i përmbushin apo refuzojnë t’i përmbushin detyrat e tyre brenda afatit të duhur.

Një shkak tjetër lidhur me shtyrjet që ka të bëjë me avokatët mbrojtës por jo domosdoshmërisht shkaktuar nga ata, janë edhe kërkesat për kohë shtesë në shqyrtimin

<sup>471</sup> Nenet 265 dhe 350, paragrafi 3

<sup>472</sup> Komentari i Procedurës Penale, fq. 366.

<sup>473</sup> Neni 56.

<sup>474</sup> Në përputhje me ligjin 9109, datë 17 korrik 2003, “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, Dhoma Kombëtare e Avokatisë ka miratuar statutin e saj në prill të vitit 2005, si dhe ka krijuar një komitet disiplinor.



e fashikullit të gjykimit. Kjo mund të shkaktohet edhe për arsye se prokuroria nuk është në gjendje t'i përgatisë fashikujt e gjykimit për gjykatën ose gjykata nuk është në gjendje t'i përgatisë ato për mbrojtjen. Gjithsesi, gjykata duhet të bëjë të mundur që fashikujt e gjykimit të jenë të gatshme për shqyrtim si dhe për fotokopjim, dhe që mbrojtja të informohet lidhur me këtë fakt. Një zgjidhje edhe më e mirë do të ishte që prokurori të detyrohet t'i japë një kopje të fashikullit të gjykimit edhe avokatit mbrojtës.<sup>475</sup>

*Mosparaqitja e prokurorit* – Megjithëse mosparaqitja e prokurorit fatmirësisht ndodh rrallë, përsëri kjo gjë ndodh. Ka edhe raste kur prokurorët e vonojnë procesin në mënyra të tjera, duke mos përmbushur detyrat e tyre në afatet e duhura. Për ta kufizuar këtë fenomen, duhet krijuar mundësia e ndërrimit të prokurorit ose që ndaj tij të merren masa disiplinore.

*Mossjellja e të paraburgosurve nga ana e policisë*<sup>476</sup> – Ky është një shkak tjetër i shpeshtë për vonesat dhe varet në një masë shumë të madhe në ekzistencën e një infrastrukture të përshtatshme. Gjithsesi, marrja e disa masave të mëposhtme do ta përmirësonte situatën:

- Vendosja e të paraburgosurve në ndërtesa afër gjykatës ku zhvillohet seanca e gjykimit.
- Automjete të mjaftueshme për të sjellë të pandehurit në gjykatë.
- Krijimi i formave më të mira/të lehta të komunikimit mes policisë dhe gjykatave.
  - o Nëse i pandehuri/i paraburgosuri është transferuar në një ndërtesë tjetër, duhen dërguar fletëthirrjet dhe duhet njoftuar gjykata.
  - o Gjykata duhet njoftuar nëse i pandehuri/paraburgosuri do të vonohet për në seancë.
- Gjykata duhet të raportojë drejtuesit përkatës të policisë për rastet e vonesave të gjata apo mossjelljes së të paraburgosurve në gjykatë.
- Policët përgjegjës për shoqërimin e të paraburgosurve në gjykatë duhen kontrolluar rregullisht.
- Përmbushja e këtyre rekomandimeve duhet të bëhet subjekt i kontrollit në gjykatë nga inspektorati.

#### *Planifikimi dhe kalendari i seancave gjyqësore*

Siç u përmend në fillim, KPrP ka nevojë të rishikohet sidomos për sa u përket planifikimit dhe kalendarit të seancave gjyqësore. Në përgjithësi, për rishikimin e KPrP-së, Prezenca e OSBE-së do të rekomandonte të shihej Kodi i Procedurës Penale të Bosnjë-Hercegovinës. Megjithatë edhe me KPrP aktual, me një planifikim të duhur

<sup>475</sup> Krahaso KPrP, neni 332.

<sup>476</sup> Rregullore e Ministrisë së Rendit Publik Nr. 1075 datë 15.09.1999, "Për sigurinë dhe trajtimin e të paraburgosurve", kreu XI. Megjithëse nuk shkruhet shprehimisht, rregullorja i referohet Policisë së Rendit [Publik], e cila tani është e rregulluar me ligjin nr. 8553, datë 25.11.1999, "Për Policinë e Shtetit".

ka shumë mundësi për zhvillimin e seancave gjyqësore më të shkurtra. Duhet theksuar edhe një herë se nëse ato çka thuhet gjatë seancës varen kryesisht nga palët, është gjykata ajo që është përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit në mënyrë të saktë dhe efikase. Për këtë arsye, gjykata duhet të reagojë me ashpërsi ndaj çdo përpjekjeje për të ngadalësuar procesin dhe të shqyrtojë me sy kritik çdo kërkesë për shtyrje.<sup>477</sup>

Së bashku me kërkesën për gjykimin e çështjes,<sup>478</sup> prokurori duhet të paraqesë edhe të gjithë informacionin e vlefshëm për njoftimin e dëshmitarëve. Siç u përmend më sipër, mbrojtja duhet njoftuar menjëherë lidhur me kërkesën për gjykim dhe për faktin se ajo mund të shqyrtojë dhe mund të marrë një kopje të fashikullit të gjykimit.<sup>479</sup> Në mënyrë që të mundësohet planifikimi i seancave të dëshmitarëve, prokurori duhet të tregojë objektin dhe vlerën e provës që paraqet dëshmia e secilit dëshmitar. Kjo e bën edhe më të lehtë vlerësimin e gjykatës se cilët dëshmitarë duhet të pranohen e cilët jo.<sup>480</sup> Prokurori duhet të tregojë gjithashtu se sa kohë mendon se do të zgjasë secila seancë dëshmitarësh. Të njëjtin detyrim duhet të kenë edhe avokatët mbrojtës kur dorëzojnë listën për pyetjen e dëshmitarëve.<sup>481</sup> Përpara fillimit të seancës gjyqësore, gjykata duhet të përgatisë një projektplan se sa do të zgjasë dhe/ose sa seanca do të duhen për shqyrtimin gjyqësor dhe çfarë do të shqyrtohet në secilën seancë. *Me aq mundësi sa ofron Kodi aktual i Procedurës Penale, parimi për gjykim të pandërprerë duhet respektuar dhe duhen planifikuar seanca që mund të zgjasin edhe gjithë ditën derisa të përfundojë gjykimi.*<sup>482</sup> Projektplani duhet diskutuar dhe duhet rënë dakord me prokurorin dhe avokatin mbrojtës. Duhet bërë përpjekje që ky plan të respektohet nga të gjithë dhe të sigurohet pjesëmarrja e të gjithë personave të thirrur për të dëshmuar. Bazuar në kërkesat e paraqitura për dëgjimin e dëshmitarëve, gjykata duhet të fillojë thirrjen e dëshmitarëve. Çfarëdolloj nevojë që lind për ndryshimin e planit, i duhet komunikuar menjëherë gjykatës në mënyrë që ajo të jetë në gjendje të bëjë një planifikim tjetër.<sup>483</sup>

Çështjet e thjeshta që kërkojnë në maksimum vetëm disa orë, duhen planifikuar bashkërisht në mënyrë që brenda një dite të përfundojnë disa çështje.

Duhet bërë përpjekje gjithashtu që të evitohet leximi fjalë për fjalë i dokumenteve të gjata, të cilët ndërkohë janë në dispozicion si për gjykatën, ashtu dhe për palët. Duket se kjo praktikë nuk ka asnjë qëllim praktik, sepse leximi i dokumenteve zakonisht bëhet lexim i shpejtë monoton nga i cili nuk kuptohet asgjë. Duhet që, ose parimi i seancës gojore të respektohet me rreptësi (të lejohen shënime por të mos lexohen tekste me zë

<sup>477</sup> KPrP, neni 342, shih gjithashtu Urdhrin nr. 1830 të MD, datë 3 prill 2001, “Për miratimin e Rregullores ‘Për organizimin dhe funksionimin e administratës gjyqësore, neni 8 pika 10.

<sup>478</sup> KPrP, neni 331.

<sup>479</sup> KPrP neni 335.

<sup>480</sup> KPrP, neni 357 paragrafi 2.

<sup>481</sup> KPrP, neni 337.

<sup>482</sup> KPrP, neni 342.

<sup>483</sup> Komentari i KPrP, fq. 444.

të lartë), ose dokumentet me shkrim të paraqiten në variant të shkurtuar.<sup>484</sup> E njëjta gjë mund të thuhet edhe për leximin me zë të lartë të vendimeve përfundimtare. Parimi i publikimit garantohet duke vënë në dispozicion të *kujtdo* personi të interesuar sipas kërkesës, vendimet përfundimtare dhe kërkesat me shkrim.

Zbatimi i sugjerimeve paraqitur më sipër mund të kryhet nëpërmjet ndryshimeve në KPrP dhe urdhrave administrativë të lëshuar nga Ministri i Drejtësisë për fushat që janë nën juridiksionin e tij, ku të përcaktohen me hollësi detyrimet që kanë gjykatat për të bërë të mundur që shqyrtimi gjyqësor të përfundojë brenda një afati të arsyeshëm kohor dhe të respektohet parimi i gjykimit të pandërprerë. Më pas, mund të përcaktohen masat disiplinore të sugjeruara më lart.

Statistikat e gjykatës duhet të tregojnë numrin e seancave për çështje të ndryshme (ose në përqindje numrin e çështjeve që kanë për shembull 1, 3 ose 6 seanca), kohën e përgjithshme të dëgjimit dhe kohën efektive të dëgjimit,<sup>485</sup> si dhe të tregojnë arsyet për shtyrjet. Si përfundim, kontrolli dhe vlerësimi i gjyqtarëve duhet të marrë në konsideratë gjëra të tilla si aftësinë e tyre për të planifikuar dhe për të drejtuar gjykime të pandërprerë, si dhe nëse ndjekin apo jo se si po shkojnë hetimet për personat e paraburgosur (shih më poshtë).

### 1.3. Hetimi paraprak

Megjithëse Prezenca e OSBE-së nuk e ka përfunduar ende analizën e plotë lidhur me hetimin paraprak, deri tani përvoja ka treguar se në shumë raste në vend që hetimet të kryhen në një kohë sa më të shkurtër të jetë e mundur, përdoren afatet maksimale të lejuar nga KPrP.<sup>486</sup> Kohëzgjatja e hetimeve paraprake ka rëndësi të veçantë kur personat ndodhen në paraburgim.

Si shembull po japim më poshtë shqyrtimin e fashikullit të një çështjeje në Gjykatën e Krimeve të Rënda:

Çështja ka të bëjë me një person të akuzuar në Gjykatën e Krimeve të Rënda për pjesëmarrje dhe organizimin e një organizate kriminale dhe për trafikim narkotikësh.<sup>487</sup> Hetimi u krye kryesisht në Itali duke përgjuar telefonatat përpara se çështja të transferohej në Shqipëri. Nuk është e qartë nëse u kryen hetime apo jo që nga momenti kur i pandehuri u arrestua në Shqipëri më 9 korrik 2003 dhe çështja u regjistrua në prokurorinë shqiptare. As kërkesa për gjykim dhe as gjykimi nuk tregojnë të jetë kryer ndonjë hetim pas transferimit të dosjes. Megjithatë, periudha që u desh për të përfunduar “hetimin” në Shqipëri u zgjat tri herë dhe u deshën gjithsej 8 muaj. Atëherë

<sup>484</sup> Në disa vende, p.sh. në Suedi parimi i seancës verbale interpretohet shumë prerazi; kështu në kreun 46, paragrafi 5 i Kodit të Procedurës (lidhur me çështjet penale) thuhet “Seanca kryesore do të jetë verbale. Palët mund të dorëzojnë apo të lexojnë kërkesa me shkrim vetëm nëse gjykata gjykon se kjo gjë do të ndihmonte në të kuptuarit e prezantimit apo do t’i shërbente procesit në njëfarë mënyre”.

<sup>485</sup> Koha totale që nga fillimi deri në përfundim të secilës seancë.

<sup>486</sup> KPrP, nenet 263, 264, 323 dhe 324. Shih gjithashtu edhe diskutimin lidhur me këtë temë në Vendimin Unifikues Nr. 6 të Gjykatës së Lartë, datë 11 nëntor 2003.

<sup>487</sup> KP, nenet 333 dhe 284/a.

kërkesa për gjykim u depozitua më 23 prill 2004 dhe pas një gjykimi të përsheptuar, gjykata shpalli vendimin më datë 7 qershor 2004.

Një sërë vendimesh lidhur me dhunën në familje tregojnë se megjithëse i pandehuri e pranon akuzën dhe faktet e lidhura ngushtë me ngjarjen janë mbledhur, përsëri duhen muaj që të përfundojnë hetimet. Është sidomos ekspertiza psikiatriko-ligjore ajo që e vonon më shumë procesin.

KPrP e detyron prokurorin që të informojë gjyqtarin me shkrim për gjendjen e të arrestuarit çdo dy muaj nga zbatimi i vendimit të arrestit.<sup>488</sup> Gjithsesi, nga diskutimet e shumta me gjyqtarët dhe prokurorët në vend, del që *kjo dispozitë nuk zbatohet, duke e bërë të pavlefshme kështu një garanci që parashikon KPrP që hetimet të zhvillohen me "kujdes të veçantë" për personat e paraburgosur.*<sup>489</sup> Ekziston një shqetësim i ngjashëm në lidhje me zgjatjen e afatit të hetimeve paraprake.<sup>490</sup> Zgjatjet vendosen nga prokurori i çështjes dhe mund të bëjnë ankim në gjykatën e rrethit.<sup>491</sup> Ndërkohë që shtyrja e parë prej tre muajsh nuk ka nevojë për justifikim, për shtyrjet e mëtejshme deri në dy vjet duhet që hetimi të jetë veçanërisht i kompleks ose të jetë objektivisht i pamundur për t'u kryer brenda afateve të lejuara. Përtej afatit dyvjeçar, afati i hetimit mund të zgjatet vetëm me miratimin e Prokurorit të Përgjithshëm deri në një vit, për çdo zgjatje jo më shumë se tre muaj. Megjithatë, ka shumë pak udhëzime për të përcaktuar se cilat hetime janë komplekse apo objektivisht të pamundura, dhe siç tregon shembulli i mësipërm ka arsye të dyshohet se hetimet shpeshherë zgjaten pa arsye objektivisht të justifikueshme.

Për t'i dhënë fund kësaj, duhet që edhe për shtyrjen tremujore të paraqiten justifikime dhe të përcaktohen udhëzime të qarta se cilat raste përbëjnë çështje komplekse apo të jashtëzakonshme (kjo mund të bëhet, për shembull, me anë rregulloresh administrative) dhe zgjatjet e afatit do të lejohen *vetëm* kur të ketë arsye objektivisht të justifikueshme për një gjë të tillë. Gjithashtu, shtyrjet e afatit duhet të vendosen nga gjykata apo nga kryeprokurori dhe jo siç është sot nga prokurori i çështjes. *Për më tepër detyrimi i prokurorit për të informuar gjyqtarin çdo dy muaj, duhet zbatuar me rreptësi si nga gjykata dhe nga prokuroria* dhe nëse mungon një informacion i tillë gjykata duhet ta kërkojë këtë informacion, dhe në rastet kur gjykata vlerëson se hetimet nuk po zhvillohen siç duhen, atëherë gjykata duhet ta lirojë të pandehurin në fjalë. Siç u sugjerua edhe më sipër, duhen përcaktuar gjithashtu afate maksimale për dorëzimin e raporteve të ekspertizës mjeko-ligjore dhe asaj psikiatriko-ligjore. Statistikat duhet të tregojnë qartë rastet e zgjatjes së afateve dhe arsyet përkatëse. Mënyra se si kryhen hetimet penale duhet të jetë subjekt i kontrolleve të herëpashershme.

<sup>488</sup> KPrP, neni 246 paragrafi 6.

<sup>489</sup> KEDNj, neni 5, paragrafi 3 dhe neni 6, paragrafi 1. Shih gjithashtu edhe Kushtetutën e Shqipërisë neni 28, paragrafi 3.

<sup>490</sup> KPrP, neni 324.

<sup>491</sup> KPrP, nenet 324 dhe 325.

**Rekomandime**

1. Të krijohen sisteme më të mirë të gjendjes civile dhe adresave.
2. Të krijohet një sistem më i mirë për regjistrimin e numrave të telefonit dhe atyre celularë.
3. Policia dhe prokuroria duhet të mbledhin informacion të plotë të dobishëm për qëllime njoftimi.
4. Duhet rishikuar rregullat e njoftimit.
  - o Duhet konsideruar një formë “më e thjeshtë njoftimi” pas njoftimit fillestar.
  - o Duhet konsideruar edhe njoftimi me anë të kompanive private të njoftimeve.
  - o Çdo njoftim duhet t’i kërkojë marrësit të konfirmojë dhe të japë informacion shtesë të vlefshëm për një njoftim të suksesshëm.
  - o Në njoftim duhen shprehur me hollësi pasojat që vijnë nga moszbatimi i urdhrin.
5. Në të gjitha format e komunikimit të gjykatës duhet përcaktuar personi i kontaktit në rast se dalin probleme që kanë të bëjnë me zbatimin e njoftimit.
6. Pasi të jenë njoftuar, dëshmitarët duhen kontaktuar për t’u siguruar se ata do të paraqiten sipas asaj që është planifikuar.
7. Duhet marrë në konsideratë nga ana e gjykatës që bën njoftimin, vendosja e gjobave administrative për ata persona të cilët nuk paraqiten për arsye të papërligjura.
8. Përveç sa është parashikuar në ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, duhen konsideruar masa të tjera mbrojtëse si për shembull, caktimi i një personi kontakti për dëshmitarët.
9. Duhet parashikuar masa disiplinore ndaj avokatëve mbrojtës, mundësisht në varësi të Dhomës së Avokatisë.
10. Mbrojtjes i duhet dhënë një kopje e fashikullit të gjykimin ose
11. Gjykatat duhet të bëjnë të mundur që avokati mbrojtës të ketë mundësi të shohë menjëherë fashikullin e gjykimin dhe të njoftohet për këtë fakt.
12. Duhet parashikuar mundësia e kërkesës për ndërrimin e prokurorit për mosparaqitje apo dhënies së masave disiplinore.
13. Të paraburgosurit duhen vendosur në ambiente pranë gjykatës ku gjykohet çështja.
14. Policia duhet të jetë e detyruar të njoftojë gjykatën për vonesa.
15. Duhet raportuar rastet e mosshoqërimit të të paraburgosurve nga ana e policisë dhe duhet të ketë kontrole të vazhdueshëm të policëve përgjegjës për shoqërimin e të paraburgosurve.
16. Duhet rishikuar KPrP.
17. Statistikat e gjykatës duhet të japin informacion të plotë lidhur me numrin e seancave dhe kohëzgjatjen e gjykimeve.
18. Përgjegjësia e gjykatave për të siguruar gjykime efektive duhet bërë e qartë dhe duhet dhënë e detajuar në *udhëzimet administrative*.
19. Së bashku me kërkesën për gjykim, prokurori duhet të dorëzojë të gjithë informacionin që ka të bëjë me njoftimin e dëshmitarëve.
20. Prokurori dhe avokati mbrojtës duhet të tregojnë objektin dhe vlerën e provës të dëshmisë të secilit dëshmitar si dhe të tregojnë edhe kohën që nevojitet për secilën seancë.
21. Gjykata duhet të jetë e detyruar të hartojë një plan për çdo gjykim ku të jepet me hollësi sa kohë/sa seanca nevojiten si dhe çfarë do të shqyrtohet në secilën seancë; d.m.th., kur do të thirret secili nga dëshmitarët etj.
22. Palët duhet të bien dakord për projektplanin përpara fillimit të procesit gjyqësor dhe pastaj ta zbatojnë atë.

23. Çështjet e thjeshta të planifikohen bashkë dhe të zhvillohen brenda një dite.
24. Duhet mënjënuar leximi fjalë për fjalë i dokumenteve.
25. Kontrolli i gjyqtarëve duhet të marrë parasysh aftësinë e tyre për të planifikuar dhe për të drejtuar gjykime të pandërprera.
26. Duhet parashikuar afate maksimale ligjore për kryerjen e ekspertizës mjeko-ligjore dhe asaj psikiatriko-ligjore.
27. Duhet zbatuar me përpikëri detyrimi i prokurorit për të informuar gjykatën me shkrim rreth procedimeve në rastet kur një person ndodhet në paraburgim. Duhet kontrolluar rregullisht edhe gjyqtarët edhe prokurorët për të parë nëse i zbatojnë këto detyrime apo jo.
28. Çdo zgjatje e hetimit paraprak duhet justifikuar dhe vendosur nga një gjyqtar ose të paktën një kryeprokuror.
29. Duhet parashikuar udhëzime ku të përcaktohen rastet e justifikueshme për zgjatjen e afateve.
30. Statistikat duhet të japin informacion të plotë për zgjatjen e afateve.

## 2. Mbi integritetin e dëshmitarëve dhe çështje të tjera lidhur me të

### *Hyrje*

Shqipëria është një vend në tranzicion dhe qysh nga rënia e diktaturës në vitin 1991, sistemi gjyqësor në këtë vend ka pësuar ndryshime rrënjësore për ta përafuar atë me standardet evropiane. Megjithëse me një ritëm më të ngadaltë, këto ndryshime do të vazhdojnë edhe në të ardhmen e afërt. Një shoqëri në tranzicion është një shoqëri shumë delikate dhe vendet në tranzicion, sidomos ato në Ballkan, janë goditur nga krimi i organizuar me të gjitha format e tij. Në Shqipëri, trafikimi i njerëzve, lëndëve narkotike, automjeteve, cigareve dhe mallrave të tjerë nga grupe apo struktura kriminale jo shumë të organizuara janë bërë tepër të shpeshta ndërkohë që këto mallra blihen dhe shfrytëzohen në tregun e madh e fitimprurës të Bashkimit Evropian. Kohët e fundit në Shqipëri i është kushtuar shumë vëmendje luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Gjithsesi, për të ndërtuar një shoqëri bazuar në shtetin e së drejtës dhe të të drejtave të njeriut nuk është e mjaftueshme vetëm lufta kundër kriminalitetit të nivelit të lartë. Ndërkohë që krimi i organizuar sjell kosto të mëdha shoqërore, ai nuk ndikon në jetën e përditshme të qytetarëve të cilët preken më tepër nga konflikte pronësie dhe konflikte kontraktuale si dhe nga kriminaliteti ordiner siç janë krimet e dhunshme dhe shkeljet e pronës së tyre. Paralelisht me luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, është thelbësor që të ndërtohet një sistem i fortë gjyqësor me një nivel të lartë integriteti, ku palët të kenë besim se konfliktet e tyre civile dhe penale do të zgjidhen në mënyrë të drejtë dhe transparente bazuar në fakte dhe prova të besueshme, dhe sidomos në *dëshmitë e dëshmitarëve*.

Dëshmitarët<sup>492</sup> janë një element i rëndësishëm në pjesën më të madhe të proceseve gjyqësore dhe për pasojë, edhe për funksionimin e çdo sistemi gjyqësor. Për këtë arsye është e nevojshme të sigurohet sa më shumë të jetë e mundur që dëshmitarët të paraqiten në gjykim dhe të japin dëshmi të sakta dhe të vërteta, kjo do të thotë që të ketë masa për parandalimin e dëmtimit, frikësimit, kanosjes apo ndikimit në forma të tjera të dëshmitarëve. Ndërkohë që interesat që diskutohen në çështjet civile mund të rezultojnë në përpjekje për të influencuar dëshmitarët që të dëshmojnë në favor të një pale, në çështjet penale mund të jenë përfshirë persona të cilët nuk hezitojnë që vetë ose duke kontraktuar persona të tjerë të kryejnë krime të dhunshme për të ndaluar apo për të influencuar dëshmitarët. Në Shqipëri ashtu si edhe në shumë vende të tjera, dalja si dëshmitar është detyrim ligjor.<sup>493</sup> Sidoqoftë nuk është e arsyeshme që dikush të detyrohet të paraqitet si dëshmitar, nëse kjo gjë do të rrezikonte jetën dhe sigurinë e tij. Prandaj detyrimi për t'u paraqitur si dëshmitar duhet të balancohet nga ana tjetër me të drejtën e jetës të dëshmitarit dhe të familjes siç shprehet në nenet 2 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe me të drejtën e përgjithshme për

<sup>492</sup> Duhet vënë në dukje që në rastet e trafikimit për shembull, dëshmitarët janë shpeshherë edhe vetë viktimat/palët e dëmtuar dhe në këtë analizë koncepti dëshmitar përfshin edhe viktimat që dëshmojnë në gjyq, përveç rasteve kur thuhet shprehimisht ndryshe.

<sup>493</sup> KPrP, nenet 157, 297 dhe 312; *shih gjithashtu* KP, neni 310.

sigurinë e personit dhe të pronës. Lidhur me çështjen “Doorson”, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut u shpreh:

Është e vërtetë që neni 6 nuk kërkon shprehimisht që të merren parasysh interesat e dëshmitarëve në përgjithësi dhe në veçanti interesat e viktimave që thirren për të dëshmuar. Gjithsesi, mund të vihet në rrezik jeta, liria apo siguria e personit si dhe interesat që rrjedhin përgjithësisht nga neni 8 i Konventës. Të tilla interesa të dëshmitarëve dhe viktimave në parim mbrohen nga dispozita të tjera të shkruara të Konventës, të cilat nënkuptojnë që Shtetet Kontraktuese duhet t'i organizojnë procedimet e tyre penale në mënyrë të tillë që këto interesa të mos vihen në rrezik pa arsye të justifikueshme. Në këtë kontekst, parimet e procesit të rregullt gjyqësor kërkojnë që aty ku është e përshtatshme, interesat e mbrojtjes të balancohen me ato të dëshmitarëve apo viktimave të thirrura për të dëshmuar.<sup>494</sup>

Për të inkurajuar dhënien e informacionit nga ana e dëshmitarëve, duhen marrë masa gjithashtu që paraqitja e tyre në procesin gjyqësor të jetë sa më e qetë dhe e sigurtë dhe të mos ndërhyjë në jetën normale të dëshmitarit më shumë se sa është e nevojshme. Nga ana tjetër, çfarëdolloj mase e marrë për sigurinë e dëshmitarëve duhet balancuar me të drejtat e palës mbrojtëse dhe detyrimin për të respektuar parimet e një procesi të rregullt sipas Nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

### *Konteksti shqiptar*

Në këtë kapitull, dëshmitarët ndahen, jo me shumë rigorozitet, në tri kategori: dëshmitarë të mbrojtur, dëshmitarë të përfshirë në çështje të Gjykatës për Krime të Rënda dhe dëshmitarë të tjerë. Qëllimi është që të paraqitet situata e të gjithë dëshmitarëve të cilët dëshmojnë përpara gjykatave në Shqipëri dhe të japë sugjerime për ato sfera ku nevojitet analizim dhe përmirësim i mëtejshëm, në mënyrë që të pakësohet rreziku i manipulimeve dhe të përmirësohet cilësia e dëshmive të dëshmitarëve.

Një nga shkaqet më të shpeshta për vonesën e proceseve gjyqësore në Shqipëri është mosparaqitja e dëshmitarëve. Kjo mund të ndodhë për shkaqe të ndryshme, që nga paaftësia për të lokalizuar dhe njoftuar dëshmitarët deri tek refuzimi nga ana e dëshmitarëve për t'u paraqitur nga *frika për ndëshkim*. Dëshmitarët mund të vriten me qëllim që të mos dëshmojnë, gjithashtu mbi ta mund të ushtrohet presion me anë të dhunës apo kërcënimeve ose ata edhe mund të “blihen”. Kur dëshmitarët paraqiten në gjyq, në përgjithësi nuk ekziston një ambient i mbrojtur<sup>495</sup> për ta, gjë që në shumë raste lejon që ata të konfrontohen me palët ose me persona që kanë lidhje me palët. Kjo gjë bën që dëshmitarët të jenë pre e kërcënimit dhe dhunës. Ka gjithashtu edhe dëshmitarë të cilët mund të mos frikësohen nga presionet, por që dëshmia e tyre mund të ndikohet negativisht nga prania e të pandehurit apo personave të tjerë. Ky është

<sup>494</sup> Çështja “Doorson kundër Hollandës”, 26 mars 1996, paragrafi 70.

<sup>495</sup> Në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda është ngritur kohët e fundit një dhomë dëshmitarësh me hyrje të veçantë, përndryshe ambiente të tilla nuk ekzistojnë.



një shqetësim veçanërisht në rastet ku përfshihen viktima të mitur si dhe ato raste të të gjithave formave të dhunës në familje dhe të dhunës seksuale. Një faktor tjetër që mund të ndikojë negativisht, si në gatishmërinë e dëshmitarit për të dëshmuar, ashtu edhe në cilësinë e dëshmisë, është mungesa e informimit të publikut të gjerë për rolin dhe qëllimin e dëshmisë së dëshmitarëve.

Ka pasur tregues që edhe policia ndonjëherë kërcënon dëshmitarët apo u bën presion atyre, kur dëshmitarët tërhiqen apo ndryshojnë deklaratimet e tyre [pas kërcënimeve apo presionit nga të pandehurit apo persona të tjerë]. Për shembull dëshmitarit/es mund t'i thuhet që do të ndiqet penalisht për dëshmi të rreme. Ky është padyshim një shqetësim sidomos me gratë e trafikuar, të miturit si dhe persona të tjerë të cilët nuk kanë mekanizma të fortë mbështetës.

Në Shqipëri janë marrë disa masa për të rritur sigurinë e dëshmitarëve sidomos në kontekstin e luftës kundër krimit të organizuar, me miratimin e ligjit “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë” (Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve) dhe aktet nënligjore të tij.<sup>496</sup> Qëllimi i ligjit është të sigurojë një mbrojtje efektive për dëshmitarët dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë të përfshirë në raste krimesh të rënda. Përkufizimi i “krimit të rëndë” në zbatim të ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve, ka një fushë veprimi të ndryshme nga juridiksioni i Gjykatave për Krime të Rënda.<sup>497</sup> Kjo do të thotë që raste që përfshijnë persona nën mbrojtje mund të gjykohen nga gjykata të ndryshme rrethesh, por do të thotë gjithashtu që masat për mbrojtjen e dëshmitarëve nuk janë të zbatueshme për të gjithë personat e përfshirë në proceset gjyqësore të Gjykatave për Krime të Rënda. Megjithatë, në shumicën e rasteve, personat që janë subjekt i mbrojtjes sipas ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve, d.m.th., dëshmitarë të mbrojtur<sup>498</sup> dhe bashkëpunëtorë të drejtësisë, janë të përfshirë në çështje që gjykohen nga Gjykatat e Krimeve të Rënda (GjKR).<sup>499</sup> Shih tabelën e mëposhtme.

<sup>496</sup> Ligji nr. 9205, datë 15 mars 2004, “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë” (Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve) dhe aktet nënligjore të botuar në *Fletoren Zyrtare* nr. 61, 3 gusht 2005. Ligji është mbështetur gjerësisht në legjislacionin lituan, Republika e Lituaniës, Ligji për mbrojtjen nga ndikimi kriminal të pjesëmarrësve në procedimet penale dhe veprimtari klandestine, oficerët e policisë dhe drejtësisë, Vilnius, 13 shkurt 1996, nr. I – 1202.

<sup>497</sup> Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda (GjKR; i nënkupton të dyja).

<sup>498</sup> Terminologjia është paksa ngatërruese, pasi ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve përcakton person ndaj të cilit zbatohen masat e posaçme të mbrojtjes si “dëshmitar i drejtësisë”, ndërsa titulli i ligjit i referohet “mbrojtjes së dëshmitarëve” dhe KPrP neni 361/a u referohet “dëshmitarëve të mbrojtur”. Këtu përdoret termi “dëshmitarë të mbrojtur”.

<sup>499</sup> Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve, neni 2 f), Kodi i Procedurës Penale (KPP) neni 75/a, dhe ligji nr. 9110, datë 24 Korrik 2003, Mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave për Krimet e Rënda (ligji për GjKR), neni 5.

VII. GJYKIME EFIKASE DHE ÇËSHTJE LIDHUR ME DËSHMITARËT

Fusha e veprimit e ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve		Juridiksioni i Gjykatave për Krime të Rënda	
Neni i KP	Vepra Penale	Neni i KP	Vepra Penale
73	Genocidi	73	Genocidi
74	Krime kundër njerëzimit	74	Krime kundër njerëzimit
75	Krimet e luftës	75	Krimet e luftës
79 a-ë	Vrasje me dashje për arsye të cilësive të veçanta të viktimës	79 c, ç	Vetëm kundër funksionarëve publikë (c), kallëzuesit, dëshmitarit, të dëmtuarit ose palëve të tjera ndërgjyqëse(ç)
89/a	Shitblerja e transplanteve		
100	Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur		
101	Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç		
109	Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit	109	Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit
		109/b	Shtrengimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënie e pasurisë
110/a	Trafikimi i personave	110/a	Trafikimi i personave
111	Rrëmbimi i avionëve, anijeve dhe mjeteve të tjera	111	Rrëmbimi i avionëve, anijeve dhe mjeteve të tjera
114/a	Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese		
114/b	Trafikimi i femrave për prostitucion	114/b	Trafikimi i femrave për prostitucion
128/b	Trafikimi i të miturve	128/b	Trafikimi i të miturve
208	Dorëzimi i territorit		
209	Dorëzimi i forcave të armatosura		
211	Provokimi i luftës		
213	Dhënia e informatave sekrete		
219	Atentati	219	Atentati
220	Komploti	220	Komploti
221	Kryengritja	220	Komploti
222	Thirrjet për armatosje ose marrja pa të drejtë e komandës		
230	Aktet terroriste	230	Aktet terroriste
230/a	Financimi i terrorizmit	230/a	Financimi i terrorizmit

Fusha e veprimit e ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve		Juridiksioni i Gjykatave për Krime të Rënda	
Neni i KP	Vepra Penale	Neni i KP	Vepra Penale
		<b>230/b</b>	Fshehja e fondeve dhe e pasurive të tjera, që financojnë terrorizmin
<b>231</b>	Veprat e dhunshme ndaj pasurisë	<b>231</b>	Veprat e dhunshme ndaj pasurisë
<b>232</b>	Shpërndarja e substancave të rrezikshme	<b>232</b>	Shpërndarja e substancave të rrezikshme
<b>233</b>	Krijimi i turmave të armatosura	<b>233</b>	Krijimi i turmave të armatosura
<b>234</b>	Prodhimi i armëve luftarake	<b>234</b>	Prodhimi i armëve luftarake
		<b>234/a</b>	Organizata terroriste
		<b>234/b</b>	Banda e armatosur
<b>278/a</b>	Trafikimi i armëve dhe i municionit	<b>278/a</b>	Trafikimi i armëve dhe i municionit
<b>283</b>	Prodhimi dhe shitja e narkotikëve		
		<b>283/a</b>	Trafikimi i narkotikëve
<b>284/a</b>	Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale	<b>284/a</b>	Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale
<b>284/c</b>	Prodhimi dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope		
<b>284/ç</b>	Prodhimi, tregtimi dhe përdorimi i paligjshëm i prekursorëve		
<b>286</b>	Nxitja për përdorimin e drogës		
<b>287</b>	Pastrimi i produkteve të veprës penale		
		<b>287/a</b>	Çelja e llogarive anonime
<b>333</b>	Organizata Kriminale	<b>333</b>	Organizata kriminale
		<b>333/a</b>	Grupi i strukturuar kriminal
<b>334</b>	Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal	<b>334</b>	Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal

*Dëshmitarët e mbrojtur dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë* – Për t’u cilësuar si të tillë, dëshmitarët dhe bashkëpunëtorët duhet të jenë të përfshirë në një çështje “krimi të rëndë” siç përcaktohet në ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve. Dëshmia e personit duhet të jetë e një rëndësie themelore për çështjen ose duhet të shërbejë për të parandaluar krime të tjera të rënda dhe personi duhet të jetë “në gjendje rreziku aktual, konkret dhe serioz” dhe të jetë i gatshëm të bashkëpunojë plotësisht.<sup>500</sup> Masat e posaçme të mbrojtjes janë:

“Ndryshimi i identiteti, ndryshimi i vendbanimit, mbrojtja e përkohshme e identitetit, e të dhënave dhe dokumenteve, masa të veçanta mbrojtëse, fizike dhe teknike, rehabilitimi social, ruajtja, ndryshimi dhe sigurimi i përkohshëm i vendit të punës, dhënia e ndihmës financiare, rikualifikimi profesional, dhënia e këshillave dhe e ndihmës së specializuar ligjore ose mënyra të tjera të caktuara sipas ligjit.”<sup>501</sup>

Edhe personat *e afërm ose të lidhur* me një dëshmitar të mbrojtur apo bashkëpunëtor të drejtësisë mund të përfitojnë masat e posaçme të mbrojtjes. Ligji i përkufizon “personat e afërm” si personat që ndodhen në gjendje rreziku aktual, konkret dhe serioz për shkak të lidhjeve familjare, të gjinisë a krushqisë me dëshmitarin ose bashkëpunëtorin e drejtësisë, ndërsa “personat e lidhur” përcaktohen si personat që, për shkak të natyrës së marrëdhënieve konkrete që kanë me dëshmitarin ose bashkëpunëtorin e drejtësisë, ndodhen në gjendje rreziku aktual, konkret dhe serioz.<sup>502</sup>

Në seancat gjyqësore, dëshmitarët e mbrojtur dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë mund të dëgjohen nën një identitet tjetër/të rremë me anë të metodave të posaçme për deformimin e zërit ose me anë të lidhjes audiovizive.<sup>503</sup>

*Dëshmitarët në GjKR* – Përveç masave të rezervuara për dëshmitarët e mbrojtur dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë, GjKR mund të lejojë që përpara tyre të pyetet çfarëdo lloj dëshmitari në prani të të pandehurit dhe avokatit mbrojtës, por pa qenë në kontakt vizual me ta.<sup>504</sup> GjKR-së i lejohet më tepër se gjykatave të tjera për të mbajtur seanca me dyer të mbyllura, sidomos kur bëhet fjalë për sigurinë e *ndonjë* pjesëmarrësi.<sup>505</sup> Sidoqoftë, përdorimi i dëshmitarëve anonimë duhet të jetë i kufizuar, pasi kjo gjë e mbart në vetvete rrezikun që i pandehuri të mos ketë mundësinë t’i kundërshtoj efektivisht deklaratat e një dëshmitari. Gjykata Evropiane ka gjykuar se dëshmitarët anonim nuk janë provë e

<sup>500</sup> Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve, nenet 8 dhe 9.

<sup>501</sup> Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve, neni 10.

<sup>502</sup> Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve, neni 2, paragrafi c, ç, dhe neni 9.

<sup>503</sup> Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve, neni 10 paragrafi 1 d), KPrP neni 361/a dhe ligji “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda”, neni 8 c.

<sup>504</sup> Në mënyrë që ky nen të jetë efektiv, duhet pranuar se qëllimi është që identiteti i dëshmitarëve të jetë sekret ndaj kujtdo, jo vetëm ndaj të pandehurit dhe avokatit të tij mbrojtës, prandaj është një dispozitë që lejon dëshmitarë anonim.

<sup>505</sup> Ligji për GjKR, neni 7.

mjaftueshme për të bazuar dënimin dhe që kur përdoren dëshmitarë anonim, problemi që kjo gjë i shkakton mbrojtjes duhet kompensuar me anë të procedurave që ndiqen nga autoritetet gjyqësore.<sup>506</sup>

*Dëshmitarët e tjerë* – Fakti që një dëshmitar nuk i përmbush kriteret për të qenë i mbrojtur sipas ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve, apo nuk pyetet në GjKR, nuk do të thotë që nuk ekziston kërcënimi, madje i fortë, ndaj një dëshmitari të tillë. Për më tepër, siç u theksua edhe më sipër, në rastet që kanë të bëjnë sidomos me dhunën në familje apo dhunën seksuale, mund të jetë shumë e vështirë për dëshmitarët të flasin lirshëm në prani të të pandehurit dhe/apo të personave të tjerë. Prandaj, është e nevojshme të shihet në tërësi se çfarë masash mund të merren në raste të ndryshme dhe çfarë mund të bëhet për të përmirësuar situatën pa kompromentuar të drejtat e mbrojtjes. Për ata dëshmitarë të cilët nuk janë as dëshmitarë të mbrojtur as të thirrur në GjKR, zbatohen rregullat e zakonshme për dëgjimin e dëshmitarëve. Në këto kushte, si rregull i përgjithshëm dëshmitari paraqitet në një seancë publike ku identiteti dhe adresa e të cilit bëhen të ditura dhe ku ai përballlet me të pandehurin dhe avokatin mbrojtës.

Në kuadrin aktual ligjor ka një sërë rregullash që mund të përdoren për të ndaluar ndikimin apo kërcënimin e dëshmitarëve. Këto rregulla janë të zbatueshme për të gjithë dëshmitarët në çështjet penale.<sup>507</sup> Kështu që, aty ku *ka arsye* për të besuar se personi mund të jetë i ekspozuar ndaj dhunës, kërcënimeve apo të ofertave përfitimi me qëllim që të mos dëshmojë apo të bëjë dëshmi të rreme, mund të *sigurohen* prova gjatë hetimit paraprak, që do të thotë se dëshmitarit nuk do t'i duhet të paraqitet në gjyq dhe që në këtë mënyrë krijohet më pak ngacmim për të ndikuar dëshmitarin.<sup>508</sup> Seanca kryhet në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës dhe i pandehuri ka të drejtë të jetë i pranishëm (ndoshta i pandehuri edhe mund të përjashtohet pa shkelur shumë të drejtat e mbrojtjes).<sup>509</sup> Një arsye për të mbajtur një seancë me dyer të mbyllura, d.m.th., seancë pa praninë e publikut dhe medias, është që të mbrohen dëshmitarët apo të pandehurit në çështjet penale.<sup>510</sup> Në çështjet civile, seancat me dyer të mbyllura mund të bëhen në rrethana të veçanta kur kjo është në interes të drejtësisë.<sup>511</sup>

Në ato çështje penale ku është *absolutisht e pamundur* paraqitja e dëshmitarit, gjykata, me kërkesën e palëve, mund të vendosë të marrë në pyetje një dëshmitar apo ekspert në vendbanimin e tij. Kjo seancë është e mbyllur për publikun dhe i pandehuri përfaqësohet me anë të avokatit mbrojtës por nuk i lejohet të marrë pjesë personalisht.<sup>512</sup> Për sa i përket konceptit *pamundësi absolute*, kjo shprehje e fortë tregon se kjo dispozitë

<sup>506</sup> Çështja “Kostovski kundër Hollandës”, 20 nëntor 1989, paragrafi 43, 44, shih gjithashtu çështjen “Doorson kundër Hollandës”, 26 mars 1996, paragrafi 71 e në vazhdim.

<sup>507</sup> Për çështjet civile shih, KPC, neni 292.

<sup>508</sup> KPrP, neni 316.

<sup>509</sup> KPrP, nenet 321 dhe 322.

<sup>510</sup> KPrP, neni 340.

<sup>511</sup> KPrC, neni 173 dh).

<sup>512</sup> KPrP, neni 364.

është e zbatueshme vetëm kur dëshmitari nuk mund të paraqitet për shkak të një sëmundjeje të rëndë apo për arsye të tjera shtrënguese. Megjithatë, në Komentarin e KPrP shpjegohet vetëm që kur dëshmitari nuk paraqitet për *arsye të përlligjura*, seanca mund të mbahet në vendqëndrimin e tij.<sup>513</sup> Për këtë arsye, mund të argumentojmë se në rastet kur kërcënohet siguria e një dëshmitari dhe dëshmitari nuk i përmbush kriteret për mbrojtje nga ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve, mund të zbatohet kjo dispozitë, dhe në raste të tilla i pandehuri mund të përjashtohet kur shihet e nevojshme. Në çështjet civile, për shkak sëmundjesh apo arsyesh të tjera të veçanta, dëshmitarët dhe ekspertët mund të pyeten jashtë gjykatës por në prani të palëve apo përfaqësuesve të tyre.<sup>514</sup> Në çështjet penale gjykata mund të largojë cilindo person që pengon zhvillimin normal të seancës.<sup>515</sup>

Në Kodin e Procedurës Penale, ka një dispozitë mjaft të paqartë, neni 361 pika 7, e cila parashikon që: “Dëshmitari mund të pyetet në distancë, brenda ose jashtë vendit, me anë të lidhjes audiovizive, duke respektuar rregullat e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe dispozitat e këtij Kodi. Personi i autorizuar nga gjykata qëndron në vendin ku ndodhet dëshmitari dhe bën vërtetimin e identitetit të tij, si dhe kujdeset për zhvillimin e rregullt të marrjes në pyetje e për zbatimin e masave të mbrojtjes. Këto veprime ai i pasqyron në procesverbal.”

Ndërkohë që kjo dispozitë mund të interpretohet si e zbatueshme për çdo dëshmitar, referimi ndaj marrëveshjeve ndërkombëtare dhe dispozitave [të tjera] të Kodit mund të jetë një tregues që përcakton se kjo dispozitë është e zbatueshme vetëm për disa kategori dëshmitarësh. Kështu për shembull, Konventa e Palermos,<sup>516</sup> ku Shqipëria është palë, e cila është e zbatueshme për krimin ndërkombëtar e të organizuar, u kërkon shteteve anëtare të përcaktojnë rregulla të qarta për të lejuar që dëshmitarët e dëshmitarëve të jepen në mënyrë të tillë që të mbrojnë sigurinë e dëshmitarit/viktimës, siç janë lejimi i dhënies së dëshmisë nëpërmjet lidhjes audiovizive apo mjeteve të tjera të përshtatshme.<sup>517</sup> Për më tepër neni 361/a, i cili u miratua me të njëjtin ligj, si dhe pika 7 e nenit 361,<sup>518</sup> parashikon që “Kur disponon mjete teknike, gjykata mund të vendosë që marrja në pyetje e tyre të zhvillohet në distancë me anë të lidhjes audiovizive, sipas rregullave të parashikuara në pikën 7 të nenit 361”. Kjo dispozitë në veçanti dhe referimi ndaj pikës 7 të nenit 361, është një tregues mjaft i qartë që masat e përcaktuara në pikën 7 të nenit 361, janë të zbatueshme vetëm për dëshmitarët e mbrojtur dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë. Në anën tjetër, duke pasur parasysh se pika 7 e nenit 361 nuk përmban kufizime apo kushte për zbatimin e saj, duhet arsyetuar se kjo dispozitë është e zbatueshme për të gjithë dëshmitarët kur ekzistojnë probleme sigurie.

<sup>513</sup> Komentari i Procedurës Penale; Halim Islami, Artan Hoxha dhe Ilir Panda, Tirana 2003, fq. 489.

<sup>514</sup> KPrC, neni 236.

<sup>515</sup> KPrP, neni 341.

<sup>516</sup> Konventa e Kombeve të Bashkuara për Krimin Ndërkombëtar e të Organizuar (Konventa e Palermos), miratuar më 12-15 dhjetor 2000.

<sup>517</sup> Konventa e Palermos, neni 24, paragrafët 2 b dhe 4, shih gjithashtu nenin 18, paragrafin 18.

<sup>518</sup> Ligji nr. 9276, datë 16 shtator 2004.

Si përfundim, ndikimi me anë kërcënimi, dhune apo ofertash e përfitimesh ndaj dëshmitarëve apo viktimave është vepër penale dhe vrasja me paramendim e një dëshmitari, viktime apo pale ndërgjyqëse, konsiderohet veçanërisht serioze.<sup>519</sup>

*Të miturit* – Në legjisllacionin shqiptar nuk ka kufizime për sa i përket thirrjes së dëshmitarëve të mitur, por dëshmitarët nën 14 vjeç nuk mund të bëjnë betimin e dëshmitarit.<sup>520</sup> Pyetja e të miturve mund të bëhet nga kryetari i seancës, i cili mund edhe të ndihmohet nga një familjar i të miturit ose nga një specialist i fushës së edukimit të fëmijëve.<sup>521</sup> Përveç kësaj, nuk ekzistojnë rregulla të tjerë të veçantë.

Në tabelën e mëposhtme jepet një përmbledhje e masave të ndryshme në sistemin shqiptar të drejtësisë që mund të merren për të mbrojtur dëshmitarët.

Lloji i dëshmitarit	Masa	Kushtet për t'u zbatuar	Nenet
<b>Çdo dëshmitar</b>	Marrja e provave gjatë hetimit paraprak.. Avokati mbrojtës duhet të jetë i pranishëm, i pandehuri <i>ka të drejtë</i> të marrë pjesë.	Arsye të shëndosha për të besuar se personi mund të jetë subjekt dhune, kërcënimesh apo ofertash për përfitim me qëllim që të mos dëshmojë apo që të bëjë dëshmi të rreme	KPrP 316
<b>Çdo dëshmitar</b>	Seancë me dyer të mbyllura (përjashtohen vetëm publiku dhe media)	Ë nevojshme për të mbrojtur dëshmitarin/ët	KPrP 340, KPrC 173 dh)
<b>Çdo dëshmitar</b>	Seancë në vendbanimin/ vendqëndrimin e dëshmitarit. Seancë me dyer të mbyllura ku avokati mbrojtës duhet të jetë i pranishëm dhe i pandehuri “mund” të jetë i pranishëm.	“Pamundësi absolute”, sëmundje apo arsye të tjera të veçanta	KPrP 364, KPrC 236
<b>Çdo dëshmitar</b>	Përjashtimin e personave që kërcënojnë dëshmitarin	Pengon zhvillimin normal të seancës	KPrP 341
<b>Çdo dëshmitar</b>	Ndikimi i një dëshmitari përbën vepër penale	Veprim drejtuar kundër personit në kapacitetin e tij/saj si dëshmitar	KP 79, 311, 312 dhe 312/a

<sup>519</sup> KP, nenet 79, 311, 312 dhe 312/a.

<sup>520</sup> KPrP, nenet 155, 360.

<sup>521</sup> KPrP, neni 361, paragrafi 5.

VII. GJYKIME EFIKASE DHE ÇËSHTJE LIDHUR ME DËSHMITARËT

Lloji i dëshmitarit	Masa	Kushtet për t'u zbatuar	Nenet
<b>Dëshmitarët në GjKR</b>	Pyetja e dëshmitarit në prani por pa kontakt vizual me të pandehurin	Në ligj nuk përmenden kushte, por qëllimi është mbrojtja e dëshmitarëve	Ligji për GjKR 8 a)
<b>Dëshmitarët në GjKR</b>	Pyetja e dëshmitarit pa i komunikuar të pandehurit dhe mbrojtësit identitetin e dëshmitarit	Në ligj nuk përmenden kushte, por qëllimi është mbrojtja e dëshmitarëve	Ligji për GjKR 8 b
<b>Dëshmitarët e mbrojtur dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë në procesin gjyqësor</b>	Pyetja e dëshmitarit nën identitet tjetër/të rremë	Që personi të jetë përcaktuar si dëshmitar i mbrojtur apo bashkëpunëtor i drejtësisë	Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve 10, 1 d), KPrP 261/a dhe ligji për GjKR 8 c
<b>Dëshmitarët e mbrojtur dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë procesin gjyqësor</b>	Pyetja e dëshmitarit me anë mjetesh të posaçme për deformimin e zërit	Që personi të jetë përcaktuar si dëshmitar i mbrojtur apo bashkëpunëtor i drejtësisë	Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve 10, 1 d), KPrP 261/a dhe ligji për GjKR 8 c
<b>Dëshmitarët e mbrojtur dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë në procesin gjyqësor</b>	Pyetja e dëshmitarit me anë të lidhjes audiovizuale	Që personi të jetë përcaktuar si dëshmitar i mbrojtur apo bashkëpunëtor i drejtësisë	Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve 10, 1 d), KPrP 261/a dhe ligji për GjKR 8 c



<p><b>Dëshmitarët e mbrojtur dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë</b></p>	<p>Ndryshim identiteti, ndryshim i vendbanimit brenda ose jashtë vendit, mbrojtja e përkohshme e identitetit, e të dhënave dhe dokumenteve, masa mbrojtëse, fizike dhe/ose teknike, rehabilitim social, ruajtje, ndryshim i vendit të punës dhe sigurim i punësimit të përkohshëm, ndihmë financiare, rikualifikim profesional, dhënia e ndihmës së specializuar ligjore ose masa të tjera të caktuara sipas ligjit.</p>	<p>Dëshmia e personit duhet të jetë e një rëndësie themelore për rastin ose duhet të shërbejë për të parandaluar krime të tjera serioze dhe personi duhet të jetë në rrezik aktual, konkret dhe serioz dhe të jetë i gatshëm të bashkëpunojë plotësisht.</p>	<p>Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve, nenet 8 dhe 9</p>
---	--	--	--

*Viktimat e trafikimit* – Përveç masave të paraqitura më sipër, ekzistojnë programe rajonale për leje të përkohshme qëndrimi për viktimat e trafikimit. Shqipëria është zotuar të marrë pjesë në këtë program dhe janë rekomanduar ndryshime në ligjin për të huajt, por deri tani nuk janë miratuar.<sup>522</sup> Arsyeja përtej këtyre programeve është që viktimat e trafikimit të kenë mundësi të dëshmojnë kundër shkelësve në procedimet gjyqësore.<sup>523</sup> Në këtë kuptim, strehëzat për viktimat e trafikimit luajnë një rol themelor.<sup>524</sup>

### *Komente përmbyllëse*

Ndërkohë që ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe aktet nënligjore përfaqësojnë padyshim një hap të rëndësishëm përpara, përsëri mbetet shumë për të bërë për të siguruar sigurinë e dëshmitarëve të tjerë dhe për të rritur besueshmërinë e dëshmimeve të dëshmitarëve në Shqipëri. Masat e posaçme të parashikuara në ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve kanë një kosto të shtrenjtë dhe fusha e veprimit të ligjit është e kufizuar. Për të bërë një krahasim, sipas një raporti mbi mbrojtjen e dëshmitarëve të përgatitur nga

<sup>522</sup> Ligji nr. 8492, gusht 1999, “Për të huajt”; *shih gjithashtu* Paktin e Stabilitetit për Evropën Juglindore, Grupi i Punës për Trafikimin e Qenieve Njerëzore; Deklaratë e Angazhimeve – Legalizimi i Statusit të Personave të Trafikuar, Tiranë, 11 dhjetor 2002.

<sup>523</sup> Rekomandimi R(2000)11 i Këshillit të Evropës për Veprim Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore për Qëllim Shfrytëzimi Seksual (19/5/2000), Deklaratë Ministeriale e Hagës për Udhëzimet Evropiane për Masa Efektive në Parandalimin dhe Luftën kundër Trafikimit të Grave për Qëllim Shfrytëzimi Seksual (26/4/1997).

<sup>524</sup> Shih vendimin nr. 1 të Këshillit Ministerial të OSBE-së, Rritja e Përpjekjeve të OSBE-së për të Luftuar Trafikimin e Qenieve Njerëzore (28/11/2000).

<sup>525</sup> Raport për mbrojtjen e dëshmitarëve (Studim i praktikave më të mira) – Për të parandaluar viktimizimin e dëshmitarëve; PC-CO (1999) 8 REV, miratuar nga Komisioni PC-CO në mbledhjen e tretë plenare të tij (Strasburg, 15-17 shkurt 1999).

<sup>526</sup> KPrC, nenet 105, 105/a, 105/b dhe 106.

Këshilli i Evropës në vitin 1999, i cili mbulonte tri shtete anëtare, numri i dëshmitarëve të pranuar në programet e tyre përkatëse mbrojtës varionte nga dy deri në shtatë për një milion banorë në vit, kurse numri mesatar i të afërmeve që shoqëronin një dëshmitar ishte dy deri në tre.<sup>525</sup>

Një problem i veçantë për shumë dëshmitarë dhe që nuk është diskutuar më lart në këtë analizë, është vështirësia për të siguruar transportin dhe kostot e lidhura me udhëtimin për në gjykatë. Një mënyrë e dukshme për të përmirësuar këtë situatë, do të ishte mbulimi i shpenzimeve të udhëtimit për dëshmitarët që vijnë të dëshmojnë. Kjo do të ishte gjithashtu edhe një mënyrë efektive për të ndikuar gatishmërinë e dëshmitarëve për t'u paraqitur në gjyq. Për momentin, kjo gjë është parashikuar vetëm për dëshmitarët në procedimet civile, ku pala e cila kërkon të dëgjojë një dëshmitar, është e detyruar të paguajë shpenzimet e dëshmitarit.<sup>526</sup> Ndërsa në çështjet penale, në rastin më të mirë, dëshmitarët i sjell policia në gjykatë.

## *Paraburgimi; Shtojca 1*

### **Pyetësor për autoritetin e qendrës së paraburgimit dhe përshkrimin e qendrës së paraburgimit**

1. Qendra e paraburgimit:
2. Qendra është për meshkuj, femra apo të mitur?
3. Emri i Drejtorit:
4. Data/t e vizitës/vizitave:
5. Emri i intervistuesit:
6. Sa është kapaciteti maksimal i qendrës së paraburgimit? Sa të paraburgosur ka aktualisht?
7. Sa dhoma paraburgimi ka? Sa është madhësia e këtyre dhomave? Sa të paraburgosur ka në një dhomë paraburgimi?
8. Nëse kjo qendër është kryesisht për të paraburgosur meshkuj, a ka edhe të paraburgosura femra dhe të paraburgosur të mitur? Nëse po, sa femra/të mitur ka?
9. Nëse ka të mitur, a janë të ndarë nga të rriturit? Nëse jo, si mbahen/me kë i ndajnë dhomat e paraburgimit?
10. Nëse ka të paraburgosura femra, a janë të ndara nga meshkujt?
11. A ka të burgosur të dënuar? Nëse po, sa janë dhe kur janë dënuar?
12. A kanë mundësi të paraburgosurit të dalin jashtë për të bërë ushtrime; ku bëhet kjo gjë dhe sa shpesh?
13. A ka qendra mjekësore të përshtatshme për të paraburgosurit?
14. Cilat janë kushtet sanitare dhe sa shpesh u lejohet personave në këtë qendër të bëjnë dush?
15. Cilat janë kushtet për vizita nga familjarët (kur, sa shpesh, për sa kohë, ku)?
16. Cilat janë kushtet për vizitat e avokatëve mbrojtës (p.sh. vetëm gjatë ditëve të javës në një orar të caktuar, sa shpesh, për sa kohë, ku, a u duhet autorizim nga prokurori)?
17. Pasi të keni bërë një vizitë nëpër ambientet e qendrës së paraburgimit, ju lutem përshkruani gjendjen e ambienteve sanitare, kushtet higjienike të ambienteve, dhomën e ajrimit, dhomat e takimeve, etj.
18. Komentë të tjera

## Paraburgimi; Shtojca 2

### Pyetësor për të paraburgosurit

**Shënim:** Pyetësi përbëhet nga 62 pyetje për të paraburgosurit, disa nga të cilat nuk janë të përdorshme ose të përshtatshme për rastin konkret. Sidoqoftë, nëse një pyetje nuk është e përdorshme ose e përshtatshme, shënojeni me **J/P** (*jo e përdorshme ose e përshtatshme*) në vend që ta lini vendin bosh. Për ta bërë më të lehtë kryerjen e intervistës dhe të mos i drejtoni 62 pyetje të paraburgosurit, përpara se të kryeni intervistat, ju lutemi njihuni me pyetësin dhe me “Udhëzimin për mënyrat e kryerjes së vizitave në paraburgim”. Mundohuni që veçanërisht të miturve t’ua drejtoni pyetjet në një gjuhë të thjeshtë dhe të qartë.

### E rëndësishme!

Përpara se të filloni intervistën, bëjini të ditur personit që do të intervistoni se pjesëmarrja në intervistë është krejtësisht vullnetare dhe së çfarëdolloj informacioni që do të jepet do të mbetet konfidencial. Më pas, pyeteni nëse dëshiron të intervistohet apo jo. Shpjegojini pjesëmarrësit gjithashtu qëllimin e programit për Zhvillimin e një Gjykimi të Drejtë, që ju nuk mund të ndërhyri në çështjen e atij individi dhe se nuk jeni në pozicion për të diskutuar nëse ai person është fajtor apo jo.

### Informacion i përgjithshëm

1. Data e intervistës
2. Emri i asistentit/intervistuesit nga zyra rajonale
3. Emri i të akuzuarit (jo i detyrueshëm):
4. Gjinia:
5. Datëlindja: I mitur:
6. Minoriteti (p.sh. grek, arumun etj):
7. Vendbanimi:
8. Institucioni i paraburgimit:
9. Avokati mbrojtës (emri):

### Të dhëna për çështjen

10. Klasifikimi i veçantë i çështjes; për t’u përcaktuar nga intervistuesi (p.sh. dhunë në familje, vepra penale për motive morale, korrupsion, shpërdorim detyre, krim i motivuar politikisht, gjakmarrje, çështje zgjedhore, i sëmurë mendor apo i akuzuar i mitur):
11. I akuzuar me shkelje penale/nën hetim (vepra penale dhe nenet përkatës):
12. A ka qenë i dënuar më parë i pandehuri (nëse po, për çfarë dhe çfarë dënimi iu dha)?

### Arrestimi

13. Data e arrestimit:
14. Përshkruani arrestimin (si ndodhi)?

III. Përshkruani ndonjë keqtrajtim gjatë arrestimit ose gjatë marrjes në pyetje nga policia?

15. A iu dha të paraburgosurit një kopje e vendimit?

16. Nëse nuk iu dha një kopje, a iu dhanë arsyet për arrestimin (d.m.th., informacion në lidhje me akuzën)? Kush e dha informacionin; policia gjyqësore apo prokurori, apo të dy bashkë?

17. A u njoftua i paraburgosuri se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë, për të komunikuar me avokatin mbrojtës dhe për njoftimin e të afërmeve lidhur me arrestimin e tij. Kush e dha këtë informacion; policia gjyqësore apo prokurori?

18. A u krijuan lehtësira për të paraburgosurin që ai të komunikonte me avokatin mbrojtës dhe të njoftonte të afërmit për arrestimin apo a u njoftua se autoritetet kishin kontaktuar avokatin dhe/apo këta persona?

19. A është transferuar i pandehuri nga një institucion paraburgimi në një tjetër (nëse po, a është njoftuar avokati i tij, familja apo shokët?):

20. Nëse vendi i paraburgimit nuk është i njëjtë me vendbanimin, cila është arsyeja (p.sh. krimi është kryer në një rreth tjetër, për arsye sigurie, etj.)

### **Kontrolli personal dhe kontrolli mjekësor**

21. A u kontrollua i paraburgosuri? Nëse po, jep një përshkrim.

22. A u mor ndonjë provë fizike nga i paraburgosuri (kampionë gjaku, lëngje trupore)?

23. A iu morën shenjat e gishtërinjve të paraburgosurit, a u fotografua apo u mbajt ndonjë evidencë tjetër identifikimi?

24. A iu bë kontrolli mjekësor nga një mjek ekzaminues? Nëse po, kur dhe nga kush, dhe cilat ishin rezultatet e kontrollit? Nëse i paraburgosuri ishte femër, a pati probleme me faktin se sa intim u krye kontrolli?

### **Pyetjet fillestare dhe informacioni dhënë të paraburgosurit**

25. A u mor i pandehuri në pyetje nga autoritetet? (nëse po, sa herë dhe nga kush)?  
Nëse jo, vazhdo me pyetjen 51.

26. Nëse është marrë në pyetje, a u informua i pandehuri për të drejtën e këshillimit me avokat përpara pyetjeve?

27. Nëse është marrë në pyetje, a u informua i pandehuri për të drejtën për të mos bërë ndonjë deklaratë përpara seancës së pyetjeve?

28. Nëse është marrë në pyetje, a ishte avokati mbrojtës i pranishëm gjatë pyetjeve?

29. Nëse është marrë në pyetje dhe avokati mbrojtës nuk ishte i pranishëm; a e kërkoi i pandehuri praninë e avokatit gjatë pyetjeve?

30. Nëse është zbatueshme, a u informua i pandehuri për të drejtën e tij për të pasur një përkthyes (nëse po, a u mundësua një përkthyes i përshtatshëm)?

31. Nëse është marrë në pyetje dhe nëse i pandehuri është i mitur, a ishte i pranishëm njëri nga prindërit apo një i rritur tjetër i përshtatshëm?

32. Nëse është marrë në pyetje, përshkruaj rrethanat e marrjes në pyetje (për

shembull, ashpërsinë, sa zgjati koha e pyetjeve, sa pushime u bënë gjatë seancës së pyetjeve etj...):

### **Marrja e avokatit mbrojtës**

33. Kur u caktua avokati mbrojtës për të pandehurin? Kush e caktoi avokatin mbrojtës; i pandehuri, familja e tij, prokurori/gjykata?
34. Kur u takua i pandehuri për herë të parë me avokatin e tij mbrojtës? Sa zgjati takimi dhe a u zhvillua ky takim pa praninë e të tjerëve?

### **Seanca për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë**

35. Kur u dërgua i pandehuri përpara autoritetit gjykues (E rëndësishme! Sa orë/ditë pas arrestimit)? Nëse i paraburgosuri nuk ka parë një gjyqtar, ju lutemi shënojeni.) 54. A u përfaqësua i pandehuri në seancën për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë (nga një avokat privat apo i caktuar nga gjykata)?
36. A pati mundësi i pandehuri të konsultohet me avokatin e tij mbrojtës përpara seancës? Sa zgjati konsultimi? A u zhvillua pa praninë e të tjerëve; nëse jo; kush ishte i pranishëm?
37. Ku u zhvillua seanca (në sallën e gjyqit, në zyrën e gjyqtarit, në ndonjë vend tjetër)?
38. Sa zgjati seanca?
39. A paraqiti i pandehuri apo avokati i tij mbrojtës fakte për të hedhur poshtë urdhrin për arrest në burg (nëse po, a i dëgjoji trupi gjykues provat)?
40. Cilat ishin arsyet për masën e sigurisë të arrestit në burg (rrezik arratisjeje, rrezik për shkatërrimin e fakteve, rreziku për kryerjen e një krimi tjetër)?
41. A u informua i pandehuri për të drejtën e apelimit e vendimit për arrest në burg (nëse po, a është depozituar ndonjë ankesë)?
42. A ka pasur seanca të tjera shtesë në gjykatë gjatë të cilave i pandehuri ka qenë i pranishëm (p.sh. seanca apelimi apo të tjera)?

### **Informacion i mëtëjshëm në lidhje me avokatin mbrojtës**

43. A ka mundësi i pandehuri të komunikojë me avokatin e tij me anë të shërbimit postar, telefon apo nëpërmjet familjarëve ose autoriteteve të burgut (jepni arsyet për ndalimin e komunikimit)?
44. Sa shpesh (gjatë javës, muajit) dhe sa herë e takon i pandehuri avokatin e tij?
45. A lejohet në përgjithësi i pandehuri të komunikojë vetëm për vetëm me avokatin e tij (tregoni kufizimet që mund të jenë vendosur në komunikimin vetëm për vetëm si dhe personat e tjerë të pranishëm gjatë komunikimit) Ku zhvillohet komunikimi?
46. A ka kufizime në takimet me avokatin mbrojtës (p.sh. moslejimi i vizitave gjatë fundjavës apo kufizim i kohës së komunikimit)?
47. Shënoni forma të tjera të komunikimit me avokatin (me shkrim apo me telefon):
48. A përfaqëson avokati mbrojtës edhe të bashkëpandehur (shënoni rastet e konfliktit të interesit)?
49. Shënoni vlerësimin e të pandehurit për avokatin e tij mbrojtës (probleme që

lidhen me konflikte interesash, përfaqësimin e duhur të rastit të të pandehurit, etj...):

50. Cila është tarifa e shpërblimit për avokatin (shënoni ato raste kur avokati i caktuar nga gjykata kërkon pagesë shtesë)?

### Hetimi

51. Përveç seancës për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë, sa herë është marrë në pyetje i pandehuri nga policia apo prokurori?

52. A ka qenë avokati mbrojtës i pranishëm në secilën seancë? Nëse jo, kur dhe pse nuk ishte avokati i pranishëm?

53. A ka marrë pjesë i pandehuri në ndonjë veprimtari hetimore (p.sh. identifikime, ekzaminimin e vendit të ngjarjes apo objekteve etj.)?

54. A ishte i pranishëm avokati mbrojtës?

55. Shënoni ndonjë periudhë të gjatë mosveprimi nga ana e autoriteteve apo avokatit mbrojtës dhe arsyet (ka pasur javë ose muaj pa asnjë ngjarje)?

### Të kuptuarit e procedurave nga ana e të pandehurit

56. Gjuha e procedimit (nëse nuk është gjuha shqipe):

57. Nëse është e zbatueshme, a është siguruar një përkthyes për të pandehurin (nëse është kërkuar) dhe a ka qenë i kënaqur i pandehuri me përkthimin e procedimit dhe të dokumenteve (për shembull, a i është dhënë të pandehurit deklarimi e tij/saj në gjuhën që kupton):

### Kushtet e paraburgimit dhe trajtimi

58. Sa shpesh vizitohen të paraburgosurit nga familjarët apo të tjerë (p.sh. nga një kujdestar apo punonjës social nëse i paraburgosuri është i mitur)? Sa zgjasin vizitat dhe ku kryhen (shënoni kufizimet që mund të jenë vënë për vizitat e familjarëve)?

59. A është ushtruar ndaj të paraburgosurit dhunë, kërcënime apo forma të tjera keqtrajtimi nga policia apo personeli në paraburgim (përshekruaj)?

60. Të paraburgosurit e mitur dhe të rritur mbahen veç a veç apo bashkë? Nëse mbahen bashkë si janë marrëdhëniet ndërmjet tyre?

61. A kanë mundësi të paraburgosurit të dalin jashtë për të bërë ushtrime; ku bëhet kjo gjë dhe sa shpesh?

62. A ka qendra mjekësore të përshtatshme për të paraburgosurit? (nënvizo ndonjë problem lidhur sidomos me sëmundjet mendore etj....)

63. Çfarë mendimi kanë të paraburgosurit për institucionet e paraburgimit (ushqimi, kushtet fizike etj.)?

### Komentet përmbyllëse

64. Duke pasur parasysh sa më sipër, tregoni ndonjë problem, shkelje të ligjit apo konventave ndërkombëtare, si për shembull Konventa Evropiane të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (informacioni dhënë të pandehurit, anëtarët e familjes, mundësia për avokat mbrojtës, periudhat kohore etj.):

## Paraburgimi; Shtojca 3

Tabela vijuese përmban informacion mbledhur nga 10 vendime gjykate që kanë lidhje me paraburgimin. Megjithatë, është për t'u theksuar se fakti që diçka është përmendur nuk do të thotë se është diskutuar në mënyrë të kënaqshme.

Nr.	Çështja <sup>527</sup>	Arrestimi <sup>528</sup>	Fakte <sup>529</sup>	1. Arsyeya. A është diskutuar kriteri i dyshimit?	2. A janë përshkruar kriteret e veçanta? <sup>530</sup>	3. A është diskutuar kriteri i proporcionalitetit?	4. A është diskutuar kriteri i domos-doshmërisë?	Arsye të tjera	
								Komente	
1.	Durrës Nr. 82, 3/2-03 114/b <sup>531</sup>	Në flagrancë	Po	Po	Jo	Jo	Rrezikshmëria e krimit	Prokurori ka nevojë për më tepër prova	Lidhet me nr. 2
								Ka nevojë për më tepër hetime	Lidhet me nr. 1
2.	Durrës Nr. 86, 4/2-03 114/b/2 dhe 25 <sup>532</sup>	Në flagrancë *	Po	Po	Jo	Vepër penale e rëndë	Jo		
3.	Durrës Nr. 112, 20/2-03 114/a/5, 84 <sup>533</sup>	Në flagrancë *	Po	Po	- Arratisje - Vepër penale	Vepra penale ka dënime të rënda	Jo		Vepra penale dhe arrestimi jo në të njëjtën ditë
4.	Durrës Nr. 137, 3/3-03	Urdhër gjykate	Jo	Po	Jo	Jo	Rrezikshmëri sociale e të pandehurve		

<sup>527</sup> Të gjithë vendimet janë nga gjykata të shkallës së parë; nr. 9 është nga GjKJ. Çështjet do të përshkruhen si më poshtë: Emri i gjykatës, numri i vendimit dhe data e vendimit.

<sup>528</sup> A ishte kryer arrestimi pas një vendimi gjykate, me urdhër të prokurorit apo është kryer me iniciativë të policisë, pra, në flagrancë?

<sup>529</sup> A janë përshkruar faktet, pra krimi, që kanë sjellë arrestimin?

<sup>530</sup> Që do të thotë, rrezikshmëri e marrjes ose vërtetësisë së provës, rreziku që i pandehuri të largohet ose të kryejë krime të tjera, KPrP neni. 228 pika 3.

<sup>531</sup> Trafikimi i femrave (114/b).

<sup>532</sup> Trafikimi i femrave në bashkëpunim me të tjerët.

<sup>533</sup> Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese (114/a) dhe Kanosja (84).



Nr.	Çështja <sup>534</sup>	Arrestimi	Fakte	1. Arsyeja. A është diskutuar kriteri i dyshimit?	2. A janë përshkruar kritere të veçanta? <sup>535</sup>	3. A është diskutuar kriteri i proporcionalitetit?	4. A është diskutuar kriteri i domos-doshmërisë?	Arsye të tjera
	114/a							Dy të dyshuar
5.	Durrës Nr. 221, 3/4-03 278/3 dhe 283 <sup>536</sup>	Në flagrancë	Po	Po	- Prova - Arratisje	Sanksione	Rrezikshmëria e aktit	
6.	Durrës Nr 226, 6/4-03 333, 34, 110/a/2, 128/b/2 dhe 189/1 <sup>537</sup>	Urdhër ndërkombëtar	Po	Po	Jo	Jo	Rrezikshmëri sociale e aktit	Nevojë për hetim gjatë arrestit në burg të të pandehurve Pesë të pandehur
7.	Gjiro-kastrër Nr. 2, 4/1-04 260 <sup>538</sup>	Në flagrancë	Jo	Jo	Jo	Jo		Arrestimi konsiderohet i paligjshëm Të dy të dyshuarit u liruan

<sup>534</sup> Të gjithë vendimet janë nga gjykata të shkallës së parë; nr. 9 është nga GjKR. Çështjet do të përshkruhen si më poshtë: Emri i gjykatës, numri i vendimit dhe data e vendimit.

<sup>535</sup> Që do të thotë, rrezikshmëri e marrjes ose vërtetësisë së provës, rreziku që i pandehuri të largohet ose të kryejë krime të tjera, KPrP neni. 228 pika 3.

<sup>536</sup> Mbatja pa leje e armëve (278/3) dhe prodhimi dhe shitja e narkotikëve (283).

<sup>537</sup> Krijimi i organizatave kriminale (333), kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal (334), trafikimi i personave (110), trafikimi i personave në bashkëpunim (110/a), trafikimi i të miturve (128/b), trafikimi i të miturve në bashkëpunim (128/b) dhe falsifikimi i letënjohjeve, i pasaportave ose i vizave (189 paragrafi 1).

<sup>538</sup> Mitmarrja (260).

Nr.	Çështja <sup>539</sup>	Arrestimi	Fakte	1. Arsyeja. A është diskutuar kriteri i dyshimit?	2. A janë përshkruar kriteret të veçanta? <sup>540</sup>	3. A është diskutuar kriteri i proporcion-nalitetit?	4. A është diskutuar kriteri i domos-doshmërisë?	Arsye të tjera
8.	Durrës Nr 309, 24/6-05	Në flagrancë	Po	Po	Arratisje	Ndëshkim i rëndë	Jo	Situatë e tensionuar midis familjeve dhe sa i përhapur është krimi
	88 <sup>541</sup>					Rëndësia e faktit		I dyshuari vuante nga epilepsia dhe vdiq në paraburgim
9.	GjKR Nr 114, 9/9-05	Urdhër gjykatë	Po	Po	Jo	Jo	Jo	
	333/a, 172, 28/4 <sup>542</sup>							Arrestimi i Leonard Kokës
10.	Gjiro-kastër Nr 40, 5/6-05	Në flagrancë	Po	Jo	Jo	Jo	Jo	
	283/1 <sup>543</sup>							Dy të pandehur, një i rritur dhe një i mitur

\*Nga vendimet 2 dhe 3 është e paqartë nëse arrestimi ishte kryer në flagrancë, por nga konteksti duket se arrestimet janë “konsideruar” si të tillë

<sup>539</sup> Të gjithë vendimet janë nga gjykata të shkallës së parë; nr. 9 është nga GjKR. Çështjet do të përshkruhen si më poshtë: Emri i gjykatës, numri i vendimit dhe data e vendimit.

<sup>540</sup> Që do të thotë, rrezikshmëri e marrjes ose vërtetësisë së provës, rreziku që i pandehuri të largohet ose të kryejë krime të tjera, KPrP neni. 228 pika 3. <sup>541</sup> Plagosja e rëndë me dashje (88).

<sup>542</sup> Grupi i strukturuar kriminal (333/a), kontrabanda me mallra që paguhet akcizë (172), dhe banda të armatosura dhe organizata kriminale (28).

<sup>543</sup> Prodhimi dhe shitja e narkotikëve.

## Paraburgimi; Shtojca 4

### Informacion nga sondazhi i paraburgimit

- Informacioni i mëposhtëm paraqet pikëpamjet dhe perceptimet e të intervistuarve dhe jo të OSBE-së.
- Përqindjet kanë të bëjnë vetëm me numrin e përgjithshëm të paraburgosurve të intervistuar dhe jo me popullsinë e burgjeve në tërësi.
- Nëse një pyetje mund të përgjigjej me PO ose JO, të dyja përgjigjet janë paraqitur. Nëse përqindjet e përgjigjeve PO dhe JO nuk japin 100%, kjo ndodh sepse i intervistuari *nuk e dinte, nuk ishte i sigurt ose sepse pyetja nuk ishte e zbatueshme.*

<i>Informacion i përgjithshëm</i>
<ul style="list-style-type: none"><li>▪ <b>U intervistuan 71 të paraburgosur</b></li><li>▪ 21% (15 të paraburgosur) ishin të mitur</li><li>▪ 3% (2 të paraburgosur) ishin gra</li><li>▪ 4% (3 të paraburgosur) ishin të huaj; 1 italian dhe 2 kosovarë</li></ul>
<i>Të dhëna penale</i>
<ul style="list-style-type: none"><li>▪ 72% (51 të paraburgosur) <u>nuk</u> kanë qenë dënuar më parë</li><li>▪ 28% (20 të paraburgosur) kanë qenë dënuar më parë</li></ul>
<i>Momenti i arrestimit</i>
<ul style="list-style-type: none"><li>▪ <b>49% (35 të paraburgosur) u shprehën se janë keqtrajtuar nga policia në momentin e arrestimit ose kur janë marrë në pyetje</b><ul style="list-style-type: none"><li>o <b>Nga ata të cilët u shprehën se janë keqtrajtuar, 7 ishin të mitur</b></li></ul></li><li>▪ 51% (36 të paraburgosur) u shprehën se <u>nuk</u> ishin keqtrajtuar në momentin e arrestimit apo gjatë marrjes fillestare në pyetje</li><li>▪ 37% (26 të paraburgosur) u shprehën se u ishte dhënë një kopje e vendimit për masën e sigurisë<ul style="list-style-type: none"><li>➤ Nuk është e qartë nëse kjo ndodhi në momentin e arrestimit apo kur ata i sollën në komisariatet e policisë</li></ul></li><li>▪ 61% (43 të paraburgosur) u shprehën se <u>nuk</u> u ishte dhënë një kopje e vendimit</li><li>▪ 32% (23 të paraburgosur) u shprehën se ishin njoftuar për arsyen e arrestimit</li><li>▪ <b>27% (19 të paraburgosur) u shprehën se <u>as</u> nuk u ishte dhënë një kopje e vendimit dhe <u>as</u> nuk ishin njoftuar për arsyen e arrestimit</b></li><li>▪ 70% (50 të paraburgosur) u shprehën se ishin vënë në dijeni për të drejtën e tyre për të mos bërë asnjë deklaratë</li><li>▪ 28% (20 të paraburgosur) u shprehën se <u>nuk</u> ishin vënë në dijeni për të drejtën e tyre për të mos bërë asnjë deklaratë</li></ul>

- 34% (24 të paraburgosur) u shprehën se ishin vënë në dijeni për të drejtën e tyre për të pasur avokat
- 63% (45 të paraburgosur) u shprehën se nuk ishin vënë në dijeni për të drejtën e tyre për të pasur avokat
- 28% (20 të paraburgosur) u shprehën se ishin vënë në dijeni për të drejtën për të njoftuar familjet e tyre
- 51% (36 të paraburgosur) u shprehën se nuk ishin vënë në dijeni për të drejtën për të njoftuar familjet e tyre
  - **Vetëm 24% (17 të paraburgosur) ishin vënë në dijeni për të gjitha të drejtat e tyre, d.m.th për të mos bërë deklarata, për të pasur avokat dhe për të njoftuar familjet e tyre**
- 21% (15 të paraburgosur) u shprehën se iu dha mundësia për të komunikuar me avokatin
- **68% (48 të paraburgosur)** u shprehën se nuk iu dha mundësia për të komunikuar me avokatin
- 25% (18 të paraburgosur) u shprehën se iu dha mundësia për të kontaktuar anëtarët e familjes
- **41% (29 të paraburgosur) u shprehën se nuk iu dha mundësia për të komunikuar me anëtarët e familjes**
  - 34% (24 të paraburgosur) ishin arrestuar në shtëpi ose ndryshe në prani të anëtarëve të familjes
  - 20% (14 të paraburgosur) u shprehën se iu dha mundësia për të komunikuar si avokatin, ashtu edhe familjen

#### *Transferimi i të paraburgosurit nga një qendër paraburgimi në tjetrën*

- 34% (24 të paraburgosur) u shprehën se ishin transferuar nga një qendër paraburgimi në tjetrën
  - **Në 50% të këtyre rasteve, familjarët e të paraburgosurit nuk ishin vënë në dijeni për transferimin**

#### *Kontrolli personal dhe kontrolli mjekësor*

- 89% (63 të paraburgosur) u shprehën se ishin kontrolluar pas arrestimit
- 10% (7 të paraburgosur) u shprehën se nuk ishin kontrolluar pas arrestimit
- 10% (7 të paraburgosur) u shprehën se iu morën prova fizike (kampionë të gjakut, lëngje trupore, flokë, etj.)
- 90% (64 të paraburgosur) u shprehën se nuk iu morën asnjë provë fizike
- 92% (65 të paraburgosur) u shprehën se iu morën shenjat e gishtave
- 90% (64 të paraburgosur) u shprehën se u fotografuan
- 13% (9 të paraburgosur) u shprehën se u vizituan nga një mjek ekzaminues
- 87% (62 të paraburgosur) u shprehën se nuk u vizituan nga një mjek ekzaminues

*Gra të paraburgosura - 2*

**Të dyja gratë e paraburgosura u shprehën se të gjitha gratë e paraburgosura duhet të bëjnë një test shtatzënie.<sup>544</sup> Gjithsesi, nga dy gratë e intervistuar, njëra nuk pranoi të bëjë testin dhe nuk u detyrua**

*Pyetjet fillestare dhe informacioni dhënë të paraburgosurit*

- 79% (56 të paraburgosur) u shprehën se u morën në pyetje nga policia
- 18% (13 të paraburgosur) u shprehën se nuk u morën në pyetje nga policia
- 35% (25 të paraburgosur) u shprehën se u njoftuan për të drejtën për të pasur avokat përpara se të merren në pyetje
- **49% (35 të paraburgosur) u shprehën se nuk u njoftuan për të drejtën për të pasur avokat përpara se të merren në pyetje**
- 21% (15 të paraburgosur) u shprehën se u njoftuan se kanë të drejtë të mos bëjnë ndonjë deklaratë përpara se të merren në pyetje
- **62% (44 të paraburgosur) u shprehën se nuk u njoftuan se kanë të drejtë të mos bëjnë ndonjë deklaratë përpara se të merren në pyetje**
- 14% (10 të paraburgosur) u shprehën se avokati mbrojtës ishte i pranishëm gjatë marrjes në pyetje
- **70% (50 të paraburgosur) u shprehën se avokati mbrojtës nuk ishte i pranishëm gjatë marrjes në pyetje**
- 25% (18 të paraburgosur) u shprehën se kërkuan praninë e avokatit gjatë marrjes në pyetje
- **48% (34 të paraburgosur) u shprehën se ata nuk ishin në dijeni për të drejtën për avokat**

*Të mitur - 14*

- 3 u shprehën se kishin një prind apo një të rritur tjetër të përshtatshëm gjatë marrjes në pyetje
- **11 u shprehën se nuk kishin një prind apo një të rritur tjetër të përshtatshëm gjatë marrjes në pyetje**

*Marrja e avokatit mbrojtës*

- 52% (37 të paraburgosur) u shprehën se u takuan me avokatin e tyre mbrojtës përpara seancës për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë
- 41% (29 të paraburgosur) u shprehën se e takuan për herë të parë avokatin e tyre në/gjatë seancës për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë
- 49% (35 të paraburgosur) u shprehën se takimi i parë me avokatin e tyre u bë vetëm për vetëm

<sup>544</sup> Sipas nenit 230, paragrafi 2, nuk mund të vendoset arresti në burg ndaj një gruaje që është shtatzënë. Megjithatë, kjo është një e drejtë që u jepet grave dhe nëse gruaje nuk pretendon se është shtatzënë, gratë në përgjithësi nuk duhet t'u kërkohet të bëjnë një test shtatzënie.

- **39% (28 të paraburgosur) u shprehën se takimi i parë me avokatin e tyre nuk u bë vetëm për vetëm**
- 46% (33 të paraburgosur) u shprehën se u përfaqësuan nga një avokat i caktuar privatisht
- 34% (24 të paraburgosur) u shprehën se u përfaqësuan nga një avokat i caktuar nga shteti.
- 73% (52 të paraburgosur) u shprehën se iu dha mundësia për të komunikuar me avokatin mbrojtës
- 17% (12 të paraburgosur) u shprehën se nuk iu dha mundësia për të komunikuar me avokatin mbrojtës
- 66% (47 të paraburgosur) u shprehën se në përgjithësi ishin në gjendje të komunikonin vetëm për vetëm me avokatin e tyre
- **18% (13 të paraburgosur) u shprehën se në përgjithësi nuk ishin në gjendje të komunikonin vetëm për vetëm me avokatin e tyre**
- 25% (18 të paraburgosur) u shprehën se iu vunë kufizime gjatë takimeve me avokatin e tyre mbrojtës\*
- 70% (50 të paraburgosur) u shprehën se nuk iu vunë kufizime gjatë takimeve me avokatin e tyre mbrojtës\*
  - Ata që u shprehën për kufizime thanë se takimet u zhvilluan gjatë ditëve të javës ndërmjet orës 9:00 dhe 15:00 dhe nuk mund të zgjasnin më tepër se 10-15 minuta. Duke marrë në konsideratë që të paraburgosurit nuk u pyetën nëse takimet mund të zhvilloheshin jashtë këtyre orëve, ka të ngjarë që ata që u shprehën se nuk pati kufizime, u shprehën kështu për të treguar se nuk kishte *kufizime të tjera*
- 18% (13 të paraburgosur) u shprehën se një ose më shumë të pandehur janë përfaqësuar nga i njëjti avokat mbrojtës
- 45% (32 të paraburgosur) u shprehën se avokati i tyre mbrojtës ishte i pranishëm në çdo seancë gjyqësore
- 32% (23 të paraburgosur) u shprehën se avokati i tyre mbrojtës nuk ishte i pranishëm në çdo seancë gjyqësore

#### *Seanca për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë*

- 93% (66 të paraburgosur) u shprehën se kishin parë një gjyqtar
- 13% (9 të paraburgosur) u shprehën se u dërguan përpara gjyqtarit brenda dy ditëve [48 orë] nga arrestimi
- 59% (42 të paraburgosur) u shprehën se u dërguan përpara gjyqtarit brenda tri ditëve [72 orë] nga arrestimi
- 17% (12 të paraburgosur) u shprehën se u dërguan përpara gjyqtarit më vonë se tri ditë [72 orë] nga arrestimi
- 4% (3 të paraburgosur) u shprehën se nuk kishin parë asnjëherë një gjyqtar
  - ❖ 2 ishin arrestuar pasi ishin gjykuar dhe dënuar në mungesë
  - ❖ 1 ishte arratisur nga burgu më 1997 nga vendi ku vuante dënimin dhe ishte kapur


- 7% (5 të paraburgosur) u shprehën se nuk ishte e zbatueshme për ta
  - 2 të paraburgosur nuk e mbanin mend se kur u dërguan përpara një gjyqtari
  - 3 janë gjykuar në gjendje të lirë dhe vuanin dënimin pas një vendimi gjykate të formës së prerë
  - **76 % (54 të paraburgosur) u shprehën se nuk u dërguan përpara një gjyqtari brenda afatit kohor prej 48 orësh siç parashikohet nga Kushtetuta**
- 80% (57 të paraburgosur) u shprehën se seanca për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë u zhvillua në sallën e gjyqit
- 11% (8 të paraburgosur) u shprehën se seanca për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë u zhvillua në zyrën e gjyqtarit
- 77% (55 të paraburgosur) u shprehën se u përfaqësuan nga avokati mbrojtës në seancën për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë
- 13% (9 të paraburgosur) u shprehën se nuk u përfaqësuan nga avokati mbrojtës në seancën për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë
- **39% (28 të paraburgosur) u shprehën se patën mundësi të komunikonin me avokatin mbrojtës përpara seancës për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë**
  - Prej tyre, 17 të paraburgosur u shprehën se patën mundësinë të komunikonin me avokatin mbrojtës vetëm për vete
  - 11 të paraburgosur u shprehën se ishin të detyruar të komunikonin me avokatin e tyre mbrojtës në prani të të tjerëve, pra në një sallë gjyqi
- 48% (34 të paraburgosur) u shprehën se avokati i tyre mbrojtës kishte kundërshtuar vendimin për arrest në burg
- 31% (22 të paraburgosur) u shprehën se avokati i tyre mbrojtës nuk e kishte kundërshtuar vendimin për arrest në burg
- **8% (6 të paraburgosur) u shprehën se arsyet për arrest në burg ishin përmendur kur ishte dhënë vendimi pas seancës për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë**
  - 4 të paraburgosur u shprehën se rreziku që ata të kryenin krime të mëtejshme ishte përmendur si arsye për arrestin në burg
  - 1 i paraburgosur u shpreh se rreziku i arratisjes ishte përmendur si arsyeja për arrest në burg
  - 1 i paraburgosur u shpreh se rreziku i shkatërrimit të fakteve ishte përmendur si arsye për arrest në burg
- 45% (32 të paraburgosur) u shprehën se ishin njoftuar për të drejtën e apelimit të vendimit për arrest në burg
- **32% (23 të paraburgosur) u shprehën se nuk ishin njoftuar për të drejtën e apelimit të vendimit për arrest në burg**
- 28% (20 të paraburgosur) u shprehën se kishin apeluar vendimin për arrest në burg

<i>Hetimi</i>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• 8% (6 të paraburgosur) u shprehën se kishin marrë pjesë në veprime hetimore (d.m.th. kontroll shtëpie, identifikime, dëgjimi i dëshmitarëve) <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Avokati mbrojtës ishte i pranishëm vetëm në 1 rast</li> </ul> </li> <li>• 77% (55 të paraburgosur) u shprehën se <u>nuk</u> kishin marrë pjesë në veprime hetimore</li> </ul>
<i>Të kuptuarit e procedurave nga ana e të pandehurit</i>
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Të paraburgosurit italian iu sigurua një përkthyes dhe ishte i kënaqur me përkthimin e procedurave dhe dokumenteve</li> <li>➤ Një qytetar çek i paraburgosur në Gjirokastër nuk fliste as shqip as anglisht, dhe nuk mund të intervistohet për shkak se nuk kishte njeri që mund të përkthente pavarësisht se intervistuesit mund të shkonin në çfarëdoj ore të përshtatshme mjafton që të kishte një përkthyes. Kjo do të thotë që ky person nuk mund të kuptonte procedurat</li> </ul>
<i>Kushtet e paraburgimit dhe trajtimi</i>
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ 27% (19 të paraburgosur) u shprehën se të paraburgosurit e mitur dhe të rritur mbahen bashkë</li> <li>▪ 35% (25 të paraburgosur) u shprehën se të paraburgosurit e mitur dhe të rritur <u>nuk</u> mbahen bashkë <ul style="list-style-type: none"> <li>➤Kategoria “jo e zbatueshme” (J/P) tregon se 27 të paraburgosur (38%) nuk ishin në dijeni për këtë gjë ose që asnjë i mitur nuk mbahej i paraburgosur në institucionin e tyre të paraburgimit</li> </ul> </li> <li>▪ 100% (të gjithë të paraburgosurit) u shprehën se e kishin mundësinë të dilnin jashtë çdo ditë</li> <li>▪ 31% (22 të paraburgosur) u shprehën se ka qendra të përshtatshme mjekësore për të paraburgosurit</li> <li>▪ 52% (37 të paraburgosur) u shprehën se <u>nuk</u> ka qendra të përshtatshme mjekësore për të paraburgosurit</li> <li>▪ 17% (12 të paraburgosur) u shprehën se nuk kanë pasur probleme shëndetësore dhe si rrjedhim nuk janë në dijeni nëse qendra mjekësore ishte e përshtatshme apo jo.</li> </ul>



*Paraburgimi; Shtojca 4*

**Koha ndërmjet arrestimit dhe momentit që i pandehuri pa një gjyqtar**



## Paraburgimi; Shtojca 5

Tabelat e mëposhtme përmbajnë informacion mbledhur nga një numër dosjesh të prokurorisë.

Numri i përgjithshëm i dosjeve të konsultuara: 59

Numri i çështjeve ku i pandehuri është i paraburgosur: 36

Numri i çështjeve ku i pandehuri nuk është i paraburgosur: 23


Periudhat pasive	Të paraburgosur	Jo të paraburgosur	Numri i përgjithshëm i çështjeve
Pa periudhë pasive <sup>545</sup>	5	3	8
2 – 4 javë	2	4	6
1 – 2 muaj	5	6	11
2 – 3 muaj	6	4	10
3 – 4 muaj	6	0	6
4 – 5 muaj	3	3	6
5 – 6 muaj	2	0	2
6 – 7 muaj	4	0	4
7 – 8 muaj	1	0	1
8 – 9 muaj	0	0	0
9 – 10 muaj	0	0	0
10 – 11 muaj	0	1	1
11 muaj – 1 vit	0	1	1
Më shumë se 1 vit	2	1	3

Periudha mesatare pasive ku i pandehuri ishte i <b>paraburgosur</b>	3,5 muaj
Periudha mesatare pasive në çështjet ku i pandehuri <u>nuk</u> ishte i <b>paraburgosur</b>	2,5 muaj
Nr. i përgjithshëm i veprimeve <sup>546</sup> të ndërmarra; <b>të gjitha dosjet</b>	12
Nr. i përgjithshëm i veprimeve në çështjet ku i pandehuri ishte i <b>paraburgosur</b>	11
Nr. i përgjithshëm i veprimeve në çështjet ku i pandehuri nuk ishte i <b>paraburgosur</b>	13
Nr. i përgjithshëm i veprimeve të ndërmarra; Dosjet e Prokurorisë së Tiranës	25
Nr. i përgjithshëm i veprimeve të ndërmarra; të gjitha, përveç dosjeve të Prokurorisë së Tiranës	9

<sup>545</sup> Kategoria *Pa periudhë pasive* tregon rastet ku nuk ka pasur periudha pasive apo ku këto të fundit, nuk kanë zgjatur më tepër se dy javë.

<sup>546</sup> Veprimet: çdo veprim hetimi, i tillë si arrestimi i të pandehurit, marrja në pyetje e dëshmitarëve, kontrollet e shtëpisë, sekuestrimi i provave, kërkesat për ekspertizë ose për informacion nga autoritete

## Paraburgimi; Shtojca 5



## *E drejta për një mbrojtje efektive; Shtojca 1*

### **Pyetësor për avokatët mbrojtës**

#### **I. Informacion i Përgjithshëm**

1. Emri (**jo i detyrueshëm!**):
2. Sa vite keni që ushtroni profesionin:
3. Rrethi ku ushtroni profesionin:
4. Merrni çështje të caktuara nga gjykata apo merrni vetëm çështje private?
  
5. Kush e cakton avokatin normalisht (i pandehuri apo familja)?
6. Sa është tarifa juaj për orë ose për çështje?
  
7. A varet tarifa e shpërblimit nga rezultati i çështjes?
8. Në cilën fazë caktoheni normalisht (menjëherë pas arrestimit apo më vonë)?
9. A ndodh që ju të përfaqësoni më shumë se një të pandehur në një çështje?
10. Si siguroheni që nuk ka konflikt interesash?
11. Kur ndodh normalisht kontakti i parë me klientin e paraburgosur dhe në çfarë mënyre (telefon, takim personal)?
12. Jeni gjithmonë i pranishëm në fazën e pyetjeve me të paraburgosurin?
13. Konsultoheni me klientin tuaj përpara seancës për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurisë?
14. Në çfarë vendi konsultoheni (në qendrën e paraburgimit apo në gjykatë)?
15. Çfarë ju duhet të bëni për të komunikuar me klientin tuaj që ndodhet i paraburgosur në komisaritet e policisë apo në një qendër paraburgimi (p.sh. leje nga prokurori apo gjykata)?
16. A ka ndodhur që nuk ju kanë lejuar? Në qoftë se po, për cilat arsye?
  
17. A mund të bëni biseda vetëm për vetëm me klientin tuaj (përcaktoni personat e pranishëm gjatë komunikimit dhe tregoni nëse kjo ka qenë kërkuar me një urdhër të gjykatës apo nëse avokati organizonte takime në grup më të pandehur të tjerë)?
18. A ka kufizime të tjera për sa i përket takimeve me klientët (kufizime kohore)?
19. Sa zgjasin normalisht këto takime?
20. A informoheni më parë rreth veprimeve hetimore?
21. Merrni pjesë në veprime të tjera hetimore, si p.sh. dëgjimi i dëshmitarëve, hetime në vendin e ngjarjes, identifikime, etj.?
22. Sa herë takoheni me klientët tuaj përpara seancës kryesore?
  
23. A keni kohë të mjaftueshme për t'u njohur me dosjen përpara seancës kryesore?
24. Probleme apo komente të tjera?

## E drejta për një mbrojtje efektive; Shtojca 2

### Rezultatet e pyetësorit të avokatëve mbrojtës

- Në anketim morën pjesë 69 avokatë të cilët plotësuan pyetësorin.
- Informacioni paraqet pikëpamjet dhe perceptimet e atyre që morën pjesë në anketim dhe jo ato të OSBE-së.
- Përqindjet janë të lidhura vetëm me numrin total të avokatëve mbrojtës të cilët morën pjesë në anketim.
- Në rastet kur për një pyetje ka një ose më shumë mundësi përgjigjesh (p.sh. pyetja 4: A merrni përsipër çështje të caktuara nga gjykata apo vetëm çështje private), pyetje ndahet në disa pyetje, p.sh. 4a dhe 4b.
- Opsioni P/J tregon që personi është përgjigjur në një mënyrë që mund të interpretohet si PO dhe si JO njëherësh, apo ndonjëherë si PO dhe ndonjëherë si JO.
- J/P do të thotë jo e përdorshme ose jo e përshtatshme.
- Përgjigjet e pyetjeve 10, 16b, 18 dhe 22 ishin shumë të ndryshme dhe për këtë janë paraqitur veçmas në Shtojcën 3.
- Për pyetjet 11, 15 dhe 19 përgjigjet ishin kaq të ndryshme sa që nuk ia vlen të paraqiteshin këtu.

Nr.	Pyetja	Po	Jo	P/J	J/P	Po	Jo	P/J	J/P
4a	Merrni përsipër çështje të caktuara nga gjykata?	3	40	26	0	4%	58%	38%	0%
4b	Merrni përsipër çështje private?	40	3	26	0	58%	4%	38%	0%
5a	Kush e cakton normalisht avokatin: i pandehuri?	12	23	33	1	17%	33%	48%	1%
5b	Kush e cakton normalisht avokatin: familja?	23	12	33	1	33%	17%	48%	1%
6a	Tarifa caktohet sipas kohës së shpenzuar?	0	59	10	0	0%	86%	14%	0%
6b	Tarifa caktohet sipas çështjes?	59	0	10	0	86%	0%	14%	0%
7	A varet tarifa nga rezultati i çështjes?	30	35	4	0	43%	51%	6%	0%
8a	A caktoheni normalisht menjëherë pas arrestimit/ ndalimit?	33	25	10	1	48%	36%	14%	1%
9	A ndodh që të përfaqësoni më tepër se një të pandehur në një çështje?	43	25	1	0	62%	36%	1%	0%

Nr.	Pyetja	Po	Jo	P/J	J/P	Po	Jo	P/J	J/P
12a	A jeni <i>gjithmonë</i> i pranishëm në marrjen në pyetje të të paraburgosurit?	28	41	0	0	41%	59%	0%	0%
12b	A jeni <i>në shumicën e rasteve</i> i pranishëm në marrjen në pyetje të të paraburgosurit?	33	36	0	0	48%	52%	0%	0%
12c	A jeni <i>disa herë</i> i pranishëm në marrjen në pyetje të të paraburgosurit?	4	65	0	0	6%	94%	0%	0%
12d	A jeni <i>rrallë</i> i pranishëm në marrjen në pyetje të të paraburgosurit?	3	66	0	0	4%	96%	0%	0%
12e	Nuk jeni <i>asnjëherë</i> i pranishëm në marrjen në pyetje të të paraburgosurit?	1	68	0	0	1%	99%	0%	0%
13a	A komunikoni <i>gjithmonë</i> me klientin tuaj, përpara seancës së verifikimit/vleftësimit?	45	24	0	0	65%	35%	0%	0%
13b	A komunikoni <i>shumicën e rasteve</i> me klientin tuaj, përpara seancës së verifikimit/vleftësimit?	18	51	0	0	26%	74%	0%	0%
13c	A komunikoni <i>disa herë</i> me klientin tuaj, përpara seancës së verifikimit/vleftësimit?	2	67	0	0	3%	97%	0%	0%
13d	A komunikoni <i>rrallë</i> me klientin tuaj, përpara seancës së verifikimit/vleftësimit?	2	67	0	0	3%	97%	0%	0%
13e	Nuk komunikoni <i>asnjëherë</i> me klientin tuaj përpara seancës së verifikimit/vleftësimit?	2	67	0	0	3%	97%	0%	0%
14a	Në ç'vend komunikoni: <i>në qendrën e paraburgimit?</i>	38	9	19	3	55%	13%	28%	4%

Nr.	Pyetja	Po	Jo	P/J	J/P	Po	Jo	P/J	J/P
14b	Në ç'vend komunikoni: <i>në gjykatë?</i>	9	38	19	3	13%	55%	28%	4%
16a	A ka ndodhur që nuk ju kanë lejuar?	30	36	1	2	43%	52%	1%	3%
17a	A keni mundësi të flisni vetëm për vetëm me klientin tuaj?	60	4	2	3	87%	6%	3%	4%
18	A ka kufizime në lidhje me takimin me klientët (kufizime në kohë)?	27	40	1	1	39%	58%	1%	1%
20	A njoftoheni paraprakisht për veprimet hetuese?	30	31	7	1	43%	45%	10%	1%
21a	A merrni <i>gjithmonë</i> pjesë në veprimet e tjera hetuese; dëgjimin e dëshmitarëve, hetimet në vendin e ngjarjes, etj.?	5	64	0	0	7%	93%	0%	0%
21b	A merrni pjesë <i>shumicën</i> <i>e rasteve</i> në veprimet e tjera hetuese; dëgjimin e dëshmitarëve, hetimet në vendin e ngjarjes, etj.?	14	55	0	0	20%	80%	0%	0%
21c	A merrni pjesë <i>disa</i> <i>herë</i> në veprimet e tjera hetuese; dëgjimin e dëshmitarëve, hetimet në vendin e ngjarjes, etj.?	18	51	0	0	26%	74%	0%	0%
21d	A merrni pjesë <i>rrallë</i> në veprimet e tjera hetuese; dëgjimin e dëshmitarëve, hetimet në vendin e ngjarjes, etj.?	13	56	0	0	19%	81%	0%	0%
21e	Nuk merrni <i>asnjëherë</i> pjesë në veprimet e tjera hetuese; dëgjimin e dëshmitarëve, hetimet në vendin e ngjarjes, etj.?	19	50	0	0	28%	72%	0%	0%
23	A ju lihet kohë e mjaftueshme për t'u njohur me çështjen përpara seancës kryesore?	55	10	4	0	80%	14%	6%	0%

## E drejta për një mbrojtje efektive; Shtojca 3

### Pyetja 10: Si siguroheni që nuk ka konflikt interesash?

Përgjigjet	Nr. i përgjigjeve	Përqindja
Pas shqyrtimit të dosjes	13	19%
Pas diskutimit me të pandehurin	10	14%
Pas shqyrtimit të dosjes dhe diskutimit me të pandehurin	6	9%
Zbatoj ligjin	5	7%
Bëhet e qartë gjatë hetimit paraprak	4	6%
Varet nëse i pandehuri e pranon apo jo akuzën	3	4%
Varet nga çështja	1	1%
Shqyrtoj provat	1	1%
Pasi konsultohem dhe kërkoj leje nga të bashkëpandehurit	1	1%
J/P (avokati mbrojtës nuk ka përfaqësuar ndonjëherë të bashkëpandehur)	25	36%

### Pyetja 11: Kur e takoni për herë të parë klientin e paraburgosur dhe në çfarë mënyre (me telefon, takim personal)?

Përgjigjet	Nr. i përgjigjeve	Përqindja
Takim personal	38	55%
Me telefon	1	-
Takim personal në qendrën e paraburgimit	10	14%
Pasi i pandehuri është njohur me akuzën	7	10%
Pas arrestimit/ndalimit	6	7%
Disa orë përpara seancës së verifikimit/vleftësimit	1	-
Pas seancës së verifikimit/vleftësimit	6	7%

### Pyetja 15: Çfarë duhet të bëni për të komunikuar me klientin tuaj që ndodhet në dhomat e shoqërimit apo në dhomat e paraburgimit (p.sh. leje nga prokuroria apo gjykata)

Përgjigjet	Nr. i përgjigjeve	Përqindja
Autorizim nga prokurori	37	54%
Autorizim nga prokurori dhe gjykata	2	3%
Prokurë dhe autorizim nga prokuroria	6	7%
Prokurë	3	4%
Asnjë leje, thjesht licencë nga Dhoma e Avokatisë	12	17%



Përgjigjet	Nr. i përgjigjeve	Përqindja
Ne nuk na lejohen takimet	2	3%
J/P	2	3%

**Pyetja 16b: Pse nuk u lejohet komunikimi drejtpërdrejtë me të arrestuarin/ ndaluarin?**

Përgjigjet	Nr. i përgjigjeve	Përqindja
Për arsye të paligjshme	8	12%
Hyrja ndalohet nga policët	5	7%
Hyrja ndalohet gjatë pushimeve/fundjavave	3	4%
Hyrja ndalohet kur policia është në gatishmëri	2	3%
Hyrja ndalohet kur policia po e merr në pyetje të arrestuarin	2	3%
Hyrja ndalohet nëse nuk ke autorizim nga prokuroria/ gjykata	2	3%
Hyrja ndalohet sepse personeli i burgut dhe policët nuk e njohin ligjin	1	1%
Hyrja ndalohet sepse nuk mund ta takosh klientin tënd përpara seancës së verifikimit vleftësimit	1	1%
Hyrja ndalohet kur konsiderohet se avokati mund të pengojë në ecurinë e hetimeve	1	1%
Hyrja ndalohet kur ka trazira në qendrën e paraburgimit	1	1%
Hyrja ndalohet kur ka kaluar orari i takimit me klientin	1	1%
Hyrja ndalohet pas orës 15:00	1	1%
Hyrja ndalohet deri në identifikimin e të pandehurit	1	1%
Hyrja ndalohet për arsye personale	1	1%
J/P (avokati mbrojtës ka gjithmonë mundësi për të hyrë)	39	57%

**Pyetja 18: A ka kufizime të tjera për të takuar klientin (kufizime në kohë)?**

Përgjigjet	Nr. i përgjigjeve	Përqindja
Ka kufizime në kohë	9	13%
Takimet mund të bëhen vetëm nga ora 08:30 deri në 13/14/15:00. Pas këtij orari si dhe gjatë fundjavës, nuk lejohet hyrja	8	12%
Ndonjëherë ka kufizime në kohë	3	4%

Përgjigjet	Nr. i përgjigjeve	Përqindja
Takimet nuk mund të zgjasin më tepër se 30 minuta	2	3%
Kemi vështirësi me policinë	2	3%
Hyrja ndalohej gjatë orarit të pastrimit dhe gjatë vakteve	1	1%
Hyrja ndalohej kur policia është duke kryer veprime të ndryshme	1	1%
J/P (avokatit mbrojtës nuk i është vënë ndonjë kufizim)	43	62%

### Pyetja 19: Sa zgjasin normalisht komunikimet me klientin?

Përgjigjet	Nr. i përgjigjeve	Përqindja
0 – 15 minuta	7	10%
15-30 minuta	14	20%
30-45 minuta	3	4%
45-60 minuta	3	4%
30-60 minuta	14	20%
1-2 orë	5	7%
Varet nga çështja	17	24%
Nuk ka kufizime	6	9%

### Pyetja 22: Sa herë e takoni klientin tuaj përpara seancës gjyqësore?

Përgjigjet	Nr. i përgjigjeve	Përqindja
Varet nga çështja	19	28%
Sa herë që e gjykoj të nevojshme	15	22%
1-2 herë	8	12%
Disa herë	8	12%
2-3 herë	6	9%
3-4 herë	4	6%
Të paktën 1 herë	2	3%
Një herë në 10 ditë	2	3%
Sa herë që e kërkon klienti	2	3%
5-6 herë	1	1%
Një herë në javë	1	1%
Varet nga leja e policisë	1	1%

## E drejta për një mbrojtje efektive; Shtojca 4

<b>Tarifat e shpërblimit për avokatët e caktuar nga shteti</b>
<p><b>Durrës</b> <i>Kryetari i Gjykatës së Rrethit</i> Tarifat për avokatët e caktuar nga shteti janë të bazuara vetëm në Rregulloren e vitit 1996. Gjykata është në dijeni të një urdhri të përbashkët të vitit 2005, por tarifat e përcaktuara në këtë urdhër nuk mund të aplikohen për shkak të buxhetit shumë të kufizuar të gjykatës. Avokatët ngurrojnë të marrin përsipër çështje të caktuara nga shteti.</p> <p><i>Kryetari i Dhomës së Avokatisë Durrës</i> Gjykata zbaton rregulloren e vitit 1996. Avokatët mbrojtës preferojnë të mos marrin përsipër çështje të paguara nga shteti për shkak të vështirësive për t'u paguar. Gjykata e vonon kaq shumë pagesën, sa që avokatët heqin dorë nga marrja e pagesës.</p>
<p><b>Gjirokastrë</b> <i>Zyra e financës në Gjykatën e Rrethit</i> Si bazë për llogaritjen e tarifave për avokatët e caktuar nga shteti janë Rregullorja e vitit 1996 dhe Udhëzimi i vitit 2006 i Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor. Urdhri i përbashkët i vitit 2005 nuk zbatohet. Avokatët paguhën në bazë të Udhëzimit të vitit 2006.</p> <p><i>Anëtarë të Dhomës së Avokatisë së Gjirokastrës</i> <u>Anëtari 1</u> pranon me shumë zor çështje të caktuara nga shteti për shkak të pagesës shumë të ulët. Për më tepër, anëtarët e Dhomës së Avokatisë së Gjirokastrës kanë rënë dakord të mos pranojnë çështje të caktuara nga shteti, pasi në Gjykatën e Rrethit Gjirokastrë nuk zbatohet urdhri i përbashkët i vitit 2005.</p> <p><u>Anëtari 2</u> pranon çështje të caktuara nga shteti. Deri në janar të vitit 2006, ky anëtar paguhej sipas Rregullosës së vitit 1996. Që në shkurt të po këtij viti ky anëtar është paguar sipas Udhëzimit të vitit 2006. Ky avokat është paguar pa asnjë vonesë. Sipas këtij anëtari, Urdhri i përbashkët është firmosur vetëm “për të kënaqur egon e zyrtarëve të lartë, por pa pasur asnjë mundësi zbatimi”.</p>
<p><b>Korçë</b> <i>Kryetari i Gjykatës së Rrethit</i> Pavarësisht Urdhrit të përbashkët të vitit 2005, gjykata zbaton vetëm Rregulloren e vitit 1996. Për shkak të buxhetit të kufizuar, avokatët e caktuar nga shteti paguhën vetëm 5 000 lekë për çështje. Gjatë vitit 2005, avokatët e caktuar nga shteti u paguan për 30 çështje nga një total prej 80 çështjesh.</p> <p><i>Anëtarë të Dhomës së Avokatisë së Korçës</i> <u>Anëtari 1</u> është njoftuar nga Gjykata e Rrethit që avokatët e caktuar nga shteti do të paguhën 5 000 lekë për çështje gjatë vitit 2006. Pagesa do të bëhet vetëm në fund të vitit 2006.</p>

Anëtari 2 deklaroi se në Gjykatën e Rrethit Kolonjë, tarifën për avokatët e caktuar nga shteti llogariten në bazë të Urdhrit të përbashkët dhe paguhen në fund të çdo procesi gjyqësor, ndërsa avokatët e caktuar nga shteti në Gjykatën e Rrethit Korçë paguhen 5 000 lekë për çështje në fund të vitit. Llogaritja bëhet në bazë të numrit të seancave në të cilat ka marrë pjesë avokati.

### **Kukës**

#### *Kancelari i Gjykatës së Rrethit*

Si bazë për llogaritjen e tarifave për avokatët e caktuar nga shteti janë Rregullorja e vitit 1996 dhe Udhëzimi i vitit 2006 i Zyrës së Administrimit Buxhetit Gjyqësor. Gjykata rrallë cakton avokatë mbrojtës, por kur cakton pagesa është 5 000 lekë për çështje.

#### *Anëtarë të Dhomës së Avokatisë Kukës*

Anëtari 1: Tarifën bazohen në Rregulloren e vitit 1996. Për çështjet e caktuara nga shteti anëtari merr 3 000 lekë për të përfaqësuar një të pandehur të akuzuar për një vepër penale dhe 2 000 lekë për të përfaqësuar një të pandehur të akuzuar për kundërvajtje penale. Anëtari nuk e ka marrë Urdhrin e përbashkët të vitit 2005.

Anëtari 2: Për çështje të caktuara nga gjykata, anëtari paguhet 1 000 - 3 000 lekë. Pagesa vonohet gjithmonë me pretendimin se nuk ka fonde. Gjatë vitit 2005, ky avokat u caktua 30 herë nga gjykata e rrethit Kukës, por u pagua vetëm për 10 çështje. Për çështjet e caktuara nga prokuroria dhe kur i pandehuri gjykohet në mungesë, avokatët nuk paguhen fare. Anëtari nuk është në dijeni të Urdhrit të përbashkët të vitit 2005.

### **Shkodër**

#### *Kryetari i komanduar i gjykatës së rrethit*

Pagesa për avokatët e caktuar nga shteti bazohet në Urdhrin e përbashkët të vitit 2005, por mund të jetë që ata nuk marrin minimumin e përcaktuar në Urdhrin e përbashkët. Sidoqoftë, deri tani nuk ka pasur ankesa. Për shkak se një pjesë e buxhetit të gjykatës shpenzohet për pagesën e dietave të gjyqtarëve, karburant për gjeneratorin dhe fatura të telefonit, fondet për pagesën e avokatëve të caktuar nga shteti janë të kufizuara.

#### *Anëtar i Dhomës së Avokatisë Shkodër*

Baza për llogaritjen e tarifave të avokatëve të caktuar nga shteti është Urdhri i përbashkët i vitit 2005, por avokatët nuk paguhen në bazë të këtij Urdhri. Për t'u paguar si avokat i caktuar nga shteti, duhet të paguash taksa, gjë që e bëjnë vetëm avokatët me pozitë të fortë. Kështu, avokatët me më pak eksperiencë marrin çështje të caktuara nga shteti për të fituar përvojë dhe për t'u bërë të njohur, por nuk paguhen fare.

### **Tiranë**

#### *Kryetari i Gjykatës së Rrethit*<sup>547</sup>

Tarifën për avokatët e caktuar nga shteti bazohen kryesisht në rregulloren e vitit 1996. Pas përfundimit të çështjes, gjyqtari vërteton shumën që i duhet paguar avokatit në varësi të numrit të seancave dhe llojit të çështjes.

<sup>547</sup> Letër nga Kryetari i Gjykatës së Rrethit Tiranë, Albert Meçe, 2 qershor 2006.

**Vlorë***Zyra e Financës në Gjykatën e Rrethit*

Si bazë për llogaritjen e tarifave për avokatët e caktuar nga shteti janë Rregullorja e vitit 1996 dhe Udhëzimi i vitit 2006 i Zyrës së Buxhetit të Administrimit Gjyqësor. Urdhri i përbashkët i vitit 2005 do të ishte vështirë të zbatohet. Për arsye se tarifat për avokatët e caktuar nga shteti buxhetohen si kosto operative dhe se buxheti për avokatët e caktuar nga shteti është i reduktuar, avokatët paguheshin vetëm nëse mbeten fonde dhe pasi janë paguar të gjitha kostot e tjera operative. Nëse paguheshin, avokatët marrin 2 000 lekë për çështje. Kështu, nga viti 2004 deri në 2006, nuk janë shpenzuar më tepër se 170 000 lekë për të paguar avokatët mbrojtës që punojnë në Gjykatën e Rrethit Vlorë.

*Kryetari dhe anëtar i Dhomës së Avokatisë Vlorë*

Tarifat që u paguheshin avokatëve të caktuar nga shteti, janë të parregullta dhe kanë ardhur duke u ulur gradualisht që nga viti 1999. Në vitin 1999 ata paguheshin 5 000 lekë për deri në tri seanca, në vitet 1999-2000 ata janë paguar 3 000 lekë deri në tri seanca, ndërsa nga viti 2003 kjo tarifë është ulur në 2 000 lekë deri në dy seanca dhe 1 000 nëse ka vetëm një seancë. Llogaritja bazohet në Rregulloren e vitit 1996. Që nga viti 2004, ata nuk janë paguar aspak dhe për pasojë vazhdojnë të refuzojnë gjithnjë e më tepër marrjen përsipër të çështjeve të caktuara nga shteti.

**Disa shembuj të tjerë<sup>548</sup>**

Avokati mbrojtës 3: Kur caktohem nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, shumicën e rasteve nuk paguhem. Prokuroria gjithashtu lëshon pagesat për çështje jo për klient. Unë nuk e di se si bëhen llogaritjet dhe gjykata nuk e sqaron një gjë të tillë. Ndonjëherë paguhem 3 000 lekë, herë të tjera 4 000 lekë dhe disa herë jo më shumë se 1 500 lekë. Me të tilla tarifa nuk mund të mbijetohet dhe të gjithë avokatët e caktuar nga shteti kërkojnë pagesë shtesë nga të pandehurit. Për t'i lehtësuar gjërat ne i këshillojmë të pandehurit t'u thonë gjykatës se ata nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare.

Avokati mbrojtës 4: Kur caktohem nga shteti duhet që të paguhemi sipas tarifave të miratuara nga Ministria e Drejtësisë por në fakt nuk paguhemi sipas këtyre tarifave.

Avokati mbrojtës 5: Kur caktohem nga prokuroria nuk paguhemi fare, ndërsa kur caktohem nga gjykata paguhemi me një vit vonesë.

<sup>548</sup> Deklarimi i avokatit mbrojtës 3 është marrë nga një intervistë e bërë më 29 mars 2006 ndërsa deklaratat e avokatëve mbrojtës 4 dhe 5 janë cituar nga anketimi i avokatëve mbrojtës.

## Dhuna në familje; Shtojca 1

### Vendime gjyqësore për dhunën në familje

Nr. <sup>549</sup>	Vepra (KP)	I dëmtuari akuzues		Provat	I pa-ndehuri pranon akuzën	Deklarohet fajtor	Gjykim i shkurtuar ⇒ ulje dënimi 1/3	Masa e dënimit/ Masa pas uljes së dënimit Vit (V) Muaj (M) Ditë (D)	Rrethana lehtësuese (L)	
		Ankim në gjykatë	Ankim në gjykatë						Rrethana rënduese (R)	Komente (K)
1.	84 <sup>550</sup> dhe 278/2 <sup>551</sup>	Jo	Jo	Proces verbal (p-v) i sekuestrim (sek.) të armës; p-v i kontrollit të banesës; ekspertim teknik i armës; p-v i arrestimit.	Po	Po	Po	Burgim (Burg.): 10 M/ 6 M, 20 D	L: Pendim i thellë; Motivet shoqërore në kryerjen e aktit kriminal lidhen me vetë familjen e të pandehurit.	R: Krimi është kryer duke përdorur armë.
2.	112/2	Jo	Jo	Thëniet e të pandehurit ku pranon akuzën; p-v i kallëzimit; p-v i kqyrjes së vendit të ngjarjes (KVN).	Po	Po	Po	Gjohë <sup>552</sup> 60 000/ 40 000	L: Pendim i thellë.	K: Cilësimi juridik i veprës ka ndryshuar, nga neni 84 në nenin 112.

\*Shënim: Masa e dënimit për veprën e kryer është kombinuar me masën e dënimit pas gjyimit të shkurtuar.

Nr.	Vepra (KP)	I dëmtuari akuzues		Provat	I pandehuri pranon akuzën	Deklarohet fajtor	Gjykim i shkurtuar => ulje dënimi 1/3	Masa e dënimit/ Masa pas uljes së dënimit Vit (V) Muaj (M) Ditë (D)	Rrethana lehtësuese (L)	
		Ankim në gjykatë							Rrethana rënduese (R)	Komente (K)
3.	76 <sup>553</sup> -22 <sup>554</sup>	Jo		Thëniet e të pandehurit ku pranon akuzën; p-v KVN; p-v i sek. të provave materiale; ekspertim mjeko-ligjor; ekspertim balistik.	Po	Po	Po	Burg.: 8 V/5 V, 4 M		L: Pendim i thellë; I pandehuri ka qenë i dehur.
4.	84	Jo		Deklarime të të dëmtuarës; deklaramet e dëshmitarëve.	Jo	Po	Jo	Gjorbë: 50 000		L: I pandehuri nuk ka qenë i dënuar më parë.
5.	84	Jo		Dëshmi e të dëmtuarës; p-v i arrestit në flagrancë; p-v i kapjes në flagrancë; p-v i sek. të provave; ekspertim mjeko-ligjor.	Po	Po	Jo	Gjorbë: 50 000		L: I pandehuri ka qenë i dehur.
6.	89 <sup>555</sup>	Jo Po		P-v i kallëzimit të krimit; p-v i deklarameteve të të dëmtuarës; ekspertim mjeko-ligjor.	Po	Po	Po	Gjorbë: 60 000/ 40 000		L: Pendim i thellë.

Nr.	Vepra (KP)	I dëmtuari akuzues		Provat	I pandehuri pranon akuzën	Deklarohet fajtor	Gjykim i shkurtuar => ulje dënimi 1/3	Masa e dënimit/ Masa pas uljes së dënimit Vit (V) Muaj (M) Ditë (D)	Rrethana lehtësuese (L)	
		Ankim në gjykatë							Rrethana rënduese (R)	
7.	84 dhe 90/2 <sup>556</sup>	Jo		Deklarime të disa dëshmitarëve; ekspertim mjekoligjor, p-v i kallzimit në polici.	Po	Po	Po	Gjorbë: 150 000/ 100 000	L: Pendim i thellë; I pandehuri nuk ka qenë i dënuar më parë.	
8.	84	Jo		Shpjegime të të dëmtuarës; deklaratimet e dëshmitarëve; ekspertim mjekoligjor; pohimet e të pandehurit.	Po	Po	Po	Burg.: 3 M, 24 D*	L: Pendim i thellë; I pandehuri ka zëvendësuar dëmin e shkaktuar nga vepra <sup>557</sup> ; I pandehuri është paraqitur në polici. <sup>558</sup>	R: I dënuar më parë.
9.	90	Po		Ekspertim mjekoligjor; pohimi i të pandehurit.	Po	Po	Po	Gjorbë: 50 000/ 33 334	L: Pendim i thellë.	
10.	89	Jo Po		“I pandehuri e pranon akuzën, e cila provohet dhe nga tërësia e provave shkresore të ndodhura në fashikullin e gjykimit.”	Po	Po	Po	Gjorbë: 60 000/ 40 000		



Nr.	Vepra (KP)	I dëm-tuari akuzues		Provat	I pa-ndehuri pranon akuzën	Dekla-rohet fajtor	Gjykim i shkurtuar => ulje dënimi 1/3	Masa e dënimit/ Masa pas uljes së dënimit Vit (V) Muaj (M) Ditë (D)	Rrethana lehtësuese (L)	
		Ankim në gjykatë	Ankim në gjykatë						Rrethana rënduese (R)	Komente (K)
11.	84	Jo	Jo	Deklarime të dëshmitarëve; p-v i sek. të provës materiale; ekspertim teknik.	Po	Po	Po	Burg.: 5 M, 20 D*	L: Pendim i thellë; Marrëdhëniet ndërmjet palëve janë normalizuar <sup>559</sup> .	
12.	84	Jo	Jo	P-v i kallëzimit të të dëmtuarës; p-v i deklarimit të dëshmitarëve; pohimi i të pandehurit.	Po	Po	Po	Burg.: 3 M/2 M => 18 M pezulluar ekzekutimi i dënimit (e.d.)	L: Pendim i thellë; Gjendja familjare.	
13.	84	Jo	Jo	P-v i kallëzimit të krimi, deklarime të dëshmitares.	Po	Po	Jo	Burg.: 3 M=> 2 V pezulluar (e.d.)	L: Pendim i thellë; Marrëdhëniet ndërmjet palëve janë normalizuar; Gjendja familjare.	
14.	84	Jo	Jo	Pohimi i të pandehurit.	Po	Po	Po	Gjobë: 110 000/ 75 000	L: Pendim i thellë.	

Nr.	Vepra (KP)	I dëmtuari akuzues		Provat	I pa-ndehuri pranon akuzën	Deklarohet fajtor	Gjykim i shkurtuar ⇒ ulje dënimi 1/3	Masa e dënimit/ Masa pas uljes së dënimit Vit (V) Muaj (M) Ditë (D)	Rrethana lehtësuese (L)		Rrethana rënduese (R)	
		Ankim në gjykatë	Ankim në gjykatë						Komente (K)	Komente (K)		
15.	90	Po	Po	Deponimet e të dëmtuarës; deponimet e dëshmitarit; ekspertim mjekoligjor.	Jo	Po	Jo	Gjorbë: 50 000	L: Vendimi thotë: “Në caktimin e masës së dënimit, gjykata ka parasysh, rrezikshmërinë e vogël të personit, faktin se janë bashkëshortë, [560] kanë një fëmijë, i padënuar më parë, intelektual, etj.”			
16.	112/1 <sup>561</sup> dhe 90/1	Po	Po		Jo	Jo	-	-	K: Çështja është pushuar për mungesë provash bindëse. E dëmtuara nuk ka bërë ekzaminim mjekësor.			
17.	76-22	Jo	Jo	P-v dhe foto nga KVN; p-v i sek. të provës materiale; ekspertim mjekoligjor.	Po	Po	Po	Burg: 5 V/3 V, 4 M	L: Pendim i thellë; I pandehuri është paraqitur në polici.		R: Vepra është e përhapur	
18.	89	Jo	Po	Pohimi i të pandehurit; ekspertim mjekoligjor; deklaratimet e shtetasve të ndodhura në fashikullin e gjykimit.	Po	Po	Po	Burg: 6 M/4 M ⇒ 18 M pezulluar (e.d.)	L: Pendim i thellë.		R: I dënuar më parë.	

Nr.	Vepra (KP)	I dëmtuari akuzues		Provat	I pa-ndehuri pranon akuzën	Deklarohet fajtor	Gjykim i shkurtuar => ulje dënimi 1/3	Masa e dënimit/ Masa pas uljes së dënimit Vit (V) Muaj (M) Ditë (D)	Rrethana lehtësuese (L)	
		Ankim në gjykatë	Ankim në gjykatë						Rrethana rënduese (R)	Komente (K)
19.	84 dhe 278/3 <sup>56</sup>	Jo	Jo	Deklarime të dëshmitarëve; p-v të arrestit në flagrancë; ekspertim teknik; aktet e fashikullit të hetimit.	Po	Po	Po	Burg.: 2 M, 15 D/ 1 M, 20 D	L: Pendim i thellë; I pandehuri ka zëvendësuar dëmin e shkaktuar nga vepra; I pandehuri është paraqitur në polici; Marrëdhëniet ndërmjet palëve janë normalizuar.	
20.	84	Jo	Jo	P-v i pyetjes së të dëmtuarës dhe dëshmitarëve; aktet e fashikullit të procedimit penal.	Jo	Po	Jo	Burg.: 1 M	L: Neni 48 dhe 49 i KP R: Dënuar më parë.	
21.	76-22	Jo	Jo	Ekspertim mjekoligjor; tabelë fotografike e plagëve të të dëmtuarës, kqyrja e të dëmtuarës; deklaratimet e dëshmitarëve.	Po	Po	Jo	Burg.: 8 V	L: Pendim i thellë.	

Nr.	Vepra (KP)	I dëm-tuari akuzues		Provat	I pa-ndehuri pranon akuzën	Dekla-rohet fajtor	Gjykim i shkurtuar => ulje dënimi 1/3	Masa e dënimit/ Masa pas uljes së dënimit Vit (V) Muaj (M) Ditë (D)	Rrethana lehtësuese (L)	
		Ankim në gjykatë							Rrethana rënduese (R)	Komente (K)
22.	76	Jo		Ekspertim mjeko-ligjor; p-v i sek. të provave materiale, ekspertim toksikologjik; p-v të përgjimeve të kryera në polici; deklarimet e dëshmitarëve; pohimi i të pandehurit.	Po	Po	Po	Burg.: 12 V/ 8 V	L: Pendimi.	K: <b>Personi i pandehur është femër.</b>
23.	84 & 278/2	Jo		P-v i deklarimeve të të dëmtuarës; p-v i kallëzimit të krimit; p-v i sek. të provave materiale; ekspertim teknik.	Po	Po	Po	Burg.: 15 M/ 10 M	L: Pendim i thellë; Marrëdhëniet ndërmjet palëve janë normalizuar; I pandehuri ishte i dehur.	R: Armëbajtja pa leje, vepër e përhapur.

Nr.	Vepra (KP)	I dëmtuari akuzues		Provat	I pandehuri pranon akuzën	Deklarohet fajtor	Gjykim i shkurtuar => ulje dënimi 1/3	Masa e dënimit/ Masa pas uljes së dënimit Vit (V) Muaj (M) Ditë (D)	Rrethana lehtësuese (L)
		Ankim në gjykatë	Komente (K)						
24.	90	Po	Po		?	Jo			K: E dëmtuara akuzuese ka tërhequr akuzën, çështja është pushuar.
25.	84 dhe 119/1 <sup>563</sup>	Jo	Jo	P-v i sek. të provave materiale; akt ekspertimi grafik.	Po	Po	Gjobë: 90 000/ 60 000		L: Pendim i thellë; Gjendja ekonomike, arsimore, shoqërore, familjare e të pandehurit. R: Vepër e përhapur.
26.	85 <sup>564</sup>	Jo	Jo	Ekspertim tekniko-balistik; ekspertim mjeko-ligjor; ekspertim psikiatriko-ligjor; p-v i KVN.	Po	Po	Burg.: 2 Y, 3 M / 1 Y, 6 M		L: Pendim: I pandehuri është punonjës policie; Gjendja e veshitë ekonomike dhe shoqërore e familjes.
27.	82 <sup>565</sup> dhe 278/2	Jo	Jo	Ekspertim tekniko-kimik; p-v dhe tabela fotografike e KVN; p-v i sek. të provave materiale; ekspertim balistik; ekspertim psikiatriko-ligjor.	Po	Po	Burg.: 4 V, 6 M / 3 V		L: Gjendja e veshitë ekonomike e familjes; E pandehura është nënë e një fëmije të porsalindur. K: Personi i pandehur është femër.

Nr.	Vepra (KP)	I dëmtuari akuzues		Provat	I pandehuri pranon akuzën	Deklarohet fajtor	Gjykim i shkurtuar => ulje dënimi 1/3	Masa e dënimit/ Masa pas uljes së dënimit Vit (V) Muaj (M) Ditë (D)	Rrethana lehtësuese (L)	
		Ankim në gjykatë							Rrethana rënduese (R)	Komente (K)
28.	88/1 <sup>566</sup> dhe 278/2	Jo		P-v i KVN; ekspertim teknik i armës; ekspertim mjekoligjor; ekspertim psikiatriko-ligjor; deklarime të të pandehurit dhe dëshmitarëve.	Po	Po	Jo	Burg.: 6 V	L: Pendim; Marrëdhëniet ndërmjet palëve janë normalizuar. R: Vepër e përhapur.	K: Gjykatata ka ndryshuar cilësimin juridik të veprës nga neni 76-22 (vrasje e mbetur në tentativë) në nenin 88/1, me arsyetimin se dashja për kryerjen e vrasjes nuk provohet. <sup>567</sup>
29.	84 dhe 278/2	Jo		Provat që implikojnë të pandehurin nuk janë analizuar.	Po	Po	Jo	B.: 1 V => 8 M, 12 D pezulluar (e.d.)	L: Marrëdhëniet ndërmjet palëve janë normalizuar; Pendim i thellë; Gjendja e vështirë ekonomike e familjes; I pandehuri ka qenë i dehur. R: Kanosje në sy të fëmijëve.	
30.	89	Jo		Deklarime të dëshmitarëve.	Jo	Po	Jo	Burg.: 5 M	K: Në apel, i pandehuri u deklarua fajtor për dënime të tjera me dashje, neni 90/2 i KP.	
31.	76	Jo		P-v dhe foto të KVN; p-v i kqyerjes së kufomës; ekspertim mjeko-ligjor; pohimi i të pandehurit.	Po	Po	Po	Burg.: 15 V / 10 V	L: Pendim; I pandehuri u paraqit në polici; I pandehuri nuk e mban mend krimin për shkak të uljes së ekuilibrit mendor; Gjendja e rëndë ekonomike. R: Dënuar më parë.	

Nr.	Vepra (KP)	I dëmtuari akuzues		Provat	I pa-ndehuri pranon akuzën	Deklarohet fajtor	Gjykim i shkurtuar => ulje dënimi 1/3	Masa e dënimit/ Masa pas uljes së dënimit Vit (V) Muaj (M) Ditë (D)	Rrethana lehtësuese (L)	
		Ankim në gjykatë	Ankim në gjykatë						Rrethana rënduese (R)	Komente (K)
32.	76-22 dhe 278/2	Jo	Jo	P-v i KVN; ekspertim balistik; ekspertim mjeko ligjor; deklarime të dëshmitarëve.	Po	Po	Po	Burg.: 6 V/ 4 V	L: Pranon fajin; Pendim i thellë; Gjendja shëndetësore e të pandehurit; Marrëdhëniet ndërmjet palëve janë normalizuar.	
33.	88/1	Jo	Jo	Vendimi nuk përshkruan ngjarjen.	Po	Po	Po	Burg.: 3 V/ 2 V	K: <b>Personi i pandehur është femër.</b>	
34.	83 <sup>568</sup> dhe 278/2	Jo	Jo	P-v i kqyerjes së kufomës; ekspertim psikiatriko-ligjor; p-v i sek. të armës; p-v i KVN.	Po	Po	Jo	Burg.: 5 V => 5 V pezulluar (e.d.)	L: Krimi është kryer nga provokimi/ veprime të padrejta të viktimës <sup>569</sup> ; Pendim; Marrëdhëniet ndërmjet të pandehurës dhe familjes së viktimës janë normalizuar; Nënë e shtatë fëmijëve; Gjendja e vështirë ekonomike. K: Gjykata ka ndryshuar cilësimin juridik të veprës nga neni 76 (vrasje) në nenin 83; <b>Personi i pandehur është femër.</b>	

Nr.	Vepra (KP)	I dëmtuari akuzues		Provat	I pa-ndehuri pranon akuzën	Deklarohet fajtor	Gjykim i shkurtuar ⇒ ulje dënimi 1/3	Masa e dënimit/ Masa pas uljes së dënimit Vit (V) Muaj (M) Ditë (D)	Rrethana lehtësuese (L)	
		Ankim në gjykatë	Jo						Rrethana rënduese (R)	
									Komente (K)	
35.	84 dhe 278/2	Jo	Jo	Ekspertim teknik i armës; deklarime të dëshmitarëve; p-v i kontrollit të banesës.	Po	Po	Po	Burg.: 1V, 6M/ 1V	L: Shëndeti i të pandehurit; Gjendja ekonomike e veshurë e të pandehurit.	
36.	84 dhe 278/2	Jo	Jo	P-v i kallëzimit të krimt; ekspertim teknik i municionit; akte të tjera të përshtira në dosjen e prokurorisë.	Po	Po	Po	Burg.: 7M/ 4M, 20D	R: Krimi në familje është përhapur; Grindje të vazhdueshme.	
37.	76 dhe 278/4 <sup>570</sup>	Jo	Jo	Ekspertim balistik; ekspertim mjekoligjor; ekspertim teknik; deklarime të dëshmitarëve; p-v dhe foto të KV/N; p-v i kqyrjes së kufomës; p-v i sek. të provave materiale.	Po	Po	Po	Burg.: 15V/ 10V	L: Pendim i thellë; I pandehuri u dorëzua në polici; I pandehuri ka qenë i dehur.	
38.	84 dhe 89	Jo	Jo	Ekspertim mjekoligjor; pohimi i të pandehurit	Po	Po	Po	Burg.: 3M/ 2M	L: Pendim i thellë.	
39.	84	Jo	Jo	Pohimi i të pandehurit; p-v i sek. të provave materiale; vendim për vlerësimin e provës materiale të sekuestruar; deklarime të dëshmitarëve; akte të ndodhura në dosjen e prokurorisë.	Po	Po	Po	Burg.: 1V/ 8M		



Nr.	Vepra (KP)	I dëmtuari akuzues		Provat	I pandehuri pranon akuzën	Deklarohet fajtor	Gjykim i shkurtuar => ulje dënimi 1/3	Masa e dënimit/ Masa pas uljes së dënimit Vit (V) Muaj (M) Ditë (D)	Rrethana lehtësuese (L)	
		Ankim në gjykatë							Rrethana rënduese (R)	Komente (K)
40.	82	Jo		P-v dhe foto të KVN; p-v i kqytjes së kufomës; ekspertim mjeko-ligjor, ekspertim psikiatriko-ligjor; pohimi i të pandehurit; deklarime të dëshmitarëve.	Po	Po	Jo	Burg.: 10 V	L: Pendim i thellë.	
									R: Vepër e përhapur.	

<sup>549</sup> Nr. 1-23: Gjykata e rrethit (GjRr.) Tiranë, Nr. 24: GjRr Vlorë; Nr. 25: GjRr Kukës; Nr. 26-38: GjRr Shkodër; Nr. 9: GjRr Fier; Nr. 40: GjRr Durrës.

<sup>550</sup> Kanosje.

<sup>551</sup> Armëmbajtje pa leje.

<sup>552</sup> Gjobat janë në lekë.

<sup>553</sup> Vrasje me dashje.

<sup>554</sup> Tentativë.

<sup>555</sup> Plagosje e lehtë me dashje.

<sup>556</sup> Rrahje.

<sup>557</sup> Neni 48/d i KP.

<sup>558</sup> Neni 48/dh i KP.

<sup>559</sup> Neni 48/e i KP.

<sup>560</sup> Në të vërtetë, fakti që e dëmtuara dhe i pandehuri ishin të ndarë përmendet në mënyrë të përsëritur në vendim.

<sup>561</sup> Neni 112 i Kodit Penal – Dhunim i banesës.

<sup>562</sup> Mbajtja e municionit luftarak pa leje të organeve kompetente shtetërore.

<sup>563</sup> Kanosje dhe fyerje.

<sup>564</sup> Vrasje nga pakuqdesia.

<sup>565</sup> Vrasje e kryer në gjendje të tronditjes të fortë psikike.

<sup>566</sup> Plagosje e rëndë me dashje.

<sup>567</sup> Megjithatë, në apel, i pandehuri u deklarua fajtor për vrasje të mbetur në tentativë dhe për armëmbajtje pa leje, siç ishte akuzuar në fillim. Masa e dënimit nuk ndryshoi.

<sup>568</sup> Vrasje e kryer me kapërcim të kufijve të veitëmbrojtjes së nevojshme.

<sup>569</sup> Neni 48/b i Kodit Penal.

<sup>570</sup> Prodhimi dhe mbajtja e armëve luftarake dhe e municionit pa leje, ka sjellë pasoja të rënda.

## Dhuna në familje; Shtojca 2

### Veprat penale tek vendimet gjyqësore lidhur me dhunën në familje

Tabela dhe grafiku i mëposhtëm tregojnë shpërndarjen e veprave penale tek 40 vendime gjyqësore lidhur me dhunën në familje, të cilat trajtohen nga ky studim.

#### *Veprat e kryera vetëm ose kombinuar me vepra të tjera penale në 40 çështjet që kanë të bëjnë me dhunën në familje*

Neni 76 – Vrasje me dashje; 3 çështje

Neni 76 dhe 22 – Vrasje e mbetur në tentativë; 4 çështje

Neni 82 – Vrasje e kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike; 1 çështje

Neni 84 – Kanosje (kundërvajtje penale) ; 18 çështje

Neni 88 – Plagosje e rëndë me dashje; 3 çështje

Neni 89 – Plagosje e lehtë me dashje; 5 çështje

Neni 90/1 – Dëmtime të tjera me dashje, rrahje si dhe çdo vepër tjetër dhune; 4 çështje

Neni 90/2 – Dëmtime të tjera me dashje, kur kanë shkaktuar paaftësi për punë deri në 9 ditë; 1 çështje

Neni 112/2 – Dhunim i banesës; 1 çështje

Neni 119 – Fyerje; 1 çështje

Neni 278 – Mbatje pa leje e armëve; 12 çështje

#### *Veprat e kryera në kombinim me armëmbajtje pa leje (12)*

3 çështje për vrasje me dashje (Neni 76 i Kodit Penal [KP])

2 në kombinim me armëmbajtje pa leje (Neni 278 i KP). Në një prej çështjeve, personi i pandehur ishte femër.

1 çështje për vrasje të kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike (Neni 82 i KP) e kombinuar me armëmbajtje pa leje (Neni 278 i KP). Personi i pandehur ishte femër.

4 çështje për vrasje të mbetur në tentativë (Neni 76 & 22 i KP)

1 e kombinuar me armëmbajtje pa leje (Neni 278 i KP)

18 çështje për kanosje (Neni 84 i KP)

6 të kombinuara me armëmbajtje pa leje (Neni 278 i KP). Në këto çështje, kanosjet janë kryer me armë

3 çështje për kanosje ishin të kombinuara me vepra të tjera; 1 - dëmtime të tjera me dashje; 1 - fyerje; 1 – plagosje e lehtë

3 çështje për plagosje të rëndë me dashje (Neni 88 i KP). Personi i pandehur ishte femër në 2 prej çështjeve.

2 të kombinuara me armëmbajtje pa leje (Neni 278 i KP)


#### *Veprat e kryera në kombinim me vepra të tjera penale (4)*

4 çështje për dëmtime të tjera me dashje (Neni 90/1 i KP)

1 e kombinuar me dhunim banese (Neni 112 i KP)

1 çështje për dëmtime të tjera me dashje (Neni 90/2 i KP) e kombinuar me kanosje (Neni 84 i KP)

1 çështje për fyerje (Neni 119 i KP) u krye në kombinim me kanosje (Neni 84 i KP)



**CIP Katologim në botim BK Tiranë**

Roos, Mari-Ann

Analizë e sistemit të drejtësisë penale në Shqipëri: raport i Programit për Zhvillimin e një Gjykimi të Drejtë / Mari-Ann Roos; përkth. Adriana Dervishaj, etj.; red. Frank Dalton, etj. - Tiranë: OSCE, 2006.

244 f. ; 24 cm.

Bibliogr.

ISBN 99943-926-5-4

343(496.5) (047)